AVOKATI I POPULLIT

RAPORTI VJETOR

Për veprimtarinë e institucionit të Avokatit të Popullit
Viti 2022

Adresa: Bulevardi: “Zhan D’Ark” Nr.2, Tiranë, Shqipëri

PËRMBAJTJA

Fjala përshëndetëse e Avokatit të Popullit

KREU 1
Kuadri ligjor dhe institucional

KREU II
Zbatimi i rezolutës së Kuvendit të RSH-së për vitin 2021 nga institucioni i Avokatit të Popullit

KREU III
Vlerësim i situatës së respektimit të të drejtave të njeriut nga administrata publike
3.1 Përmbledhje e veprimtarisë të seksioneve të institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2022
3.2 Të drejtat e personave të privuar nga liria
3.3 Respektimi i të drejtave të njeriut nga organet e Policisë së Shtetit
3.4 Parandalimi i dhunës dhe torturës
3.5 Respektimi i të drejtave të njeriut nga Prokuroria
3.6 E drejta për një proces të rregullt ligjor në sistemin gjyqësor
3.7 Ndihma juridike falas
3.8 Të drejtat e ish të dënuarve dhe përndjekurve politikë nga sistemi komunist
3.9 Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore civile dhe administrative
3.10 Respektimi i të drejtës së pronës
3.11 Rregullimi i marrëdhënieve të punës dhe respektimi i të drejtës për një proces të rregullt ligjor në procedurën administrative
3.12 Mbrojtja e konsumatorit
3.13 Respektimi i të drejtave që lidhen me pushtetin vendor
3.14 Mbrojtja dhe të drejtat e fëmijës
3.15 Respektimi i të drejtës për kujdes shëndetësor
3.16 Respektimi i të drejtës për arsimim
3.17 Respektimi i të drejtës për kujdes social
3.18 Respektimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuar
3.19 Barazia gjinore
3.20 Mbrojtja e të drejtave të komunitetit LGTBIQ
3.21 Të drejtat e minoriteteve (pakicave) kombëtare
3.22 Respektimi i të drejtave në fushën e sigurimeve shoqërore
3.23 Të drejtat e të moshuarve
3.24 E drejta për një mjedis të shëndetshëm

KREU 4
Angazhime të tjera institucionale
4.1 Studimi “Dhuna ndaj grave në politikë”
4.2 Raporti “Vlerësim mbi qasjen dhe përdorimin familjar të transfertave të mbrojtjes sociale”
4.3 Raporti i veçantë “Politikat e pensionit ushqimor, detyrimit për ushqim, për fëmijët”
4.4 Raporti veçantë “Vlerësimi i Ndikimit të të Drejtave të Fëmijëve (CRIA)”

4.5 Raporti i veçantë “Vlerësimi i ndikimit të ndryshimeve klimatike në të drejtat e fëmijëve në Shqipëri”
4.6 Monitorimi i institucioneve në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të Komitetit Europian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor dhe Degradues (CPT)
4.7 Opinione Amicus Curia në Gjykatën Kushtetuese
4.8 Kontributi i dhënë nga institucioni i Avokatit të Popullit, gjatë procesit të Reformës në Drejtësi
4.9 Monitorimi i pavarur i të drejtave të emigrantëve të huaj si dhe operacionet e përbashkëta me FRONTEX për rikthimin e shtetasve të parregullt nga vendet e BE-së
4.10 Konferenca vjetore

KREU 5
Bashkëpunimi
5.1Bashkëpunimi me institucionet e administratës publike dhe niveli i zbatimit të rekomandimeve të AP-së
5.2 Bashkëpunimi ndërkombëtar
5.3 Bashkëpunimi në kuadër të projekteve
5.4 Paraqitjet publike të Avokatit të Popullit në ushtrim të mandatit të tij promovues

KREU 6
Shërbimet mbështetëse
6.1 Menaxhimi i Burimeve Njerëzore dhe Administrative
6.2 Vështrim mbi të ardhurat dhe shpenzimet

KREU 7
Shifra dhe fakte në lidhje me ankesat dhe trajtimin e tyre

FJALA PËRSHËNDETËSE E AVOKATIT TË POPULLIT

Ndërsa ju prezantojmë Raportin Vjetor të Avokatit të Popullit të Shqipërisë, edhe këtë vit, mëtojmë ta shndërrojmë këtë hapësirë në një oaz reflektimi mbi rëndësinë e të drejtave të njeriut në shoqërinë tonë. Shqipëria, si shumë vende të tjera, mbetet një shoqëri në tranzicion në rrugën e saj të mundimshme nga totalitarizmi në demokraci. Ky tranzicion kërkon një ndryshim thelbësor e tërësor në mënyrën e të menduarit dhe sjelljen tonë si shoqëri. Ndërsa reformat ligjore ecin përpara me një ritëm të pëlqyeshëm, qasja e bazuar në të drejtat e njeriut nuk rezulton të ecë me të njëjtin ritëm.

Tranzicioni ynë ende i papërfunduar drejt demokracisë lyp që ne të përqafojmë parimet e të drejtave të njeriut, të dëgjojmë njëri-tjetrin dhe të punojmë së bashku drejt një qëllimi të përbashkët.

Nuk ka dëshmi më të qartë e të dukshme të efikasitetit dhe funksionalitetit të një demokracie sesa hapësira që ajo u jep më të disavantazhuarve dhe respekti që ajo tregon për ta. Një nga grupet shoqërore që nuk ka ende vendin dhe rolin që i takon në shoqëri janë edhe gratë. Si grua, nënë, motër, bijë, drejtuese e institucionit më të rëndësishëm të të drejtave të njeriut në vend, besoj se duhet shtuar vëmendja rreth çështjeve të barazisë efektive gjinore. Gjatë viteve, Shqipëria ka bërë përparim të dukshëm në fuqizimin e grave, pjesërisht falë Ligjit të vitit 2008 për Barazinë Gjinore në Shoqëri. Ky ligj krijoi një kornizë të fortë normative për barazinë midis grave dhe burrave, duke futur kuota gjinore në pozicionet vendimmarrëse të zgjedhura dhe të emëruara, duke krijuar një mekanizëm të barazisë gjinore në nivel qendror dhe lokal dhe duke përmirësuar mbledhjen e të dhënave të ndara sipas gjinisë. Megjithatë, zbatimi i këtij ligji nuk ka qenë plotësisht efektiv për disa faktorë.

Është e dukshme se ligji për Barazinë Gjinore ka vuajtur përgjatë këtyre viteve nga mungesa e zbatimit të dispozitave kundër diskriminimit, duke i lënë shumë gra të cilat përballen me diskriminim, pa garancitë ligjore që u takojnë.

Në këtë suazë, rishikimi i Ligjit për Barazinë Gjinore është një hap kritik drejt arritjes së barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave në Shqipëri. Katërmbëdhjetë vjet pas miratimit të tij, është koha për të reflektuar mbi efektivitetin e vazhdueshëm të Ligjit për Barazinë Gjinore në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të të gjitha grave dhe vajzave që jetojnë në Shqipëri.

Rishikimi i këtij ligji është përfshirë në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030, si një hap kyç për forcimin e promovimit të një shoqërie të barabartë dhe të drejtë gjinore. Avokati i Popullit duke qëndruar krah për krah e duke bashkëvepruar me aktorë të rëndësishëm në luftën për avancimin e të drejtave të njeriut, si OKB-ja në Shqipëri e cila ka paraqitur edhe një dokument me qëndrime dhe propozime konkrete për ligjin e ri, shpreson që së shpejti të fillojë një dialog i gjerë publik mbi nevojën e zhvillimit të mëtejshëm të barazisë gjinore.

Shqipëria duhet të sigurojë që legjislacioni i saj kombëtar për barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin të jetë plotësisht në përputhje me acquis të BE-së për barazinë gjinore.

Ne duhet të punojmë së bashku për të advokuar nevojën për vendosjen e kuotave gjinore në të gjithë sektorët si dhe për të promovuar përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e vazhdueshme të grave në jetën publike. Ne po ashtu kemi nevojë për sisteme efektive të llogaridhënies për mekanizmin e barazisë gjinore, mekanizma të qartë ankesash administrative dhe gjyqësore për të siguruar zbatimin e masave antidiskriminuese gjinore dhe lidhje sistematike me Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe kostot përkatëse për të lejuar investimet përkatëse.

Avokati i Popullit është plotësisht i përkushtuar për të mbështetur këtë proces e për të përshpejtuar përparimin mbi Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm në Shqipëri. Ne si institucion, me mbështetjen e UN Women do të shërbejmë duke nisur prej vitit 2023 si Feminicide Watch Center për të raportuar çdo vit në detaj në lidhje me këtë fenomen që është per fat të keq ende një plagë shoqërore botërore

Ne duhet të punojmë së bashku si shoqëri për të garantuar respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në mënyrë që demokracia të hedhë rrënjë të forta në Shqipëri.

Le të vazhdojmë të punojmë drejt një shoqërie ku të drejtat e njeriut dhe demokracia nuk janë thjesht ideale utopike, por realitet për të gjithë shqiptarët.

KREU 1

Kuadri ligjor dhe institucional

Institucioni i Avokatit të Popullit funksionon sipas Kushtetutës dhe ligjit "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar. Ky i fundit është ndryshuar në vitin 2014 (ligji nr.155, datë 27.11.2014) ku ndër të tjera ka pasur një ndryshim edhe në nenet 2 dhe 29 të ligjit duke përcaktuar qartë institucionin e Avokatit të Popullit si promotor të nivelit më të lartë të standardet e të drejtave dhe lirive të njeriut në vend. Avokatit të Popullit i është dhënë një mandat i dyfishtë: *të mbrojë dhe promovojë të drejtat e njeriut.*

Si organe të mandatuara nga Kushtetuta, të pavarura nga qeveria, me një kompetencë të gjerë në fushën e të drejtave të njeriut, institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut (IKDNJ) janë një lojtar kyç në mbrojtjen dhe promovimin e këtyre të drejtave, demokracisë dhe shtetit të së drejtës. Këto institucione punojnë me qeverinë, parlamentin dhe gjyqësorin, si dhe me organizatat e shoqërisë civile dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut. Për më tepër, ato janë krijuar dhe funksionojnë duke iu referuar Parimeve të Parisit të OKB-së dhe Parimeve të Venecias, të cilat kërkojnë që IKDNJ-të të kryejnë punën e tyre në mënyrë të pavarur dhe të promovojnë respektimin e të drejtave themelore, parimeve demokratike dhe sundimit të ligjit në të gjitha rrethanat, duke përfshirë edhe në situata të gjendjes së jashtëzakonshme.

Sundimi i ligjit dhe të drejtat e njeriut janë parime të ndërlidhura dhe përforcojnë njëri-tjetrin: një regjim i fortë i shtetit ligjor është jetik për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe shteti i së drejtës mund të realizohet plotësisht vetëm në një mjedis që mbron të drejtat e njeriut. Funksionimi i pavarur dhe efektiv i një IKDNJ në çdo vend është një tregues i respektimit të shtetit ligjor. Në të vërtetë, mangësitë që ndikojnë në pavarësinë dhe efektivitetin formal dhe funksional të IKDNJ-ve kanë ndikim në aftësinë e IKDNJ-ve për të përmbushur në mënyrë efektive mandatin e tyre dhe për këtë arsye të luajnë rolin e tyre si pjesë e kontrolleve dhe balancave që mbrojnë kuadrin e sundimit të ligjit.

Ndërsa mandati specifik i çdo IKDNJ-je mund të ndryshojë, roli i përgjithshëm i IKDNJ-ve është të promovojë dhe mbrojë të drejtat e njeriut, duke përfshirë të drejtat civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore, si dhe të trajtojë diskriminimin në të gjitha format e tij. Duke pasur parasysh gjerësinë e mandatit të tyre, çdo IKDNJ zgjedh prioritetet strategjike për punën e tyre, bazuar në kriteret objektive që lidhen me kontekstin kombëtar.

Pavarësisht nga mandati i tyre specifik, IKDNJ-të janë unike në atë që pavarësia, pluralizmi, llogaridhënia dhe efektiviteti i tyre vlerësohen periodikisht dhe i nënshtrohen akreditimit ndërkombëtar. Ky akreditim kryhet nga Nënkomiteti i GANHRI për Akreditimin (SCA), i mbështetur nga Zyra e Komisionerit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut dhe përfshin rishikimin e përputhshmërisë së çdo IKDNJ -je me Parimet e Parisit të OKB-së, standardet ndërkombëtare për funksionimin e pavarur dhe efektiv të IKDNJ-ve. Ky akreditim përforcon IKDNJ-të si bashkëbisedues kyç në terren për mbajtësit e të drejtave, organizatat e shoqërisë civile, aktorët shtetërorë dhe organet ndërkombëtare.

Instanca e drejtpërdrejtë në të cilën raporton Avokati i Popullit është Kuvendi dhe objekti kryesor i mandatit të tij janë të gjitha të drejtat dhe liritë e njeriut të parashikuara në Kushtetutë, ligjet dhe instrumentet juridike ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. Ky raportim është në kuadër të informimit të përgjegjshëm që Avokati i Popullit duhet të bëjë për ta mundësuar Kuvendin të vlerësojë politikat në përmirësimin e standarteve të të drejtave të njeriut në vend.

Roli i Avokatit të Popullit, siç parashikohet në legjislacionin përkatës është të ndikojë drejtpërdrejt dhe tërthorazi në të gjitha proceset vendimmarrëse në shoqëri që prekin liritë e parashikuara nga Kushtetuta dhe aktet e tjera normative të Republikës së Shqipërisë, si dhe parimet e njohura përgjithësisht dhe normat e së drejtës ndërkombëtare. Ky legjislacion siguron që Avokati i Popullit duhet të jetë pika qendrore kombëtare dhe qendra e ekspertizës për të drejtat dhe liritë e njeriut, me lidhje të ngushtë dhe bashkëpunim me të gjitha strukturat shtetërore dhe ato të shoqërisë civile.

Avokati i Popullit, një institucion që si traditë të vetën ka ndërveprimin me qytetarët dhe vepron si mbrojtës i të drejtave të qytetarëve dhe ndërmjetës mes tyre e administratës publike, ka mundësinë që ta realizojë rolin e tij për promovimin e një qeverisjeje të hapur në dy mënyra.

E para është ajo nëpërmjet zbatimit të parimeve të kësaj qeverisjeje vetë, në plan të parë, si një organ kushtetues. Kjo realizohet përmes një transparence në nivele më të larta me publikun përsa i përket aktiviteteve të zhvilluara, efiçencës që ato sjellin por edhe nëpërmjet nxitjes së organeve kushtetuese për përmbushjen më efektive të mandateve të tyre kushtetuese.

Mënyra e dytë është përpjekja e vazhdueshme për të krijuar një frymë më bashkëpunuese në raport me vendimmarrësin sesa thjesht atë të të kritikuarit të veprimtarisë të saj. Një frymë e tillë krijohet përmes rekomandimeve në hartimin e politikave qeveritare për një "*qeverisje të hapur*" dhe kontributi mund të shkojë edhe më tej duke e ndihmuar pushtetin ekzekutiv në realizimin e fushatave informuese për këto strategji apo iniciativa.

Avokati i Popullit gjithnjë e më shumë po bëhet jo vetëm një institucion i zëshëm por edhe një institucion i domosdoshëm për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve dhe nxitjen e llogaridhënies nga organet qeveritare. Ai është duke vënë gjithnjë e më shumë theksin në ushtrimin e mandatit të tij si një pararojë të mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve dhe nxitjen e llogaridhënies nga organet qeveritare. Kjo është bërë më e dukshme duke patur parasysh nevojën për një qeveri të hapur dhe të përgjegjshme.
Duke vepruar brenda juridiksionit dhe kompetencave të njohura në Kushtetutë dhe në ligjin organik të tij, Avokatit të Popullit përmes shqyrtimit të ankesave jo vetëm synon përmirësimin e cilësisë së jetës për qytetarët shqiptarë, por njëkohësisht përmirësimin e qeverisjes dhe "*edukimin administrativ*" për administratën publike në tërësi.

Gjithnjë e më në rritje është kërkesa e qytetarëve për të pasur e kërkuar ndërhyrjen e Avokatit të Popullit apo qëndrimin e tij institucional në lidhje me çështje me interes të lartë publik. Kjo është

një përgjegjësi të cilen Avokati i Popullit mëton ta ushtrojë dhe realizojë në perputhje me mandatin e tij kushtetues pavarësisht kapaciteteve të kufizuara që disponon.

Në përfundim, vlen të theksohet edhe Rekomandimi i miratuar nga Komiteti i Ministrave i Këshillit të Europës në lidhje me *zhvillimin dhe forcimin e institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (IKDNJ).* Komiteti i Ministrave i rekomandon çdo shteti anëtar të Këshillit të Europës të krijojë, mbajë dhe forcojë një Institucion Kombëtar të të Drejtave të Njeriut (IKDNJ) në përputhje me Parimet e Parisit, të sigurojë një mjedis të favorshëm për to, si dhe të bashkëpunojnë me to.

Rekomandimi gjithashtu inkurajon Shtetet Anëtare të Këshillit të Europës që të eksplorojnë mënyra të reja për të zhvilluar një rol më të fortë dhe pjesëmarrje kuptimplotë të IKDNJ-ve dhe Rrjetit Europian të Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (ENNHRI-t) në Këshillin e Europës. Ky rekomandim përbën një instrument i cili sjell standarde të reja dhe nxit praktikat e mira, duke njohur rolin e institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut por edhe të organizatave të shoqërisë civile si promovues të të Drejtave të Njeriut.

KREU II

Zbatimi i rezolutës së Kuvendit të RSH-së për vitin 2020 nga institucioni i Avokatit të Popullit

Në kuadër të vlerësimit të veprimtarisë së institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2021, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar, më datë 21.7.2022, rezolutën përkatëse ku, ndërmjet të tjerash, i ka rekomanduar institucionit të Avokatit të Popullit marrjen e një sërë masash, që lidhen me ushtrimin e funksioneve të tij kushtetuese dhe ligjore.

Në zbatim të kësaj rezolute, institucioni i Avokatit të Popullit, brenda periudhës korrik-dhjetor 2022, si dhe bazuar dhe në mandatin e tij si një institucion më i lartë kombëtar për promovimin, parandalimin e shkeljeve dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ka ndërmarrë veprimet e mëposhtme**:**

1. Të intensifikojë reagimin institucional me vizibilitet më të shtuar në publik për rekomandimet që nuk zbatohen apo në rast mosbashkëpunimi nga autoritetet publike, me qëllim rritjen e besimit të publikut ndaj këtij institucioni kushtetues.

Niveli i zbatimit të rekomandimeve nga institucionet e administratës publike ka qenë dhe mbetet një shqetësim i vazhdueshëm për institucionin e Avokatit të Popullit. Përtej hapave dhe iniciativave pozitive të konstatuara ndër vite, mbetet shumë për tu bërë në këtë drejtim jo vetëm, nga organet e administratës publike në nivel qendror dhe vendor (sidomos sa i përket zbatimit të rekomandimeve), por dhe nga Kuvendi i Shqipërisë, si organi legjislativ ku paraqiten dhe diskutohen raportet e hartuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit.

Eshtë kjo arsyeja që në mënyrë të vazhdueshme, institucioni i Avokatit të Popullit ka monitoruar dhe monitoron nivelin e zbatimit të rekomandimeve të adresuara organeve të administratës publike nëpërmjet përgatitjes së informacioneve të përditësuara, të cilat bëhen pjesë e raportimeve periodike apo vjetore.

Ndërkohë, në faqen zyrtare të institucionit, është hapur një rubrikë ku janë përfshirë rekomandimet e pazbatuara, institucionet përgjegjëse si dhe institucionet që nuk kanë kthyer përgjigje në lidhje me rekomandimet e adresuara nga Avokati i Popullit, çka mundëson një aksesueshmëri dhe vizibilitet nga çdo qytetar apo subjekt i interesuar, duke respektuar rregullat e transparencës dhe të mbrojtjes së të dhënave personale.[1]

[1] Për më shumë mund ti referoheni linkut:
https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Regjistri%20i%20insittucioneve%20qe%20nuk%20kane%20kthyer%20pergjigje%20si%20dhe%20nuk%20kane%20zbatuar%20rekomandimet%20e%20AP.pdf.

2. Të informojë Kuvendin për institucionet që nuk kthejnë përgjigje në lidhje me rekomandimet e adresuara, si dhe të përfshijë në raportin vjetor dhe periodik institucionet që nuk kanë kthyer përgjigje.

Siç jeni në dijeni, në zbatim të Vendimit të Kuvendit të Shqipërisë Nr.134/2018, "Për miratimin e Manualit të Monitorimit Vjetor dhe Periodik", institucioni i Avokatit të Popullit ka informuar në mënyrë periodike (në formë elektronike dhe shkresore) Kuvendin e Shqipërisë në lidhje me rekomandimet që institucioni i Avokatit të Popullit i ka adresuar institucioneve publike, si dhe statusin e zbatimit të tyre.

Gjithashtu, në bazë të vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr.49/2017 "Për krijimin e Mekanizimit për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj", institucioni i Avokatit të Popullit ka respektuar detyrimin për të hedhur në mënyrë periodike në platformën ndërinstitucionale të gjitha rekomandimet e adresuara institucioneve të administrates publike, statusin e zbatimit të tyre si dhe institucionet përgjegjëse.

Gjithsesi, në zbatim të kësaj pike të rezolutës, institucioni i Avokatit të Popullit i ka dërguar Kuvendit të Shqipërisë një informacion të detajuar (*16 nëntor 2022*) në lidhje me institucionet që nuk kthejnë përgjigje për rekomandimet e adresuara. Gjithashtu, institucioni i Avokatit të Popullit këtë informacion të përditësuar do ta përfshijë edhe në raportin vjetor apo periodik.

3. Të intensifikojë sesionet informuese në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në rang vendi, me qëllim përmirësimin e njohurive të nxënësve për të drejtat e tyre themelore dhe punën e Avokatit të Popullit në mbrojtjen e këtyre të drejtave me qëllim rritjen e numrit të ankesave/kërkesave që vijnë drejtpërdrejt nga fëmijët.

Për periudhën janar – dhjetor 2022, janë realizuar 40 veprimtari promovuese "Ditë të Hapura" me pjesëmarrjen e nxënësve, mësuesve dhe prindërve në rang vendi, konkretisht në Tiranë, (si p.sh. shkolla 9 –vjeçare "Ali Demi", "Skënder Çaçi", "Niket Dardani", "Hasan Prishtina" "Tirana jonë", "Faik Konica" shkolla e mesme e përgjithshme "Ismail Qemail", etj); në shkolla 9-vjecare në Durrës, Shijak, Vorë, Krujë, Elbasan, Kamëz, Krrabë, Paskuqan etj.

Qëllimi i këtyre aktiviteteve promovuese ka qenë përmirësimi i njohurive të nxënësve dhe mësuesve për të drejtat e fëmijëve të parashikuara në Kushtetutë, në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve (KDF), si dhe në ligjin nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës". Gjithashtu, gjatë këtyre aktiviteteve promovuese, Komisioneri dhe SMPDF-ja kanë informuar nxënësit dhe mësuesit, lidhur me punën e Avokatit të Popullit dhe rolin e tij për mbrojtjen, monitorimin dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve dhe të të rinjve nën moshën 18 vjeç në Republikën e Shqipërisë.
Për këtë qëllim janë shpërndarë në shkolla edhe broshura dhe materiale të tjera informuese për të drejtat e fëmijëve dhe punën e Avokatit të popullit për mbrojtjen e tyre. Një rëndësi të veçantë gjatë promovimit i kemi kushtuar konsultimit me fëmijët dhe dëgjimit të zërit të tyre në çështje që prekin të drejtat dhe mirëqenien e tyre. Po kështu, gjatë këtyre aktiviteteve kemi pasur

mundësinë të marrim edhe ankesat të drejtpërdrejta nga fëmijët apo edhe mësuesit, çka ka rezultuar në një rritje të numrit të ankesave të trajtuara nga SMPDF-ja.

Si anëtar i Rrjetit Europian të Ombudsmanëve për Fëmijë (ENOC), Avokati i Popullit, nëpërmjet SMPDF-së, ka marrë pjesë në Konferencën e Përgjithshme vjetore të ENOC-ut të zhvilluar në *datat 19-21 shtator*, ku është prezantuar edhe puna e Avokatit të Popullit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri. Gjatë kësaj Konference kemi mbështetur realizimin e dispozitave të parashikuara në Konventën për të Drejtat e Fëmijëve, të cilat kanë të bëjnë me të drejtën për një mjedis të shëndetshëm (neni 24).

4. Të vijojë inspektimet/monitorimet e Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve dhe të rrisë numrin e rekomandimeve nga ky seksion me qëllim mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Për periudhën *janar-dhjetor 2022*, janë realizuar *10 inspektime/monitorime* (përveç organizimit të ditëve të hapura të raportuara më sipër), për të cilat janë adresuar *30 rekomandime* organeve të administratës publike me qëllim garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve si dhe janë paraqitur 3 (tre) raporte të veçanta[2]. Në vlerësim të komunikimit zyrtar dhe monitorimit për zbatimin e tyre informojmë, se rekomandimet e adresuara nga Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve janë pranuar nga institucionet përkatëse, të cilat kanë marrë masa për zbatimin e tyre.

Me mbështetjen financiare të UNICEF-it institucioni i Avokatit të Popullit nëpërmjet Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve, realizoi monitorimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve dhe garantimin e të drejtave të tyre në 7 bashkitë më të prekura nga tërmet i 26 nëntorit 2019, konkretisht, Shijaku, Durrësi, Kruja, Tirana, Kamza, Kurbini dhe Lezha[3].

Në përfundim të procesit të monitorimit/inspektimit Avokati i Popullit adresoi rekomandimet përkatëse në shtatë bashkitë e lartpërmendura dhe organeve të administratës publike në nivel qendrorë (Ministrisë së Shtetit dhe Rindërtimit, Ministrisë së Financave dhe Ekonimisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Drejtorisë së Përgjithshme të Gjëndjes Civile, Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar) bazuar në problematikat e identifikuara për mbrojtjen e fëmijës gjatë periudhës së tërmetit dhe gjendjes së emergjencës civile.

Në datën *19 korrik 2022* kemi prezantuar raportin e vlerësimit të ndikimit të ndryshimeve klimatike në të drejtat e fëmijëve në Shqipëri me mbështetjen e organizatës *Save the Children*. Ky raport ka vlerësuar dhe analizuar ndikimin që kanë politikat në fushën e mbrojtjes klimatike mbi fëmijët, qoftë në këndvështrimin mbi ndikimin që ka mbi jetën dhe shëndetin e fëmijëve, por edhe nga perspektiva e pjesëmarrjes së tyre në proceset vendimmarrëse dhe konsultuese.

---

[2] Raportet e veçanta: "Politikat e pensionit ushqimor, detyrimit për ushqim për fëmijët", "Vlerësimi i ndikimit tek të drejtat e fëmijëve gjatë COVID-19", dhe "Vlerësimi i ndikimit tek të drejtat e fëmijëve nga ndryshimet klimatike".

[3] 2Post-Disaster Needs Assessment, Volume A, the Government of Albania, the European Union, the United Nations agencies, and the World Bank 2020.

Ndërkohë, në datën *18 nëntor 2022*, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Fëmijës (20 nëntor), institucioni i Avokatit të Popullit, me mbështetjen e UNICEF-it, organizoi veprimtarinë promovuese lidhur me prezantimin e raportit të veçantë "Vlerësimi i Ndikimit të të Drejtave të Fëmijëve (CRIA-Covid-19)".

Gjithashtu në datën *23 dhjetor 2022* në bashkëpunim me organizatën "Të Ndryshëm & Të Barabartë" institucioni i Avokatit të Popullit organizoi tryezën e rrumbullakët *"Përfshirja e të Mbijetuarve të Dhunës Seksuale dhe Trafikimit në Përmirësimin e Sistemit të Drejtësisë".* Kjo është një qasje e re pune në kuadër të fuqizimit të bashkëpunimit të institucionit të Avokatit të Popullit me shoqërinë civile duke bërë të mundur për herë të parë ngritjen e Panelit Këshillimor të të Mbijetuarve të Dhunës Seksuale pranë institucionit tonë.

5. Të rrisë aktivitetin ndërgjegjësues dhe informues në zyrat rajonale me qëllim promovimin dhe nxitjen e respektimit të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individëve dhe promovimit të mekanizmave mbrojtës të tyre.

Duke qenë se Institucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut të konceptohen dhe veprojnë si institucione lider në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, institucioni i Avokatit të Popullit, çështjet që lidhen me promovimin, informimin apo sensibilizimin lidhur me të drejtat e njeriut si dhe rolin e institucionit në këtë drejtim i ka pjesë të mandatit të tij, bazuar sidomos në standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Zyrat rajonale kanë vijuar të forcojnë një prani të vlerësueshme të institucionit të Avokatit të Popullit më afër qytetarëve në këto rajone, nëpërmjet një pune të vazhdueshme të përfaqësuesve në terren, duke u mundësuar qytetarëve informacione të nevojshme mbi rolin dhe funksionin e institucionit të Avokatit të Popullit, marrjen e ankesave dhe dërgimin në kohë për shqyrtim nga ekspertët sipas seksioneve, si dhe kthimin e përgjigjeve qytetarëve brenda një kohe të shkurtër dhe optimale. Prania e tyre në këto rajone jo vetëm ka ngushtuar distancën, por edhe ka sjellë institucionin e Avokatit të Popullit më pranë qytetarëve.

Fushatat promovuese dhe puna në terren e përfaqësuesve rajonalë kanë qenë pjesë të rëndësishme të aktivitetit të përditshëm të punës së tyre, duke synuar në vazhdim rritjen dhe forcimin e besimit të qytetarëve tek Avokati i Popullit jo vetëm si një objektiv për t'u arritur por edhe si sodisfaksion dhe përgjegjësi. Puna në terren është bazuar në një planifikim paraprak të gjithësecilit, nëpërmjet hartimit dhe realizimit të plotë të planeve mujore duke evidentuar aktivitetin dhe problematikat e hasura.

Zyrat rajonale të Avokatit të Popullit kanë treguar të jenë shumë efektive dhe në plotësim të pritshmërive të Institucionit të Avokatit të Popullit, referuar promovimit të këtij institucioni dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut në gjithë hapësirat gjeografike ku këto zyra operojnë. Një indikator matës që tregon efektivitetin e zyrave rajonale të Avokatit të Popullit si dhe për rrjedhojë edhe rritjen e besimit të qytetarëve tek këto zyra është numri i ankesave gjithmonë në rritje.

Rritja e Kapaciteteve në drejtim të qasjes proaktive ndaj pritjes dhe shërbimeve që i ofrohen qytetarët në zyrat rajonale ka qenë dhe do të mbetet në fokusin e Avokatit të Popullit. Për këtë qëllim, janë organizuar trajnime, seminare, pjesëmarrje në konferenca etj, aktivitete këto që kanë

ndikuar në ngritjen profesionale, rritjen e performancës, përmirësimin e etikës dhe të cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve. Një nga mjetet efikase, mbetet forcimi i një komunikimi të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm me qytetarët, për t'ju përgjigjur interesimit të tyre rreth objektit të ankesave dhe rrugët që duhet të ndjekin për zgjidhjen e të drejtës të pretenduar prej tyre.

Zyrat Rajonale të Avokatit të Popullit, në funksion të ushtrimit të mandatit promovues të institucionit, si një nga instrumentat më të rëndësishëm për ndërgjegjësimin e qytetarëve lidhur me të drejtat e tyre dhe rolin e institucionit në këtë drejtim kryejnë në vazhdimësi aktivitete ndër të cilat:

- ✓ takime dhe pjesëmarrje në një sërë aktivitetesh me përfaqësues nga organizata të ndryshme të shoqërisë civile në nivel vendor përfshirë dhe përfaqësues të shoqatave të komuniteteve egjiptiane e rome, përfaqësues të shoqatave për të drejtat e PAK, perfaqësues të shoqatave në mbrojtje të te drejtave te grave etj;
- ✓ aktivitete promovuese dhe ditë të hapura në bashkitë dhe njesitë administrative të qarqeve përkatëse, ku janë shpërndarë ndër të tjera edhe fletëpalosje të posaçme që institucioni i Avokatit të Popullit ka përgatitur lidhur me të drejtat e qytetarëve;
- ✓ përfaqësim aktivisht në mediat e shkruara dhe audiovizive në nivel lokal për promovimin e zyrës rajonale dhe të mandatit të institucionit;
- ✓ promovimi i aktivitetit të zyrave rajonale në rrjetet sociale;

Konkretisht, disa nga aktivitetet e lidhura me promovimin e zyrës rajonale dhe të institucionit të Avokatit të Popullit janë si më poshtë:

- ✓ Organizim i ditëve të hapura dhe takime me përfaqësues të shoqatave të ndryshme në nivel vendor në qarkun e Beratit, Gjirokastrës, Vlorës, Kukësit, Shkodrës, etj. si dhe në njësitë administrative të këtyre qarqeve;
- ✓ Pjesëmarrje në aktivitetin e zhvilluar nga Bashkia Berat, në partneritet me UNDP Shqipëri në Ditën Ndërkombëtare të Romëve;
- ✓ Pjesëmarrje në takimet me Anëtarët e Grupit të Task Forcës Bashkiake ROMACTED në Bashkitë e Pogradecit dhe Vlorës;
- ✓ Pjesëmarrje në aktivitetin e zhvilluar nga Qendra për të Drejtat në Punë;
- ✓ Pjesëmarrje në aktivitetin e organizuar nga Bashkia Shkodër në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve në Situatë Rruge;
- ✓ Pjesëmarrje në panaire apo në nisma të ndryshme të zhvilluara në qarqet e Republikës së Shqipërisë;
- ✓ Pjesëmarrje në takimin e organizuar në Vlorë nga organizata 'Drejtësi Sociale' mbi mundësitë e përfitimit të ndihmës ligjore, parësore dhe dytësore, me anëtarë të komunitetit Rom dhe Egjiptian.
- ✓ Pjesëmarrje në organizime të ndryshme të bëra nga Qëndrat Rinore, etj.

Gjithashtu, duhet të theksohet se përfaqësuesit e zyrave rajonale janë punonjës të rekrutuar me kontrata të përkohshme (6 orë në ditë), ndërkohë që është e nevojshme që këta punonjës të jenë pjesë e strukturës dhe organikës të institucionit dhe të punojnë me kohë të plotë, një rekomandim i cili është theksuar dhe nga Nënkomiteti i Akreditimit në GANHRI-it (Aleanca Globale e të

Drejtave të Njeriut) gjatë finalizimit të dhënies së statusit "A" për institucionin e Avokatit të Popullit. (Dhjetor 2020)[4]

Më poshtë jepet një vështrim krahasimor të ankesave të ardhura nga Zyrat vendore për vitin 2022 dhe për vitin 2021.

		Z.R. Sarandë	Z.R. Dropull	Z.R. Berat	Z.R. Vlorë	Z.R. Kukës	Z.R. Pogradec	Z.R. Shkodër	TOTALI
Total ankes + K/O	2021	588	122	315	180	110	231	64	1610
	2022	**669**	**104**	**540**	**261**	**163**	**1086**	**88**	2911
Ndryshimi		14%	-15%	71%	45%	48%	370%	38%	81%

Paraqitja grafike e të dhënave në tabelën e mësipërme është si në vijim:



[4] https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Raporti%20i%20N%C3%ABn-Komitetit%20t%C3%AB%20Akreditimit%20t%C3%AB%20GANHRI-t%20-%20Dhjetor%202020.pdf

6. Të angazhohet në përgatitjen e një plani masash për informimin dhe promovimin e mekanizmave mbrojtës të të drejtave dhe lirive, me fokus të veçantë shtetasit pjesë e grupeve vulnerabël dhe atyre të margjinalizuara të shoqërisë.

Në ushtrim të mandatit të tij kushtetues, për promovimin, mbrojtjen dhe parandalimin e shkeljes së të drejtave dhe lirive të ligjshme të individit, Seksioni i Pëgjithshëm, ka formuluar dhe përcaktuar një plan masash[5], me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin për mekanizmat mbrojtës të të drejtave të njeriut, me fokus të veçantë shtetasit pjesë e grupeve vulnerabël dhe atyre të margjinalizuara të shoqërisë.

Në këtë plan masash janë planifikuar aktivitete, me qëllim përmirësimin e njohurive të qytetarëve për të drejtat e tyre themelore, të qasjes në informacion dhe rritjen e mundësisë së qasjes së qytetarëve tek institucioni i Avokatit të Popullit, duke përfshirë njerëzit e zonave të largëta, njerëzit pa qasje në internet, të moshuarit dhe njerëzit me sfida të tjeratë mundësisë për qasje dhe për të rritur ndërgjegjësimin mbi rolin, misionin e Avokatit të Popullit, rritjen e dukshmërisë dhe besueshmërisë ndaj tij.

Në këtë kuadër, gjatë këtij viti, janë organizuar dhe zhvilluar veprimtari "Ditë e Hapur" në Bashkinë Dropull, Gjirokastër, Pogradec, Pustec, Korçë, Berat, Vlorë, Përmet, Kolonjë, Kukës, Has, Shkodër, Malësi e Madhe, Lezhë, me qëllim takim me qytetarët, marrjen e ankesave pranë vendbanimeve të tyre, mbaJtjen e sesioneve ndërgjegjësuese për rolin e institucionit të Avokatit të Popullit, si mbrojtës i të drejtave dhe lirive të njeriut, informuar mbi të drejTat që ata gëzojnë

Gjithashtu në këto qytete, për bashkëpunimin dhe konsolidimin e punës në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, janë organizuar tryeza dhe takime me shoqatat që operojnë në mbrojtje të grupeve në nevojë si dhe me përfaqësues të institucioneve shtetërore, atyre qendrore dhe vendore, të cilat ofrojnë shërbime për qytetarët.

Qytetarëve, organizatave të shoqërisë civile, punonjësve të administratës shtetërore, pjesëmarrës në takimet e zhvilluara u janë shpërndarë broshura dhe materiale të tjera informuese për punën e Avokatit të Popullit në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të grupeve vulnerabël në Shqipëri.

Janë zhvilluar takime diskutimi me studentë e pedagogë në Universitetin “Fan S.Noli” Korçë dhe Universitetin “Eqrem Çabej”, Gjirokastër. Qëllimi i këtyre takimeve, ishte njohja në mënyrë më të thelluar me problematikat me të cilat ballafaqohet sot arsimi i lartë si dhe forcimi i bashkëpunimit lidhur me adresimin e këtyre problematikave pranë organeve përkatëse.

Auditorit iu përcoll një informacion i zgjeruar mbi rolin dhe funksionet e institucionit të Avokatit të Popullit, trajtimi nga ana e institucionit i ankesave të depozituara nga qytetarët si dhe mënyrat se si qytetarët mund të aksesojnë këtë institucion, si një instrument për vënien në vend të të drejtave dhe lirive të shkelura. U diskutuan problematika shqetësuese për studentët si: tarifat e shkollimit, strehimi në konvikte, kushtet dhe infrastuktura, cilësia e mësimdhënies akademike etj.

Për përmirësimin e kushteve të jetesës për grupet dhe individët e prekshëm, përfshirë personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit, viktimat e dhunës seksuale dhe gjinore si dhe respektimin e zbatimin e standardeve të shërbimeve shoqërore në Institucionet e Përkujdesjes Shoqërore,

[5] Bashkëlidhur këtij informacioni do të gjeni Planin e Masave.

rezidenciale dhe ditore, janë kryer inspektime në Qendra Rezidenciale të Zhvillimit[6], në Qendrat Ditore për të Moshuarit,[7] në Qendra të Trajtimit të Viktimave të Dhunës[8]. Gjatë inspektimeve janë kryer takime diskutimi në këto qendra me drejtues, stafin dhe përfitues, të cilët frekuentojnë dhe janë të akomoduar në këto institucione.

Pas inspektimeve të kryera, për garantimin e të drejtave të përfituesve, për një shërbim sa më cilësor në zbatim të standardeve të shërbimeve sociale në Institucionet e Përkujdesjes Shoqërore, janë hartuar dhe dërguar rekomandimet përkatëse Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Kryetarëve të Bashkive, Këshillit të Qarkut, Shërbimit Social Shtetëror, Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.

Përpos këtyre aktiviteteve promovuese, përfaqësues të institucionit tonë pas përfundimit të takimeve të organizuara, kanë dhënë intervista në mediat lokale për të informuar dhe ndërgjegjësuar më tej qytetarët që të adresojnë çdo problematikë që ata hasin me institucionet shtetërore.[9]

Këto aktivitete kanë synuar gjithashtu rritjen e aksesueshmërisë të institucionit të Avokatit të Popullit te qytetarët, në funksion të rritjes së kredibilitetit të tij.

7. Të vijojë bashkëpunimin me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi përmes projekteve konkrete për të koordinuar dhe bashkuar përpjekjet me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për mbrojtjen dhe parandalimin e shkeljeve.

Siç ju kemi informuar edhe më parë, bashkëpunimi i Avokatit të Popullit me institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka qënë i frytshëm dhe ka përfshirë të gjitha ato tema sensitive që dy institucionet mund të adresojnë në kuadër të respektimit të së drejtës për barazi para ligjit si dhe në luftën kundër diskriminimit të të gjitha formave. Jo vetëm kaq por ky bashkëpunim ka qënë sinergjik në organizimin e punës së zyrave rajonale të ngritura nga ana e Avokatit të Popullit dhe nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në qytete të ndryshme të vendit.

Pikërisht për të vazhduar konsolidimin e kësaj qasjeje institucionale, institucioni i Avokatit të Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi edhe gjatë 2022 kanë vazhduar

---

[6] Qendra e Zhvillimit Korçë datë 13.04.2022.
Qendra e Zhvillimit "Unë jam si Ju" Berat/ datë 21.09.2022.

[7] Qendra Sociale Ditore "Shtëpia e Përbashkët" Berat/ datë 22.09.2022.
Qendra Ditore për të Moshuarit, Kukës/ datë 07.10.2022.

[8] Strehëza e Emergjencës për gratë dhe vajzat e dhunuara, Kukës/ datë 07.10.2022.
Qendra Psiko-Sociale "Vatra", Vlorë/ datë 29.09.2022.
Qendra e Emergjencës së Viktimave të dhunës në familje Sarandë/ datë 19.08.2022.
Qendra e Emergjencës së Viktimave të dhunës në familje – Pogradec/ datë 17.08.2022.
Qendra e Menaxhimit për rastet e dhunës seksuale, LILIUM/ datë 11.08.2022.
Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje/ datë 04.08.2022.

[9] Linku i intervistave:
https://youtu.be/Tp5XNXmGZDs
https://www.facebook.com/watch/?v=862012841483149
https://www.youtube.com/watch?v=8oHE5EsXz04
https://www.facebook.com/watch/?v=418214030385078

realizimin e trajnimeve të përbashkëta, në fusha të ndryshme të së drejtës me qëllim rritjen e kapaciteteve të punonjësve të zyrave rajonale të Avokatit të Popullit dhe KMD-së, forcimin e bashkëpunimit midis tyre si dhe për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve që ofrohen ndaj qytetarit.

Në vijim të ciklit të trajnimeve të zhvilluara më parë, më *datë 30.06.2022*, Avokati i Popullit në bashkëpunim me KMD-në organizoi trajnimin online me temë: "*Avokati i Popullit dhe roli i tij në mbrojtje të të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar*". Ky aktivitet trajnues synoi rritjen e kapaciteteve të punonjësve të Zyrave Rajonale të dy institucioneve fushën e mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuar si dhe për forcimin e bashkëpunimit mes tyre.

Në bazë të marrëveshjes dhe trajnimeve të realizuara, për periudhën në fjalë zyrat rajonale të Avokatit të Popullit kanë referuar *11 raste* tek përfaqësuesit e zyrave rajonale të KMD dhe po i njëjti numër ka qenë dhe referimi nga zyrat e KMD-së tek zyrat rajonale të Avokatit të Popullit.

Gjatë kësaj periudhe në bashkëpunim me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë hartuar dy raporte të veçanta me tematikë "*Dhuna ndaj grave në politikë*" dhe "*Vlerësim mbi qasjen dhe përdorimin familjar të transfertave sociale*", të cilat janë dërguar për njohje, në fund të muajit dhjetor 2022, pranë Kuvendit të Shqipërisë.

Siç është informuar edhe më parë, të dy institucionet vazhdojnë të jenë pjesë aktive e Marrëveshjes së Bashkëpunimit për krijimin e "Aleancës kundër urrejtjes", e cila si qëllim të saj ka angazhimin e aktorëve kryesorë të përfshirë në aspekte të ndryshme të parandalimit të gjuhës së urrejtjes, për të koordinuar dhe bashkuar përpjekjet, për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të advokuar si një front kundër këtij fenomeni.

Në këtë kuadër, më *datë 28 shkurt 2022*, "Aleancës kundër urrejtjes", zhvilloi një aktivitet në Universitetin e Elbasanit në kuadër të 12-vjetorit të miratimit të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, ku mori pjesë Avokatja e Popullit znj. Erinda Ballanca dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi z. Robert Gajdja.

KREU 3

Vlerësim i situatës së respektimit të të drejtave të njeriut nga administrata publike

3.1 Përmbledhje e veprimtarisë të seksioneve të institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2022

➢ *Veprimtaria e Seksionit të Veçantë*

Veprimtaria e Seksionit të Veçantë si pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit është fokusuar në disa çështje të trajtuara në vijimësi që lidhen me garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve nga veprimet apo mosveprimet e organeve ligjzbatuese.

Gjatë vitit 2022 për rastet (ankesat dhe rastet me iniciativë) që kemi përfunduar hetimin administrativ dhe provuar se ankesat e shtetasve kanë qenë të bazuara, janë përgatitur *41 rekomandime*, të cilat *92* u janë drejtuar organeve ligjzbatuese të administratës publike dhe për dijeni *14* organeve të tjerë, me një total prej *113 pikash nënrekomandime* për t'u zbatuar nga ana e tyre.

Në vëmendjen e punës tonë kanë qenë *të drejtat të personave të burgosur*, për shkak të veçimit të tyre nga pjesa tjetër e shoqërisë. Disa nga ankesat apo shqetësimet e adresuara prej tyre në institucionin e Avokatit të Popullit kanë të bëjne me: të drejtën për t'u punësuar dhe shpërblyer për punën e kryer, trajtimin shëndetësor e në mënyrë të veçantë të kategorisë të të burgosurve me sëmundje kronike, procedurat e transferimit, të drejtën për të vazhduar arsimin e mesëm dhe të lartë gjatë qëndrimit në IEVP, të drejtën për t'u informuar etj. Në zbatim të ligjit nr. 81/2020, një nga aktet e rëndësishëm të miratuar gjatë vitit 2022, në kuadër të përcaktimit të rregullave për garantimin e të drejtave të të burgosurve, është dhe Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve. Vlerësojmë se një pjesë e mirë e mendimeve dhe sugjerimeve tona u morën në konsideratë duke i parashikuar në këtë akt nënligjor.

Gjithashtu, në fokusin e punës tonë ka qenë edhe hetimi administrativ i *ankesave të punonjësve të admistratës së IEVP-ve*, si të lidhura ngushtë me shërbimin që ata i ofrojnë të burgosurve. Nuk mund të trajtohen problematikat në sistemin penitenciar pa marrë parasysh vështirësitë, me të cilat përballen ata që janë në kontakt të drejtpërdrejtë me personat e privuar nga liria, ata që japin kontribut çdo ditë për menaxhimin e burgjeve.

Objekti i ankesave dhe i rasteve me iniciativë të administruara në institucionin e Avokatit të Popullit *ndaj strukturave të Ministrisë së Brendshme dhe të Policisë së Shtetit* ka qenë i larmishëm, në një pjesë të të cilave është konstatuar se nuk janë respektuar të drejtat themelore të shtetasve dhe janë dërguar rekomandimet përkatëse. Ndër to, do të evidentonim rastet për shoqërime të paligjshme apo mbajtje në gjendje shoqërimi tej afatit të nevojshëm për sqarimin e shkakut/arsyes së shoqërimit; për mos pasqyrimin në procesverbalin e arrestimit në flagrancë të

orës faktike të personave të shoqëruar si të dyshuar për kryerjen e një vepre penale; për mos njoftimin nga policia të familjarëve të të shoqëruarve apo moslejimin e tyre të komunikojnë vetë me ta me telefonat e tyre; për mos mbajtje dhe mos dhënie të procesverbaleve për veprimet e kryera nga punonjësit e policisë; për arrestime apo ndalime të paligjshme; për sjellje pa etikë të punonjësve të policisë gjatë komunikimit; për vendosje të masave administrative të kundërligjshme nga punonjësit e Policisë Rrugore; për cënimin e të drejtës së shtetasve për t'u pranuar e arsimuar në Akademinë e Sigurisë; për shkelje të të drejtave të shtetasve të huaj në Shqipëri, si refuzim të hyrjes në vendin tonë, refuzimin e pajisjes së tyre me leje qëndrimi, për ndalimin në qendrën e mbyllur pa aplikuar më parë masat alternative, për mbajtjen në gjendje ndalimi tej afatit ligjor; për cënim të të drejtave ligjore të punonjësve të Policisë së Shtetit lidhur me mos pagesën për punën e kryer tej orarit zyrtar, dietat dhe transferimet, etj.

Përgjatë vitit 2022, funksionimi i *sistemit gjyqësor* në të gjitha nivelet ka vijuar të përballet me vështirësi. Efektet e procesit të reformës në drejtësi edhe këtë vit kanë rritur volumin e punës në sistem për shkak të mungesave dhe largimeve të një numri të konsiderueshëm gjyqtarësh dhe moszëvendësimit të tyre me të rinj. Në disa raste të trajtuara nga ana jonë janë konstatuar zvarritje të proceseve gjyqësore, dorëzime me vonesë të vendimeve të arsyetuara, shtyrje të gjykimit të çështjeve të reja, etj. Në funksion të ushtrimit të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të shtetasve, institucioni i Avokatit të Popullit ka ndjekur me shumë vëmendje diskutimet dhe debatet publikë mbi propozimin e *hartës së re gjyqësore* nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Ministria e Drejtësisë. Avokati i Popullit vlerësoi se ky propozim nuk e përmirëson aksesin në drejtësi për qytetarët e veçanërisht për kategoritë vulnerabël, ndaj u rekomandoi organeve kompetente rishikimin e propozimit të hartës së re gjyqësore në kuadër të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, rekomandime të cilat nuk u pranuan.

Avokati i Popullit vlerëson se me miratimin e hartës së re gjyqësore, për të garantuar aksesin në drejtësi të qytetarëve, shtimi i qendrave të ofrimit të *shërbimit të ndihmës juridike* parësore dhe zbatimi me rigorozitet i vendimeve gjyqësore nga Dhomat e Avokatisë lidhur me ofrimin e ndihmës juridike dytësore duhet të jenë domosdoshmëri dhe objektiva të Ministrisë së Drejtësisë. Kjo vlen në mënyrë të veçantë për kategoritë vulnerabël që janë subjekte përfituese të këtij ligji të cilët do të kenë një kosto të shtuar për ndjekjen e një procesi gjyqësor, me qëllim realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre ligjore dhe kushtetuese.

Një vëmendje të shtuar kemi pasur edhe në verifikimin e problematikave të qytetarëve dhe ankesave të tyre ndaj *strukturave të prokurorisë*, si: zvarritje të pajustifikuara në hetimin e procedimeve penale, problematika në zbatimin e dispozitave procedurale që parashikojnë dhe rregullojnë të drejtat e palëve në procesin penal, e më konkretisht mosnjohja me aktet dhe provat (dosjen) mbi bazën e të cilave ngrihen akuzat penale; mungesa ose vonesat në njoftimin e palëve për vendimet e marra nga organi i Prokurorisë, kryesisht kallëzuesit të veprës penale, sidomos në rastet e vendimeve për mosfillim të procedimit penal; mosinformim për kallëzimin e bërë; vonesë për njoftimet e palëve në procesin penal etj. Gjithashtu kemi evidentuar se nga organet prokurorisë janë administruar kallëzimet e bëra nga personat ndaj të cilëve zhvillohen hetime për dhunim fizik të tyre nga punonjësit e Policisë së Shtetit gjatë momentit të kapjes, shoqërimit në

organet e Policisë apo gjatë marrjes së deklarimeve të tyre. Në vijim të veprimeve, procedimet penale janë bashkuar në të njëjtin procedim dhe hetimet janë ndjekur nga i njëjti prokuror, problematikë kjo që është trajtuar dhe bërë objekt i disa rekomandimeve të cilat u janë dërguar organeve respektive të prokurorisë.

Një rëndësi të veçantë i kemi kushtuar jo vetëm çështjes së pagesave të kësteve të dëmshpërblimit *të ish të dënuarve politikë dhe trashëgimtarëve të tyre*, por kemi trajtuar gjerësisht edhe domosdoshmërinë e ndryshimeve ligjore dhe miratimit të akteve nënligjore për të drejtat e tjera që duhet të përfitojë kjo kategori. Po ashtu, nisur nga shqetësimet e ngritura në tryeza ku janë diskutuar problematika të drejtësisë tranzitore dhe të drejtat e personave të persekutuar në sistemin komunist, nga ana jonë është dërguar rekomandim lidhur me bashkëpunimin ndërmjet strukturat kompetente për identifikimin dhe ruajtjen e vendvarrimeve të personave të zhdukur gjatë regjimit komunist, si edhe shmangien e dhënies së lejeve të përdorimit, shfrytëzimit dhe ndërtimit të objekteve të ndryshme mbi këto hapësira dhe sheshe.





➢ *Veprimaria e Mekanizmit Kombëtar kunder Torturës (MKPT)*

Mekanizmi Kombëtar përgjatë vitit 2022 ka kryer vizita inspektuese të paparalajmëruara në vendet e privimit të lirisë, përfshirë: *26 Institucione të Ekzekutimit të Vendimeve Penale; 36 Njësi Policore; 3 Qendra; 4 Spitale Psikiatrike dhe 4 Shtëpi të Moshuarish.*

I gjithë aktiviteti i mësipërm është shoqëruar me *90 rekomandime* dhe me një korrespondencë zyrtare të dendur për të sqaruar shumë detaje dhe fenomene të konstatuara gjatë inspektimeve. Qëllimi i këtyre vizitave dhe inspektimeve ishte vlerësimi i progresit të autoriteteve kompetente në zbatimin e rekomandimeve të MKPT-së, të dërguara përmes rekomandimeve, si dhe respektimi i të drejtave të të burgosurve dhe personave që ju privohet liria, të drejta të cilat garantohen nga aktet ndërkombëtare si dhe nga legjislacioni kombëtar. Përveç kësaj, nga ana e MKPT-së është mbajtur në konsideratë edhe veprimtaria promovuese e të drejtave të njeriut në bashkëpunim me Administratën e Burgjeve dhe Drejtorinë e Policisë së Shtetit.

Gjithashtu, MKPT përgjatë vitit 2022 ka trajtuar *31 ankesa dhe 14 raste me iniciativë*, nga të cilat 25 ankesa për burgjet (pretendim ushtrim dhune, mungesë mjekimi dhe medikamentesh, mungesë kushtesh jetese, mbipopullimi në burgje etj,), dhe 6 ankesa për policinë (pretendim ushtrim dhune, shoqërim i padrejtë etj,), nga hetimi administrativ i të cilave ka konkluduar me dërgimin e *10 rekomandimeve* institucioneve përkatëse.
Gjatë periudhës raportuese, MKPT ka publikuar *1 raport të veçantë*, dhe konkretisht raporti i Avokatit të Popullit "*Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna për Shqipërinë nga Komiteti*

Europian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor dhe Degradues", i cili i është drejtuar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

MKPT-së në bashkëpunim me Drejtorinë e Policisë Kufitare dhe të Migracionit dhe FRONTEX ka vazhduar të monitorojë në mënyrë konstante operacionet e riatdhesimit vullnetar e të detyruar të shtetasve shqiptarë nga vendet e BE-së dhe shteteve të zonës Shengen, me qëllim transferimin sipas rregullave të shtetasve shqiptarë me vendim riatdhesimi nga territoret e vendeve anëtare të BE-së, ku për vitin 2022 janë kryer *23 operacione riatdhesimi*.

Edhe gjatë vitit 2022, ka vijuar të zbatohet Marrëveshja e Bashkëpunimit të nënshkruar me UNHCR në kuadër të projektit të përbashkët "Refugjatët dhe Azilkërkuesit në vendet e Europës Juglindore", për kontrollin e kufirit dhe mbrojtjen e refugjatëve në Shqipëri, në zonën jugore të Shqipërisë (Gjirokastër, Sarandë, Përmet) dhe në zonën juglindore (Korçë, Devoll Bilisht), ku përgjatë këtij viti raportues ka pasur prezencë në pikat kufitare të Kapshticës (Korçë) dhe Gërhot (Gjirokastër). Në këtë kuadër, është duke u hartuar një Raport Monitorimi *"Për respektimin e të drejtave dhe lirive të migrantëve të parregullt, refugjatëve dhe azilkërkuesve në Shqipëri"*, për vitin 2022, nisur nga gjetjet e inspektimeve periodike të kryera nga MKPT në Qëndrat e Përkohshme të Pritjes dhe Strehimit të Migrantëve të parregullt në Kapshticë, Korçë dhe në Gërhot, Gjirokastër, si dhe nga monitorimi i vazhdueshëm që kryejnë dy ekspertëve të jashtëm për kufirin dhe refugjatët të Avokatit të Popullit, në këto dy zona.





➢ *Veprimtaria e Seksionit të Administratës*

Veprimtaria e Seksionit të Administratës, edhe për vitin 2022, është përqendruar në monitorimin e disa prej të drejtave themelore më të rëndësishme të njeriut, të garantuara dhe parashikuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut me Protokollet e saj Shtesë.

Gjatë vitit 2022 për rastet (ankesat dhe rastet me iniciativë) që kemi përfunduar hetimin administrativ dhe provuar se ankesat e shtetasve kanë qenë të bazuara, janë përgatitur *37 rekomandime*, drejtuar 80 organeve të administratës publike, me një total prej *79 pikash nënrekomandime* për t'u zbatuar nga ana e tyre.

Çështjet e pronësisë vazhdojnë të konsiderohen ende sot, një shqetësim madhor për zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të Shqipërisë. Tregu i pasurive të patundshme përballet në mënyrë konstante me sfida të shumta, që në një numër të konsiderueshëm të rasteve, origjinojnë nga mungesa e një sistemi të qartë e funksionues të administrimit të të drejtave të pronësisë. Mirëspecifikimi i të drejtave të pronësisë dhe regjistrimi i mirëdokumentuar i pronave të paluajtshme kanë një rëndësi primare në projektimin afatgjatë dhe përmirësimin e planifikimit urban, si dhe të zhvillimit të infrastrukturës, duke lejuar hapësirat e nevojshme për implementimin e reformave shtetërore.

Me qëllim që të jetë efiçent, sistemi i administrimit të pronave duhet të garantojë pronësinë dhe zotërimin e pronës nga pronarët e ligjshëm, duke i shërbyer përforcimit të qendrueshmërisë së sektorit të pronave të paluajtshme, reduktimit të mosmarrëveshjeve për tokën, lehtësimit të transaksioneve në lidhje me pronat dhe mbështetjes së mirëqeverisjes. Realiteti kaotik i pronave të paluajtshme në vend dhe shqetësimet e grupeve të interesit për të drejtat e pronësisë kanë rritur vëmendjen mbi rëndësinë e efektivitetit të reformave dhe efiçencës se agjensive shtetërore përgjegjëse për këto çështje.

Ekzekutimi i një vendimi të formës së prerë dhënë nga cdo gjykatë konsiderohet si një pjesë integrale e "gjykimit" për përmbushjen e të cilit shteti ka detyrim për të organizuar një sistem për zbatimin e vendimeve i cili është efektiv si në ligj dhe në praktikë dhe siguron zbatimin e tyre duke shmangur vonesat e panevojshme.

E drejta për një proces të rregullt gjyqësor parashikohet në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Element i këtij procesi është edhe ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Për këtë, duhet theksuar se dispozitivi i vendimit duhet të jetë i qartë, në mënyrë që të bëhet i kuptueshëm për përmbaruesin apo për organe të tjera të ngarkuara për ekzekutimin e tij.

Pra, qëllimi është që të ekzekutohet sa më lehtë dhe të mos krijojë konflikte edhe gjatë kësaj faze. Po kështu, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, në jurisprudencën e saj ka konsoliduar qëndrimin se ekzekutimi i një vendimi gjyqësor është pjesë përbërëse e konceptit të gjykimit të drejtë, parashikuar nga neni 6 i Konventës. Kjo gjë u elaborua më së miri në çështjen “Hornsby kundër Greqisë”.

Në nenin 6 të Konventës flitet për gjykim të drejtë, pra, për barazi palësh dhe mjetesh në dispozicion të tyre, gjykatë të krijuar me ligj dhe të pavarur e të paanshme, të drejtë për avokat edhe kryesisht ose për tu mbrojtur vetë, gjykim të shpejtë dhe publik, paraqitje provash dhe dëshmitarësh, të drejtë për përkthim në gjuhën e preferueshme, dhe elementë të tjerë të konsideruar si përbërës të nenit 6. Megjithatë nuk ka asgjë për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore si element më vehte të proçesit të rregullt gjyqësor.

Edhe përgjatë vitit 2022, *strehimi dhe e drejta e banesës*, si një ndër çështjet më të mprehta sociale, kanë vazhduar të jenë në fokusin e punës të Seksionit të Administratës. Në kuadër të trajtimit të programeve sociale, problematikat kryesore të evidentuara lidhen me mungesën e transparencës përgjatë ndjekjes së procedurave të rregullta ligjore përsa i përket shërbimeve të cilat ofrohen nga bashkia *në kuadër të politikave të saj sociale p*ër kategoritë në nevojë si:
-për kushte të papërshtatshme të jetesës në banesa;
-nevojë për rikonstruksion të menjëhershëm;
-përmbytje;
-ashtu edhe lidhur me problematikat që duhen zgjidhur si pasojë e shpronësimeve të ndodhura në kuadër të programit të rindërtimit në zbatim edhe të aktit normativ Nr 9, datë 16.12.2019 *“Për Përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”*, ku janë konstatuar zvarritje të procedurave të shqyrtimit të dosjeve përkatëse, mungesë transparence të vendimmarrjes e cila kalon për miratim në organet kolegjiale të njësive të qeverisjes vendore, etj.

Kjo e drejtë është trajtuar në kompleksitet nga ky seksion edhe në vijim të ankesave/rasteve me iniciativë që janë depozituar nga qytetarët për shkak edhe të pasojave të tërmetit të nëntorit 2019, si rezultat i moszgjidhjes së problematikave nga institucionet kompetente të cilat i përkasin problematikave të hasura në harmoni me të drejtën e pronësisë lidhur procedurat e shpronësimit të banesave individuale për interes publik si dhe procedurave për strehimin social.

Rregullimi i marrëdhënieve të punës dhe respektimi i të drejtës për një proces të rregullt ligjor në procedurën administrative, janë çështje që vazhdojnë të trajtohen nga Seksioni i Administratës, si një nga problematikat kryesore të shqyrtimit të ankesave/kërkesave për largimet, lirimet, transferimet, emërimet nga puna në administratën shtetërore të depozituara nga persona që gëzojnë ose jo statusin e nëpunësit civil. Gjithashtu, janë adresuar dhe hartuar rekomandimet përkatëse për rastet që burojnë nga marrëdhënia e punës, si në nivel vendor ashtu dhe qendror.

Mbrojtja e konsumatorit është një tjetër fushë e së drejtës ku Seksioni i Administratës ka luajtur një rol proaktiv në takimet zyrtare me drejtues të OSHEE e UKT për problematikat e paraqitura nga ankuesit. Janë analizuar me kujdes shpjegimet e dërguara nga institucionet si edhe të dokumentacionit të përcjellë dhe shpesh është vlerësuar se ka vend për përmirësim të procedurës dhe mundësitë të rivënies në vend të të drejtave të shkelura.





➢ *Veprimtaria e Seksionit të Mbrojtjes dhe Promovimit të të Drejtave të Fëmijëve*

Garantimi i respektimit të të drejtave të fëmijëve, në kuadër të mbrojtjes së veçantë që fëmijët gëzojnë nga shteti, si dhe parimi i interesit më të lartë të fëmijës kanë qenë fokusi i veprimtarisë së Seksionit të Mbrojtjes dhe Promovimit të të Drejtave të Fëmijëve, brenda mandatit kushtetues e ligjor të Avokatit të Popullit, në trajtimin e çdo rasti, edhe për vitin 2022. Pjesëmarrja e fëmijëve në aktivitetet tona në institucionet e edukimit, por jo vetëm, u ka mundësuar atyre të shprehen lirisht për çështje që i shqetësojnë në përputhje me moshën dhe pjekurinë e tyre, si dhe na ka mundësuar të dëgjojmë pikëpamjet dhe mendimet e fëmijëve.

Kjo ka përmirësuar rezultatet e punës sonë, çka është evidentuar në rritjen në vazhdimësi të numrit të fëmijëve që ankohen drejtëpërdrejt tek Avokati i Popullit. Besojmë dhe shpresojmë se këtë praktikë pune do ta përdorin edhe organet e tjera të administratës shtetërore, si një vlerë e shtuar që sjell garantimin e të drejtës së fëmijës për pjesëmarrje. Shtimi i veprimtarive promovuese me dhe për fëmijët, është kryer në funksion të edukimit e ndërgjegjësimit të të drejtave që ata kanë.

Në sistemin e regjistrimit të rasteve të trajtuara gjatë këtij viti janë rreth *223 raste*, ankesa, kërkesa, raste me iniciativë, me objekt të drejtat e fëmijëve, prej të cilave *79 raste me iniciativë*. Edhe gjatë këtij viti është vijuar me përmbushjen e njërës prej sfidave të institucionit, atë të arritjes së një numrit të ankesave dhe kërkesave drejtëpërdrejt nga vetë fëmijët, të cilat kanë arritur numrin *92* për vitin 2022.

Nga trajtimi i rasteve me organet e administratës publike është evidentuar se problematikat prekin një numër të konsiderueshëm subjektesh-fëmijë, të cilët mund të përfitojnë nga trajtimi dhe dhënia zgjidhje e tyre. Pjesëmarrja, dëgjimi dhe respektimi i mendimit të fëmijës, bën të mundur edhe realizimin e të drejtave të tjera të fëmijës.

Në lidhje me masat e marra gjatë pandemisë Covid-19, Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve evidentoi aktet normative të nxjerra për përballimin e kësaj situate[10], dhe vlerësoi se si ndikuan tek fëmijët dhe të rinjtë masat kufizuese të marra, në këto tre aspekte:

- ✓ *e drejta dhe aksesi në arsim;*
- ✓ *e drejta dhe aksesi në kujdesin për mbrojtjen shoqërore;*
- ✓ *të drejtat e fëmijëve në konflikt me ligjin.*

Në përfundim të këtij vlerësimi të gjitha gjetjet dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit, u paraqitën gjatë vitit 2022 tek organet e administratës shtetërore përkatëse në nivel qendror dhe vendor, për marrjen e masave për të ardhmen.

Në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, gjatë situatës së emergjencave, Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve realizoi monitorimin e strukturave përgjegjëse në njësitë e qeverisjes vendore të prekura nga tërmeti i 26 nëntorit të 2019.

Gjetjet dhe rekomandimet e këtij procesi inspektimi/monitorimi iu adresuan në fund të vitit 2022 institucioneve përgjegjëse, organeve të administratës publike, në nivel qendror dhe vendor, për marrjen e masave për garantimin e të drejtave të fëmijëve, në situatat e emergjencave civile apo fatkeqësive natyrore.

Gjatë vitit 2022, Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve, pas kryerjes së hetimeve administrative të pavarura, iu ka drejtuar institucioneve shtetërore të administratës publike në nivel qendror dhe vendor, *30 rekomandime dhe ka hartuar 3 raporte të veçanta*.

Në kuadrin e anëtarësisë në rrjetin ENOC (Rrjeti Europian i Ombudsmaneve për Fëmijët), fëmijët, përfaqësues të vendit tonë morën pjesë në projektin ENYA, me qëllim përgatitjen e rekomandimeve lidhur me drejtësinë klimatike. Rekomandimet e adresuara nga të rinjtë e vendit tonë dhe të rinjtë e 19-të vendeve të tjera Europiane u prezantuan në Forumin ENYA (Rrjeti Europian i Këshilltarëve të Rinj).
Rekomandimet e ENOC-ut do të bëjnë të mundur hartimin dhe nxjerrjen e udhëzimeve të Këshillit të Europës, të cilat do të pasqyrojnë një qasje gjithëpërfshirëse strategjike për respektimin, mbrojtjen dhe përmbushjen e të drejtave të fëmijës, veçanërisht në lidhje me drejtësinë klimatike. Falë mbështetjes së vazhdueshme që institucioni i Avokatit të Popullit i ka dhënë institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës, u bë i mundur anëtarësimi i këtij të fundit si anëtar i asociuar i ENOC-ut. Ky anëtarësim bën të mundur që zëri i fëmijëve dhe të rinjve të Kosovës të dëgjohet tashmë në nivel ndërkombëtar.

[10] Bazuar në studimin e institucioneve anëtare të ENOC, me mbështetjen financiare të UNICEF. Ky raport filloi në vitin 2021 dhe u botua në vitin 2022.





➢ *Veprimtaria e Seksioni të Përgjithshëm*

Edhe gjatë vitit 2022, Seksioni i Përgjithshëm, si pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit, ka vazhduar ti kushtojë një vëmendje të posaçme grupeve, komuniteteve dhe individëve vulnerabël

apo në risk, të cilët janë më të cënueshëm dhe të pambrojtur. Qasja sistemike ndaj problematikave të konstatuara, ka përbërë sërish fokusin kryesor të rekomandimeve të derguara në fushat e të drejtës për arsim, të drejtës për kujdes shëndetësor, të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, të drejtave të personave të moshuar e mbrojtjes shoqërore, të drejtave të pakicave kombëtare, të drejtave të grave dhe komunitetit LGBTI, ndihmës ekonomike e të drejtës për një mjedis të shëndetshëm.
Gjatë vitit 2022 për rastet (ankesat dhe rastet me iniciativë) që kemi përfunduar hetimin administrativ dhe provuar se ankesat e shtetasve kanë qenë të bazuara, janë përgatitur *51 rekomandime*, drejtuar 141 organeve të administratës publike, me një total prej *132 pikash nënrekomandime* për t'u zbatuar nga ana e tyre

Nën dritën e kuadrit të ri strategjik ndërkombëtar dhe kombëtar është rekomanduar hartimi i planeve konkrete të integrimit dhe përfshirjes së Romëve dhe Egjiptianëve në nivelin e qeverisjes vendore, për ti bërë ata të ndihen pjesë e një shoqërie me diversitet, gjithëpranuese dhe demokratike.

Masa e ndihmës ekonomike vijoi të mbetet, në vlerësimin e ankuesve, shumë e ulët në raport me shpenzimet mujore më të domosdoshme për të mbijetuar. Lidhur me të drejtën për të përfituar nga sistemi i sigurimeve shoqërore, konstatohet se problematikat vijojnë të jenë të njëjta apo të ngjashme me ato të raportura në vitet pararendës, ku vend jo të vogël ka zënë trajtimi i ankesave lidhur me mosmarrjen e përgjigjes lidhur me kërkesën, për verifikimin e vjetërsisë së punës, si dhe për masën e ulët të përfitimit të pensionit të pleqërisë.

Vazhdimi i pandemisë së Covid 19, ka evidentuar në kuadër të respektimit të së drejtës për përkujdesje shëndetësore cilësore, faktin se individët e varfër dhe të cënueshëm financiarisht janë përballur me kosto të larta ekonomike shtesë sa i përket kujdesit shëndetësor.

Problematikat e konstatuara për personat me aftësi të kufizuar kanë qënë të shumta. Ato kanë konsistuar në, furnizimin me paketa ushqimore dhe të mbështetjes ekonomike të personave me aftësi të kufizuar, veçanërisht ata që banojnë në zonat e thella apo personave të pastrehë, të cilët janë me aftësi të kufizuar, verifikimin periodik të gjendjes shëndetësore të përfituesve të akomoduar në Institucionet Rezidenciale të Përkujdesjes Shoqërore, inkurajimi i shtimit të përdorimit të gjuhës së shenjave në komunikimet publike zyrtare, apo edhe i qasjes në infrastrukturën rrugore të personave me aftësi të kufizuar.

Komuniteti LGBTI vazhdoi të ballafaqohet me problematika të shtuara përgjatë vitit 2022, të tilla si: ekonomia e përkeqësuar, punësimi, strehimi dhe siguria, si dhe mundësinë e komunitetit LGBTI për të plotësuar nevojat e tij bazike. Papunësia e lartë mes anëtarëve të komunitetit LGBTI, ka të bëjë me faktin se ky komunitet vuan nga numri i lartë i papunësisë sistemike, për shkaqe të tilla si: diskriminimi, bullizmi dhe largimi i komunitetit LGBTI nga sistemi arsimor.
Vlerësimi ynë i kahershëm, ndaj veprimtarisë së organeve publike ka si pikë reference faktin se, qëndrimi ndaj rekomandimeve të Avokatit të Popullit tregon ndjeshmërinë ndaj të drejtave të njeriut dhe shkallën e kulturës së mirëqeverisjes që ka administrata publike. Synimi ynë vazhdon të jetë të ushtruarit e presionit të nevojshëm pozitiv ndaj administratës sonë publike, me synimin

për të ndikuar sa më shumë në realizimin e standardeve më të larta të respektimit dhe ushtrimit efektiv të të drejtave dhe lirive të njeriut.





3. 2 Të drejtat e personave të privuar nga liria[11]

Gjetjet që do të parashtrojmë më poshtë si pjesë e këtij raporti janë rezultat i hetimit administrativ të pavarur[12] që ka ndërmarrë institucioni i Avokatit të Popullit për të verifikuar ankesat individuale të paraqitura si nga të burgosurit ashtu dhe nga familjarë të tyre, lidhur me respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale (IEVP). Shqyrtimi i ankesave individuale të të burgosurve dhe përfundimet përkatëse kanë në një numër jo të vogël rastesh karakter përgjithësues.

Në raportin e vitit të kaluar jeni njohur me një nga çështjet, e cila ka qenë objekt i punës sonë ndër vite, pasi nuk pati gjetur zgjidhje, pavarësisht interesimit tonë të vazhdueshëm. Bëhet fjalë për mos nxjerrjen e aktit nënligjor për shpërblimin me para të punës së kryer nga të burgosurit.[13] Në vitin 2021, është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.602, datë 13.10.2021 "*Për përcaktimin e rregullave të posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës, kohëzgjatjen dhe shpërblimit të saj*", ku ndër të tjera përcaktohet pagesa për punën e siguruar nga administrata e IEVP-së dhe nga subjekte private. Sa i përket zbatimit të këtij akti nënligjor, gjatë vitit 2022 kemi kërkuar të informohemi nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë nëse ishte parashikuar buxheti i nevojshëm për shpërblimin e punës të të burgosurve. Referuar përgjigjes që kemi marrë nga Ministria e Drejtësisë[14], pas koordinimit të tre institucioneve për çështjen e buxhetit, janë lidhur kontrata pune për 340 të punësuar të dënuar/ të paraburgosur sipas nevojave dhe organikës së miratuar të institucionit për vitin 2022 dhe deri më nëntor 2022 janë kryer pagesat për 170 të dënuar/paraburgosur, për shkak se të burgosurit e tjerë të punësuar nuk kanë kartë ID dhe janë në pritje për pajisjen me këtë dokument, për të vijuar më tej me pajisjen me numër llogarie bankare. Ndërsa, disa IEVP janë në pritje të finalizimit nga bankat e nivelit të dytë për hapjen e llogarive për këtë kategori të punësuarish. Gjithashtu, jemi informuar se në zbatim të kësaj VKM-je, aktualisht janë 8 të burgosur të punësuar në sektorin privat, si operatorë në njësitë tregtare të institucionit, të cilët trajtohen financiarisht nga këto kompani. Pavarësisht përpjekjeve të bëra, vlerësojmë se ky numër të punësuarish është relativisht i vogël[15], ndaj do duhen marrë masa thelbësore e proaktive për zgjidhjen e kësaj çështjeje e garantimin efektiv të së drejtës së punësimit të të burgosurve me qëllim jo vetëm fitimin dhe zhvillimin e aftësive për punë dhe njohurive profesionale, por edhe shpërblimin me para për punën e kryer.

Ankesa e një të burgosuri na dha mundësinë të kryejmë verifikime të thelluara mbi *procedurën e transferimit* në vendin tonë të shtetasve shqiptarë për të vuajtur pjesën e mbetur të dënimit të dhënë nga një gjykatë e huaj. Ankuesi shprehet se është njohur me vendimin e gjykatës shqiptare që e ka dënuar në mungesë me burgim të përjetshëm në përfundim të procesit gjyqësor për njohjen

[11] Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Veçantë në institucionin e Avokatit të Popullit.
[12] Për vitin 2022, numri i rasteve me iniciativë dhe ankesave të administruara nga të burgosur apo familjarë të tyre është 76 dhe nga punonjës të IEVP-ve është 3.
[13] Në vitin 2013, i është dërguar rekomandim Ministrisë së Drejtësisë, ku është kërkuar hartimi i projekt VKM-së për përcaktimin e kritereve të shpërblimit të punës të të burgosurve dhe dërgimin e tij sa më parë për miratim në Këshillin e Ministrave. Përgjigjet që kemi marrë ndër vite nga Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve mund t'i përmbledhim duke thënë se, hartimi i projekt vkm-së për shpërblimin e punës ndodhej në një procedurë të përhershme studimi
[14] Përgjigjja nga Ministria e Drejtësisë është dërguar në muajin nëntor 2022.
[15] Numri i të burgosurve (të dënuar dhe të paraburgosur) referuar inspektimeve te institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2022 ka qenë përafërsisht 5500 shtetas.

e një vendimi të Gjykatës së Mbretërisë në Winchester kur i është komunikuar transferimi për në Shqipëri, ndërsa ndodhej në burg në Angli. Pas transferimit në vendin tonë ai nuk ka mundur të kundërshtojë vendimin për mungesë të njohurive ligjore dhe të pamundësive financiare për të paguar një avokat. Nga ana jonë ka patur interesim pranë autoriteteve të përfshira në procedurën e njohjes së vendimit të huaj dhe transferimit në Shqipëri të këtij shtetasi. Në përfundim të hetimit tonë administrativ, pasi kemi analizuar në tërësi dokumentacionin, marrëveshjen ndërkombëtare në fuqi që ka të bëjë me transferimin e të burgosurve dhe legjislacionin që rregullon këtë fushë ka rezultuar se: institucionet e përfshira në procedurën e njohjes së vendimit të huaj nuk janë koordinuar për të garantuar që i burgosuri të transferohet vetëm pasi t'i jepej forma e prerë vendimit penal të gjykatës tonë dhe se ka vend për të përmirësuar procedurën e transferimit në mënyrë që garantohet efektivisht një proces i rregullt ligjor, dhe konkretisht ushtrimi i së drejtës së ankimit nga palët në proces për të kundërshtuar një vendim gjyqësor në një gjykatë më të lartë. Duke parë angazhimin në rritje të institucioneve tona dhe atyre të vendeve të tjera, për të transferuar të dënuarit shqiptarë, pritshmëria është që numri i çështjeve të kësaj natyre të shtohet. Prandaj nisur nga ky rast, i rekomanduam[16] Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë së Përgjithshme dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor: Analizimin e këtij rasti dhe marrjen e masave për koordinimin e veprimeve administrative dhe procedurale ndërmjet institucioneve të përfshira në procedurën e njohjes së vendimit të huaj, për të siguruar të drejtën e shtetasit shqiptar që do të transferohet në vendin tonë për të vuajtur pjesën e mbetur të dënimit të dhënë nga një gjykatë huaj, për t'u përfaqësuar në këtë proces në gjykatën shqiptare me një mbrojtës të caktuar prej tij dhe për të ushtruar të drejtën e ankimit.

Lidhur me transferimin e shtetasve shqiptarë për të vuajtur pjesën e mbetur të dënimit në një IEVP të vendit tonë, në institucionin e Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë edhe një shtetas tjetër, i cili shprehte shqetësimin për djalin e tij për zvarritje të këtyre procedurave. Për të përmbushur synimin e dënimit me burgim, rehabilitimin dhe riintegrimin e të burgosurit në jetën familjare, shoqërore dhe ekonomike, në ligjin nr. 81/2020 "*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*", neni 39, pika 5, është përcaktuar se të burgosurit, si rregull, caktohen në institucione pranë vendbanimit të familjeve të tyre. Këtij qëllimi i shërben edhe Konventa e Këshillit të Europës "*Për transferimin e personave të dënuar*", ratifikuar me ligjin nr.8499, datë 10.06.1999. Me ratifikimin e kësaj Konvente, shteti shqiptar është angazhuar të bashkëpunojë me shtete të tjerë për t'i krijuar mundësinë shtetasve shqiptarë të vuajnë dënim me burgim në vendin tonë. Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese u njohëm me qëndrimin e Ministrisë së Drejtësisë për sa i përket transferimit në përgjithësi të të burgosurve shqiptarë që vuajnë dënimin jashtë vendit. Sipas Ministrisë së Drejtësisë ka një numër të konsiderueshëm shtetasish shqiptarë të dënuar që presin të transferohen në burgjet e Shqipërisë dhe pranimi i kërkesave të tyre nuk është një çështje thjesht procedurale apo administrative, por është një çështje që lidhet me politikat penitenciare shtetërore, hapësirat e lira në sistemin penitenciar, marrëdhëniet me shtetet e ndryshme si dhe vlerësimin e kostove të shtuara financiare për mbajtjen e çdo të dënuari të burgosur në burgjet tona konform standardeve aktuale europiane. Për sa i përket rastit konkret, Ministria e Drejtësisë na ka dhënë vetëm informacion të përgjithshëm se arsyeja është

[16] Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës. https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20per%20koordinimin%20ndermjet%20institucioneve%20te%20perfshira%20ne%20proceduren%20e%20njohjes%20se%20vendimeve%20te%20huaja%20penale.pdf.

mbipopullimi i IEVP-ve[17] në vend, por nuk na vuri në dispozion ndonjë informacion lidhur me kapacitetet dhe popullimin e IEVP Tropojë, që ndodhet më afër vendbanimit të familjes së të dënuarit, apo të ndonjë IEVP-je tjetër. Nisur nga ky rast, i paraqitëm gjetjet tona[18] Ministrisë së Drejtësisë duke dhënë mendimin tonë se duhet të ketë një vëmendje dhe angazhim të shtuar të autoriteteve shqiptare për krijimin e hapësirave të nevojshme akomoduese për të mundësuar transferimin e shtetasve shqiptarë për të vuajtur dënimin në IEVP-të e vendit.

Referuar kuadrit ligjor mbi trajtimin dhe të drejtat e të burgosurve, evidentojmë se një nga risitë pozitive të sjella nga ligji nr.81/2020 "*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*", është *garantimi i të drejtës së të burgosurve për të vazhduar arsimin e mesëm dhe të lartë* gjatë qëndrimit në IEVP.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka verifikuar ankesën e paraqitur nga një i dënuar, i cili pretendonte se nuk i ishte krijuar mundësia për të përfunduar arsimin e lartë. Më konkretisht ky i dënuar shpjegonte se, kur ndodhej në gjendje të lirë ndiqte studimet në një nga universitet publike të Tiranës. Kur është arrestuar si i dyshuar për kryerjen e dy veprave penale, studimet janë ndërprerë. Pasi ai është dënuar me vendim të formës së prerë, ka treguar interes për të vijuar studimet, ndaj i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për të përfunduar arsimin e lartë, por nuk i është garantuar e drejta për arsim.

Nga hetimi administrativ i këtij rasti rezultoi se të dënuarit i është krijuar mundësia që të vijojë studimet për vitin akademik 2022-2023 përmes platformës online, por Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe IEVP-ja kanë hasur në vështirësi që i dënuari të ndjekë çdo ditë leksionet online për një kohëzgjatje 3-4 orë, për arsye të kapaciteteve jo të plota infrastrukturore dhe orarit të veprimeve që kanë IEVP-të. Gjithashtu, u konstatua se nuk është nxjerrë ende akti nënligjor ku të përcaktohen rregullat për mënyrën e zhvillimit të arsimit, akt që duhet të ishte nxjerrë brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit nr.81/2020 "*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*". Ligji ngarkon për nxjerrjen e këtij akti, Ministrin e Drejtësisë dhe ministrin përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional.

Nga ana jonë iu rekomandua[19] Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Arsimit marrja e masave për bashkërendimin e punës për përgatitjen dhe nxjerrjen e aktit nënligjor ku të përcaktohen rregullat për zhvillimin e arsimit të mesëm dhe të lartë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penal si dhe marrja e masave për përllogaritjen e një buxheti të dedikuar për të garantuar efektivisht të drejtën e të burgosurve për zhvillimin e arsimit të mesëm dhe të lartë.

Një numër jo i vogël ankesash të trajtuara nga ana jonë kanë të bëjnë me *trajtimin shëndetësor të të burgosurve*. Sipas ligjit nr. 81/2020 "*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*",[20] personeli mjekësor duhet të kontrollojë periodikisht të gjithë të burgosurit sipas një grafiku të hartuar nga drejtoria e institucionit dhe të burgosurit me sëmundje kronike

[17] Ndërkohë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve deklaron që ka kapacitete të lira.
[18] Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës. https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20per%20transferimin%20e%20A.S%20nga%20burgu%20i%20Kosoves%20ne%20nje%20burg%20te%20Shqiperise.pdf.
[19] Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës. https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20per%20arsimimin%20ne%20burgje_yTR1hIJ.pdf.
[20] Më konkretisht bazuar në nenin 41, pika 10 dhe nenin 42, pika 9 të ligjit nr. 81/2020.

përfitojnë shërbime të kujdesit shëndetësor sipas standardeve që zbatohen për këto kategori pranë institucioneve të specializuara jashtë sistemit të burgjeve.

Për sa i përket trajtimit shëndetësor të kategorisë të të burgosurve me sëmundje kronike, kemi kryer veprime hetimore për të verifikuar nëse një i paraburgosur në IEVP "Jordan Misja", Tiranë, i diagnostikuar me Diabet mellitus, kishte kryer ose jo disa analiza dhe ekzaminime të domosdoshme për të përcaktuar stadin e kësaj sëmundje. Në përfundim të hetimit rezultoi se nuk ishte planifikuar periodiciteti i ekzaminimeve që duhet të kryente i paraburgosuri, si person i diagnostikuar me diabet mellitus, në zbatim të Guidës për Diagnostikimin, Klasifikimin dhe Trajtimin e Diabetit Mellitus, si dhe nuk ishte mbajtur procesverbal për çdo rast që sipas IEVP-së, i paraburgosuri kishte refuzuar të shoqërohej për të kryer vizita, në zbatim të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve. Në këtë drejtim, vlerësojmë të theksojmë se gjatë procesit të draftimit dhe miratimit të Rregullores e re të Përgjithshme të Burgjeve[21] janë marrë në konsideratë rekomandimet dhe sugjerimet tona duke parashikuar në këtë akt nënligjor që: refuzimi i të burgosurit për të marrë medikamente apo për të kryer ekzaminime të dokumentohet në një procesverbal të nënshkruar prej tij dhe punonjësve të IEVP-së dhe në rast se i burgosuri nuk pranon të nënshkruajë procesverbalin, ky dokument të nënshkruhet nga më shumë se një punonjës dhe të administrohet pranë shërbimit ligjor me numër protokolli të brendshëm, në mënyrë që të evidentohet në kohë kryerja e veprimit.

Në Guidën për Diagnostikimin, Klasifikimin dhe Trajtimin e Diabetit Mellitus, botuar në vitin 2019 nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, ndodhet tabela me periodicitetin e ekzaminimeve që duhet të kryejë personi me diabet mellitus. Nga ana jonë është çmuar se metodologjia e kësaj tabele duhet të zbatohet nga mjekët e IEVP-ve në planifikimin e analizave për të burgosurit e diagnostikuar me diabet mellitus.

Gjithashtu, në objektin e punës tonë ka qenë edhe hetimi administrativ i ankesave të punonjësve të admistratës së IEVP-ve, si të lidhura ngushtë me shërbimin që ata i ofrojnë të burgosurve. Nuk mund të trajtohen problematikat në sistemin penitenciar pa marrë parasysh vështirësitë, me të cilat përballen ata që janë në kontakt të drejtpërdrejtë me personat e privuar nga liria, ata që japin kontribut çdo ditë për menaxhimin e burgjeve. Çmojmë se jo vetëm kjo kategori është subjekt i punës sonë për sa i përket të drejtave që gëzojnë, por edhe se mënyra e trajtimit të tyre pasqyrohet në marrëdhëniet me të burgosurit. Ankesat e personelit të IEVP-ve që kemi shqyrtuar kanë patur si objekt mos dhënien e dietave në rastet e komandimit jashtë qendrës së punës apo jashtë vendbanimit, trajtimi i munguar me uniformë, ndalesat në pagën mujore të infermierëve të IEVP-ve dhe ulja e pagesës së tyre për orët shtesë si dhe mos dhënia e pagesës kalimtare kur një punonjës i Policisë së Burgjeve largohet nga detyra. Hetimi administrativ që ndërmorëm ka përfunduar për sa i përket ankesës së një ish punonjësi të Policisë së Burgjeve për mosdhënien e pagesës kalimtare, çështje që ka gjetur zgjidhje gjatë shqyrtimit tonë nga vetë masat e marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Po ashtu një problematikë e trajtuar nga ana jonë ishte ajo e mos dhënies së dietave disa punonjësve të policisë së IEVP Lezhë, të cilët ishin komanduar në vitin 2018 – 2019 në Forcën Operacionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Lidhur me këtë të fundit ka rezultuar se

[21] VKM nr.209, datë 06.04.2022 "Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve".

punonjësit e policisë të komanduar nuk ishin trajtuar me dieta sipas legjislacionit në fuqi. Nga ana jonë iu rekomandua[22] IEVP Lezhë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve marrja e masave të nevojshme për përllogaritjen konkrete dhe trajtimin me dieta të punonjësve të policisë së komanduar në periudhën përkatëse.

Së fundmi, është e rëndësishme që të theksojmë përmirësimin e bashkëpunimit me Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe në mënyrë të vecantë ngritjen e strukturave të veçanta për vlerësimin e rekomandimeve të institucioneve të të drejtave të njeriut.

3.3 Respektimi i të drejtave të njeriut nga organet e Policisë së Shtetit[23]

Objekti i ankesave dhe i rasteve me iniciativë të administruara në institucionin e Avokatit të Popullit gjatë vitit 2022[24], ndaj strukturave dhe punonjësve të Ministrisë së Brendshme dhe të Policisë së Shtetit ka qenë i larmishëm, ku do të evidentonim rastet për shoqërime të paligjshme apo mbajtje në gjendje shoqërimi tej afatit të nevojshëm për sqarimin e shkakut/arsyes së shoqërimit; për mos pasqyrimin në procesverbalin e arrestimit në flagrancë të orës faktike të personave të shoqëruar si të dyshuar për kryerjen e një vepre penale; për mos njoftimin nga policia të familjarëve të të shoqëruarve apo moslejimin e tyre të komunikojnë vetë me ta me telefonat e tyre; për mos mbajtje dhe mos dhënie të procesverbaleve për veprimet e kryera nga punonjësit e policisë; për arrestime apo ndalime të paligjshme; për sjellje pa etikë të punonjësve të policisë gjatë komunikimit; për vendosje të masave administrative të kundërligjshme nga punonjësit e Policisë Rrugore; për cënimin e të drejtës së shtetasve për t'u pranuar e arsimuar në Akademinë e Sigurisë; për shkelje të të drejtave të shtetasve të huaj në Shqipëri, si refuzim të hyrjes në vendin tonë, refuzimin e pajisjes së tyre me leje qëndrimi, për ndalimin në qendrën e mbyllur pa aplikuar më parë masat alternative, për mbajtjen në gjendje ndalimi tej afatit ligjor dhe për mos sigurimin e mbrojtjes dhe përkthyesit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale; për cënim të të drejtave ligjore të punonjësve të Policisë së Shtetit lidhur me mos pagesën për punën e kryer tej orarit zyrtar, dietat dhe transferimet, etj.

Disa nga të drejtat kushtetuese dhe ligjore për të cilat janë bërë rekomandime gjatë vitit 2022 mund të përmenden si më poshtë vijon:

- *E drejta e shtetasve për të mos iu cënuar integriteti fizik dhe trajtuar me dinjitet*

Gjatë vitit 2022 janë administruar disa ankesa dhe raste të filluara me nismën e institucionit tonë pas bërjes publike në media të cilat kanë pasur si objekt ushtrim të dhunës fizike e psikologjike dhe tejkalim të forcës në rastet e tubimeve të organizuara nga subjekte politike apo grupime të ndryshme qytetarësh, shoqërimit, pyetjes apo arrestimit/ndalimit të tyre si autorë të dyshuar të veprave penale. Në rastet kur shkeljet e konstatuara nuk përmbanin elementë të ndonjë vepre penale, por shkelje disiplinore, janë bërë rekomandime drejtuar strukturave të Policisë së Shtetit për fillimin e procedimeve disiplinore e dhënien e masave administrative, si dhe marrjen e

[22] Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës. https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20per%20dietat%20e%20disa%20punonjesve%20te%20policise%20se%20IEVP%20Lezhe%20te%20komanduar%20ne%20DPB%20ne%20vitin%202019.pdf.
[23] Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Veçantë në institucionin e Avokatit të Popullit.
[24] Numri rasteve me iniciativë dhe ankesave të administruara për vitin 2022 është 71.

masave tekniko organizative për trajnimin e punonjësve të policisë dhe mos përsëritjen e tyre në të ardhmen. Disa nga këto ankesa dhe raste kanë qenë:

Rasti i filluar me iniciativë pas publikimit në disa media vizive dhe të shkruara në datën 07.12.2022 e në vijim, të pamjeve filmike dhe fotove të shtetasit të arrestuar për kryerjen e një vepre penale G.Sh. në ambientet e Spitalit të Traumës Tiranë. Ky shtetas shfaqet me pranga në duar, i enjtur dhe i shtrirë në një krevat në ambientet e spitalit ku po merrte trajtim mjekësor. Më pas ai shfaqet sërish me pranga në dorën e djathtë duke nënshkruar një dokument të përpiluar nga punonjësit e Policisë së Shtetit të cilët ishin të pranishëm. Këto pamje filmike dhe fotografike provojnë faktin e pakundërshtueshëm se i arrestuari G.Sh. mbahej i lidhur me pranga në mënyrë të vazhdueshme në Spitalin e Traumës dhe me shumë mundësi i lidhur në krevatin në të cilin ndodhej i shtrirë.

Avokati i Popullit e dënoi ashpër sulmin e kryer nga ky shtetas ndaj z. S.B.. Gjatë veprimtarisë së tij, institucioni ynë në mënyrë të vijueshme ka shprehur qëndrime publike kundër çdo lloj forme të dhunës fizike apo psikologjike si nga punonjësit e institucioneve shtetërore ndaj qytetarëve, ashtu edhe nga shtetas të ndryshëm ndaj përfaqësuesve të strukturave shtetërore dhe atyre politike. Në të gjitha rastet vlerësojmë ndëshkimin ligjor të të gjithë personave që kryejnë këto akte të kundërligjshme.

Por, ndërkohë nga shqyrtimi i këtij rasti të bërë publik në media, Avokati i Popullit, pavarësisht pozitës ligjore në të cilën gjendet shtetasi i arrestuar G.Sh., solli në vëmendje dhe analizojë fenomenin negativ që cënon rëndë të drejtat themelore të individëve sikurse është ai i mbajtjes lidhur me pranga të personave të ndaluar/arrestuar apo dënuar në kushte spitalore.

Nga analizimi i kuadrit ligjor në fuqi, konstatuam se procedura e mbajtjes të prangosur të personave të arrestuar apo ndaluar nga Policia e Shtetit në kushte spitalore, nuk është e bazuar në aktet normative në fuqi. Kjo sjellje vjen në kundërshtim të plotë dhe të hapur me: nenet 17, 25 dhe 28/5 të Kushtetutës tonë; nenin 3 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut *për të mos iu nënshtruar torturës ose dënimit ose trajtimit çnjerëzor ose poshtërues;* jurisprudencën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut; Procedurën standarde me titull:*"Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre"*, miratuar me Urdhrin nr. 925, datë 18.07. 2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Gjithashtu edhe Komiteti i Parandalimit të Torturës (KPT) të Këshillit të Europës është shprehur se praktika e mbajtjes së prangosur në spital e personave të burgosur është një akt degradues ndaj individëve dhe duhet zëvëndësuar me masa të tjera alternative sigurie. Për sa më sipër, i rekomanduam[25] Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë: Marrjen e masave të menjëhershme për garantimin e trajtimit njerëzor dhe jo degradues të shtetasit të arrestuar G.Sh., duke i hequr prangat dhe mos mbajtjen e tij të lidhur

[25] Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës. https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandimi%20drejtuar%20DPP%20Shtetit%20dhe%20DVP%20Tirane%20per%20G.Sh.pdf

gjatë trajtimit mjekësor; Analizimin e thellë e me objektivitet të këtij rasti, nxjerrjen e përgjegjësive konkrete dhe fillimin e procedurës disiplinore ndaj punonjësve të policisë që kanë kryer shkelje ligjore; Marrjen e masave të menjëhershme për njohjen e punonjësve të Policisë së Shtetit me Procedurën standarde me titull: *"Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre"*, miratuar me Urdhrin nr. 925, datë 18.07. 2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit; Përgjithësimin e këtij rasti në të gjitha strukturat vendore e qëndrore të Policisë së Shtetit me qëllim që të mos përsëriten në të ardhmen raste të tilla të shkeljes së të drejtave themelore të shtetasve nga ana e punonjësve të këtij organi. *Rekomandimi u mirëprit dhe u pranua.*

➢ *Shoqërimi i shtetasve në organet e Policisë së Shtetit, respektimi i kritereve ligjore dhe i të drejtave të tyre*

Shoqërimi i shtetasve në organet e policisë është një veprim administrativ i shpeshtë në veprimtarinë e përditëshme të strukturave vendore të Policisë së Shtetit[26]. Ky veprim, i cili kryhet si për rastet e shkeljeve administrative ashtu edhe në rastet kur një person dyshohet se ka kryer një vepër penale, sjell si pasojë kufizimin e lirisë së të shoqëruarit. Për këto arsye, kjo e drejtë e Policisë së Shtetit duhet të aplikohet në mënyrë rigoroze konform kritereve të përcaktuara qartësisht në dispozitat e cituara e ligjit "Për Policinë e Shtetit", si dhe në Procedurën standarde të punës "Rregullat për trajtimin e shtetasve të shoqëruar në mjediset e policisë", miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Nga shqyrtimi i disa ankesave dhe nga inspektimet e bëra në organet e Policisë së Shtetit kemi konstatuar se numri i personave të shoqëruar ka qenë i konsiderueshëm dhe sidomos në rastet e tubimeve të ndryshme.

Për shkak të mungesës së ambienteve të shoqërimit në disa struktura vendore të Policisë së Shtetit, si dhe i kushteve të tyre, sikurse parashikohet në ligjin dhe në procedurën standarde të cituar më sipër, si mungesës së hapësirave, të ndriçimit natyral, të orendive të nevojshme për të qëndruar ulur, të kushteve higjeno-sanitare, etj., shoqërimi i shtetasve në organet e Policisë së Shtetit sjell edhe shqetësime të tjera pa anashkaluar ato psikologjike. Ndonëse në disa komisariate e stacione policie ka filluar përmirësimi i kësaj situate në ambientet e shoqërimit, por problemi është evident në disa komisariate në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, respektivisht në komisariatet nr. 2, 3 e 4, ku numri i shtetasve të shoqëruar ka rezultuar shumë i lartë. Disa nga rastet për të cilat janë konstatuar shkelje ligjore lidhur me të shoqëruarit mund të përmendim:

- Ankesa e bërë nga shtetasit A.G., G.L., Sh.G.(D.), V.C.(D), L.I.(D.), A.I. dhe Z.I.. Sipas ankuesve, disa punonjës të Komisariatit të Policisë Tepelenë kishin kryer veprime të kundërligjshme ndaj tyre, si hyrje në banesë, shoqërim në komisariat, heqje e aparateve të telefonit celular dhe nuk i kishin lejuar që të komunikonin me të afërmit dhe me avokatin e tyre.

[26] Shoqërimi është dërgimi i shtetasit në ambientet e policisë, në institucionet shëndetësore, në qendrat e rehabilitimit, te kujdestari ose personi përgjegjës, në institucionin urdhërdhënës ose në institucionet e tjera me ose pa vullnetin e tij, sipas përcaktimeve të bëra në nenet 109 dhe 122, pika 1 të ligjit nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit".

Pas shqyrtimit të këtij rasti konstatuam se veprimet e punonjësve të policisë, si vajtja e hyrja në banesë, këqyrja e vendit të ngjarjes, shoqërimi i ankuesve dhe kryerja e veprimeve të tjera procedurale ishin bërë mbi bazën e kërkesës dhe kallëzimit të bërë nga shtetaset A.H. dhe V.D., të cilat banonin në banesën objekt konflikti pronësie. Qëllimi i hyrjes në banesë ka qenë administrimi dhe ndjekja e kallëzimit të bërë në përputhje me aktet normative në fuqi të cilat rregullojnë veprimtarinë e Policisë së Shtetit dhe të policisë gjyqësore, si dhe parandalimi i ndonjë ngjarjeje të rëndë kriminale ndërmjet palëve në konflikt.

Ndërsa heqja e telefonave të të shoqëruarve nuk është një veprim korrekt. Ai vjen në kundërshtim me frymën e Procedurës standarde të punës "Rregullat për trajtimin e shtetasve të shoqëruar në mjediset e policisë". Aparatet e telefonit celular në këtë rast nuk ishin sende të kundërligjshme dhe as sende rrezikshme që mund të cënonin jetën e tyre, atë të punonjësve të policisë dhe sigurinë e institucionit/komisariatit. Ndërkohë konstatuam se nga punonjësit e policisë që kishin punuar me ankuesit e shoqëruar nuk ishin përpiluar e dhënë kopjet e procesverbaleve të veprimeve të kryera me të shoqëruarit. Ky qëndrim/mosveprim vjen në kundërshtim të plotë dhe të hapur me nenin 109/5 të ligjit "Për Policinë e Shtetit" dhe me Kreun e VII-të, pika 1, gërma "a.3" të Procedurës standarde të cituar më sipër.

Për këtë rast, i rekomanduam[27] Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastër dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit: Marrjen e masave të nevojshme për fillimin e ecurisë disiplinore ndaj punonjësve të që kanë kryer veprime procedurale me ankuesit; Marrjen e masave të nevojshme për të ushtruar kontroll në mënyrë të vijueshme në të gjitha strukturat vendore të policisë lidhur me zbatimin e kritereve të shoqërimit të shtetasve në ambientet e policisë dhe respektimin e të drejtave ligjore të të shoqëruarve, duke përfshirë edhe përpilimin dhe dhënien e procesverbalit për veprimet e kryera me të shoqëruarit; Trajnimin në vijimësi të punonjësve të Policisë së Shtetit lidhur me njohjen e akteve normative që rregullojnë veprimtarinë e këtij organi, rastet dhe kriteret e shoqërimit dhe respektimin e të drejtave ligjore të personave të shoqëruar; si dhe përgjithësimin e këtij rasti në strukturat vendore të Policisë së Shtetit me qëllim që shkelje të tilla të mos përsëriten në të ardhmen. *Rekomandimi u mirëprit dhe u pranua*.

- Me shumë vëmendje janë monitoruar nga institucioni i Avokatit të Popullit protestat e zhvilluara në disa qytete të vendit ndaj rritjes së çmimeve të disa produkteve në muajin Mars 2022. Në media janë shfaqur pamje të personave të veshur civilë, të cilët kanë kufizuar fizikisht protestues dhe më pas i kanë dorëzuar ata tek punonjës të policisë të veshur me uniformë për t'i shoqëruar në mjediset e policisë.

Lidhur me këto veprime është ngritur shqetësim në media nga qytetarë të ndryshëm, duke i konsideruar si të paligjshme, pasi punonjës të policisë të veshur civilë nuk identifikohen e si të tillë mund të sjellin mosbindjen ndaj urdhrave të tyre.

Në përfundim të hetimit të rastit të filluar me iniciativë për këtë çështje dhe analizimit të kuadrit ligjor në fuqi, arritëm në përfundimin se legjislacioni nuk vendos ndalime për punonjësit e policisë të veshur civilë për të kufizuar fizikisht persona dhe për të realizuar shoqërimin e tyre në

[27] https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20drejtuar%20Kom%20Pol%20Tepelene%20dhe%20DVP%20Gjirokaster%20per%20Z.I.pdf.

mjediset e strukturave të Policisë së Shtetit, nëse dyshohet se këta shtetas kanë kryer një vepër penale. Por, evidentuam se këta punonjës gjatë kapjes dhe shoqërimit të shtetasve nuk mbanin në mënyrë të dukshme dokumentin e identifikimit, siç parashikohet në nenin 37, pika 5 të Rregullores së Policisë së Shtetit të miratuar me VKM Nr.750, datë 16.09.2015 dhe në përputhje me praktikën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Ndërkohë konstatuam se nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit nuk ishin miratuar rregulla të posaçme në rastet kur punonjësit e strukturave qendrore dhe vendore për hetimin e krimeve do të kryejnë detyra në publik pa uniformë policie, në zbatim të nenit 37, pika 5 të Rregullores se Policisë së Shtetit.

Për sa më lart i rekomanduam[28] Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit: Hartimin dhe miratimin e një procedure standarde në zbatim të nenit 37, pika 5 të Rregullores së Policisë së Shtetit, lidhur me rregullat që duhet të zbatojnë në rastet kur punonjësit e Policisë së Shtetit, efektivë të strukturave qëndrore dhe vendore për hetimin e krimeve, do të kryejnë detyra në publik pa uniformë. Në hartimin e këtyre rregullave të kihet në vëmendje praktika e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut për rastet konkrete; Marrjen e masave për trajnimin e punonjësve të strukturave qëndrore dhe vendore për hetimin e krimeve me qëllim që kur kryejnë detyra në publik pa uniformë si dhe në rastet kur ndërhyjnë për të arrestuar apo shoqëruar persona të dyshuar si autorë të veprave penale të identifikohen/prezantohen me dokumentin zyrtar si punonjës të Policisë së Shtetit. *Rekomandimi u mirëprit dhe u pranua*.

- *E drejta kushtetuese e lirisë së personit*

Liria është një nga të drejtat themelore kushtetuese të çdo personi e garantuar nga neni 27 i Kushtetutës tonë dhe neni 5 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Për këto arsye rastet e heqjes dhe kufizimit të lirisë janë përcaktuar në mënyrë shteruese në pikën 2 të nenit 27 të Kushtetutës dhe në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale. Sipas nenit 111 të ligjit nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit", punonjësi i policisë bën arrestimin dhe ndalimin e personit, sipas përcaktimeve në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale[29].

Nga përmbajtja e nenit 251 të këtij Kodi rezulton se oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore, atributet e të cilëve i gëzojnë edhe punonjësit e Policisë së Shtetit, në rastet e parashikuara në pikën 1 janë të detyruar të bëjnë arrestimin e shtetasve, ndërsa në rastet e pikave 2 dhe 3 arrestimi është një një veprim në diskrecionin e tyre. Ndërsa në nenin 253, pika 2 të Kodit të Procedurës

[28] https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20per%20hartimin%20dhe%20miratimin%20e%20rregullave%20lidhur%20kryerjen%20e%20detyrave%20te%20punonjesve%20ne%20publik%20pa%20uniforme.pdf.

[29] Referuar nenit 251 të këtij Kodi, pika 1, oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore kryejnë detyrimisht arrestimin e cilitdo që kapet në flagrancë për një krim me dashje, të kryer ose të mbetur në tentativë, për të cilin ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se pesë vjet. Ndërsa sipas pikës 2 të këtij neni, oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore kanë të drejtë të arrestojnë cilindo që kapet në flagrancë për një krim me dashje, të kryer ose të mbetur në tentativë, për të cilin ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se dy vjet ose për një vepër penale të kryer nga pakujdesia, për të cilën ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se dhjetë vjet. Gjithashtu në pikën 3 të po këtij neni parashikohet se, kur lind nevoja e domosdoshme, për shkak të rëndësisë së faktit ose të rrezikshmërisë së subjektit, e motivuar me akt të veçantë, oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore kanë të drejtë të arrestojnë cilindo që kapet në flagrancë, edhe kur nuk janë kushtet e pikës 2.

Penale parashikohet e drejta e policisë gjyqësore që të kryejë ndalimin me iniciativën e vet kur nuk është e mundur, për shkak të gjendjes së ngutshme, të pritet urdhri i prokurorit. Pikërisht në këto raste mund të abuzohet nga punonjësit e policisë gjatë ushtrimit të kësaj të drejte ligjore në dëm të shtetasve. Sipas nenit 255 të KPrP, në të gjitha rastet e arrestimit në flagrancë dhe ndalimit të shtetasve, punonjësit e policisë gjyqësore kanë detyrimin që të njoftojnë menjëherë prokurorinë e vendit ku është kryer arrestimi ose ndalimi; t'i bëjnë të ditur të arrestuarit ose të ndaluarit se nuk ka asnjë detyrim të bëjë deklarata dhe në qoftë se do të flasë, çfarëdo që ai thotë, mund të përdoret ndaj tij në gjykim; t'i bëjnë të ditur të ndaluarit ose të arrestuarit edhe të drejtën që ai ka për të zgjedhur mbrojtës dhe njoftojnë menjëherë mbrojtësin e zgjedhur ose, kur është rasti, atë të caktuar nga prokurori; të shënojnë në procesverbal datën orën dhe emrin e oficerit të policisë gjyqësore që ka kryer arrestimin ose ndalimin; ta informojnë menjëherë personin e arrestuar për arsyet e arrestimit ose ndalimit dhe për të drejtat e tij, sipas nenit 34/b, të këtij Kodi; me pëlqimin e të arrestuarit ose të ndaluarit, duhet të lajmërojnë pa vonesë familjarët, ndërsa kur i arrestuari ose i ndaluari është i mitur lajmërohet detyrimisht prindi ose kujdestari si dhe zbatohen rregullat e Kodit të Drejtësisë për të Miturit.

Nga ankesat e ardhura në institucion ka pasur pretendime lidhur me arrestime/ndalime të paligjshme, mos sigurimin e mbrojësit ligjor, mos njoftimin e familjarëve, mos shënimin e saktë të orës/çastit të arrestimit në flagrancë apo ndalimit të tyre, etj. Për disa ankesa, pas hetimit kemi konstatuar në një numër rastesh shkelje ligjore që lidhen me kohën e shënimit në procesverbalin e arrestimit në flagrancë apo ndalimit të shtetasve. Këto shkelje kryhen në rastet kur personi shoqërohet në organin e policisë pas kapjes në flagrancë ose për ndonjë verifikim administrativ dhe gjatë punës që punonjësit e policisë kryejnë, rezulton se ai është i dyshuar se ka kryer një vepër penale ose është shpallur në kërkim për shkak se ndaj tij ka një dënim me burgim në mungesë. Mbi bazën e provave dhe dokumentacionit të administruar ai arrestohet ose ndalohet, por ora e arrestimit/ndalimit në procesverbal në këto raste shënohet ajo e mbajtjes/përpilimit të procesverbalit dhe jo ora faktike kur atij i është privuar liria.

Sqarojmë se nuk është kompetencë e institucionit të Avokatit të Popullit që të vlerësojë bazueshmërinë ligjore të arrestimeve dhe ndalimeve që kryejnë punonjësit e policisë gjyqësore, pasi ai është atribut ligjor i prokurorisë dhe gjykatës, por institucioni i Avokatit të Popullit vlereson a janë zbatuar garancitë ligjore proceduriale për këto qytetarë. Në këtë kuptim kemi reaguar dhe bërë rekomandimet përkatëse kur kemi konstatuar mos kryerjen e detyrimeve ligjore lidhur me respektimin e të drejtave të personave të arrestuar/ndaluar të parashikuara në nenin 255 të KPP. Gjatë trajtimit të ankesave të shtetasve kemi konstatuar veçanërisht gjatë tubimeve, se punonjësit e policisë u ngarkojnë të arrestuarve një numër të madh vepra penale. Më pas, gjatë hetimit dhe gjykimit të tyre ka rezultuar se ata janë akuzuar dhe dënuar për një apo dy vepra penale dhe jo për të gjitha ato të referuara nga ana e policisë gjyqësore. Po kështu, kjo problematikë është konstatuar nga ana jonë edhe gjatë fazës së vleftësimit dhe caktimit të masave të sigurimit personal nga gjykata. Gjatë arrestimeve masive gjykatat kanë caktuar masa sigurie shumë më të lehta sesa "arresti në burg". Ky fakt provon që referimi dhe ngarkimi i tyre si të dyshuar për kryerjen e disa veprave penale ka qënë i pa bazuar dhe fiktiv dhe me qëllim për të justifikuar arrestimet e kryera dhe intimiduar qytetarët që të mos marrin pjesë në tubime e aktivitete të tjera masive për të shprehur pakënaqësitë e për të kërkuar të drejtat e tyre. Avokati i

Popullit vlerëson se vendosja e masës së arrestimit në flagrancë apo të ndalimit ndaj autorëve të veprave penale nga policia gjyqësore, duhet të aplikohet si rast përjashtimor dhe si masë e fundit për personat e dyshuar si autorë të kryerjes së veprave penale të cilat parashikojnë dënime të rënda penale. Kjo masë e fundit duhet të aplikohet në përputhje me kriteret dhe kushtet e përcaktuar në nenet 228, 229 dhe 230 të Kodit të Procedurës Penale dhe në përshtatje me shkallën e nevojave të sigurimit, të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikon vepra penale, si dhe kur masat e tjera nuk janë të përshtatshme për shkak të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe të autorit të saj. Ndërkohë duhet të vlerësohet me kujdes dhe përgjegjshmëri fakti se arrestimi i një personi sjell pasoja sociale, ekonomike e psikologjike tek vetë personi, në familjen përkatëse dhe më gjerë në rrethin miqësor e shoqëror të tij.

Është e rëndësishme që të theksojmë se, institucioni i Avokatit të Popullit nuk është kundër ndjekjes penale dhe dënimit të autorëve të veprave penale. Por ndërkohë shprehim shqetësimin legjitim se gjatë inspektimeve të bëra për rastet e arrestimeve/ndalimeve masive në ambientet e sigurisë sidomos në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, ku janë akomoduar personat e ndaluar, kemi konstatuar tejmbushjen mbi kapacitetin e tyre. Lidhur me këto problematika po referojmë rastet e mëposhtme:

-Ankesa e paraqitur nga shtetasi B.A., i cili shkruante se kishte në pronësi një automjet tip veturë, punonte taksist duke qenë i pajisur me licence "Për transport udhëtarësh me taksi", lëshuar nga Bashkia Tiranë. Në datën 22.03.2022 ka transportuar nga Tirana në Kukës tre persona të huaj. Kur ka mbërritur në hyrje të qytetit Kukës është ndaluar nga një patrullë policie. Pasi është dërguar në Komisariatin e Policisë Kukës, është arrestuar për veprën penale "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve", si dhe është bërë sekuestrimi i automjetit të tij dhe të dokumentacionit përkatës. Gjykata e Shkallës së Parë Kukës, ka marrë në shqyrtim kërkesën e organit të prokurorisë, e ka lënë të lirë atë dhe ndërkohë ka caktuar si masë sigurimi personal "Detyrimin për t'u paraqitur një herë në dy javë para policisë gjyqësore."
Nga përgjigjet e ardhura nga Drejtoria Vendore të Policisë Kukës, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës dhe Gjykata e Shkallës së Parë Kukës, rezultoi se arrestimi në flagrancë i ankuesit ishte bërë si i dyshuar për kryerjen e veprës penale "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve". Në ngarkim të tij ishte regjistruar procedim penal dhe se organi i gjykatës kishte vendosur caktimin ndaj tij të masës së sigurimit personal "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore". Ndërkohë më pas nga organi i prokurorisë ishte dërguar në Gjykatën e Shkallës së Parë Kukës kërkesa për pushimin e çështjes penale nr. 121/2022. Gjykata vendosi pushimin e çështjes penale dhe vendimi ka marrë formë të prerë.

Pas shqyrtimit të kësaj ankese dhe të përgjigjeve të dërguara, ne vlerësuam se në rastet kur autorë të dyshuar të kësaj vepre penale janë taksistët nëpërmjet vënies në dispozicion ose përdorimit të mjeteve të transportit me të cilët ata ushtrojnë këtë aktivitet, dyshimet duhet të bazohen në prova konkrete. Në kryerjen e kësaj vepre penale është shumë e rëndësishme ana subjektive e figurës së veprës penale që është faji (në këtë lloj vepre penale, dashja) si dhe qëllimi spekulativ. Në këtë rast, nga ana e policisë gjyqësore dhe/apo organi i prokurorisë nuk ishte administruar asnjë provë që krijonte dyshime të arsyeshme ndaj shtetasit B.A., se ai ka kryer veprën penale të parashikuar nga neni 298/1 i KP dhe mbi bazën e të cilave është arrestuar në flagrancë e proceduar penalisht.

Ndërkohë konstatuam se veprimet e para hetimore, sikurse janë verifikimi i komunikimeve telefonike, këqyrja e aparateve të telefonëve dhe e automjeteve, etj., nuk ishin kryer shpejt por pas disa muajve, duke i bërë ato jo efektive dhe nga ana tjetër duke passjellë pasoja juridike, ekonomike dhe psikologjike për ankuesin.

Për sa më sipër, i rekomanduam[30] Drejtorisë Vendore të Policisë Kukës dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës: Ushtrimin e ndjekjes penale për veprën penale "Ndihma për kalimin e paligjshëm të kufijve", vetëm në ato raste kur ndaj tyre krijohen dyshime të arsyeshme dhe të bazuara në prova se ata e kanë kryer atë; Në rastet e aplikimit të masave shtrënguese të sigurimit personal dhe të sekuestrimit të automjeteve e të dokumentacionit përkatës shtetasve të dyshuar si autorë të kësaj vepre penale, veprimet hetimore, sikurse janë verifikimi i komunikimeve telefonike, këqyrja e automjeteve, e dokumentacionit, etj., të kryhen brenda një kohe sa më të shpejtë dhe të arsyeshme. *Rekomandimi është bërë gjatë muajit Dhjetor 2022 dhe jemi në pritje të përgjigjes.*

- Gjatë shqyrtimit të ankesës të një shtetasi ndaj Komisariatit të Policisë Durrës për arrestim të padrejtë si dhe mos pasqyrimit në procesverbalin e arrestimit në flagrancë të kohës reale, konstatuam se ora e arrestimit të tij e pasqyruar në procesverbalin e arrestimit në flagrancë, i cili është një nga dokumentet që administrohet në fashikullin penal, nuk ishte e saktë, sepse ishte vendosur ora e mbajtjes/përpilimit të procesverbalit dhe jo ora faktike e arrestimit të tij në flagrancë. Diferenca kohore ndërmjet orës faktike dhe asaj të pasqyruar në procesverbalin e arrestimit në flagrancë ishte 5 orë e 30 minuta.

Duke iu referuar neneve 144 e 250 të Kodit të Procedurës Penale, shënimi në procesverbal i çastit (orës) së arrestimit në flagrancë ose të ndalimit është një element i rëndësishëm mbi bazën e të cilit fillojnë të llogariten efektet e paraburgimit. Ndërsa në bazë të nenit 258, pika 1, të K.Pr.P., nga çasti (ora) e arrestimit ose ndalimit fillon afati i 48-të orëve, brenda të cilit prokurori kërkon vleftësimin e masës së sigurimit në gjykatën e vendit ku është kryer arrestimi ose ndalimi.

Po ashtu, konstatuam se materialet procedurale nga ana e Komisariatit të Policisë Durrës ishin dërguar në organin e prokurorinë tej afatit të parashikuar në nenin 255/1, të K.Pr.P. Respektimi i detyrimi ligjor për njoftimin e menjëhershëm të prokurorit është me rëndësi sepse lidhet ngushtësisht me detyrimin e prokurorit që, brenda dyzet e tetë orëve nga arrestimi ose ndalimi, kërkon vleftësimin e masës në gjykatën e vendit ku është kryer arrestimi ose ndalimi. Mosrespektimi i këtij afati bën që arrestimi ose ndalimi të humbasë fuqinë.

Ndaj, i rekomanduam[31] Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës: Marrjen e masave të nevojshme për analizimin e këtij rasti, nxjerrjen e përgjegjësive konkrete, ndryshimin e praktikës lidhur me shënimin e orës së arrestimit në flagrancë të shtetasve, dërgimin e materialeve procedurale në organin e prokurorisë në mënyrë të menjëhershme në të gjitha rastet e arrestimeve në flagrancë ose ndalimeve të shtetasve nga oficerët e policisë gjyqësore dhe përgjithësimin e këtij rasti në

[30] https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20drejtuar%20DVP%20Kukes%20dhe%20Prok.%20Kukes%20lidhur%20me%20fill.%20e%20procedimeve%20per%20taksistet.pdf.
[31] https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20drejtuar%20DVP%20Durres%20per%20I.H.pdf.

strukturat në varësi me qëllim që shkelje të tilla të mos përsëriten në të ardhmen. *Rekomandimi në fjalë u mirëprit dhe u pranua.*

➢ *Garantimi i të drejtës së ushtrimit të profesionit dhe raportimit të ngjarjeve nga punonjësit e medias gjatë tubimeve*

Liria e medias është e garantuar nga neni 22, pikat 2 e 3 të Kushtetutës tonë. Shumë shpesh liria e një shoqërie përcaktohet nga liria e shtypit dhe e mediave, për shkak se mediat kanë një rol qëndror i cili është informimi i publikut në mënyrë reale dhe objektive për çështje që ndodhin në shoqëri.

Me liri të medias kuptohet gjithashtu dhe e drejta që i takon medias për të mbikëqyrur punën e qeverisë dhe institucioneve të tjera shtetërore qëndrore e vendore. Pasja e një lirie të tillë nga ana e medias arrin të sjellë rezultate para publikut për evidentimin dhe luftimin e tyre, si: krimi i organizuar, korrupsioni dhe afera të ndryshme korruptive, nepotizmin në institucionet publike, etj., rezultate që për një demokraci konsiderohen si arritje konkrete. Por gjatë ushtrimit të detyrës së tyre punonjësit e medias në disa raste janë përballur me vështirësi të ndryshme, si dhunuar fizikisht e psikologjikisht si dhe penguar në ushtrimin e saj nga subjekte të ndryshme private dhe shtetërore.

Këto probleme janë hasur gjatë monitorimit të tubimeve ku punonjës të medias janë penguar në ushtrimin e detyrës nga punonjësit e Policisë së Shtetit, sikurse mund të përmendim shoqërimin e tyre, marrjen e pajisjeve filmike e fotografike, apo fshirjen e tyre. Sulmet kundër gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias përbëjnë shkelje serioze të të drejtave të njeriut sepse ato synojnë jo vetëm individët, por privojnë të tjerët nga e drejta e tyre për të marrë informacion, duke kufizuar kështu debatin publik, i cili është në zemër të demokracisë pluraliste. Në përgjigje të nivelit alarmant dhe të papranueshëm të kërcënimeve ndaj gazetarëve dhe aktorëve të medias në Europë, dhe duke pasur parasysh efektin dëmtues në funksionimin e shoqërisë demokratike, në Prill 2016, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Europës miratoi Rekomandimin CM/Rec (2016) 4 për mbrojtjen e gazetarisë dhe sigurinë e gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias.

Një problematikë e tillë është konstatuar edhe në rastin e bërë publik në media për një ngjarje të ndodhur gjatë përplasjes ndërmjet tifozëve të Romës dhe të Feyenoord-it në datën 25.05.2022 në qytetin e Tiranës. Gjatë kësaj përplasjeje, punonjësit e Policisë së Shtetit kanë ndaluar fotoreporterin në detyrë G.Sh, i kanë marrë me forcë aparatin fotografik dhe i kanë kërkuar atij që të fshinte fotot e bëra gjatë përplasjes së policisë me tifozët. Sipas medias, ai ka qenë me dokumentin e identifikimit të varur në qafë në kohën që po bënte fotografitë lidhur me skenën e ngjarjeve. Gjithashtu ai është shprehur se punonjësit e policisë i kanë kthyer aparatin fotografik pasi ka komunikuar me zëdhënësin e Policisë së Shtetit, por disa foto është detyruar që t'i fshinte me pretendimin se ata dukeshin me fytyra.

Ndërkohë në media është publikuar edhe reagimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, i cili është shprehur se ka kërkuar hetimin e këtij rasti nga strukturat përkatëse të Drejtorisë së Standardeve Profesionale dhe Departamentit të Sigurisë Publike.

Ne vlerësuam se ndjekja e rastit në fjalë nga strukturat përkatëse të Policisë së Shtetit nuk ishte bërë me përkushtimin e duhur. Këto struktura i kanë kapacitetet e duhura njerëzore e teknike që

të bëjnë të mundur identifikimin e punonjësit të policisë që i ka marrë aparatin fotografik gazetarit G.Sh. dhe e ka detyruar atë që të fshijë disa nga fotot e realizuara prej tij.

Në këtë përfundim arritëm nisur edhe nga analizimi i disa rasteve të tjera të ngjashme të ndodhura më parë, në të cilat punonjësit e policisë janë sjellë në mënyrë jokorrekte dhe pa etikë me gazetarët gjatë komunikimeve në ngjarje të ndryshme ku kanë qenë të pranishëm punonjësit e medias. Ndër këto mund të përmendim:
- Rastin e bërë publik në median online, "Lapsi.al", në datën 06.01.2022. Kjo media ka botuar një artikull lidhur me dhunën e ushtruar ndaj korrespondentin e ABC në Shkodër S.Sh. në sy të dy fëmijëve të tij, nga trupat e RENEA-s;
- Rastin e shoqërimit në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë të gazetarit të TV *"Fax News"*, B.B., i cili në datën 9 mars 2020, rreth orës 23:25 ka shkuar pranë mjediseve të Ministrisë së Brendshme, për të monitoruar një tubim që po zhvillohej nga disa qytetarë në mbështetje të shtetasit turk, S.S.
- Po ashtu, mund të përmendim rastet e shoqërimit në organet e policisë të disa gazetarëve gjatë protestave të organizuara gjatë muajit dhjetor 2020 pas vrasjes së të ndjerit K.R., si gazetarit të "*RTV Ora*", Xh.M., të Kryeredaktorit të gazetës "*Koha Jonë*", Q.Xh., të gazetarit të "*Syri TV*" në Durrës, A.M., si edhe punonjësit të medias "*Durrës Lajm*", Sh.D., të cilat i kemi referuar në Drejtoritë Vendore të Policisë Tiranë e Durrës.

Ka rëndësi që reagimi i policisë së shtetit në këto raste të mos mbyllet vetëm me deklarata publike, por duhet që ngjarjet të mos përsëriten si dhe masat e marra të jenë efektive.
Për sa më sipër, Avokati i Popullit i rekomandoi[32] Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit: Marrjen e masave të menjëhershme nga strukturat e Policisë së Shtetit për të garantuar të drejtën e ushtrimit të profesionit dhe raportimit të ngjarjeve nga punonjësit e medias të pranishëm në tubime apo aktivitete të tjera të kësaj natyre; analizimin në mënyrë të thellë, me objektivitet dhe me profesionalizëm të shkaqeve të sjelljes pa etikë të punonjësve të policisë ndaj gazetarëve; trajnimin në vijimësi të punonjësve të policisë me qëllim që të lejojnë gazetarët të kryejnë profesionin dhe misionin e tyre dhe të sillen me etikë gjatë komunikimit me ta; ndëshkimin e punonjësve të policisë që kryejnë shkelje me gazetarët dhe punonjësit e medias me masa disiplinore në mënyrë proporcionale me shkeljet e kryera; si dhe përgjithësimin e këtyre rasteve në strukturat e Policisë së Shtetit me qëllim mos përsëritjen në të ardhmen të shkeljeve.

➢ *Mbrojtja e të drejtave të shtetasve të huaj që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë*

Në bazë të nenit 2 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", Avokati i Popullit ushtron misionin e tij ligjor edhe për mbrojtjen e të drejtave të të huajve, të cilët janë ose jo rezidentë të rregullt në Shqipëri, të refugjatëve, azilkërkuesve, si dhe të personave pa shtetësi që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë, nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike shqiptare.

[32] https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20drejtuar%20DPP%20Shtetit%20per%20respekt%20.e%20%20te%20drejtave%20te%20punonjesve%20te%20medias%20ne%20tubime.pdf.

Gjatë viteve të fundit në territorin e vendit tonë kanë hyrë me qëllim qëndrimi këtu apo kalim në vendet e BE-së një numër jo i vogël shtetasish nga vende të ndryshme, kryesisht nga Azia, të cilët largohen për shkak të varfërisë së tejskajshme, luftrave që i kanë përfshirë këto vende, etj. Ata krahas problematikave të tjera, mund të jenë të traumatizuar nga ngjarjet e rënda që kanë ndodhur në këto shoqëri apo në familjet e tyre. Ndodhur në këto rrethana, dhe shpesh herë pa të ardhura financiare e veshmbathje të nevojshme, ata meritojnë një përkujdesje të shtuar humane, veçanërisht nga strukturat shtetërore. Por pavarësisht kësaj, këto struktura kanë detyrimin që të respektojnë të gjitha të drejtat ligjore që atyre u garantohen nga Kushtetuta e RSh-së, Konventat Ndërkombëtare dhe aktet e tjera normative ligjore e nënligjore në fuqi në vendin tonë. Gjatë vitit 2022 kemi administruar disa ankesa të bëra nga shtetas të huaj të rregullt ose jo, të cilët kanë ngritur pretendime lidhur me shkeljen e të drejtave ligjore edhe nga strukturat e Policisë së Shtetit.

Ndër këto raste për të cilat është bërë rekomandim mund të përmendim ankesën e tre shtetasve irakianë O.D., A.U. dhe N.S., të cilët shkruanin se kishin hyrë në mënyrë të paligjshme në territorin e Republikës së Shqipërisë në vitin 2017 dhe kanë kërkuar azil. Pas pranimit të kërkesës për azil ata janë vendosur në një apartament në Tiranë së bashku. Më pas janë pajisur me leje qëndrimi dhjetëvjeçare nga Zyra e Migracionit dhe Kufirit Tiranë dhe janë punësuar në kompani të ndryshme. Në dhjetor 2020 janë arrestuar nga policia e Tiranës për shkaqe ende të panjohura dhe janë dërguar në Qendrën e Mbyllur për të Huajt në Karreç në bazë të urdhrave të ndalimit të nxjerrë nga Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit Tiranë. Sipas tyre, ndonëse kishte kaluar afati ligjor maksimal deri në një vit, ata vazhdonin të mbaheshin të ndaluar në këtë qendër.

Pas shqyrtimit të kësaj ankese, të përgjigjeve të ardhura nga QMH Karreç dhe Drejtoria Vendore e Kufirit dhe Migracionit Tiranë, si dhe verifikimit të dokumentacionit të bërë nga ana jonë pranë kësaj qendre rezultoi se pasi u është dhënë statusi i azilantit dhe leja e qëndrimit në territorin e RSH-së, në datën 03.12.2020 nga Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit (DRKM) Tiranë janë nxjerrë urdhrat e ndalimit të ankuesve në QMH Karreç dhe është bërë refuzimi/heqja e lejeve të qëndrimit. Pas kësaj, ndaj tyre nga DRKM Tiranë janë nxjerrë urdhrat e dëbimit. Në vijim, është bërë zgjatja e afatit të qëndrimit të tyre në këtë qendër në bazë të kërkesës së kësaj të fundit edhe për 6 muaj të tjerë, që në vlerësimin tonë është i pabazuar në ligjin për të huajt dhe i paargumentuar. Pavarësisht se këta shtetas kanë plotësuar afatin një vjeçar të qëndrimit në QMH Karreç, dhe nga kjo qendër janë nxjerrë urdhër largimet respektive ata nuk janë lënë të lirë por janë transferuar në DVKM Tiranë. Po në të njëjtën datë nga DVKM Tiranë janë nxjerrë tre urdhra ndalimi për mbylljen e tyre në QMH Karreç, për arsye se janë subjekt i një urdhri dëbimi nga territori i Republikës së Shqipërisë si "Person i padëshiruar". Ky ndalim është bërë në kundërshtim të plotë dhe të hapur me ligjin "Për të huajt", sepse afati maksimal i mbajtjes së një shtetasi të huaj në këtë qendër është një vit. Gjithashtu, ndalimi në qendrën e mbyllur të një shtetasi të huaj të parregullt në RSH-së është masa e fundit administrative, në bazë të vlerësimit rast pas rasti, kur janë ekzekutuar të gjitha masat e mundshme alternative.

Në përfundim të hetimit, i rekomanduam[33] Qendrës së Mbyllur për të Huajt Karreç, Drejtorisë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit Tiranë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit: Marrjen e masave të menjëhershme për të bërë të mundur nxjerrjen sa më shpejtë të shtetasve irakianë N.S, O.D. dhe A.U. nga QMH Karreç; Analizimin e këtij rasti, nxjerrjen e përgjegjësive

[33] https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20drejtuar%20M.Brendshme%20,%20DPP%20shtetit%20etj%20lidhur%20me%20respektimin%20e%20te%20drejtave%20te%20huajve.pdf.

përkatëse; Trajnimin e punonjësve të Policisë Kufitare dhe Migracionit me qëllim respektimin e të drejtave ligjore të shtetasve të huaj; Ndryshimin e praktikës së deritanishme nga Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, që, në rastet e zgjatjes së afatit të qëndrimit mbi 6 muaj, por jo më shumë se një vit të shtetasve të huaj në QMH Karreç, të bëhet me vendim të arsyetuar, vetëm në rastet e parashikuara në ligj dhe në përputhje me nenet 99 e 100 të KPA; Përgjithësimin e këtij rasti në strukturat rajonale të Policisë Kufitare dhe Migracionit. *Rekomandimi u mirëprit dhe u pranua*.

- Nga hetimi administrativ i ankesës së paraqitur nga shtetasi palestinez Q.Sh., për refuzimin e shtetësisë shqiptare rezultoi se refuzimi i shtetësisë shqiptare ishte bërë sepse ai nuk plotësonte kriteret ligjore. Gjithashtu u informuam se, ankuesi është njoftuar zyrtarisht se ka përfunduar procedura e aplikimit të tij dhe se i është refuzuar kërkesa.

Objekt i hetimit tonë administrativ, në këtë rast, nuk ishte vlerësimi i shkaqeve që kanë çuar në mosmiratimin e kërkesës për fitimin e shtetësisë shqiptare të ankuesit, por vetëm nëse janë respektuar procedurat përkatëse të refuzimit të aplikimit. Nga dokumentacioni i administruar konstatuam se njoftimi zyrtar për refuzimin e kërkesës për fitimin e shtetësisë shqiptare ankuesit i është bërë nëpërmjet një shkrese të nënshkruar nga Drejtori Vendor i Policisë Tiranë. Ndërkohë, referuar legjislacionit në fuqi, konkretisht ligjit nr.113/2020 *"Për shtetësinë"*, ku parashikohet procedura për fitimin, rifitimin dhe humbjen e shtetësisë shqiptare, refuzimi bëhet me akt administrativ të ministrit. Kundër këtij akti, personi që ka paraqitur kërkesën mund të bëjë ankim në gjykatën kompetente administrative, në përputhje me afatet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fuqi.

Ne vlerësuam se nxjerrja e këtij akti përveçse është kërkesë e ligjit, njëkohësisht është një domosdoshmëri për të garantuar të drejtën e ankimit në gjykatë. Mosnxjerrja e aktit administrativ sipas kushteve të lartpërmendura nga organi kompetent, sipas kërkesave dhe formës ligjore, mund të bëhet shkak për pavlefshmërinë ose paligjshmërinë e tij në gjykatë.

Për sa më sipër i rekomanduam[34] Ministrisë së Brendshme: Marrjen e masave për nxjerrjen e aktit administrativ nga ministri, në rastet e refuzimit të kërkesave të shtetasve të huaj për fitimin e shtetësisë dhe unifikimin e praktikës; si dhe njoftimin e aktit administrativ shtetasve të huaj kur nuk plotësojnë kriteret ligjore, me qëllim garantimin e të drejtës së ankimit, në kuadër të procesit të rregullt ligjor. *Rekomandimi u pranua.*

3.4 Parandalimi i dhunës dhe torturës[35]

Avokati i Popullit nëpërmjet **Mekanizmit Kombëtar** për Parandalimin e Torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar[36](MKPT) edhe gjatë vitit 2022 ka vijuar të përmbushë detyrat e tij funksionale të përcaktuara në legjislacionin kombëtar si dhe në standardet ndërkombëtare.

[34] https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20shtetesia.pdf.
[35] Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i MKPT-së në institucionin e Avokatit të Popullit.
[36] Neni 81 i ligjit nr. 81/2020"Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", si dhe Neni 30 dhe 30/1 i ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar.

Më konkretisht, MKPT ka kryer *73 inspektime periodike,* disa kontrolle me tematikë të veçantë, pjesëmarrje në 23 operacione për rikthimin e detyruar të shtetasve shqiptarë qëndrojnë në mënyrë të paligjshme në vendet e BE-së në bashkëpunim me Frontex, si dhe vizita inspektuese në të gjitha institucionet e tjera të privimit të lirisë, si dhe trajtimi i ankesave dhe konkludimi me disa rekomandime. I gjithë aktiviteti i mësipërm ka rezultuar me 1 raport të veçantë dhe me *90 rekomandime* dhe me një korrespondencë zyrtare të dendur për të sqaruar shumë detaje dhe fenomene të konstatuara gjatë inspektimeve.

Qëllimi i këtyre vizitave dhe inspektimeve ka qenë vlerësimi i kushteve të qëndrimit dhe trajtimit të shoqëruarve, paraburgosurve dhe të dënuarve dhe progresit të autoriteteve kompetente në zbatimin e rekomandimeve të MKPT, të dërguara përmes rekomandimeve. Respektimi i të drejtave të të burgosurve dhe personave qe ju privohet liria, te drejta të cilat garantohen me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore të kësaj fushe duhet të jetë në vëmendje e të tërave institucioneve shtetërore. Përveç kësaj, nga ana e MKPT është mbajtur në konsideratë edhe veprimtaria promovuese e të drejtave të njeriut në bashkëpunim me Administratën e Burgjeve dhe Drejtorinë e Policisë së Shtetit.

Për vitin 2022, MKPT ka trajtuar *31 ankesa* dhe *14 raste me iniciativë*, nga të cilat *25 ankesa* lidhen me sistemin e burgjeve (pretendim ushtrim dhune, mungesë mjekimi dhe medikamentesh, mungesë kushtesh jetese, mbipopullimi në burgje etj.,) dhe *6 ankesa* lidhen me policinë (pretendim ushtrim dhune, shoqërim i padrejtë etj.,)

I.1 Gjetjet e konstatuara nga inspektimet në institucionet penitenciare pasqyrohen si në vijim:

1. *Konstatimi i përsëritur në lidhje me kushtet materiale tejet* degraduese dhe pa mundësinë e rikonstruktimit të mjediseve në regjimet e brendshme, të cilat bëjnë të pamundur garantimin e të drejtave të të burgosurve, në IEVP Durrës, IEVP Burrel, IEVP Tepelenë, IEVP 302 Tiranë. Meqenëse këto gjetje vazhdojnë të konstatohen në mënyrë të përsëritur, madje me kushte edhe më të degraduara si rrjedhojë e mungesës së investimeve dhe amortizimit Avokati i Popullit i ka rekomanduar Ministrit të Drejtësisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, që të evidentohen shkaqet dhe eventualisht përgjegjësitë për moszbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit**,** për disa vite rrjesht në këtë aspekt.

2. *Infrastruktura e ndërtimit të godinave të banimit dhe ambienteve të përbashkëta*, vazhdon të paraqesë probleme të amortizimit, lagështirës, furnizimit me ndërprerje të energjisë elektrike dhe ujit, sigurimit të ndriçimit natyral dhe të ajrosjes së plotë të qelive, pranisë së insekteve, kushteve jashtë standardeve të tualeteve, kuzhinave, dusheve, ambienteve të ajrimit, dhomave të izolimit, etj. Institucionet me problematika emergjente infrastrukturore paraqiten IEVP Durrës, IEVP 302 Tiranë, IEVP Rrogozhinë, IEVP Tepelenë, IEVP Burrel. Përjashtim bëjnë IEVP-të e reja dhe ato të ri konstruktuara të cilat praktikisht kanë krijuar një sistem me dy standarde në sistemin penitenciar shqiptar.

3. *Mbipopullimi ka pësuar një rritje përgjatë vitit 2022* në disa nga IEVP-të veçanërisht në sektorët e paraburgimit, si në IEVP 302, IEVP 313, Jordan Misja, Tiranë, si dhe IEVP Durrës, IEVP Drenovë, IEVP Peqin, ky fenomen vazhdon të jetë prezent. Gjatë vizitave, grupet e

inspektimit kanë gjetur 4 (katër) deri në 6 (gjashtë) persona të akomodohen në një qeli, duke mos respektuar standardin 4m^2 për çdo të burgosur[37].

4. *Moszbatimi i marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë për ngritjen e një Institucioni të Posaçëm Mjekësor*, të parashikuar në ligjin Nr. 44/2012, datë 08.05.2012 "Për Shëndetin Mendor", me qëllim strehimin dhe trajtimin e personave që kanë marrë nga gjykata masën "mjekim i detyruar" dhe "shtrim i përkohshëm". Avokati i Popullit nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, ka tërhequr në mënyrë të përsëritur vëmendjen për kushtet e trajtimit në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale ku janë vendosur personat me çrregullime të shëndetit mendor që kanë kryer vepra penale ose persona me masë mjekësore mjekim i detyruar. Siç është informuar dhe më parë, në datat 27 dhe 28 nëntor 2021, u krye me sukses procesi transferimit nga IEVP Krujë i 314 shtetasve me masë mjekësore[38] dhe akomodimi i tyre në dy godinat në IEVP Lezhë[39]. Për vitin 2022, institucioni i Avokatit të Popullit ka monitoruar kushtet dhe trajtimin e personave me probleme të shëndetit mendor të akomoduar në IEVP Lezhë dhe ka rekomanduar *përmirësimin i kushteve dhe i trajtimit të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore, si dhe rregullimet ligjore në strukturën organike të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Lezhë.* Ky rekomandim i është drejtuar Ministrit të Drejtësisë, Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve dhe për dijeni, Kryeministrit të Republiks së Shqipërisë. Vlen të theksojmë që në krye të herës se, në aktet kombëtare dhe ndërkombëtare të miratuara dhe të ratifikuara nga legjislativi shqiptar, përcaktohet qartë se, shtetasit për të cilët është dhënë masa mjekësore "Mjekim i detyruar" dhe "Shtrim i përkohshëm", nuk duhet të jenë të akomoduar në IEVP në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, por ata duhet të trajtohen në një Institucion të Posaçëm Mjekësor në varësi të MSHMS.

Ligji nr.44/2012 "Për Shëndetin Mendor", ka përcaktuar qartë se, trajtimi shëndetësor për personat me çrregullime të shëndetit mendor, pavarësisht veprës penale që kanë kryer dhe për të cilët gjykata kompetente ka vendosur masën "mjekim i detyruar" apo "shtrim i detyruar", duhet të kryhet në një Institucion të Posaçëm Mjekësor, pjesë e sistemit shëndetësor të integruar, dhe jo në institucionet e sistemit penitenciar.

Konkretisht, në nenin 28, pika 2 të këtij ligji, përcaktohet se: *"Trajtimi i personave në institucionet mjekësore të posaçme është i njëjtë me trajtimin e pacientëve të tjerë me çrregullime të shëndetit mendor. Institucionet mjekësore të posaçme, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, janë pjesë e sistemit shëndetësor të integruar. Mënyrat dhe rregullat e ngritjes dhe funksionimit të këtyre institucioneve mjekësore të posaçme dhe masat e sigurisë për ruajtjen e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave"*. Sa më sipër rekomanduam: Deri në ngritjen e Institucionit të Posaçëm Mjekësor, të merren masa të menjëhershme, për hartimin/miratimin e rregullores së funksionimit të Institucionit Tranzitor Lezhë. Të merren masa të menjëhershme, për miratimin sa më parë të strukturës organike të IEVP Lezhë, bazuar në një studim të qartë dhe konkret të kryer

[37] Bashkëlidhur në Aneksin 1, Tabela pasqyruese në lidhje me popullimin në IEPV-të.

[38] 217 shtetas me masë mjekësore "shtrim i detyruar" dhe 97 shtetas me masë mjekësore "shtrim i përkohshëm"

[39] IEVP Lezhë përmes urdhrit Nr. 8927/1, datë 27.09.2018 të Ministrit të Drejtësisë është klasifikuar Burg i sigurisë së zakonshme, me një seksion të veçantë për trajtimin e shtetasve me masë mjekësore mjekim i detyruar.

nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë , për të shtuar kapacitetet e shërbimit mjekësor dhe shërbimeve mbështetëse të këtij institucioni, me qëllim rritjen e cilësisë të shërbimeve ndaj personave me masë mjekësore. Të merren masa të menjëhershme, në kuadër të investimeve të Qeverisë Shqiptare për Rindërtimin, të cilat janë planifikuar për t'u kryer për rikonstruksionin e godinave të tjera në territorin e IEVP Lezhë, të ndërtohet dhe përshtatet dhe njëra prej godinave, për shkak të rritjes së numrit të personave me masë mjekësore me çrregullime të shëndetit mendor, që ndodhen në institucionet e sistemit peniteciar. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, bazuar në Planin e Përbashkët të Veprimit për trajtimin e personave me masë mjekësore, të detajojnë aktivitete specifike me afate kohore konkrete për këta persona, sipas angazhimeve të marra në marrëveshjen e përbashkët, në zbatim të kërkesave të ligjit nr.44/2012 "Për shëndetin mendor" dhe ligjit nr. 81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve".

5. *Mungesa e mjekëve në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale* vijon të mbetet një problematikë shqetësuese e sistemit tonë penitenciar. Avokati i Popullit gjatë vitit 2022, në IEVP-të e inspektuara në rang vendi ka rekomanduar marrjen e masave për plotësimin e pozicionit të mjekut me kohë të plotë sipas parashikimeve në organikën e institucionit. Mungesa e mjekëve në një pjesë të madhe të IEVP mbulohet nga mjeket me kohë të pjesshme, prej 4-orësh në ditë pune.

6. Mangësive të theksuara në ofrimin e mundësisë për *aktivitete social-kulturore për të burgosurit*.

7. Shpërblimi i punës së të burgosurve parashikohet në nenet 43 dhe 44 të ligjit nr. 81/2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve". Në nenin 44 të ligjit të cituar më sipër parashikohet se: "*1. I burgosuri ka të drejtën e një shpërblimi mujor për punën e tij. Shpërblimi për secilën kategori caktohet në vlerë të drejtë në proporcion me sasinë dhe cilësinë e punës së kryer dhe organizimin e punës që rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave. 2. I burgosuri ka të drejtë të disponojë lirshëm dyzet për qind të të ardhurave të fituara nga puna*". Nga verifikimi i organikës së punësimit, në të gjitha IEVP-të të burgosurit në organika ishin të punësuar kryesisht si sanitarë, shpërndarës ushqimi, berber, lavanderi, mirëmbajtës, etj.
Nga informacioni i marrë përgjatë inspektimeve si dhe intervistat me të punësuarit e burgosur rezultoi se, nga muaji Tetor i vitit 2021 kur u miratua VKM-ja nr.602, datë 13.10.2021 *"Për përcaktimin e rregullave të posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës, kohëzgjatjen dhe shpërblimin e saj",* deri në muajin Maj të vitit 2022, ende nuk ishte përfunduar procedura e miratimit dhe lidhjes së kontratës tip të punës midis institucionit dhe të burgosurit të punësuar. Për këtë shkak, të burgosurit e punësuar, për një periudhë 7 mujore, nuk përfitonin asnjë të drejtë, qoftë me ulje ditë dënimi dhe as nuk ishin trajtuar financiarisht për shpërblimin e punës, sipas kësaj VKM-je. Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se vonesat në miratimin e kontratës "tip" për të punësuarit, përbën shkelje e të drejtës për të përfituar nga mundësitë që u jep ligji kësaj kategorie, por njëkohësisht përbën shkelje të organit shtetëror përgjegjës të ngarkuar me ligj, për moszbatimin në kohë të të gjitha të detyrimeve që rrjedhin prej tij. Ndaj kjo e drejtë ligjore nuk duhet mohuar nga DPB, por duhet të fillojë llogaritjen e efekteve financiare nga koha

e miratimit të VKM-së së mësipërme, për të tërë personat, pavarësisht momentit të lidhjes së kontratës me shkrim.

8**.** Stafi i kujdesit shëndetësor në burgje, vazhdon të ketë nevojë për *krijimin e ambienteve të përshtatshme për kryerjen e vizitave mjekësore*, pasi përgjithësisht janë të pa pajisura me mjetet e nevojshme dhe materiale ndihmëse. *Vështirësi në realizimin e konsultave, ekzaminimeve dhe analizave laboratorike* specifike, vërehen ende në disa prej IEVP-ve, për arsye të lidhura me mungesën e mjekëve me kohë të plotë në organikë apo mungesën e autoambulancave, si dhe rezistencën e spitaleve rajonale për të trajtuar personat për shkak të mungesës së kushteve të sigurisë në to, etj. *Probleme të ofrimit të shërbimit stomatologjik në IEVP* që vijnë si rrjedhojë e mungesave në aparatura dhe materiale ndihmëse. Shërbimet dentare, përveç ekstraksioneve, kryhen me vështirësi në poliambulancat publike apo në klinikat private me shpenzimet e vetë të dënuarve.

9. *Sistemet qendrore të ngrohjes/ftohjes*, pothuajse në të gjitha IEVP-të ku ishin të instaluara, nuk funksiononin si rezultat i defekteve teknike ose të mungesës së karburantit. Në shumicën e rasteve të dënuarit/paraburgosurit nuk i sigurohet ngrohja sipas parashikimeve ligjore.

10. *Mungesa në furnizimin me produktet bazë të higjienës personale* (pastë dhëmbësh, furçë dhëmbësh, shampo, etj.) dhe të detergjenteve të nevojshme për të pastruar qelitë, si dhe mungesa në uniforma dhe doreza gjatë shpërndarjes së ushqimit u konstatuan në shumicën e IEVP-ve.

11. *Mungesa e dollapëve, rafte të rrobave***.** Rrobat mbaheshin nga të dënuarit/paraburgosurit në qese plastike ose në thasë, kryesisht poshtë shtretërve.

12. *Cilësia dhe larmia e ushqimit* vazhdon të mbetet problem shqetësues thuajse në të gjitha IEVP-të.

Avokati i Popullit në rolin e MKPT-së u ka dërguar autoriteteve kompetente rekomandimet me problematikat e vërejtura të cilat nevojitet të adresohen me vendimmarrje nga organet e larta shtetërore, pasi në shumicën e rasteve ato janë rezultat i ashpërsimit të politikës penale, mungesës së fondeve, dhe mungesës së nxjerrjes së akteve nënligjore për të gjeneruar përmirësime të dukshme të sistemit, si në formë ashtu dhe në përmbajtje. Avokati i Popullit vlerëson se në sistemin penitenciar po realizohen disa reforma strukturore dhe se ka pasur përmirësim në disa aspekte të jetës së të dënuarve, por mbetet ende shumë për të arritur standardet e pranuara. Avokati i Popullit veçanërisht vlerëson hapjen e mundësive të reja për punësimin e të dënuarve si dhe kërkon që të intensifikohen përpjekjet në këtë drejtim. Dixhitalizimi i orareve të takimit të familjarëve me të burgosurit apo furnizimet me artikuj ushqimor është një hap i mire që duhet të pasohet nga shumë të tjerë.

II.1 Niveli i respektimit të të drejtave të personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar në njësitë e policisë.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, edhe gjatë vitit 2022, ka vijuar të kryejë veprimtarinë e tij në inspektimin e ambienteve të Policisë së Shtetit, duke u ndalur dhe kontrolluar veçanërisht ligjshmërinë dhe rregullsinë e shoqërimit, ndalimit apo arrestimit të individëve, kushtet dhe trajtimin e tyre brenda komisariateve, problematikat infrastrukturore dhe materiale të tyre, etj. Për të gjitha rastet e konstatuara janë prezantuar edhe vërejtjet përkatëse në rekomandimet që u janë dërguar organeve eprore të Policisë së Shtetit.

Inspektimet e kryera në njësitë policore kishin si qëllim, vëzhgimin e objekteve si dhe mbledhjen dhe vlerësimin e të dhënave mbi veprimet dhe praktikat e ndjekura nga Policia e Shtetit në përmbushje të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014 "Për Policinë e Shtetit" i ndryshuar, Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, "Për miratimin e procedurës standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre", Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, "Për miratimin e procedurës standarde "Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit", si dhe verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit në inspektimet e mëparshme. Avokati i Popullit duke mbajtur në konsideratë natyrën e çështjeve që ka trajtuar, në rastet kur shërbimet e policisë mund të parandalonin ndodhjen e ngjarjeve me pasoja për qytetarët, në kushtet e veprimeve apo mosveprimeve që përfaqësuesit e rendit publik kanë si detyrim të kryejnë. Në rastet e hetuara Avokati i Popullit ka konstatuar se nisur nga deklarimit si dhe duke iu referuar nenit 109 të ligjit, rezulton se punonjësit e policisë kanë vepruar në kundërshtim me dispozitën e mësipërme, sepse nuk mund të bëhet shoqërimi personave duke u mbështetur vetëm në dyshime të pa arsyeshme. Sipas dispozitës së cituar, dyshimet duhet të jenë të arsyeshme, për kryerjen e një krimi, për të parandaluar kryerjen e një vepre penale, ose për identifikimin e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime (pikat 'c' dhe 'ç' parashikojnë se në rastin konkret, nuk ndodhemi as para shoqërimit, ndalimit dhe as para arrestimit në flagrancë, që parashikon Kodi i Procedurës Penale (KPP). Në këto rrethana, punonjësit e Policisë kanë vepruar në kundërshtim me nenin 27 të Kushtetutës dhe nenit 5 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), që parashikojnë rastet kur mund të kufizohet liria e personit.

Gjithashtu nga këqyrja e regjistrave të shoqërimit ku duhet të pasqyrohen rastet e shoqërimit, rezulton se në disa raste nuk janë evidentuar në regjistra pas shoqërimit në ambientet e policisë. Bazuar në rregullat e shoqërimit të personave në ambientet e komisariatit duhet mbajtur procesverbali i dokumentimit të veprimeve të kryera me personin e shoqëruar pas kryerjes së veprimeve të verifikimit e sqarimit të rastit për personin, nga punonjësi i policisë, si dhe dokumentimi i të dhënave, gjeneraliteteve të shtetasit për kohën hyrjes dhe qëndrimit të tij në Komisariat, cilësinë dhe shkaqet ligjore të kufizimit të lirisë[40].

[40]VII. "*Procedura të dokumentimit të veprimit të shoqërimit*"

Nga inspektimet e kryera në strukturat e policisë, u konstatua sa më poshtë vijon:

1. Probleme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhgimi në korridoret e dhomave të shoqërimit, sigurisë dhe ambientet e marrjes në pyetje të shtetasve në disa komisariate. Për sa më sipër vlen për tu përmendur se sjellja e punonjësve të policisë së shtetit ndaj qytetarëve është përmirësuar ndjeshëm. Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës (MKPT), nisur nga kryerja e inspektimeve periodike në ambientet e privimit të lirisë së personit (dhoma shoqërimi dhe dhoma sigurie), si dhe nga trajtimi i një numri të konsiderueshëm të ankesave të shtetasve drejtuar institucionit tonë, ka konstatuar në një numër të shumtë rastesh se, nuk janë respektuar të drejtat themelore të shtetasve të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Konventat Ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë, si dhe një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore, raste për të cilat ju jeni njohur përmes rekomandimeve përkatëse dërguar organeve të policisë në nivel vendor dhe Drejtorisë së Policisë së Shtetit. Në raportet e dërguara në përfundim të inspektimeve dhe nga objekti i ankesave apo rasteve me iniciativë të administruara ndaj këtyre strukturave, evidentohen raste për shoqërime të paligjshme apo mbajtje në gjendje shoqërimi tej afatit ligjor; për keqtrajtime fizike ose psikologjike në momentet e arrestimit, shoqërimit apo gjatë marrjes në pyetje të shtetasve në organet e policisë; për arrestime apo ndalime të paligjshme; për kushte të pa përshtatshme të ambienteve të shoqërimit, etj. Ka një shqetësim të vazhdueshëm se brenda ambienteve të komisariateve ushtrohet dhunë psikologjike dhe se në raste të veçanta ka edhe pretendime për ushtrim dhune fizike. Avokati i Popullit ka hetuar në vijimësi këto pretendime apo shqetësime publike dhe ka bërë rekomandimet përkatëse kur ka gjetur prova që demonstrojnë përdorimin e forcës tej limiteve të lejuara që në raste sporadike edhe dhunë fizike. Ndërkohë, përdorimi i dhunës psikologjike është tepër i vështirë për tu provuar dhe për këtë funksionojnë vetëm masat parandaluese. Sa më sipër kemi rekomanduar për: Marrjen e masave të nevojshme dhe të domosdoshme, për krijimin (ndërtimin) sa më parë brenda sistemit të dhomave të shoqërimit dhe të sigurisë të DVP/Komisariateve të policisë në të gjithë vendin, të dhomave më vete për intervistimin apo marrjen në pyetje të personave të shoqëruar/arrestuar/ndaluar në mjediset e Policisë së Shtetit, të plotësuara me orenditë e nevojshme dhe të monitoruara me sistemin e kamerave audio-vizive, si një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve apo arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit. Marrjen e menjëhershme të masave, që në projektet për përmirësimet e reja infrastrukturore në komisariate të ndryshme, të parashikohet në të tëra rastet dhoma e intervistimit si në dhomat e shoqërimit, ashtu edhe në ato të sigurisë.

2. Mungesa e ambienteve (dhomave) më vete të intervistimit/ marrjes në pyetje të personave të privuar nga liria në mjediset e Policisë së Shtetit. Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës (MKPT), nisur nga kryerja e inspektimeve periodike në ambientet e privimit të lirisë së personit (dhoma shoqërimi dhe dhoma sigurie), si dhe nga trajtimi

---

a.3 *- Proces verbali i veprimeve të kryera me personin e shoqëruar:*

a.3.1 - Pas kryerjes së veprimeve te verifikimit e sqarimit të rastit për personin e shoqëruar, nga punonjësi i policisë hartohet procesverbali i dokumentimit të veprimeve të kryera me personin e shoqëruar.

a.3.2 - Ky procesverbal pasi plotësohet duke hedhur të gjithë të dhënat sipas përcaktimeve dhe rubrikave të përcaktuara në të, nënshkruhet në fund të çdo faqeje nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe nga vetë personi i shoqëruar.

a.3.3 - Proces verbali i veprimeve të kryera me personin e shoqëruar plotësohet nga punonjësi i policisë që është ngarkuar të kryejë verifikimin dhe trajtimin e çështjes përkatëse për personin e shoqëruar.

a.3.4 - Procesverbali hartohet në dy kopje, një kopje e procesverbalit i jepet detyrimisht personit të shoqëruar dhe kopja tjetër dorëzohet në sekretari/arshivën e njësisë policore.

i një numri të konsiderueshëm të ankesave të shtetasve drejtuar institucionit tonë, ka konstatuar në një numër të shumtë rastesh se, nuk janë respektuar të drejtat themelore të shtetasve të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Konventat Ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë, si dhe një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore, raste për të cilat janë dërguar rekomandimet përkatëse organeve të policisë në nivel vendor dhe Drejtorisë së Policisë së Shtetit. Në raportet e dërguara në përfundim të inspektimeve dhe nga objekti i ankesave apo rasteve me iniciativë të administruara ndaj këtyre strukturave, evidentohen raste për shoqërime të paligjshme apo mbajtje në gjendje shoqërimi tej afatit ligjor; për keqtrajtime fizike ose psikologjike në momentet e arrestimit, shoqërimit apo gjatë marrjes në pyetje të shtetasve në organet e policisë; për arrestime apo ndalime të paligjshme; për kushte të pa përshtatshme të ambienteve të shoqërimit, etj.

3. Pretendime për raste të ushtrimit të torturës dhe keqtrajtimit fizik e psikologjik të shtetasve nga punonjësit e policisë. Pavarësisht se ka një qasje me korrekte dhe në respektim të të drejtave të njeriut, nga punonjësit e Policisë së Shtetit, kemi patur disa ankesa si dhe raste të marra me iniciativë nëpërmjet medias. Ankesat e gjetura të bazuara janë ndjekur kryesisht nga grupe të përbashkëta me Seksionin e Veçantë, janë pasuar nga rekomandimet konkrete për marrjen e masave lidhur me personat përgjegjës. MKPT vazhdon të sjellë në vëmendje rëndësinë e veçantë që ka sjellja e organeve të shtetit kundrejt personave të shoqëruar, që në orët e para të shoqërimit. Një person i shoqëruar nga policia është në një situatë të cënueshmërisë së veçantë, pasi personi është plotësisht në duart e agjentëve të zbatimit të ligjit. Ky çekuilibër pushteti krijon një situatë rreziku ku mund të ndodhin abuzime dhe tortura.

Masat mbrojtëse, veçanërisht në fazat e hershme të shoqërimit, janë thelbësore për të parandaluar abuzimet. Këto masa përfshijnë:

- ✓ dhënien e informacionit të të shoqëruarve për të drejtat e tyre;
- ✓ sigurimin e aksesit te një avokati;
- ✓ njoftimin e anëtarëve të familjes dhe/ose një palë të tretë për personin;
- ✓ dhënien e ekzaminimit nga një mjek për të konfirmuar ose përjashtuar pretendimet për keqtrajtim dhe për të ofruar ndihmë mjekësore nëse është e nevojshme.

Përveç këtyre rasteve, nga monitorimi i shpeshtë i ambienteve të Komisariateve, MKPT ka konstatuar përsëri se personat e shoqëruar/ndaluar nga punonjësit e policisë nënshkruajnë deklaratën që vërteton se morën një kopje të fletës së fakteve me të drejtat e tyre vetëm në përfundim të procesit së marrjes në pyetje në komisariatin e policisë.[41]
Gjithashtu, është vënë re se libri i ankesë/kërkesave shpesh herë është i pa plotësuar. Ligji Nr. 108/2014, "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar neni 115 përcakton se "*çdo person i shoqëruar, i ndaluar apo i arrestuar në ambientet e policisë si dhe çdo shtetas tjetër, ndaj të cilit punonjësit e policisë, kryejnë veprime sipas dispozitave të këtij ligji ose që cenohen gjatë kryerjes së këtyre veprimeve, ka të drejtë t'u paraqesë kërkesë/ankesë me gojë ose me shkrim drejtuesve të policisë apo institucioneve të tjera shtetërore. 2. Personi, i cili shoqërohet nga policia sipas rasteve të*

[41] CPT i ka rekomanduar institucioneve përgjegjëse përgjatë vitit 2018- të se personat e shoqëruar /ndaluar duhet të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre nga fillimi i privimit të lirisë, duke siguruar informacione të qarta verbale rreth të drejtave ligjore/procedurale që ata kanë që në fillim të privimit të lirisë.

parashikuara në këtë ligj, ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës në çdo kohë. 3. Punonjësi i policisë, pasi e ka regjistruar kërkesën/ankesën, e dokumenton në regjistrin përkatës dhe është i detyruar ta dërgojë menjëherë atë në institucionin të cilit i adresohet ankesa. 4. Për kërkesat/ankesat që u drejtohen drejtuesve të policisë ku është i shoqëruari, i ndaluari apo i arrestuari, përgjigjja i jepet menjëherë, por jo më vonë se 5 ditë pune nga dita e paraqitjes së tyre."

Po kështu, Rezoluta 31/31[42] e Këshilli për të Drejtat e Njeriut të vitit 2016, i inkurajon shtetet të mbajnë azhurnuar regjistrat zyrtarë të personave në mbikëqyrje policore si dhe i rekomandon që t'ia komunikojnë këto të dhëna personit të shoqëruar ose mbrojtësit të tij.

*4. Mospërmbushje e detyrimeve ligjore për ndërtimin apo përshtatjen e ambienteve të shoqërimit sipas standardit të kërkuar (3 dhoma shoqërimi, 1 për të rritur, 1 për femra dhe 1 për të mitur)***.** Dhomat e shoqërimit në pjesën më të madhe të komisariateve nuk i plotësonin standardet për trajtim dinjitoz të personave, pasi rezultonin të pakta në numër dhe nuk krijonin ambiente të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete për femra, të rritur dhe të mitur.

5. P*robleme në ofrimin e një shërbimi shëndetësor nga disa DPV*, sa i përket plotësimit korrekt të regjistrave e kartelave mjekësore, si dhe ambienteve të papërshtatshme për ofrimin e konsultave. Në disa prej këtyre institucioneve, vizitat mjekësore vazhdonin të kryheshin përtej afatit 12 orësh, të përcaktuar në procedurat standarde të Policisë së Shtetit, ndërkohë që në disa drejtori mjeku mungon.

Disa nga rekomandimet kryesore të dërguara nga Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës për vitin 2022

1. *Rekomandimi i dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë shtetit, DVP, Tiranë, dhe Komisariatit nr. 5 Tiranë*[43].

Më datë 26.03.2022, në media është bërë publik lajmi, se në Komisariatin e Policisë nr. 5 Kamëz, Tiranë, në rrethana ende të paqarta, ka rënë zjarr në ambientet e dhomave të sigurisë dhe si pasojë ka humbur jetën i paraburgosuri A.M, 26 vjeç, lindur në Kukës, dhe banues në fshatin Çerkezë, Kamëz. Sipas raportimeve të mediave, përveç viktimës ka mbetur i lënduar dhe një tjetër i paraburgosur dhe një punonjës policie. Lidhur me këtë rast Institucioni i Avokatit të Popullit ka ndërmarrë një hetim administrativ nga e cila rezultoi mosfunksionimi korrekt i strukturave të Komisariatit nr. 5 Kamëz, që kanë për detyrë ruajtjen dhe trajtimin e personave të

---

[42] https://ap.ohchr.org/documents/dpage_e.aspx?si=A/HRC/31/L.26/Rev.1 Në këtë Rezolutë përcaktohet se shtetet duhet të mbajnë të azhurnuar regjistrat zyrtarë të personave në mbikëqyrje policore që përmbajnë të paktën informacione për:

a) arsyet e arrestimit

b) kohën e arrestimit dhe dërgimit të personit të arrestuar në një vend ndalimi, si dhe paraqitjen e parë para një organi gjyqësor ose autoriteti tjetër

c) identitetin e zyrtarëve të zbatimit të ligjit në fjalë, dhe

d) informacione të sakta në lidhje me vendin e ndalimit.

[43] https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20p%C3%ABr%20zbatimin%20ndalimit%20arrestimit%20t%C3%AB%20shtetasve%20n%C3%AB%20ambientet%20e%20organeve%20t%C3%AB%20Policis%C3%AB%20s%C3%AB%20Shtetit%20dhe%20trajtimin%20e%20tyre%20me%20dinjitet.pdf.

arrestuar/ndaluar dhe neglizhenca e tyre për ushtrimin e detyrës në zbatim të akteve normative në fuqi, të cilat rregullojnë shërbimin e ruajtjes, sigurimit dhe trajtimit të personave të arrestuar/ndaluar në këtë institucion. Mosrespektimi i procedurës standarde, ku në kreun V pika 2.2.3 thuhet se: "Punonjësit e policisë para se të kryejnë kontrollin e personit duhet të: "*Vlerësojnë situatën e rrezikut gjatë kontrollit. Tregojnë kujdes për të dalluar çdo veprim, sjellje, qëndrim apo çdo gjë tjetër që tregon se personi vuan nga ndonjë sëmundje mendore, apo gjendje e veçantë shëndetësore".*

Ndonëse nga institucioni ynë janë bërë një sërë rekomandimesh ndër vite për ndërtimin e dhomave të reja të sigurisë dhe vendosjen në punë të sistemit të monitorimit të tyre konform me procedurën standarde, jo vetëm që rekomandimi nuk është zbatuar, por nuk na është kthyer as edhe përgjigje nga ana e këtij institucioni. Sa më sipër rekomanduam:

- Marrjen e masave të menjëhershme për mospërdorimin e dhomave ekzistuese të sigurisë në Komisariatin e Policisë nr. 5, Kamëz, pasi ato nuk plotësojnë kushtet dhe kriteret që të garantojnë një trajtim njerëzor dhe dinjitoz të personave të ndaluar/arrestuar, sipas përcaktimeve në ligjin nr.108/2014 "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre", si dhe zbatimit të rekomandimit të Komitetit Europian për Parandalimin e Torturës (CPT);
- Marrjen e masave të nevojshme organizative nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për mbylljen e të gjitha atyre dhomave e ambienteve të sigurisë në strukturat vendore të Policisë së Shtetit, që nuk plotësojnë kushtet minimale të standardeve të përcaktuara në procedurën standarde;
- Përgjithësimin e këtij rasti në strukturat vendore të Policisë së Shtetit, me qëllim marrjen e masave të nevojshme për trajtimin e punonjësve të policisë që kryejnë shërbim në ambientet e sigurimit për zbatimin e rregullave të parashikuara në procedurën standarde për ruajtjen e trajtimin e kësaj kategorie personash;
- Analizimin e rastit të mos marrjes së masave nga Komisariati i Policisë nr. 5 Kamëz dhe Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë për mos zbatimin e rekomandimit të Avokatit të Popullit, bërë më shkresën e datës 16.06.2021 dhe mos kthimin e përgjigjes për qëndrimin e mbajtur ndaj tij. Në lidhje me rekomandimin e dërguar nga ana jonë, në përgjigje Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit na bën me dije se : Me urdhër nr.341, datë 12.10.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, dhomat e sigurisë të Drejtorisë Vendore të Policisë së Shtetit, por edhe të gjitha dhomat e sigurisë të komisariateve nr.1,2,3,5 janë mbyllur përfundimisht.

Nisur edhe nga disa konstatime të bëra nga ana jonë kohët e fundit në Komisariatet e Policisë Tiranë, por jo vetëm, të arrestuarit e të ndaluarit vazhdojnë të qëndrojnë për disa ditë edhe pas caktimit të masave të sigurimit "Arrest në burg" nga gjykata. Për këtë gjë kemi rekomanduar marrjen e masave organizative dhe rritjen e bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për transferimin e të arrestuarve/ndaluarve sa më shpejt nga ambientet e Policisë në IEVP konform me marrëveshjen e bashkëpunimit të lidhur ndërmjet këtyre institucioneve, respektivisht me marrëveshjen nr.

897/3, datë 04.03.2019 dhe nr. 2194, datë 05.03.2019 "Për transferimin në IEVP të të arrestuarve/ndaluarve me masën e sigurisë "Arrest në burg" dhe të dënuarve me "Burgim në mungesë". *Lidhur me këtë rekomandim Drejtoria e Përgjithshme e Policisë na bën me dije se situata vazhdon te mbetet problematike si shkak i mospasjes së vendeve të lira në IEVP.*

2. Rekomandimi i dërguar Ministrit të Drejtësisë dhe Kryetares së Komisionit të Ligjeve në Kuvendin e Shqipërisë, për ndryshim të nenit 3, të ligjit 81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimit e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve".

Në datën 22.10.2021, në media është bërë publik lajmi, sipas të cilit dhjetëra të dënuar dhe të paraburgosur në IEVP Burrel refuzojnë ushqimin në shenjë proteste për numrin e ulët të takimeve mujore me familjarët, pasi për shkak të situatës së pandemisë u lejohet vetëm një takim në muaj me ta. Gjithashtu, ata kanë kërkuar të zgjerohet rrethi i familjarëve, me të cilët mund të marrin takim.

Të burgosurve duhet tu lejohet të kenë takime dhe korrespondencë me të afërm dhe persona të tjerë, komunikim me çdo person në botën e jashtme, në kuadër të përmirësimit të kushteve për trajtimin e personave të dënuar me burgim dhe për të garantuar respektimin e të drejtave dhe lirive të tyre themelore. Për rrjedhojë, duke ju referuar standardeve ndërkombëtare dhe praktikave të shteteve të ndryshme si Italia, Serbia, Kosova, Maqedonia e Veriut etj. vërejmë se parashikimet e tyre ligjore për takimin e të burgosurve me botën e jashtme përfshijnë një rreth më të gjerë, si familjen e ngushtë duke përfshirë dhe *të afërmit dhe/ose miqtë.*

Pra rezulton se këto takime, si dhe korrespondenca përfshijnë edhe të tretë, duke e zgjeruar rrethin me persona si nipër e mbesa, miq të vjetër të cilët edhe mund të vijnë fizikisht të takojnë të burgosurit. Ky parashikim ndihmon në gjendjen e tyre psikologjike dhe emocionale, duke mos harruar se në Shqipëri të afërmit ose nuk ndodhen në territorin e Shqipërisë ose e kanë të vështirë kontaktin me të burgosurit për shkak të distancës, duke sjellë shpesh herë një pamundësi të përgjithshme në realizimin e këtyre takimeve.
Pranimi i kërkesave të burgosurve dhe të paraburgosurve shihet i lidhur edhe me një nga të drejtat themelore siç është e drejta për jetë familjare. Në këtë kuadër realizimi i takimeve dhe vizitave me familjarë dhe të afërm të tyre, duhet të konsiderohen si një e drejtë e garantuar nga ligji dhe asnjëherë si një privilegj që mund të hiqet si masë disiplinore. Në Republikën e Shqipërisë, kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.
Sa më sipër, Avokati i Popullit rekomandoi:

- Marrjen e masave të nevojshme për rishikimin e nenit 3 "Përkufizime", të ligjit nr. 81/2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", përkatësisht në pikën 1 të tij ku përkufizohen "Anëtarët e familjes", në funksion të zgjerimit të këtij rrethi;

- Marrjen e masave të nevojshme për garantimin e të drejtës të të burgosurve për të kryer biseda telefonike me anëtarët e familjes, të afërmit dhe në raste të veçanta me të tretët, sipas akteve ligjore në fuqi. *Lidhur me këtë rekomandim dërguar Ministrisë së Drejtësisë dhe Komisionit të Ligjeve ende nuk kemi një përgjigje nga këto institucione*.

3. Rekomandimi i dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe IEVP Durrës.

Në datën 18.07.2022, në media është bërë publik lajmi, se në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Durrës, një i burgosur i ka dhënë fund jetës duke u vetëvarur në qeli. Viktima ishte i burgosuri R.H., 44 vjeç, i cili ishte dënuar me 14 vjet burg për veprën penale "vrasje e mbetur në tentativë". Sipas mediave i dënuari vuante nga probleme të shëndetit mendor. Gjithashtu, në media u raportua se në dhomë me të burgosurin ka qenë edhe një i dënuar tjetër, por në ato momente, ai ka qenë në gjumë. Lidhur me këtë rast, institucioni i Avokatit të Popullit me iniciativë filloi hetimin administrativ mbi ngjarjen e ndodhur. Nga këqyrja e kartelës shëndetësore, i dënuari R.H. vuante nga probleme të shëndetit mendor.

Lidhur me këtë problematikë konstatojmë se nuk kemi referim për ndjekjen e rastit të burgosurit dhe as ndonjë trajtim të veçantë apo referim tek mjeku specialist. Mungesa në organikën e stafit mjekësor nuk garanton një shërbim shëndetësor cilësor për të burgosurit, në mënyrë që të garantojnë ruajtjen e shëndetit të personave që vuajnë dënimin në regjimin e burgjeve, si dhe krahasuar me standardet e përcaktuara në aktet ndërkombëtare për këtë qëllim. Institucioni i Avokatit të Popullit konstaton se mungesa e mjekut me kohë të plotë ka një ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë dhe mbulimin e shërbimit shëndetësor dhe për shmangien e situatave të tilla, duhen marrë masa të menjëhershme për plotësimin e stafit, pasi mund të ketë raste urgjente të cilat personeli shëndetësor nuk mund t'i përballojë dhe pasojat mund të jenë të rënda, ashtu siç ishte rasti konkret.
Sa më sipër, Avokati i Popullit rekomandoi:

- Analizimin me hollësi të rastit nga strukturat kompetente të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, për punonjësit e Policisë së Burgjeve, të sektorit psiko-social dhe atij shëndetësor në IEVP Durrës, në objekt të këtij hetimi administrativ dhe nxjerrjen e përgjegjësive përkatëse, në funksion të një sjelljeje korrekte të ofrimit cilësor të shërbimit dhe të trajtimit të të burgosurve sipas ligjit;
- Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e stafit të sektorit shëndetësor për të dënuarit me probleme të shëndetit mendor, si dhe duhet të tregohet kujdes i veçantë sa i takon përzgjedhjes së standardeve të dhomave ku do të qëndrojnë të dënuarit, higjienës vetjake të tyre, si dhe mjedisit që i rrethon. Personat të cilët vuajnë nga çrregullime të shëndetit mendor, për shkak të sëmundjes së tyre, kanë nevojë për një vëmendje të veçantë, veçanërisht nga ekipi multidisiplinar i institucionit, siç parashikohet në pikën 4, të nenit 3, të ligjit 44/2012, "Për Shëndetin mendor", i ndryshuar;
- Marrjen e masave të nevojshme për të garantuar akomodimin e të burgosurve me probleme të shëndetit mendor në mjedise të përshtatshme banimi, duke respektuar normat në minimum të hapësirës për person.

- Analizimin e këtij rasti dhe përgjithësimin i tij në të gjitha IEVP-të, në mënyrë që personeli policor, shëndetësor dhe ai social të vlerësojë më saktë rrezikun për vetëvrasje që paraqet një i burgosur. Nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, të ushtrohet më shumë dhe më mirë kontroll në IEVP-të, lidhur me zbatimin e akteve normative ligjore e nënligjore për respektimin e të drejtave të njeriut dhe të rekomandimeve të herë pas hershme të Avokatit të Popullit;
- Marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen e institucionit me autoambulancë, për transportin e të sëmurëve në rastet e emergjencave shëndetësore. *Lidhur me këtë rekomandim, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve na bën me dije se me qëllim forcimin e kontrollit kryesisht në aspektin e zbatimit të ligjshmërisë dhe respektimit të të drejtave të të dënuarve, është ngritur Drejtoria e Inspektimit brenda strukturave të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, gjë e cila do të rrisë nivelin e kontrollit në aspektin e zbatueshmërisë ligjore.*

4. Rekomandimi i dërguar Policisë së Shtetit, lidhur me vdekjen e shtetasit L.K.

Në datën 20.10.2022, në institucionin e Avokatit të Popullit është regjistruar rasti i bërë publik në media lidhur me vdekjen e një shtetasi 32-vjeçar pas ndalimit të tij nga Policia e Shtetit. Institucioni i Avokatit të Popullit filloi hetimin administrativ të çështjes ku në datë 20.10.2022, u krye një inspektim në Komisariatin e Policisë nr.3 Tiranë, në kuadër të monitorimit të respektimit të të drejtave të njeriut për personat e shoqëruar/ ndaluar nga organet e policisë së shtetit.

Në vlerësimin e institucionit të Avokatit të Popullit shkaqet e ndodhjes së kësaj ngjarjeje dhe problematikat e konstatuara janë: *arsyeja e ndalimit të 32-vjeçarit, e cila solli më pas pasojat e saj; mosveprimit nga punonjësit e policisë për dërgimin e menjëhershëm të personit të shoqëruar L.K në spital pas shfaqjes së simptomave të përkeqësuara shëndetësore; mungesës së dokumentacionit, pasi është i mangët në komisariat për kohën e qëndrimit dhe shkaqet e kufizimit të lirisë; si dhe mosmbajtja e një procesverbali për pasqyrimin e rrjedhës së ngjarjeve.* Në lidhje me këtë rast, Avokati i Popullit ka vlerësuar si të domosdoshme daljen me një rekomandim të menjëhershëm, drejtuar institucioneve përgjegjëse shtetërore për sa i përket zbatimit me korrektësi të rasteve dhe kritereve ligjore të shoqërimit, ndalimit/arrestimit të shtetasve nga punonjësit e Policisë së Shtetit dhe trajtimin e tyre me dinjitet në përputhje me aktet normative në fuqi.

Sa më sipër, Avokati i Popullit rekomandoi:

- Marrjen e masave për zbatimin efektiv të garancive ligjore të qytetarëve në lidhje me ruajtjen e shëndetit dhe të mirëqenies së tyre në momentet e para të shoqërimit nga punonjësit e policisë;
- Marrjen e masave të nevojshme nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për të ushtruar kontroll në mënyrë të vijueshme në të gjitha strukturat vendore të policisë lidhur me zbatimin e kritereve të shoqërimit të shtetasve dhe respektimin e të drejtave ligjore të personave të shoqëruar si dhe ushtrimit nga titullarët të kërkesave rigoroze llogarie për zbatim të procedurave në rastet e shoqërimit të personave;
- Marrjen e masave nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit që çdo shoqërim i personave në ambientet e policisë së shtetit të jetë i arsyeshëm dhe të ketë indiciet e duhura bazuar në ligjin për Policinë e Shtetit i cili ka përcaktuar qarte rastet kur personat shoqërohen në ambientet e Policisë së Shtetit;

- Përgjithësimin e këtij rasti në të gjitha strukturat vendore të Policisë së Shtetit, me qëllim mos përsëritjen e shkeljeve të tilla në të ardhmen nga punonjësit e policisë;
- Marrjen e masave të nevojshme për zbatimin e detyrimeve ligjore për plotësimin e Formularit të Raportit të Shoqërimit në çdo rast shoqërimi të shtetasve sapo ata sillen në organin e Policisë.
Lidhur me këtë rekomandim Drejtoria e Përgjithshme e Policisë na bën me dije se: Nga ana e Policisë së shtetit janë dërguar letër porosi dhe një sërë tërheqje vëmëndje të gjitha strukturave të Drejtorive vendore të Policisë, në lidhje me masat e marra dhe aktivitetin e tyre përgjatë shoqërimit të shtetasve.

5. Rekomandimi i dërguar Drejtorisë së Policisë së Shtetit dhe organeve të policisë në nivel vendor për krijimin e ambienteve (dhomave) më vete të intervistimit/ marrjes në pyetje të personave të privuar nga liria në mjediset e Policisë së Shtetit.

Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT), nisur nga kryerja e inspektimeve periodike në ambientet e privimit të lirisë së personit (dhoma shoqërimi dhe dhoma sigurie), si dhe nga trajtimi i një numri të konsiderueshëm të ankesave të shtetasve drejtuar institucionit tonë, ka konstatuar në një numër të shumtë rastesh se, nuk janë respektuar të drejtat themelore të shtetasve të garantuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Konventat Ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë, si dhe një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore, raste për të cilat Avokati i Popullit ka dërguar rekomandimet përkatëse dërguar organeve të policisë në nivel vendor dhe Drejtorisë së Policisë së Shtetit.
Sa më sipër, Avokati i Popullit rekomandoi:

- Marrjen e masave të nevojshme dhe të domosdoshme, për krijimin (ndërtimin) sa më parë brenda sistemit të dhomave të shoqërimit dhe të sigurisë të DVP/Komisariateve të policisë në të gjithë vendin, të dhomave më vete për intervistimin apo marrjen në pyetje të personave të shoqëruar/arrestuar/ndaluar në mjediset e Policisë së Shtetit, të plotësuara me orenditë e nevojshme dhe të monitoruara me sistemin e kamerave audio-vizive, si një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve apo arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit;
- Marrjen e menjëhershme të masave, që në projektet për përmirësimet e reja infrastrukturore në komisariate të ndryshme, të parashikohet në të tëra rastet dhoma e intervistimit si në dhomat e shoqërimit, ashtu edhe në ato të sigurisë.
Lidhur me këtë rekomandim Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit na bën me dije se është në kërkim të financimeve për plotësimin e të gjitha kushteve të nevojshme për personat e arrestuar/ ndaluar.

Monitorimi i institucioneve në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të Komitetit Europian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor dhe Degradues (CPT)

Bazuar në Rezolutën e Kuvendit datë 9.7.2020, "Për vlerësimin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit për vitin 2019"[1], Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2020, i kërkoi Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, *të monitorojë zbatimin e rekomandimeve të Komitetit Europian për*

Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor dhe Degradues (KPT), si dhe të raportojë në kohë pranë Kuvendit të Shqipërisë për nevojën e adresimit të problematikave të përsëritura ose për të cilat kërkon angazhim nga ana e tij.

Duke mbajtur në konsideratë masat që institucionet përgjegjëse ishin angazhuar të ndërmarrin gjatë hartimit të përgjigjes së Qeverisë Shqiptare, datë 27 Shkurt 2020, mbi raportin e Komitetit Europian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor dhe Degradues (KPT), gjatë vizitës së tyre në Shqipëri në datat 20 - 30 Nëntor 2018[2], kemi kërkuar të na informojnë sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, mbi rekomandimet të cilat i kemi renditur jo sipas rëndësisë por sipas radhës së gjetjeve në këtë raport.

Pas marrjes së përgjigjeve nga institucionet e mësipërme dhe mbi bazën e gjetjeve faktike kemi hartuar një *Raport të Veçantë* mbi zbatimin dhe problematikat e tyre sipas gjetjeve të vetë MKPT-së gjatë monitorimeve të njëpasnjëshme, raport i cili u publikua në datën 14.07.2022.[44]

I. Niveli i respektimit të drejtave të personave në Spitalet Psikiatrike

Avokati i Popullit vazhdimisht ka tërhequr vëmendjen për gjendjen në spitalet e kujdesit të shëndetit mendor në Shqipëri. Për vitin 2022, Mekanizmi Kombëtar ka inspektuar institucionet e shëndetit mendor si Spitali Psikiatrik Vlorë, Spitali Psikiatrik Shkodër, Spitali Psikiatrik Elbasan, IEVP Lezhë, Institutin e Veçantë Shëndetësor të të Burgosurve (IVSHB) dhe Spitali Psikiatrik Tiranë "Xhavit Gjata" Tiranë.

Nga këto inspektime, problematikat e konstatuara janë:

✓ *Moszbatimi i detyrimit ligjor ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë për ngritjen e një Institucioni të Posaçëm Mjekësor, të parashikuar në ligjin Nr. 44/2012, datë 08.05.2012 "Për Shëndetin Mendor",* me qëllim strehimin dhe trajtimin e personave që kanë marrë nga gjykata masën "mjekim i detyruar" dhe "shtrim i përkohshëm*".* Avokati i Popullit nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar, ka tërhequr në mënyrë të përsëritur vëmendjen për kushtet e trajtimit në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale ku janë vendosur personat me çrregullime të shëndetit mendor që kanë kryer vepra penale ose persona me masë mjekësore mjekim i detyruar.

✓ *Mos zbatimi i përsërtitur të nenit 28 të ligjit nr. 44/2012 "Për Shëndetin Mendor" i ndryshuar nga Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për ngritjen e institucioneve të posaçme mjekësore dhe për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor, që kanë kryer një vepër penale***,** për të cilët gjykata kompetente ka vendosur mjekimin e detyruar në një institucion mjekësor, të të paraburgosurve apo të të dënuarve që shfaqin çrregullime të shëndetit mendor gjatë vuajtjes së dënimit, si dhe për trajtimin e personave, për të cilët gjykata ka vendosur shtrimin e përkohshëm në një institucion mjekësor të posaçëm, sipas nenit 239 të Kodit të Procedurës Penale, i ndryshuar.

✓ *Shtimin në organikat e spitaleve të mjekëve psikiatër, infermierëve "kujdestarë/task forcë", stafit të sigurisë, sanitarëve dhe berberit, me qëllim ofrimin e një shërbimi të* *përshtatshëm*

[44] https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Raporti%20CPT.pdf.

për specifikat e këtij shërbimi të shëndetit mendor me shtretër. Avokati i Popullit vazhdon të vlerësojë se është i nevojshëm shtimi i menjëhershëm dhe në vitet në vijim i kuotave për specializantë në Psikiatri; riformulimi i kritereve të punësimit për funksionet klinike "kujdestar" dhe "task forcë", me edukim infermieristik dhe njohuri të thelluara në rehabilitim psikiatrik spitalor, si dhe me aftësi moshore e fizike të përshtatshme për menaxhimin e axhitimit dhe riskut të lartë; si dhe trajnimin e punonjësve aktualë.

✓ Vendosjen e *sistemit monitorues me kamera vëzhgimi* në ambientet e përbashkëta të spitaleve psikiatrike**.**

✓ *Krijimin/rikonstruksionin e plotë të dhomave të izolimit, duke i kompletuar ato në përputhje me pikën 4.6 "Infrastruktura e Izolimit", të "Standardeve të Kufizimit Fizik në Shërbimet e Shëndetit Mendor të Specializuar me Shtretër***",** miratuar me Urdhër të Ministrit të Shëndetësisë, pjesë e paketës së akteve nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 44/2012 "Për Shëndetin Mendor" i ndryshuar, si dhe *pajisjen e spitaleve me mjete të kufizimit mekanik*, konform pikës 1.2 "Elementët e kufizimit", germa b "Kufizimi Mekanik", aktit nënligjor të cituar më sipër.

✓ *Përmirësimin e kushteve në pavijone, ngrohje, dushe dhe tualete në mënyrë që të ofrohet një shërbim sa më dinjitoz të personave që trajtohen në spitalet psikiatrike*, si dhe sigurimin e bazës së nevojshme materiale për stafet psiko-sociale.

✓ Pajisjen/vënien në funksion të plotë të *laboratorëve klinikë bio-kimikë* si dhe të *aparateve të EKG-së.*

✓ *Shërbimi mjekësor mbetet me mungesa dhe nevojë të përhershme për kushte më të mira materiale dhe mbështetje me staf sigurie***.** Për shkak të kushteve minimale të sigurisë, mjekët dhe stafi mbështetës janë gjithmonë të rrezikuar.

✓ *Nevojitet ndarja dhe riorganizimi i pavijoneve të veçanta të personave me aftësi të kufizuar intelektuale, rezidentë, pacienteve akutë, sub-akutë, në mënyrë që të ofrohet një shërbim më i plotë dhe sipas nevojave për secilën kategori***,** pasi vendosja e tyre në të njëjtin pavijon, vështirëson trajtimin e tyre sipas standardeve të parashikuara në ligjin për shëndetit mendor dhe aktet nën ligjore të tij.

Për gjithë sa më sipër, Avokati i Popullit ka dërguar rekomandimet përkatëse për përmirësimin e gjendjes në spitalet e kujdesit të shëndetit mendor në Shqipëri.

➢ ***Niveli i respektimit të të drejtave në Qendrat e mbyllura për të Huajt, Qendrën Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit si dhe në Qendrën Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikut***

Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) për vitin 2022, në kuadër të monitorimit të respektimit të të drejtave në qendrat e pritjes të emigracionit, qendrat për mbrojtjen e viktimave nga trafikimi, ka realizuar inspektimet përkatëse për të vlerësuar nivelin e respektimit të këtyre të drejtave.

➢ *Qendra e Mbyllur për të Huajt, Karreç*

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues (MKPT), zhvilloi një inspektim në Qendrën e Mbyllur për të Huajt në Karreç (QMHK), *në datën 10.02.2022*, sipas planit vjetor të inspektimit, miratuar nga Avokati i Popullit.

Nga inspektimi u konstatua se vazhdonin të ishin prezente problematikat si më poshte:[45]

✓ Problematika e mungesave në staf si: mjeku, juristi, stomatologu mungesa të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në respektimin e të drejtave të personave të huaj të parregullt në Republikën e Shqipërisë.

✓ Mungesa e aparateve kartofonike, të cilat janë të domosdoshme për personat e huaj, për të komunikuar me familjet. Grupi i inspektimit u informua nga stafi i institucionit se komunikimi i të akomoduarve me familjarët zgjidhej nëpërmjet qarkullimit të aparateve celular të personave, që i disponinin të cilët, me orar të caktuar ua jepnin personave të tjerë për të komunikuar me familjarët apo përfaqësuesit ligjorë.

✓ Vijon problematika e mungesës në Qendër të përkthyesit, si një nevojë emergjente për komunikimet të cilët duhet të jenë për gjuhën angleze ose të gjuhës së huaj dominante të të huajve që ndodhen të akomoduar në këtë Qendër. Kjo mungesë sillte në vazhdimësi, vështirësi në komunikimin dhe ndërveprimin e të të akomoduarve me punonjësit e Qendrës.

✓ Një problematikë po aq e rëndësishme mbetet mungesa e ambienteve rekreative dhe sportive. Mungonin aktivitetet kulturore, argëtuese e sportive i vetmi aktivitet sportiv ishte ai i lojës me top, në një fushë të papërshtatshme për lojëra me këmbë.

✓ Në të gjitha ambientet e Qendrës ishte evidente mungesa e posterave me të drejtat ligjore të shtetasve të huaj të parregullt të ndaluar.

✓ Nuk ishte kryer lyerja periodike e dhomave të fjetjes së personave të huaj të akomoduar në Qendër, sidomos në korridorin e përbashkët të dhomave të banimit vërehej një ambient i papastër, mure të palyera dhe aromë e pakëndshme.

✓ Në Qendër nuk ofrohet shërbimi stomatologjik. Qendra ka vetëm një infermier i cili ju përgjigjet nevojave dhe shërbimit mjekësor.

✓ Mungonin zilet e emergjencës në dhomat e fjetjes. Mirëmbajtja në sistemet hidrosanitare dhe elektrike në dhomat e izolimit janë kryer vetëm pjesërisht.

➢ *Qendra Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit Babrru, Tiranë*

Mekanizmi Kombëtar (MKPT) kreu një inspektim në Qendrën Kombëtare Pritëse të Azilkërkuesve në datën 14.07.2022. Përgjatë inspektimit u konstatua se vazhdonin problematikat si më poshtë:

✓ Nuk ishin marrë masat për rritjen e kuotës ditore të trajtimit me ushqim të azilkërkuesve, duke marrë parasysh rritjen e çmimeve të shportës së ushqimeve si dhe vlerësimin e tyre vit pas viti.

✓ Nuk ishin marrë masat për rishikimin e organikës së kësaj Qendre duke pasur në vëmendje trendin e lëvizjeve migratore. Vlerësimin për shtimin e organikës me të paktën 1 infermier, 2 kujdestarë nate, 1 punëtor mirëmbajtjeje, 1 specialist finance dhe 1 sanitare të cilët janë të domosdoshëm për plotësimin e nevojave aktuale.

✓ Nuk ishin marrë masat për krijimin e një këndi lojërash për fëmijët dhe një fushë sportive të përshtatshme për kryerjen e aktiviteteve sportive.

[45] Rekomandim i datës 15.11.2021, Nr.K4/Ç21-4. Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe trajtimit të të huajve të parregullt akomoduar në Qendrën e Mbyllur për të Huajt në Karreç.

➢ *Qendra Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikut, Linzë*

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, më datë 15.07.2022 kreu një inspektim në Qendrën Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikut në vijim (QKPVT) Linzë. Nga inspektimi i kryer në këtë qendër u konstatua se nuk kanë gjetur zgjidhur problematikat e konstatuara nga inspektimet e mëparshme. Më konkretisht:

✓ Nuk ka marrë zgjidhje problematika për përfundimin sa më shpejt të projektimit dhe rindërtimit të godinës tre katëshe brenda Qendrës e cila është shembur që në tetor 2019.

✓ Nuk ka marrë zgjidhje problematika për rikonstruksionin e pjesshëm të godinës dy katëshe, pasi ambientet e saj kanë pësuar dëme të konsiderueshme dhe janë të pasigurta për banim.

3.5 Respektimi i të drejtave të njeriut nga Prokuroria[46]

Gjatë vitit 2022, institucioni i Avokatit të Popullit ka regjistruar dhe trajtuar *37 çështje* në të cilat janë ngritur dhe parashtruar pretendime dhe shqetësime ndaj veprimtarisë së organit të Prokurorisë.

Organi i prokurorisë, duke zbatuar detyrimin kushtetues si autoriteti i vetëm për ushtrimin e ndjekjes penale, duhet të kryejë një hetim të plotë e të gjithanshëm për të gjitha procedimet, brenda afateve procedurale, për të ngritur dhe përfaqësuar sa më mirë akuzën në gjykim, për të ekzekutuar në kohë vendimet penale të gjykatave dhe për të mbikëqyrur në vazhdimësi vuajtjen e dënimit.

Gjithashtu, është e rëndësishme të vlerësohen materialet dhe të arrihet në një konkluzion të bazuar për mundësinë e regjistrimit ose jo të procedimit penal, të kryhen hetime profesionale, në një kohë sa më të arsyeshme, pavarësisht ngarkesës dhe rritjes së vëllimit të punës, të mbahen komunikime korrekte me palët, subjektet, institucionet apo të interesuarit, të veprohet shpejt dhe me efikasitet në procesin e ekzekutimit etj. Mirëpo, është konstatuar fakti se në rastet e pezullimit të hetimit, në disa raste organi i Prokurorisë nuk njofton/informon apo nuk iu dërgon palëve vendimin përkatës. Avokati i Popullit ndër vite ka insistuar në respektimin e të drejtës së qytetarit për t'u informuar me vendimet përfundimtare të Prokurorisë, duke synuar garantimin e të drejtës së ankimimit që duhet t'u njihet individëve ndaj vendimeve respektive në çdo fazë të hetimit.

Evidentojmë faktin se, nëpërmjet analizës dhe argumentimit të problematikave me organet e prokurorisë, nuk kemi synuar të vlerësojmë e ndikojmë në vendimmarrjen e prokurorëve të çështjeve, pasi është e qartë se kompetente për shqyrtimin e bazueshmërisë ligjore së këtyre vendimeve është gjykata. Por në rastet e moszbatimit të detyrimeve ligjore të prokurorëve lidhur me të drejtat e kallëzuesve dhe viktimave në procesin penal, të garantuara nga Kodi i Procedurës Penale, nuk mund të qëndrojmë indiferentë. Pra, kallëzuesit dhe viktimës së veprës penale duhet t'u garantohen/realizohen në fakt të drejtat e parashikuara në nenin 58, pika 1 gërmat "d", "dh", "e', "ë", "f", në nenin 326 pika 3 dhe nenin 329/a pika 4.

Në mënyrë të grupuar sipas cenimit të të drejtave në procesin penal, ankesat e qytetarëve paraqiten si më poshtë:

[46] Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Veçantë në institucionin e Avokatit të Popullit.

Së pari, për zvarritje të pajustifikuara në hetimin e procedimeve penale. Ankesat e qytetarëve ndaj prokurorisë për zvarritje në hetimin e procedimeve penale zënë pjesën më të madhe të numrit të përgjithshëm të çështjeve të trajtuara nga institucioni i Avokatit të Popullit. Arsyet kryesore të zvarritjes në hetimin e procedimeve penale sipas vetë përgjigjeve të prokurorive lidhen kryesisht me numrin e reduktuar të prokurorëve[47] në strukturat e hetimit dhe procedimit penal, për shkaqet e zbatimit rigoroz të reformës në drejtësi dhe shkarkimit të një numri të konsiderueshëm të prokurorëve; numrin e lartë të çështjeve për një prokuror; kompleksitetin e çështjeve, sidomos ato që kanë të bëjnë me dhunën në familje, marrëdhëniet seksuale me të mitur, apo vepra të tjera të rënda penale; problemet dhe zvarritjet në kthimin e përgjigjeve të letërporosive nga autoritetet e drejtësisë të shteteve të huaja, si dhe komandimet e prokurorëve të çështjeve në prokurori të tjera për të mbuluar vakancat e krijuara. Pavarësisht këtyre, gjatë hetimeve tona janë konstatuar raste të zvarritjeve të pajustifikuara me vite të procedimeve penale.

Së dyti, problematika në zbatimin e dispozitave procedurale që parashikojnë dhe rregullojnë të drejtat e palëve në procesin penal, e më konkretisht mosnjohja me aktet dhe provat (dosjen) mbi bazën e të cilave ngrihen akuzat penale; mungesa ose vonesat në njoftimin e palëve për vendimet e marra nga organi i Prokurorisë, kryesisht kallëzuesit të veprës penale, sidomos në rastet e vendimeve për mosfillim të procedimit penal; mosveprime nga ana e prokurorit për një kohë të gjatë; mosinformim për kallëzimin e bërë; veprimet e ndjekura për zëvendësimin e prokurorit; sekuestrim i padrejtë i automjetit/pronave etj. Vonesa për njoftimet e palëve në procesin penal kanë ndodhur dhe për rastet kur organi i Prokurorisë ka marrë vendim për pushimin e çështjes.

Së treti, mos njoftimi i qytetarëve nga organet e prokurorisë lidhur me kallëzimet e bërë për vepra penale të kryera në dëm të tyre. Megjithëse ankuesit, persona fizikë e juridikë, në kallëzimet e bëra kanë dhënë adresat banimit apo punës, adresat elektronike, si dhe numrat e telefonëve, nuk kanë marrë njoftime me asnjë prej formave të komunikimit (as në rrugë postare, as në rrugë elektronike dhe as nëpërmjet telefonit). Ndërkohë nga kopjet e dokumentacionit të dërguar nga organet e prokurorisë kemi konstatuar edhe raste që njoftimi i shtetasve ndodhej në dosjen penale, por nuk kishte dokument/dëftesë komunikimi që të provojë se është bërë realisht njoftimi/komunikimi i vendimeve në fjalë. Pra, në këto raste në vlerësimin tonë njoftimi është bërë formal dhe për të plotësuar dosjen, por pa efektivitet lidhur me realizimin e të drejtave të shtetasve (kallëzuesve/viktimave të veprave penale) të parashikuara nga Kodi Procedurës Penale konkretisht neni 9/a, neni 58, neni 326 pika 3 dhe neni 329/a pika 4.

Në një rast institucioni i Avokatit të Popullit ka trajtuar një ankesë ndaj Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan në të cilën parashtrohej se ankuesi kishte regjistruar kallëzimin penal në muajin Tetor të vitit 2020 dhe nuk ka pasur informacion lidhur me hetimet e zhvilluara nga Prokuroria. Për këtë qëllim është zhvilluar një hetim administrativ në përfundim të të cilit është konstatuar se trajtimi i çështjeje në tejkalim të afateve të përshtatshme ka ardhur si rezultat i disa faktorëve, duke cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor dhe adresuam

[47] Sipas Raportit të Komisionit Europian për Shqipërinë, publikuar në 12.10.2022, Shqipëria në vitin 2021 ka pasur 300 prokurorë me kohë të plotë (10.5 për 100,000 banorë). Sipas Komisionit Europian për Efiçencën në Drejtësi (CEPEJ), mesatarja Europiane është 12 prokurorë për 100,000 banorë.
Për më tepër shih linkun si vijon:
https://ec.europa.eu/info/departments/european-neighbourhood-policy-and-enlargement-negotiations_en.

rekomandimin[48] për marrjen e masave me qëllim kryerjen e hetimeve objektive, të gjithanshme dhe të shpejta të procedimit penal, dhe njoftimin e viktimës (kallëzuesit) nga Prokuroria, në zbatim të dispozitave kushtetuese e procedurale ligjore, në kuadër të procesit të rregullt ligjor.

Një problematikë e trajtuar në vijimësi nga ana jonë lidhet me rastet e shtetasve të proceduar penalisht për kryerjen e veprave penale të ndryshme, nga ana e të cilëve ndërkohë, janë bërë kallëzime apo ankesa gjatë seancave gjyqësore për vleftësimin dhe caktimin e masave të sigurimit personal, për dhunim fizik të tyre nga punonjësit e Policisë së Shtetit gjatë momentit të kapjes, shoqërimit në organet e policisë apo gjatë marrjes së deklarimeve të tyre. Nga organet prokurorisë janë administruar kallëzimet e bëra nga personat ndaj të cilëve zhvillohen hetime apo prokurorët e çështjes kanë filluar kryesisht procedimin penal në rastet e ankesave të paraqitura në seancat gjyqësore nga të dëmtuarit. Por, në vijim të veprimeve, konstatohet se procedimet penale janë bashkuar në të njëjtin procedim dhe hetimet janë ndjekur nga i njëjti prokuror.
Lidhur me bashkimin e procedimeve penale kur kemi kallëzime të ndërsjellta të palëve konkretisht të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Policisë së Burgjeve apo të Policisë Bashkiake dhe shtetasve nën hetim, sjellim në vëmendje gjetjet e Raportit të CPT-së i bërë publik në datën 17.09.2019, pas vizitave që ka kryer në disa institucione të privimit të lirisë në Shqipëri, nga data 20 deri në datën 30 nëntor 2018. Sipas CPT-së, një përgjegjësi e tillë e dyfishtë mund të cenojë paanshmërinë e prokurorit në fjalë. Prandaj, Komiteti rekomandon që rastet e keqtrajtimit të mundshëm të policisë të hetohen nga prokurorë të cilët nuk kanë lidhje me hetimet penale kundër viktimave të pretenduara të keqtrajtuara. Në përfundim të hetimit të disa ankesave të qytetarëve u kemi rekomanduar organeve respektive të prokurorisë për ndarjen e procedimit penal të kallëzimit të paraqitur nga shtetasit nga procedimi penal me të pandehur shtetasit dhe hetimin më vete, nga prokurorë të ndryshëm. [49]
Pavarësisht adresimit të kësaj çështjeje,[50]kemi konstatuar se ky qëndrim ishte i përsëritur. Ndaj, vlerësuam se duhej të sillej në vëmendjen e organit qëndror të prokurorisë standardi ndërkombëtar më i mirë për të garantuar të drejtat e shtetasve të pandehur gjatë procesit penal nga organet e prokurorisë. Gjithashtu, përpos kësaj problematike, çmuam të evidentonim edhe disa shqetësime të tjera si vonesa apo moskthimi i përgjigjeve dhe mosdhënia e informacioneve të kërkuara nga ana jonë në kuadër të hetimit administrativ për trajtimin e ankesave të shtetasve ndaj organit të prokurorisë. Ky qëndrim është jo korrekt dhe sjell si pasojë, zvarritje dhe vonesa në afate të shqyrtimit të ankesave dhe kërkesave të shtetasve nga institucioni ynë e për rrjedhojë, edhe cenimin e reputacionit të Avokatit të Popullit në publik.

Me qëllim rritjen e performancës dhe besimit publik të organeve të prokurorisë në të ardhmen, dhe me qëllim për të garantuar respektimin me korrektesë, objektivitet, paanshmëri e

---

[48] Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës.
https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20p%C3%ABr%20marrjen%20e%20masave%20me%20q%C3%ABllim%20kryerjen%20e%20hetimeve%20objektive,%20t%C3%AB%20gjithanshme%20dhe%20t%C3%AB%20shpejta%20t%C3%AB%20procedimit%20penal.pdf.
[49] Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimet përkatëse.
https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20per%20ndarjen%20e%20procedimit%20penal%20te%20kallezimit%20te%20bere%20nga%20A.H.pdf.
https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20drejtuar%20Prok.%20Kurbim%20per%20ndarjen%20e%20proc.%20penale.pdf.
https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomadim%20drejtuar%20Prokurorise%20Sarande%20per%20ndarjen%20e%20%C3%A7eshtjeve%20penale.pdf.
[50] Për më tepër, shih: https://rm.coe.int/16809cb571 "Response of the Albanian Government to the report of the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT on its visit to Albania)" from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf (2020). Përgjigjja e qeverisë Shqiptare është dërguar në datë 27 Shkurt 2020.

profesionalizëm të rregullave dhe parimeve procedurale gjatë hetimit të procedimit penal i rekomanduam[51] Prokurorit të Përgjithshëm marrjen e masave të nevojshme për përgatitjen, miratimin dhe dërgimin organeve të prokurorisë të juridiksionit të përgjithshëm të një udhëzimi/qarkoreje për përmirësimin e punës së tyre për respektimin e të drejtave kushtetuese e ligjore të shtetasve gjatë procesit penal lidhur me problematikat e parashtruara më sipër. *Rekomandimi u mirëprit dhe u pranua*.

Po ashtu, është trajtuar në institucionin tonë problematika lidhur me mosllogaritjen e saktë të kohës së vuajtjes së dënimit. Në një ankesë është ngritur shqetësimi i një të dënuari lidhur me masën e sigurimit "Arrest në shtëpi" nga data kur vendimi kishte marrë formë të prerë e deri në datën kur ai ishte ekzekutuar, gjithsej 51 ditë, periudhë që nuk ishte llogaritur si kohë e vuajtjes së dënimit në urdhrin e ekzekutimit të vendimit penal të nxjerrë nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Në përfundim të hetimit tonë, rezultoi se është e nevojshme të mbahet një qëndrim nëse i dënuari me masë sigurimi "Arrest në shtëpi" duhet të lëvizë i lirë apo duhet të qëndrojë në shtëpi deri sa vendimi i formës së prerë të ekzekutohet dhe se duhen respektuar afatet ligjore në nxjerrjen e akteve për ekzekutimin e vendimeve penale me burgim, dërgimin në institucionet përkatëse dhe ekzekutimin e tyre në funksion të garantimit dhe moscenimit të të drejtave të shtetasve të dënuar. Për gjetjet përkatëse, iu adresua rekomandim[52] Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Gjykatës së Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

3.6 E drejta për një proces të rregullt ligjor në sistemin gjyqësor[53]

Gjatë vitit 2022, kanë vijuar po të njëjtat vështirësi për funksionimin efikas të sistemit gjyqësor në Shqipëri. Efektet e procesit të reformës në drejtësi edhe këtë vit kanë rritur volumin e punës në sistem për shkak të mungesave dhe largimeve të një numri të konsiderueshëm gjyqtarësh dhe moszëvendësimit të tyre me të rinj.

Me rëndësi është plotësimi i numrit të gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese[54], e cila realizon kontrollin kushtetues si element të rëndësishëm që ndikon në konsolidimin e shtetit të së drejtës në tre drejtime: ndarjen dhe balancimin e pushteteve; parimin e sigurisë juridike; mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave themelore të njeriut.

Ndërkohë, në Gjykatën e Lartë përgjatë vitit 2022 u emëruan 6 (gjashtë) gjyqtarë të rinj, duke çuar numrin në 15 gjyqtarë. Edhe pse ka vazhduar puna për shqyrtimin e çështjeve të akumuluara gjatë viteve në këtë gjykatë, vijon të mbetet ende tepër i lartë numri i çështjeve që presin radhën

[51] https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20drejtuar%20Prokurorit%20te%20Pergjithshem%20per%20nxjerrjen%20e%20nje%20qarkoreje.pdf.
[52] https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20per%20respektimin%20e%20afateve%20ligjore%20ne%20nxjerrjen%20e%20akteve%20per%20ekzekutimin%20e%20venidmeve%20penale.pdf.
[53] Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Veçantë në institucionin e Avokatit të Popullit.
[54] Në muajin janar 2023 u emërua anëtarja e nëntë e Gjykatës Kushtetuese.

e gjykimit, në veçanti ato civile[55]. Nga ana tjetër me këtë ngarkesë, është e vështirë që Gjykata e Lartë të përmbushë misionin kushtetues dhe ligjor të saj, që është sigurimi i uniformitetit në interpretimin e ligjit nga gjykata.

Në institucionin e Avokatit të Popullit janë paraqitur *62 ankesa* të cilat kanë si objekt të tyre kryesisht: zvarritje të proceseve gjyqësore; shtyrje të gjykimit të çështjeve të reja; dorëzim me vonesë të vendimeve të arsyetuara; ankesa ndaj vendimeve gjyqësore; si dhe problematika në respektimin e plotë të të drejtave procedurale gjatë gjykimit. Janë konstatuar në vijimësi zvarritje me vite të procesve gjyqësore në veçanti nga Gjykata Administrative e Apelit në të cilën situata mbetet kritike, si dhe në gjykatat e tjera të apelit. Në disa raste për të cilat ka përfunduar hetimi janë adresuar rekomandimet përkatëse drejtuar respektivisht Gjykatës së Apelit Tiranë dhe Gjykatës së Apelit Shkodër për marrjen e masave ligjore për shpejtimin e gjykimit të çështjeve që kanë objekt njohjen e viteve të punës, njohjen e vërtetësisë apo pavërtetësisë së dokumentit për përfitimin e pensionit të pleqërisë, duke iu garantuar shtetasve këtë të drejtë, në kuadër të procesit të rregullt ligjor[56]. Në një çështje tjetër iu drejtuam me rekomandim Gjykatës së Apelit Shkodër për marrjen e masave ligjore me qëllim respektimin e (afatit të arsyeshëm të gjykimit) garancive të procesit të rregullt ligjor në një çështje gjyqësore civile[57]. Po ashtu, i kemi rekomanduar Gjykatës së Apelit Vlorë marrjen e masave për respektimin e afateve procedurale për arsyetimin dhe dorëzimin e vendimeve gjyqësore[58].

Harta e re gjyqësore

Në funksion të ushtrimit të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të shtetasve nga veprimet apo mosveprimet e organeve të administratës publike, institucioni i Avokatit të Popullit ka ndjekur me shumë vëmendje diskutimet dhe debatet publike mbi propozimin e hartës së re gjyqësore nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Ministria e Drejtësisë. Nisur nga ndjeshmëria e veçantë e kësaj çështjeje, por njëkohësisht edhe nga ankesat e paraqitura nga qytetarët në institucion, sidomos ata që u përkasin grupeve vulnerabël, është filluar hetimi i rastit me iniciativë.

Sipas nenit 14 të ligjit nr.98/2016, kërkohet që procesi i rivlerësimit të shpërndarjes së rretheve gjyqësore të bëhet bazuar në 3 kritere:

- ✓ garantimin e aksesit në drejtësi, që lidhet me afërsinë e individit me gjykatën;
- ✓ uljen e kostove, me qëllim përdorimin me efektshmëri të burimeve publike;

[55] Nga 36.000 çështje që prisnin për tu gjykuar në mars të vitit 2020, sot numri i çështjeve të prapambetura është ulur në 28,940, ndërkohë që numri i vendimeve të marra për këtë periudhë është 11.764. Për vitin 2022 janë regjistruar rreth 2,082 çështje të reja. Janë dhënë 6,335 vendime gjyqësore, ose 440 vendime për gjyqtarë.
http://www.gjykataelarte.gov.al/ëeb/raporti_vjetor_i_performances_se_gjykates_se_larte_per_vitin_2022_redaktuar_final_14055.pdf.

[56] Për më tepër shih linkun:
https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20per%20gjykimin%20e%20ceshtjeve%20te%20pensioneve.pdf.

[57]https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20per%20gjykimin%20e%20ceshtjes-Xh.M._MM7aTc2.pdf.

[58] https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20-E.C.pdf.

- ✓ rritjen e cilësisë dhe përshtatshmërisë së shërbimeve të ofruara.

Po kështu, neni 15 i po këtij ligji parashikon parimet dhe kriteret për përcaktimin e kompetencave tokësore.

Propozim Raport Vlerësimi mbi hartën e re gjyqësore[59] i hartuar nga grupi i punës u diskutua në disa takime konsultative të organizuara. Por, pavarësisht këtyre përpjekjeve për të mbledhur opinionet, sugjerimet e rekomandimet e grupeve të interesit, vlerësojmë se ky proces duhet të kishte filluar më herët, duke garantuar mundësi dëgjimi dhe reflektimi që në fazën fillestare të ideimit të kësaj harte. Në propozimin e fundit të miratuar nga KLGJ është parashikuar:

- ➢ Nga 22 Gjykata të Shkallës së Parë (me juridiksion të përgjithshëm) të ngelen 13;
- ➢ Nga 6 Gjykata Administrative të Shkallës së Parë të ngelen 2;
- ➢ Nga 6 Gjykata Apeli në gjithë Shqipërinë të ngelet vetëm një në Tiranë.

Gjithashtu, për t'u evidentuar është fakti se nga inspektimet e kryera nga grupet e punës së institucionit të Avokatit të Popullit në disa Institucione të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, si nga të paraburgosurit/dënuarit, po ashtu edhe nga stafi administrativ janë ngritur shqetësime lidhur me projektin e hartës së re të shpërndarjes së gjykatave, sipas së cilës gjykatat e apelit do të shkrihen dhe do të ngelet vetëm Gjykata e Apelit Tiranë.

Sipas tyre, ky proces do të sillte vështirësi të mëdha organizative dhe ngarkesë në buxhet, pasi nëse do të jetë vetëm një gjykatë apeli, për shkak të burimeve njerëzore të kufizuara por edhe mjeteve në dispozicion, vështirësitë do të jenë të shumta për këtë kategori personash, por edhe të shërbimeve të kryera nga policia e burgjeve.

Avokati i Popullit vlerësoi se ky propozim nuk e përmirëson aspak aksesin në drejtësi, por përkundrazi e cenon këtë parim, duke passjellë:

- ✓ shkeljen e parimit të aksesit në drejtësi;
- ✓ rritjen e kostove për qytetarët;
- ✓ cilësinë dhe përshtatshmërinë joadekuate të shërbimeve të ofruara.

Shteti duhet t'i garantojë çdo individi akses në drejtësi, kohë dhe burime financiare për t'u dëgjuar dhe përfaqësuar. Sipas këtij propozimi mbyllen 9 gjykata në shkallë të parë (me juridiksion të përgjithshëm), ndryshimi më drastik në këto 30 vite në të gjithë rajonin.

Sipas të dhënave krahasuese të publikuara nga Komisioni Europian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) në lidhje me sistemet gjyqësore të shteteve anëtare të Këshillit të Europës, mbyllja e këtyre gjykatave në kuadër të kësaj harte të propozuar, vetëm sa ul numrin e gjykatave dhe gjyqtarëve për 100,000 banorë.[60]

[59] http://klgj.al/wp-content/uploads/2021/12/NJ%C3%8B-HART%C3%8B-E-RE-GJYQ%C3%8BSORE-.pdf.

[60] Numri i gjykatave për 100,000 banorë është tashmë nën mesataren Europiane. Ky numër për Shqipërinë ishte afërsisht 1.3 në 2018, ndërsa mesatarja Europiane është afërsisht 1.5. Pas miratimit të propozimit, ky indikator do të përkeqësohej nga ana tjetër,

Ky projekt shoqërohet me rritjen e konsiderueshme të kostove, si për qytetarët, po ashtu edhe për buxhetin e shtetit. Problemi kryesor i projektit është se i mungon një studim fizibiliteti si dhe një planifikim për kohën e vendosjes dhe zbatimit të tij në praktikë.

Në një kohë, kur edhe pse është me shumë rëndësi përfshirja e një treguesi për kohën e nevojshme të udhëtimit të qytetarëve për në gjykatë, duke përdorur transportin publik, pavarësisht se Grupi i Punës i ka kërkuar të dhëna Autoritetit Rrugor Kombëtar, pas leximit me kujdes të materialit të prezantuar evidentohet se nuk ka të dhëna të disponueshme.

Përveç Kosovës, e cila ka një sipërfaqe dhe popullsi shumë më të vogël se Shqipëria, asnjë vend Europian nuk ka vetëm një Gjykatë të Apelit siç është propozuar.

Çmojmë se, harta e re e Gjyqësorit nuk është projektuar me qëllimin për të siguruar ofrimin e aksesit adekuat të qytetarëve në gjykata, por për të adresuar numrin e ulët të gjyqtarëve që janë aktualisht në sistemin e drejtësisë.

Ajo që mbetet tepër shqetësuese dhe në konsideratë të veçantë të Avokatit të Popullit janë shtresat me të ardhura të pamjaftueshme, të cilat përbëjnë një numër të konsiderueshëm të popullsisë shqiptare (Të dhënat tregojnë që megjithëse varfëria relative ka ardhur në ulje të pakonsiderueshme nga 23.7 (në vitet 2017-2018) në 23.4 në vitin 2018, përqindja e popullatës që janë në rrezik varfërie ose jetojnë me të ardhura shumë të ulëta është 49%, që do të thotë se pothuajse gjysma e popullsisë jetojnë në kushte shumë të vështira ekonomike[61]).

Në vlerësimin tonë zbatimi i hartës së re gjyqësore përbën një shkelje dhe kufizim të të drejtave, sepse do të shkaktojë mungesë aksesi në drejtësi edhe për viktimat e dhunës me bazë gjinore, viktimat e trafikimit të qënieve njerëzore dhe viktimat nga veprat penale të ngacmimit seksual, marrëdhënieve seksuale me dhunë me të rritur e të mitur. Për këtë arsye, mendojmë se një riorganizim i tillë i sistemit gjyqësor, do të çojë në lëshimin e vendimeve për urdhrat e mbrojtjes pa praninë e palëve gjykuese në proçes, në rastin më të mirë vetëm me praninë e dhunuesit.

Njëkohësisht, duke parë zbatimin e ligjit nr.111/2017 *"Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti"*, i cili ka paraqitur vështirësi të dukshme në përfitimin e ndihmës juridike dytësore, si pasojë e moszbatimit të vendimeve gjyqësore nga ana e dhomave vendore të avokatisë, por edhe nga ulja e buxhetit për ndihmën juridike, jemi të mendimit se me një hartë të re gjyqësore këto problematika do të thellohen, duke mohuar drejtësinë për këto kategori.

E drejta e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm ligjor është një ndër të drejtat themelore të qytetarëve. Për këtë arsye, e drejta e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm nuk është dhe nuk duhet të mbetet një e drejtë apo garanci deklarative, por është standard kushtetues, i garantuar dhe

---

referuar Raport Progresit për Shqipërinë për vitin 2021, në vitin 2020 të dhënat tregojnë të njëjtën situatë kur bëhet fjalë për numrin e gjyqtarëve për 100,000 banorë. Ky numër është afërsisht 11, ndjeshëm më i ulët se mesatarja Europiane prej 21 gjyqtarësh për 100,000 banorë. Sipas Raport Progresit për Shqipërinë për vitin 2021, në vitin 2020, Shqipëria ka pasur 307 gjyqtarë me kohë të plotë (10.8 për 100,000 banorë) dhe 300 prokurorë me kohë të plotë (10.5 për 100,000 banorë). Sipas Komisionit Europian për Efiçencën në Drejtësi (CEPEJ), mesataret europiane janë 21 gjyqtarë/12 prokurorë për 100,000 banorë. (faqe 21 e Raportit)
Për më tepër, shih linkun:
https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en

[61] UN Country Report for Albania, 2020.
https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Minimumi%20jetik%20ok.pdf.

sanksionuar në aktet që përcaktojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si në nivel ndërkombëtar (neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut), ashtu edhe në të drejtën e brendshme (neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë). Mosgjykimi i çështjes gjyqësore brenda një afati të arsyeshëm, jo vetëm cenon të drejtën e ankuesit për një proces të rregullt ligjor, por për më tepër, zvarrit eventualisht përfitimet.

Ndryshimet e vitit 2017 në Kodin e Procedurës Civile synojnë të rrisin garancinë për gjykime më efektive, reduktimin e zvarritjes së procesit gjyqësor dhe afatet që duhet të përmbushen gjatë gjykimit të një çështjeje.
Me aksesin e lirë në gjykatë, kuptohet një e drejtë publike, e cila i jep titullarit të saj garancinë ligjore që të drejtohet për të kërkuar mbrojtjen e shtetit, duke detyruar organet gjyqësore kompetente të prononcohen mbi pretendimet e tij. Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se të drejtat e palëve për të qenë të pranishme dhe për t'u mbrojtur e për t'u dëgjuar në procesin gjyqësor janë aspekte të rëndësishme të procesit të rregullt, në kuptimin kushtetues. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa iu njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës. Kjo e drejtë është e lidhur ngushtë me nenin 6 të KEDNJ, duke nënkuptuar jo vetëm të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës, por edhe detyrimin e shtetit që t'ia garantojë atij këtë mundësi.
GJEDNJ shprehet se e drejta e aksesit në gjykatë duhet të jetë një e drejtë efektive dhe jo formale. Kjo Gjykatë duke marrë në shqyrtim barrierat financiare për t'iu drejtuar gjykatës ... përcaktoi se këto barriera duhet të analizohen rast pas rasti, në përputhje me mundësitë reale që ka paditësi dhe jo të merret në shqyrtim një mundësi abstrakte për të paguar nga ana e personit që kërkon të vërë në lëvizje gjykatën...[62]. Ndërhyrja që kufizon të drejtat e shtetasve, në asnjë rast, nuk mund të cenojë thelbin e së drejtës dhe duhet të jetë në përputhje të plotë me situatën që ka diktuar hartimin e normës kufizuese. Gjykata ka argumentuar se duhet një analizë e kujdesshme nga ana e organit vendimmarrës në lidhje me mjetin e përdorur për të arritur qëllimin e ligjshëm.

Referuar raportit të fundit të Komisionit Europian për Shqipërinë, kohëzgjatja e procedurave, shkalla e ulët e evadimit dhe numri i madh i çështjeve të pazgjidhura vazhdojnë të ndikojnë në efikasitetin e sistemit gjyqësor. Kohëzgjatja mesatare për një çështje në nivelin e apelit është 893 ditë. Megjithatë, në Gjykatën e Apelit Tiranë, kohëzgjatja mesatare për një çështje penale është 5820 ditë.[63]

Theksojmë se mbyllja e gjykatave të shkallës së parë dhe sidomos atyre të apelit duke filluar nga data 01.02.2023, duke lënë vetëm një të tillë në shkallë vendi, do të ndikojë në uljen e mëtejshme të besimit të qytetarëve shqiptarë në sistemin e drejtësisë, në veçanti në qytetet ku ato janë mbyllur, ndërkohë që duhet përmendur se besimi te vetë reforma në drejtësi ka pësuar rënie vit pas viti, për shkak të hapave tepër të ngadaltë me të cilët ajo po ecën, edhe pse është përmbyllur viti i gjashtë i miratimit të Reformës në Drejtësi.
Për të gjitha gjetjet tona, është përgatitur dhe dërguar rekomandim i posaçëm drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Ministrisë së Drejtësisë[64]. *Ky rekomandim nuk është pranuar nga Ministri i Drejtësisë, ndërsa Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk ka kthyer përgjigje*.

---

[62] Çështja *Albert dhe Le Compte k. Belgjikës*, 10 shkurt 1983.
[63] Për më tepër, shih në faqen 21, në linkun:
https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2022_en.
[64] https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20per%20botim.pdf

3.7 Ndihma juridike falas[65]

Institucioni i Avokatit të Popullit edhe këtë vit ka pasur në fokus të tij ndjekjen e zbatimit të ligjit nr.111/2017 *"Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti"* si dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Kemi trajtuar problematikën e shtetasve që kanë përfituar me vendim gjyqësor ndihmë juridike falas dhe përjashtimin nga pagimi i tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore, por ka pasur raste kur këto vendime gjyqësore kanë mbetur në letër, të pazbatuara nga dhomat vendore të avokatisë, duke mos përmbushur detyrimin ligjor për të caktuar avokatin përkatës, pavarësisht përpjekjeve të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.

Gjatë vitit 2022, institucioni i Avokatit të Popullit ka vijuar të marrë ankesa lidhur me ofrimin e ndihmës juridike falas dhe i ka këshilluar ankuesit drejtpërdrejtë, apo nëpërmjet orientimit në qendrat e ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore, pra duke këshilluar edhe qytetarët për rrugën ligjore në mjaft raste. Është dhënë këshillim ligjor lidhur me kriteret ligjore dhe dokumentacionin që duhet të paraqesin. Duhet evidentuar se përpos Zyrës qëndrore të institucionit[66], edhe Zyrat Rajonale të Avokatit të Popullit kanë bërë një punë për t'u vlerësuar në kuadër të informimit të qytetarëve për të drejtat dhe detyrimet ligjore, mënyrat për ushtrimin e tyre, ofrimin e asistencës ligjore për plotësimin e formularëve dhe kërkesave për përfitimin e ndihmës juridike dytësore për shtetasit që janë paraqitur pranë tyre.

Avokati i Popullit vlerëson se me miratimin e hartës së re gjyqësore, për të garantuar aksesin në drejtësi të qytetarëve, shtimi i qendrave të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe zbatimi me rigorozitet i vendimeve gjyqësore nga Dhomat e Avokatisë lidhur me ofrimin e ndihmës juridike dytësore duhet të jenë domosdoshmëri dhe objektiva të Ministrisë së Drejtësisë. Kjo vlen në mënyrë të veçantë për kategoritë vulnerabël që janë subjekte përfituese të këtij ligji të cilët do të kenë një kosto të shtuar për ndjekjen e një procesi gjyqësor, me qëllim realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre ligjore dhe kushtetuese. Buxheti i dedikuar i shtetit i ndarë për ndihmë juridike është rritur nga viti në vit. Megjithatë, ky buxhet duhet të rritet më tej për të funksionalizuar plotësisht klinikat ligjore[67].

3.8 Të drejtat e ish të dënuarve dhe përndjekurve politikë nga sistemi komunist[68]

Gjatë vitit 2022, institucioni i Avokatit të Popullit i ka kushtuar një rëndësi të veçantë jo vetëm çështjes së pagesave të kësteve të dëmshpërblimit të ish të dënuarve politikë dhe trashëgimtarëve të tyre, por ka trajtuar gjerësisht edhe domosdoshmërinë e ndryshimeve ligjore dhe miratimit të akteve nënligjore për të drejtat e tjera që duhet të përfitojë kjo kategori[69].

---

[65] Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Veçantë në institucionin e Avokatit të Popullit.

[66] Për vitin 2022, janë 4712 raste të cilat janë trajtuar si këshillime dhe orientime mbi rrugët ligjore që duhet të ndjekin subjektet ankues/kërkues për trajtimin e rasteve.

[67] Buxheti i ndarë për ndihmë juridike në vitin 2021 arriti në 547 696 euro, me një rritje prej 31% kundrejt një viti më parë. Buxheti i zbatuar në vitin 2021 arriti në 245 739 euro (nga 140 488 euro në 2020).
Për më tepër, shih në faqen 34, në linkun:
https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2022_en.

[68] Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Veçantë në institucionin e Avokatit të Popullit.

[69] 9 ankesa dhe 1 rast me iniciativë.

Nga institucionet shtetërore përgjegjëse, jo vetëm që nuk janë realizuar detyrimet ligjore ndaj shtresës së ish-të dënuarve, por evidentohet se nuk as një afat apo datë të saktë apo të parashikueshme se kur do të mbarojë procesi i plotë i dëmshpërblimit, duke shtyrë kështu për një periudhë të pacaktuar e të tejzgjatur rehabilitimin e kësaj shtrese të shoqërisë.

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se përqindja e planifikuar çdo vit në buxhetin vjetor për dëmshpërblimin e ish-të përndjekurve politikë rezulton në nivel të pamjaftueshëm për përfundimin e këtij procesi brenda një kohe optimale, por do të vijojë të zvarritet në vite, duke mos u realizuar brenda afateve të arsyeshme.

Legjislacioni për të drejtat e të përndjekurve politikë ka pësuar ndryshime të njëpasnjëshme, duke ndryshuar edhe procedurat e dhënies së dëmshpërblimit për të përndjekurit. Me ndryshimet e vitit 2014 në ligjin nr.9831, datë 12.11.2007 *"Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist"* u aplikua një skemë kategorizuese prioritarizimi si parësor dhe joparësor, duke i ndarë fondet me një raport 70% për kategorinë e përfituese parësorë me 30% për kategorinë e subjekteve përfitues joparësorë. Ndërsa fondi i vënë në dispozicion nga qeveria nuk ishte kurrësesi i mjaftueshëm.

Përveç njohjes së të drejtave për këtë kategori, ato duhet të realizohen efektivisht nga shteti, brenda afateve të arsyeshme, dhe jo thjesht të deklarohen. Duhet bërë i mundur përshpejtimi i dhënies së përfitimeve/dëmshpërblimeve për shtresën e ish të përndjekurve politikë, duke vënë në vend të drejtat e shkelura dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës së kësaj kategorie.

Vitet e fundit, fondi i parashikuar për këtë kategori ka ardhur duke u ulur, gati është përgjysmuar. Kështu, Ministria e Financave dhe Ekonomisë sqaron se realizon lëvrimin e kësteve në varësi të fondit që miratohet për secilin vit buxhetor. Ndërkohë, është konstatuar se fondi i miratuar për kategorinë e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist, për vitin buxhetor 2022 ishte vetëm 1 miliard lekë. Për këto arsye, paraqet domosdoshmëri rishikimi i këtij fondi për vitet buxhetore në vijim.

Gjithashtu, problematikë mbetet pamundësia për rivendosjen në afat për përfitimin e dëmshpërblimit. Sipas parashikimeve ligjore, ish i dënuari politik i regjimit komunist, kujdestari i tij ligjor apo familjari i viktimës së pushkatuar, nuk mund të rivendosen në afat për paraqitjen e kërkesës.
Sipas VKM nr.419, datë 14.04.2011 *"Për miratimin e afateve dhe të skemës së shpërndarjes së fondeve të dëmshpërblimit për ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist"*, të ndryshuar, pika 7 përcakton radhën e përparësisë. Sfera e subjekteve përfitues të përcaktuar në ligj është shumë e ngushtë si dhe është e pamundur të përfitojnë rradhë përparësie vetëm ata subjekte të parashikuar sipas VKM nr.419, datë 14.04.2011. Për më tepër, është diskriminuese për kategoritë e tjera që nuk përfitojnë të drejtat e tyre të njohura nga ligji.

Afati prekluziv i përcaktuar në ndryshimin ligjor "*deri më datë 31.12.2017, vetëm për aplikimet e paraqitura nga ish të dënuarit politikë, të cilët bëjnë pjesë në kategorinë e subjekteve përfituese parësore",* është në dëm të interesave për përfitimin e kësaj kategorie. Vlerësojmë se ndryshimi

i objektit në nenin 1 të tij dhe zgjerimi i subjekteve përfituese të ligjit, duhet të shoqërohet edhe me ndryshimin e nenit përkatës në lidhje me afatin e paraqitjes së kërkesave para autoritetit (Ministrisë së Drejtësisë), për t'u dhënë mundësinë e përfitimit të dëmshpërblimit.

Çmojmë se ky afat i ri i paraqitjes së kërkesave duhet të jetë i vlefshëm jo vetëm për dëmshpërblimin e familjarëve të viktimave "*të ekzekutuara pa gjyq*", por për të gjithë subjektet e parashikuara në ligj. Kjo, nisur nga trajtimi i deritanishëm nga institucioni ynë i problematikave që shqetësojnë një numër të konsiderueshëm të kësaj shtrese e që kanë të bëjnë me mosparaqitjen e kërkesave për dëmshpërblim brenda afatit ligjor të parashikuar në ligj, i cili fillimisht ka qenë data 01.07.2009 e pas ndryshimeve ligjore të pësuara në vitin 2017, ky afat ishte 31.12.2017.
Gjithashtu, një shqetësim tjetër që kemi konstatuar gjatë shqyrtimit të ankesave të bëra nga individë të kësaj shtrese përfaqësues të kategorisë "internim/dëbim", është ai i mosmarrjes së dëmshpërblimit sikurse parashikohet në nenin 6, gërma "c" të këtij ligji. Theksojmë se, ndonëse kanë kaluar *mbi 12 vjet* që ligji ka hyrë në fuqi, ende nuk është nxjerrë VKM-ja për miratimin e skemës së pensionit të veçantë për të internuarit dhe dëbuarit gjatë regjimit komunist. Pra, ndonëse ligji i njeh të drejtën e trajtimit me dëmshpërblim këtyre kategorive, ai nuk po gjen zbatim, në kushtet kur nuk është nxjerrë akti nënligjor specifik me të cilin rregullohet kjo situatë, me qëllim që individët e internuar dhe të dëbuar, të mos ndihen të diskriminuar nga pjesa tjetër e përfituesve të parashikuar nga ligji.

Vlerësojmë se mospërmbushja e këtij detyrimi ligjor nga shteti identifikon jo vetëm shkelje të parashikimeve ligjore, por edhe shkelje të së drejtës së ligjshme të individëve përfaqësues të kësaj shtrese të të dënuarve politikë të regjimit komunist, për t'u trajtuar me dëmshpërblim sipas parashikimeve të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 *"Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist"*, i ndryshuar.

Çmojmë se edhe neni 8 i ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 "*Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist",* të ndryshuar, duhet të ndryshohet, duke u riformuluar në kuadër të përfshirjes të të gjithë radhëve të trashëgimtarëve.
Në mënyrë të përmbledhur shqetësimet e institucionit tonë lidhur me 4 aspekte të këtij procesi e gjegjësisht: pagesës efektive të dëmshpërblimit, rrethet e trashëgimtarëve, premisat ligjore si dhe detyrimin për nxjerrjen e akteve nënligjore janë trajtuar në një rekomandim të posaçëm adresuar Këshillit të Ministrave.[70] *Rekomandimi ynë pavarësisht kërkesave të përsëritura ende nuk ka marrë përgjigje nga Këshilli i Ministrave*.

Po ashtu, nisur nga shqetësimet e ngritura në tryeza ku janë diskutuar problematika të drejtësisë tranzitore dhe të drejtat e personave të persekutuar në sistemin komunist, nga ana jonë është dërguar rekomandim drejtuar Këshillit Bashkiak Tiranë, për dijeni Autoritetit për Informimin mbi dokumentet e ish-sigurimit të shtetit[71] lidhur me shmangien e përdorimit të rrugëve, shesheve dhe

[70]https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20per%20te%20perndjekurit%20-%20final.pdf.
[71]https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20per%20shmangien%20e%20perdorimit%20dhe%20emertimit%20te%20shesheve,%20hapesirave%20publike%20me%20data%20dhe%20simbole%20te%20regjimit%20komunist.pdf.

hapësirave publike me data dhe simbole që lidhen me të kaluarën e regjimit komunist. Kjo për shkak se emërtimi i rrugëve, shesheve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e bashkisë është një kompetencë eskluzive e Këshillit Bashkiak, e parashikuar shprehimisht në nenin 54 pika ll të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

Janë evidentuar raste të përdorimit, emërtimit dhe shprehjes në deklarata dhe zhargonin e përditshëm të datave dhe simboleve që lidhen me të kaluarën e regjimit komunist, të cilat në gjykimin dhe vlerësimin e personave të prekur drejtpërdrejtë nga regjimi komunist, apo edhe trashëgimtarë të tyre, përbëjnë një zgjim të kujtimeve dhe situatave të rënda që kanë kaluar. *Ky rekomandim është pranuar nga strukturat e bashkisë.*
Një rekomandim tjetër për të adresuar shqetësimet e pasardhësve apo familjarëve të të zhdukurve gjatë regjimit komunist, ka qenë ai drejtuar bashkive në rang vendi lidhur me bashkëpunimin me strukturat komptente për identifikimin dhe ruajtjen e vendvarrimeve të personave të zhdukur gjatë regjimit komunist, si edhe shmangien e dhënies së lejeve të përdorimit, shfrytëzimit dhe ndërtimit të objekteve të ndryshme mbi këto hapësira dhe sheshe.

Për më tepër se tre dekada pas rënies së regjimit totalitar në Shqipëri, shumë krime çnjerëzore të asaj periudhe vijojnë të mbeten të pazbardhura. Edhe sot mijëra familje që vuajtën persekutimin komunist nuk dinë fatin e eshtrave të të afërmve të tyre, të zhdukur dhe ekzekutuar gjatë diktaturës. Shifrat janë të frikshme, mbi 6000 persona të ekzekutuar nga diktatura komuniste vazhdojnë të konsiderohen të zhdukur[72].

Shoqëritë demokratike dhe shteti i së drejtës u sigurojnë qytetarëve të tyre jo vetëm një respektim të të drejtave të tyre, por edhe mundësinë për të nderuar dhe për të përkujtuar të afërmit dhe njerëzit e tyre të dashur, të cilët mund të jenë të persekutuar, internuar, torturuar dhe vrarë (në shumë raste edhe zhdukur në mënyrë të qëllimshme). *Edhe ky rekomandim është pranuar nga strukturat respektive të organeve të pushtetit vendor.*

3.9 Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore civile dhe administrative[73]

E drejta e ekzekutimit të titujve ekzekutiv, si pjesë përbërëse e gjykimit, brenda një afati të arsyeshëm, është një nga të drejtat thelbësore proçedurale të njeriut dhe një gur themeli i një shoqërie të bazuar në shtetin e së drejtës. Tejzgjatja e proçesit të ekzekutimit të titujve ekzekutiv, pasi e drejta e tyre është njohur nga gjykata, i ka lënë dhe i le palët në pasiguri për periudha të gjata kohore, duke krijuar mundësi për rritjen e kostove proçedurale si dhe zvogëlimin/humbjen e besimit të publikut në sistemin gjyqësor.

Gjatë proçesit të shqyrtimit të *15 rasteve/ankesave, administruara gjatë vitit 2022*, si dhe atyre të mbartura, institucioni i Avokatit të Popullit ka konstatuar çështje të ndryshme të cilat kompromentojnë të drejtën për zhvillimin e një proçesi të rregullt ligjor, si rrjedhojë e

[72] https://abcnews.al/viktima-e-pushkatuara-gjatë-komunizmit-ende-ne-shqiperi-6000-te-pagjetur/.
[73] Kjo fushë e së drejtës trajtohet prej Seksionit për organet e administratës qendrore, pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre.

mosekzekutimit të titujve ekzekutiv në një afat të arsyeshëm sikurse sanksionuar në nenin 42/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë apo nenin 6/1 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriu.

Dy janë pyetjet që bëhen për të vlerësuar nëse është plotësuar kushti për një proçes ekzekutimi të titullit ekzekutiv brenda një afati kohor të arsyeshëm: së pari, kur ka filluar dhe kur ka përfunduar ekzekutimi i titullit ekzekutiv; së dyti, çfarë përbën një afat kohor "të arsyeshëm" për çështjet në proçes ekzekutimi?

Llogaritja e kohëzgjatjes së proçesit të ekzekutimit të titullit ekzekutiv, fillon nga çasti i pranimit të kërkesës së palës gjyqfituese prej Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor dhe konsiderohet i përfunduar me rastin e materializimit tërësisht të së drejtës së fituar në rrugë gjyqësore. Në jurisprudencën e GJEDNJ-së konstatohen raste kur brenda afatit të gjykimit të çështjes janë përfshirë dhe proçedurat e ekzekutimit të vendimit të dhënë nga gjykata.[74]

Kështu, as legjislacioni ynë, as dhe GJEDNJ-ja me KDNJ-në nuk kanë përcaktuar një kohë maksimale specifike për kohëzgjatjen e gjykimeve apo proçesit të ekzekutimit të vendimeve si pjesë përbërëse e gjykimit. Në vendimmarrjet e GJEDNJ-së çështja e mosrespektimit të "afatit të arsyeshëm" të gjykimit, si rrjedhojë e ekzekutimit të vendimeve, është parë duke marrë në konsideratë faktorë si:

- ✓ *Kompleksiteti i çështjeve ligjore* (Këtu përfshihen ndryshimet në legjislacion, ndërveprimi midis proçedurave administrative dhe gjyqësore);
- ✓ *Kompleksiteti faktik i çështjes* (Lidhet midis të tjerave me faktorë të tjerë si volumi i provave ose provat që duhen paraqitur nga ekspertët, numrit të dokumenteve të administruara në dosje, prania e personit të tretë si dhe ekzistenca e çështjeve të lidhura me vetë çështjen në gjykim/ekzekutim;
- ✓ *Sjellja e palëve* (Lidhet me qëndrimin e palës, nëse ka kërkuar shtyrje të proçesit apo përdorur taktika për të krijuar vonesa).

Siç është theksuar më sipër, gjatë vitit 2022, pranë institucionit të Avokatit të Popullit, janë administruar *15 ankesa, 10 ndaj Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor Shtetëror dhe 5 ndaj Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor Privat*, në të cilat konstatohet moskryerja në mënyrë të rregullt e veprimeve prej organeve të administratës publike, në cilësinë e palës debitore, për dorëzimin e detyrimit në të holla apo kryejen e veprimeve për përmbushjen e një detyrimi të caktuar, si p.sh. rikthimin në detyrë të palës gjyfituese/kreditore.

Në procesin e shqyrtimit të rasteve të administruara, Avokati i Popullit, gjykon se Udhëzimi nr.1 datë 04.06.2014, i Këshillit të Ministrave, *"Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit",* ka nevojë të përmirësohet përmbajtja e tij. Avokati i Popullit ka rekomanduar:[75]

---

[74] Në çështjen Scordino kundër Italisë. Gjykata theksoi se: "ekzekutimi është faza e dytë e proçedurës dhe se e drejta e pohuar realizohet vetëm në çastin e ekzekutimit". Scordino kundër Italisë. GJEDNJ, Gjykimi i Dhomës së Madhe, 29 mars 2006, paragrafi 197. Shih edhe Jokoviç kundër Kroacisë. GJEDNJ, 5 mars 2009, paragrafi 68; Hornsby kundër Greqisë. GJEDNJ, 1 prill 1998, paragrafi 40; Plazonic kundër Kroacisë. GJEDNJ, 6 mars 2008, paragrafi 47.

[75] Shkresa nr.K3/A2-10 Prot, datë 21.12.2022, dërguar Këshillit të Ministrave, Mistrisë së Drejtësisë dhe Minstrisë së Financave dhe Ekonomisë.

✓ Marrjen e masave për përmirësimin e Udhëzimit nr.01, datë 04.06.2014, "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit" duke garantuar një balancë të drejtë midis të drejtave të personave fizik e juridik gjyqfitues dhe ruajtjes së vazhdimësisë së veprimtarisë së autoritetit public;
✓ Përcaktimin e kushteve dhe afateve për planifikimin e riskut dhe parashikimet në kohë të nevojave buxhetore për çdo institucion në funksion të shlyerjes së detyrimeve si pasojë e vendimeve gjyqësore;
✓ Caktimin e përkufizimit të rasteve atipike e të jashtëzakonshme e cila të këtë në vëmendje edhe diferencat në buxhetet e institucioneve të ndryshme shtetërore;
✓ Në rastin e ekzekutimit të detyruar sipas pikës 9 të këtij udhëzimi parashikimin e një mekanizimi efektiv për realizimin e pagesës pa kushtëzuar atë me vullnetin e institucionit nëse ka fonde të lira në llogari.

Ky rekomandim është dërguar më datë 21.12.2022 dhe nuk është pranuar nga institucionet përkatëse.

Mosrespektimi përmbajtësor i kesaj të drejte përbën cenim të interesave pasurore për çdo taksapagues në Republikën e Shqipërisë. Cenimi i parimit për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë në një afat të arsyeshëm, në vlerësimin e institucionit të Avokatit të Popullit, vjen edhe nga një sërë shkaqesh të tilla si:

✓ mungesa e vullnetit prej autoritetit të administratës publike për përmbushjen e detyrimit të vendosur në dispozitivin e vendimit gjyqësor apo në ligj, kjo dhe në kushtet e pasjes së gjendjes në të holla;
✓ mosproçedimi i rregullt i gjykatës administrative në proçesin e shqyrtimit të "Njoftimeve" të përmbaruesit gjyqësor të çështjes për kryerjen e veprimeve të posaçme dhe marrjen e masave të tjera të nevojshme;
✓ mungesa e nivelit profesional të përmbaruesve gjyqësorë, i cili shfaqet në veprimet dhe mosveprimet e tyre gjatë procesit të ekzekutimit të titujve ekzekutivë si dhe nxjerrjes së akteve jo në përputhje me legjislacionin në fuqi;
✓ mosnjohja e legjislacionit civil dhe atij procedurial nga ana e përmbaruesve gjyqësorë; kryerja e veprimeve përmbarimore jashtë objektit të ekzekutimit, si dhe keqinterpretimi i dispozitivit të vendimit gjyqësor;
✓ mungesa e një kontrolli efektiv ndaj zbatimit të VKM-së nr. 50, datë 05.02.2014 "Për Miratimin e Strategjisë për Parandalimin dhe Shlyerjen e Detyrimeve të Prapambetura e të Planit të Veprimit";
✓ mungesa e vullnetit prej përmbaruesve gjyqësorë për vendosjen e sanksioneve ndaj subjektit pranë personit të detyruar sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë apo personave të tjerë në procesin e ekzekutimit, të cilët refuzojnë, kryejnë në mënyrë të parregullt, nuk respektojnë afatet ose kryejnë të kundërtën e asaj që është vendosur me vendim të gjykatës.

Problematikë e trashëguar është dhe procesi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, me objekt detyrimin e subjektit debitor privat të paguajë shuma të caktuara në të holla. Në rastin e kryerjes së veprimeve përmbarimore për ekzekutimin e detyrueshëm të tij mbi të ardhurat mujore të debitorit, krijohen situata në cenim të interesave jetike të tij.

Mospërcaktimi i kesaj vlere nga organet përkatëse krijon probleme thelbësore në kuadër të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore në procedurat përmbarimore në dritën e nenin 533 të Kodit të Procedurës Civile, çka bën që të jetë i pazbatueshëm prej Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor. Sipas kësaj dispozite, vendosja e masës së sekuestros mbi pagën e debitorit kryhet pa cenuar minimumin jetik, i cili deri më sot është i papërcaktuar. Në procesin e shqyrtimit të ankesave, institucioni i Avokatit të Popullit ka konstatuar se Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor ka kryer veprime për vjeljen e detyrueshme të detyrimit në të holla nga të ardhurat mujore të debitorit (paga).

Zbatimi i vendimeve të GJEDNJ-së

Në kuptim të Rekomandimit, *"Për parimet e procedurës civile për të përmirësuar funksionimin e drejtësisë"*[76] të Këshillit të Europës të gjithë pjesëmarrësit në proçes e kanë për *"detyrë të bashkëpunojnë"* me gjykatën apo autoritetet e ngarkuara me detyrimin e ekzekutimit të vendimit si dhe të respektojnë afatet kohore të caktuara, në të kundërt duhen vendosur sanksione të përshtatshme.

Për situatën në të cilën ndodhet proçesi i ekzekutimit të vendimeve të GjEDNj-së kundër Shtetit Shqiptar, institucioni Avokatit të Popullit ka në proçes hartimi një projekt raport të veçantë, i cili do të kishte përfunduar nëse Ministria përgjegjëse për financat do të informonte rregullisht sikurse kërkuar, rreth fazës në të cilën ndodhet proçesi i ekzekutimit për çdo vendim të dhënë prej GJEDNJ-së kundër Shtetit Shqiptar. Po kështu, për këtë çështje, Avokati i Shtetit nuk ka dhënë informacion shterues e të plotë për situatën në të cilën ndodhet proçesi i ekzekutimit për çdo vendim të dhënë nga GJEDNJ-ja kundër Shtetit Shqiptar.

Në informacionet e dhëna prej Avokatit të Shtetit, konfirmohet se janë *67 vendime* në monitorim e sipër prej Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, nga *71 vendime* gjithsej të dhëna prej GJEDNJ-së kundër Shtetit Shqiptar, për të cilat Avokatura e Shtetit ka paraqitur informacione, plane veprimi apo raporte veprimi. Referuar të dhënave kuptohet se numri i vendimeve në monitorim për ekzekutim prej Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, është i lartë.

Veprimtaria administrative e Avokatit të Shtetit, institucioneve të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, nuk mund të konsiderohet efektive si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimeve në një afat të përcaktuar apo të arsyeshëm.

Për vendimet e GjEDNj-së që kanë vendosur kompesimin e drejtë, ligji nr.10018/2008, *"Për Avokaturën e Shtetit",* i ndryshuar, ka parashikuar në nenin 19/4 detyrimin e institucionit përkatës të përmbush detyrimin brenda 3 muajve nga marrja formë të prerë të vendimit gjyqësor. Ky detyrim ligjor i parashikuar në dispozitën e lartpërmendur nuk është respektuar për një numër të lartë çështjesh/vendimesh.

Në vendimmarrjet e GjEDNj-së konstatohet se çështja e cënimit të parimit për zhvillimin e një proçesi të rregullt ligjor është determinante, kjo si rrjedhojë e tejzgjatjes së proçedurave

[76] Rekomandimi Nr.R (84) i Komiteti Ministrave të Këshillit të Europës për Shtetet Anëtare.

gjyqësore, administrative si dhe mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore në përputhje me parashikimin e nenit 6/1 të Konventës.

Ndërhyrjet dhe ndryshimet në legjislacion për parandalimin dhe reduktimin e kohëzgjatjes së paarsyeshme të proçesit gjyqësor, i përkufizuar si shkelje edhe në nenin 6/1 të Konventës Europiane, nuk provohet të kenë dhënë efekte, kjo për faktin se gjykatat civile, administrative apo penale, funksionojnë me kapacitete të reduktuara të trupës gjykuese.

Kjo situatë përveç se gjeneron fatura financiare të cilat paguhen nga taksapaguesi dhe nuk i rikthehen atij në respektim të parashikimeve ligjore të Kodit Civil, apo akteve të tjera nënligjore, ndikon në humbjen e besimit të individit ndaj dhënies së drejtësisë, vonon dhënien e drejtësisë për të, deri në kufirin e mohimit të saj.

Referuar veprimtarisë së autoriteteve për ekzekutimin e vendimeve të dhëna prej GjEDNj-së kundër Shtetit Shqiptar, konkludohet, se:

✓ Nuk ndodh informimi i publikut dhe mediave prej Këshillit Konsultativ për Çështjet e GJEDNJ-së, lidhur me ekzekutimin e vendimeve të dhëna kundër Shtetit Shqiptar nga GJEDNJ-ja sikurse parashikuar në nenin 19/8, pika "d" e ligjit nr.10018/2008, i ndryshuar;
✓ Nuk konstatohet publikimi në faqen zyrtare të Avokaturës së Shtetit apo të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë i raporteve vjetore të paraqitura para Komisionit të Përhershëm për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, mbi ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ-së dhe masat e ndërmarra në këtë drejtim;
✓ Proçedura e ekzekutimit për një numër vendimesh të dhëna prej GjEDNj-së nuk është përfunduar në afat të arsyeshëm apo afatin e parashikuar në ligjin nr.10018, datë 13.11.2008 *"Për Avokaturën e Shtetit",* i ndryshuar;
✓ Ndaj strukturave përgjegjëse për ekzekutimin e vendimeve në asnjë rast nuk konstatohet fillimi i ecurisë disiplinore me rastin e mosmarrjes së masave për zbatimin e vendimeve të dhëna prej GjEDNj-së në vite;
✓ Nuk ka ndodhur kryerja me preferim e veprimeve për ekzekutimin e vendimeve me objekt, detyrim për pagim të hollash deri 10.000 Euro, në kushtet e ekzistencës së vendimarrjeve më të hershme për të cilat detyrimi është mbi 10.000 Euro;
✓ Moszhvillimi i auditimit si fazë paraprake në kuadrin e zbatimit të vendimit gjyqësor me qëllim përcaktimin e personit përgjegjës i cili ka shkaktuar dëmin objekt ekzekutimi;
✓ Ndaj personit përgjegjës për shkaktimin e dëmit nuk konstatohet zhvillimi i proçedurës së posaçme nga ana e organit/institucionit debitor për shpërblimin e dëmit nga ana e tij;
✓ Masat e përgjithshme parandaluese në lidhje me ndryshimet e legjislacionit apo praktikave për shmangien e dëmeve financiare si rezultat i shkeljes së Konventës nuk rezultojnë efektive;

✓ Legjislacioni për ekzekutimin e vendimeve të GjEDNj-së në Shqipëri nuk parashikon masa/veprime për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimeve apo vendosje sanksionesh ndaj subjekteve pengues në proçesin e ekzekutimit;
✓ Parashikimi i Avokaturës së Shtetit si organ kompetent për nisjen e proçedurave të ekzekutimit të vendimeve të GjEDNj-së, në kushtet kur ky organ është ngarkuar me detyrimin e: -Përfaqësuesit dhe mbrojtësit e interesave pasurore të Shtetit Shqiptar pranë GjEDNj-së;

-koordinimit të proçesit të ekzekutimit, hartimit të planeve të veprimit dhe të raporteve;
-përfaqësimit përpara Komitetit të Ministrave të Këshillit të Ministrave;
-monitorimit të proçesit të ekzekutimit të vendimeve të GjEDNj-së nga autoritetet kombëtare,

është zgjidhje ligjore jo oportune, joefiçente dhe në konflikt interesi.
Gjithashtu, vlerësojmë si shumë të rëndësishme marrjen e masave për përmirësimin e njohurive të nëpunësve përgjegjës mbi parashikimet e Konventës Europiane për të Drejtat të Njeriut, në lidhje me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore vendase, si edhe për rëndësinë dhe pasojat e mosekzekutimit, nëpërmjet;

✓ Organizimit të sesioneve të ndërgjegjësimit me funksionarë të rëndësishëm të institucioneve përgjegjës për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, me qëllim lehtësimin e adoptimit të një kulture të tolerancës zero ndaj mosekzekutimit të qëllimshëm të vendimeve të gjykatave;
✓ Organizimit të sesioneve të trajnimit për nëpunës të përzgjedhur, në varësi të problemeve specifike për çdo vend, duke përfshirë, por pa u kufizuar te gjyqtarët, prokurorët, përmbaruesit, punonjësit socialë dhe përfaqësuesit e ministrive të ndryshme, mbi kërkesat e KEDNJ në fushën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, si edhe për rëndësinë dhe pasojat e mosekzekutimit;
✓ Përkthimit dhe shpërndarjes nëpunësve respektivë të vendimeve të GJEDNJ mbi mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore vendase, memorandumeve mbi ekzekutimin e vendimeve, studimeve të praktikave më të mira, me qëllim lehtësimin e reformave të nevojshme për t'u ndërmarrë nga institucionet vendase.

3.10 Respektimi i të drejtës së pronës[77]

Respektimi i të drejtës së pronës është një e drejtë themelore shumë e rëndësishme në një shtet demokratik dhe mosrespektimi i kësaj të drejte, e cila bën pjesë te të drejtat më themelore të njeriut, vazhdon të jetë një fenomen shqetësues për shoqërinë shqiptare. Respektimi dhe mbrojtja e së drejtës së pronës ka qenë në fokus të një numri të konsiderueshëm ankesash, të paraqitura pranë institucionit të Avokatit të Popullit edhe gjatë vitit 2022.

Institucioni i Avokatit të Popullit, në ushtrim të kompetencave dhe detyrave të tij funksionale, është përpjekur të jetë jo vetëm aktiv, por edhe proaktiv, duke trajtuar problematikave thelbësore, të ndjeshme dhe delikate për grupe të gjera individësh. Objekti i ankesave të administruara në institucionin e Avokatit të Popullit vazhdon të jetë i orientuar kryesisht ndaj drejtorive vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Inspektoriateve të Mbrojtjes së Territorit pranë Bashkive, apo edhe ndaj organeve të cilat janë ngarkuar me çështjen e rindërtimit të objekteve të dëmtuara nga tërmeti i nëntorit 2019.

Ankesat kanë patur për objekt kundërshtimin e veprimeve apo mosveprimeve të institucioneve të sipërpërmendura lidhur me: mosrespektim të afateve ligjore në trajtimin e kërkesave/aplikimeve të individëve; mosregjistrimin e titujve të pronësisë, kryesisht AMTP-ve për tokat bujqësore të

[77] Kjo fushë e së drejtës trajtohet prej Seksionit për organet e administratës qendrore, pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre, por për shkak të ngarkesës që ka patur ky Seksion gjatë vitit 2022, një numër i kufizuar rastesh janë trajtuar edhe nga Seksione të tjera.

dhëna në pronësi apo përdorim; mospërfundimin e procedurave nga organet e njësive të qeverisjes vendore për formalizimin dhe finalizimin e akteve mbi trojet e dhëna për qëllime ndërtimi; mosnxjerrjen e akteve të pronësisë për pasuritë që nuk zotërojnë një titull pronësie, apo "oborret në përdorim"; mospërfundimin e shqyrtimit të vetëdeklarimeve, prej subjekteve posedues të ndërtimeve informale; mosushtrimin e detyrimit për saktësimin/korrigjimin e të dhënave kadastrale lidhur me sipërfaqen e pasurisë, kufijtë dhe pozicionin e saj në terren; shkeljen e së drejtës së pronësisë në kushtet e mosrespektimit të procedurave për kufizimin e kësaj të drejte; qasjen me dy standarde në regjistrimin e pasurive të paluajtshme (shtet/privat); detyrimin e individit për marrjen e shërbimit pranë drejtorive vendore të ASHK-së vetëm nëpërmjet platformës e-Albania (duke kërkuar në disa raste edhe riaplikim; mosrespektimin e të drejtës së pronës, si dhe parimin për zhvillimin e një proçesi të rregullt ligjor gjatë shpronësimit dhe prishjes së ndërtimeve në zonat e reja për zhvillim; mosbërjen publike pa kërkesë të informacionit bazik mbi hartën kadastrale, adresën e pronës, emrin e pronarit, vendimmarrjet e Këshillit të Ministrave, gjykatave ose të dhënave mbi funksionimin e tregut të pasurive; moslëshimin në mënyrë të rregullt e në përputhje me aktet nënligjore të dokumentacionit të pronësisë subjekteve pronar; heqja nga posedimi i pasurisë pa u kryer më parë proçedura e shpronësimit apo dorëzimi i vlerës së shpronësimit; pamundësia e rregjistrimit në platformën e-Albania e subjekteve pronar me shtetësi jo shqiptare; zvarritje e tejskajshme pa shkak të procedurës administrative prej drejtorive vendore të ASHK-së në dhënien e shërbimit të kërkuar prej subjekteve apo në kthimin e përgjigjes Avokatit të Popullit për kërkesat apo rekomandimet e dërguara, rast pas rasti; mosmbajtje qëndrimi prej ASHK-së si dhe mosushtrim kompetence për vendosjen e sanksioneve ndaj punonjësve të drejtorive vendore, në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara në nenin 64 të ligjit nr.111/2018 "Për kadastrën"; pamundësia e komunikimit drejtëpërdrejt me drejtoritë vendore të ASHK-së (psh përmes shërbimit telefonik, apo edhe takimeve fizike në rastet të caktuara), etj.

Në vijim të sa është paraqitur në raportin përfundimtar të institucionit të Avokatit të Popullit në Kuvend për vitin 2021 për mbrojtjen e të drejtës së pronësisë, vërehet se situata nuk është përmirësuar. Avokati i Popullit përsërit se e drejta e pronës duhet të gëzojë mbrojtje jo vetëm në tekstet e akteve normative, por duhet të jetë në themel të punës së institucioneve përkatëse të administratës shtetërore, për të garantuar zbatimin efektiv të kësaj të drejte.

- Duke u ndalur më në detaje në problematikat që përmendëm më sipër, në proçesin e shqyrtimit të *ankimeve për vetëdeklarimet e kryera nga subjektet poseduese të ndërtimeve informale*, kemi konstatuar se nga ana e drejtorive vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (më poshtë DVASHK) vijon të cënohet parimi për zhvillimin e një proçesi të rregullt ligjor, kryesisht si rrjedhojë e mospërfundimit të procedurës administrative në shqyrtimin e vetëdeklarimeve. Madje në mjaft raste na ka rezultuar se janë shkelur në mënyrë flagrante, jo vetëm afatet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për trajtimin e ankesave të shtetasve, por edhe në raport me institucionin tonë.

Institucioni ynë është përpjekur të mirëkuptojë volumin e rasteve që mund të kenë në trajtim Drejtoritë Vendore të ASHK-të dhe vlerëson punën që bëhet nga specialistët e këtyre drejtorive, por nga ana tjetër duke patur parasysh rëndësinë e zgjidhjes së problemeve të pronësisë, si në raport me garantimin e të drejtës së pronësisë së shtetasve, ashtu edhe për zhvillimin ekonomik

të vendit, i kemi rekomanduar DVASHK-ve që në rast se vonesat në trajtimin e praktikave vijnë për shkak të volumit të punës që këto DVASHK duhet të përballojnë, ky shqetësim i duhet përcjellë organeve drejtuese të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (që konform nenit 7 pika 3 të ligjit "Për kadastrën", janë Këshilli Drejtues dhe drejtori i përgjithshëm) me qëllim gjetjen e zgjidhjeve konkrete dhe jo të lihen pa u trajtuar kërkesat e shtetasve, jo vetëm përtej afateve ligjore, por edhe përtej çdo *afati të arsyeshëm***.**

Shtojmë se në shumicën e ankesave të trajtuara nga institucioni ynë ndaj DVASHK-ve, na kanë rezultuar vonesa që i kemi konsideruar përtej çdo afati të arsyeshëm. Institucioni ynë nisur nga sa më sipër, ka vlerësuar se vonesa në trajtimin e këtyre praktikave, kufizon liritë dhe të drejtat e garantuara nga Kushtetuta dhe ligji të shtetasve, e më konkretisht: *të drejtën e pronësisë*. Gjithashtu nga shqyrtimi i ankesave na ka rezultuar se aplikuesve kur ata interesohen për vonesat disavjeçare, në shumë raste as nuk ju kthehet fare përgjigje.

Po kështu për institucionin tonë mbetet shqetësues fakti që ende në vitin 2022, nga DVASHK si ajo e Tiranës përdoret justifikimi se citojmë: "*në zbatim të Urdhërit nr. 2877 prot., datë 10.04.2018 të drejtorit të përgjithshëm të ASHK "Për trajtimin me prioritet të aplikimeve për legalizim të viteve 2005 – 2006", kjo drejtori ka planin e saj të punës dhe se trajtimi i vetëdeklarimeve do vijohet sipas rradhës së paraqitjes, ku prioritet do të kenë ato të periudhës 2005 – 2006*". Nga ana e institucionit tonë, jo vetëm nuk është konsideruar i bazuar ligjërisht një justifikim i tillë, por nisur nga fakti se pesë vite pas daljes së këtij Urdhëri, ende DVASHK-të nuk paskan përfunduar shqyrtimin e vetëdeklarimeve të bëra përkatësisht 17 dhe 18 vite më parë, na ka bërë të nisim verifikimin e hollësishëm të kësaj situate.

Po kështu zgjatja e një procedure të tillë pa përcaktuar një afat fundor, parë në një këndvështrim më të gjerë, cënon edhe *parimin e sigurisë juridike*. Kjo për arsye se parimi i sigurisë juridike presupozon besueshmërinë e qytetarëve tek shteti, thënë kjo jo vetëm pandryshueshmërinë e legjislacionit për marrëdhëniet e rregulluara (për të cilin është rasti të kujtojmë se ka ndryshuar shumë dekadën e fundit), por edhe garantimin e ligjshmërisë së veprimeve që shteti kryen me qytetarët e tij. Pra sigurinë juridike se shtetasit janë subjekte të veprimeve të ligjshme dhe se institucionet shtetërore do i garantojnë atyre të drejtat dhe liritë themelore.

Një çështje tjetër është edhe ajo e *pagesës së plotë paraprake për shërbimin e kërkuar*, në një kohë që shërbimi jo vetëm ofrohet përtej çdo afati ligjor, por në disa raste edhe nuk ofrohet sipas kërkesës.[78] Nga informacionet e paraqitura nga ASHK pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, jemi informuar se "*për vitet 2015-2019, figurojnë rreth 450.000 shërbime të paguara dhe të padhëna, me një vlerë prej rreth 10 milion USD*". Pra këto janë shërbime të parapaguara nga aplikuesit, por që nuk e kanë marrë ende shërbimin, ndaj institucioni ynë po vijon me shqyrtimin e hollësishëm të kësaj çështjeje.

Përtej vonesës në ofrimin e shërbimit, një problematikë tjetër që na ka rezultuar është se si në rastet kur ofrohet shërbimi për të cilin është parapaguar shërbimi, ashtu edhe në rastin kur kthehet përgjigje negative, aplikuesi paguan njësoj dhe nuk i kthehet mbrapsht pagesa e kryer. Kujtojmë se përpara kalimit në aplikimet tërësisht online, nëpërmjet platformës e-Albania

[78] Si në rastet kur ofrohet shërbimi për të cilin është parapaguar shërbimi, ashtu edhe në rastin kur kthehet përgjigje negative (psh për mungesë të një dokumenti), aplikuesi paguan njësoj dhe nuk i kthehet mbrapsht pagesa e kryer.

(shërbim ky që ka sjellë lehtësi për pjesën më të madhe të aplikuesve), praktikat e mëparëshme të punës në Zyrat e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP), kanë qenë që nëpunësit e ZRPP-së që pranonin dokumentat fizikisht në sportel, informonin paraprakisht aplikuesin për të metat, apo dokumentat që i mungonin, çka bënte që aplikuesit të mos aplikonin (dmth të mos parapaguanin për një shërbim që dihej që nuk do i ofrohej). Po kështu edhe për DVASHK-të ky lloj "filtri", bënte që nëpunësit e tyre të fokusoheshin tek çështjet me dokumentacion të plotë. Institucioni ynë po shqyrton gjetjen e një zgjidhjeje për këtë situatë, sepse shpjegimi që na është dhënë nga drejtuesit e ASHK-së, "se ky institucion është me vetëfinancim, ndaj ka nevojë për sa më tepër të ardhura", nuk mund dhe nuk duhet të jetë në dëm të qytetarit.

Po kështu na ka rezultuar se pavarësisht se legjislacioni parashikon penalitete në rast vonese si për qytetarët (neni 25 i ligjit nr.111/2018 "Për kadastrën")[79], ashtu edhe për nëpunësit e ASHK-së (neni 64 i ligjit nr.111/2018 "Për kadastrën"), [80] nga informacioni që institucioni ynë disponon deri më sot, na rezulton se masat penalizuese janë zbatuar vetëm ndaj qytetarëve, por jo ndaj nëpunësve të ASHK-së.

Të gjitha problematikat që përmendëm në lidhje me DVASHK-të, pra shkelja e të drejtave të mësipërme, sjell në marrëdhënie me shtetasit një sërë problematikash, duke filluar që nga humbja e besimit të qytetarëve tek organet e administratës publike, e deri tek rreziku i përballjes së organeve të administratës me padi civile për dëm jashtëkontrator, që mund ti jetë shkaktuar shtetasve, nga shkelja e të drejtave të sipërpërmendura. Institucioni ynë u ka bërë vazhdimisht me dije DVASHK-ve të ndryshme, se mosshqyrtimi administrativ i aplikimeve të shtetasve brenda afatit ligjor dhe/ose atij të arsyeshëm, në vartësi edhe të rrethanave të tjera të çështjes, mund të përbëjë shkak për nisjen e një procesi për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga kohëzgjatja e pajustifikuar e procedurës administrative.

Kjo pasi të drejtat e shtetasve për të trajtuar çështjet e tyre, brenda afateve të parashikuara nga aktet normative në fuqi, në mënyrë të ligjshme, transparente, të paanshme, të drejtë, duke i ndihmuar ata në mënyrë aktive, apo edhe e drejta e tyre për tu informuar për veprimtarinë e organeve shtetërore (veçanërisht në rastet kur ata janë pjesëmarrës në procedura administrative), janë të drejta të parashikuara jo vetëm nga Kodi i Procedurave Administrative (nenet 4, 5, 6, 10, 13, 15, 18/2, etj.), por së pari nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Fakti që shtetasit, për shkaqe të pavarura nga ata, nuk arrijnë të marrin një vendim përfundimtar në një procedurë administrative (qoftë ky edhe negativ), në një kohë që kanë respektuar të gjitha detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni përkatës, bën që ata të mos arrijnë të gëzojnë nga pronat e tyre, të drejtat që i garanton legjislacioni në fuqi.

---

[79] *Neni 25 - Kërkesa për regjistrim dhe kamatëvonesa.*
1. Çdo person, mbajtës i titullit të pronësisë apo i një të drejte reale, të detyrueshme për regjistrim, sipas dispozitave të Kodit Civil, apo të ligjit të veçantë, duhet të paraqesë kërkesë për regjistrimin e titullit, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të tij.
2. Nëse kërkesa për regjistrim paraqitet tej afatit 30-ditor, kërkuesi, përveç tarifës së regjistrimit, për çdo ditë vonesë, duhet të paguajë edhe kamatëvonesë, të barabartë me 10 % e tarifës së regjistrimit, por jo më shumë se 300 000 lekë.
[80] *Neni 64 - Kundërvajtjet*
1. Konsiderohen kundërvajtje administrative shkeljet e mëposhtme:
.....
b) vonesat në përgjigje të kërkesave;
c) kalimi i afateve të regjistrimit;
....
2. Për këto shkelje drejtuesi i Agjencisë dhe struktura përgjegjëse për ankimin vendos për dënimin me gjobë nga 5 000 deri në 500 000 lekë. Masa e gjobës caktohet në varësi të shkeljes së kryer dhe pasojës që ka sjellë për përfituesin e shërbimit.

Në lidhje me mungesat e përgjigjeve nga DVASHK-të, siç informuam më sipër, kanë ndodhur jo vetëm me aplikuesit, por edhe ndaj shkresave të dërguara nga institucioni ynë. Duke qenë se për ne është mjaft shqetësuese një situatë e tillë, ju kemi bërë me dijë DVASHK-ve përkatëse, se kjo sjellje e tyre vjen në kundërshtim me një sërë detyrimesh ligjore. Së pari me detyrimin ligjor të sanksionuar në neni 63/4 të Kushtetutë që parashikon se: *"Organet dhe funksionarët publik janë të detyruar t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij",* apo edhe me nenin 19, pika "b", të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit" i ndryshuar, sipas të cilit: *"Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin"*.

Për më tepër që mungesa e përgjigjeve nuk ka qenë vetëm ndaj kërkesave tona për informacion drejtuar DVASHK-ve, por edhe ndaj rekomandimeve të institucionit tonë, për të cilat neni 22 i ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit" i ndryshuar, me titullin: "*Detyrimi i organeve të administratës për t'iu përgjigjur rekomandimeve të Avokatit të Popullit*", parashikon se: "*Organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, kërkesë apo propozim për shkarkim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin, kërkesën apo propozimin për shkarkim dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit, kërkesës apo propozimit për shkarkim. Përgjigjja duhet të përmbajë shpjegime të arsyetuara për çështjen në fjalë, si dhe çfarë veprimesh, mosveprimesh apo masash ka ndërmarrë ai organ. Avokati i Popullit duhet të njoftohet dhe ka të drejtë të marrë pjesë e të flasë në mbledhjet e organeve kolegjiale të administratës publike, ku merret në shqyrtim rekomandimi, kërkesa apo propozimi i tij*".

Mungesa e përgjigjeve ndaj shkresave të dërguara nga institucioni ynë, vjen në kundërshtim edhe me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative, për shkak të moszbatimit dhe cënimit të parimeve të respektimit të hierarkisë institucionale dhe bashkëpunimit ndërinstitucional. Kjo pasi mosdhënia e informacioneve dhe shpjegimeve të kërkuara në afatin ligjor të parashikuar, sjell si pasojë jo vetëm fshehjen e arsyeve për mostrajtimin e rastit të ankuesve brenda afateve ligjore (ç'ka krijon për këta shtetas dëm moral, apo edhe material), por njëkohësisht tregon edhe mungesën e korrektesës ndaj institucionit tonë. Moskthimi i përgjigjeve ndaj shkresave të dërguara nga institucioni kushtetues i Avokatit të Popullit, sjell gjithashtu pengesa në kryerjen e misionit kushtetues e ligjor të Avokatit të Popullit, për mbrojtjen e të drejtave, lirive të shtetasve dhe interesave të tyre të ligjshme.

Në lidhje me regjistrimin në regjistrin e pasurive të paluajtshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, të 26 mijë vendimeve të dhëna në vite prej Agjencisë së Trajtimit të Pronës, të njohjes së pronës me të drejtë kompesimi (detyrim ky i parashikuar si në nenet 193/h dhe 196 të Kodit Civil, ashtu edhe në nenin 24 të ligjit nr.111/2018 "Për Kadastrën"), çështja vazhdon të mbetet e papërfunduar. Mospërfundimi i procesit të kompesimit të pronave të njohura subjekteve me të drejtë kompesimi me një nga format e parashikuara në ligjin nr.133/2015 "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e proçesit të kompesimit të pronave", mbetet çështje mjaft e mprehtë, pasi subjektet që e kanë përfituar në pronësi, kryesisht sipas ligjit 7501/1991 "Për tokën", i ndryshuar, dhe ligje të tjera të veçanta, kanë disponuar dhe disponojnë mbi pronat e ish pronarëve, në kushtet kur procesi i kompesimit ende ndodhet larg përfundimit.

Përveç konstatimeve dhe gjetjeve të lartpërmendura, institucioni i Avokatit të Popullit në procesin e shqyrtimit të rasteve ka konstatuar se organet e administratës publike në nivel lokal, kanë nivel të ulët bashkëpunimi apo ndërveprimi dhe nuk përmbushin detyrimin ligjor për dhënie shpjegimesh dhe informacioni tek Avokati i Popullit brenda afatit ligjor të caktuar, situatë kjo që përsëritet vit pas viti.

Tjetër çështje që haset në veprimtarinë e drejtorive vendore të ASHK-së është se gabimet që kanë ardhur nga veprimtaria e ish zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, sot drejtoritë vendore të ASHK-së, nuk korrigjohen edhe pse korrigjimi i gabimit të konstatuar, sipas ligjit nr.111/2018, "Për Kadastrën", është i detyrueshëm për t'u kryer me iniciativën e vetë organit. Duhet theksuar se drejtoritë vendore të ASHK-së nuk kanë nisur apo përfunduar regjistrimin fillestar të pronave në 359 zona kadastrale[81].

Mungesa e regjistrimit fillestar të pasurive në këto zona kadastrale ka sjellë pasiguri të individëve në dokumentet e pronësisë që zotërojnë, pasi pasuria mund të zotërohet me dokumente nga më shumë se një individ. Pasiguria ligjore e dokumentave të pronësisë që zotërojnë mbajtësit e titullit në këto zona, reflektohet së pari në konfliktet e mundshme me persona/individë/subjekte që zotërojnë edhe ata dokumente pronësie për të njëjtën pronë, pasojë e të cilave, përveç cënimit të të drejtës së pronësisë mbi qarkullimin civil të sendit, ka gjeneruar edhe konflikte. Edhe në ato zona kadastrale ku ka përfunduar regjistrimi fillestar i pasurisë në përputhje me ligjin 111/2018 *"Për Kadastrën"* ka problematika të shumta në drejtim të pajisjes së individëve apo subjekteve me aktet kadastrale, si çertifikata, kartela, etj., pasi ende këto zyra kërkojnë nga individët dokumentacion plotësues edhe pse ky është një detyrim i vetë drejtorive vendore të ASHK-së për t'u përmbushur.

Theksojmë se regjistrimi i titujve të pronësisë është një shërbim që garantohet nga shteti. Kjo veprimtari ka në themel respektimin dhe garantimin e së drejtës së pronësisë. E drejta e pronës nuk mund të vihet në diskutim apo cenohet nga dështimi i sistemeve të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Legjislacioni në fuqi garanton se procesi i krijimit të titullit të pronësisë si dhe regjistrimit të tij kryhet në çdo rast prej organit publik/shtetëror, për rrjedhojë, çdo gabim në të dhënat kadastrale, cenim të së drejtës së pronësisë, bëjnë përgjegjës organin publik/shtetëror për zgjidhjen e tij si dhe pagimin e dëmshpërblimit. Përkundër situatës ligjore të krijimit dhe regjistrimit të titujve të pronësisë, në veprimtarinë e drejtorive vendore të ASHK-së konstatohet "delegimi" për zgjidhje i çështjeve të ndryshme jo pranë organit kompetent të administratës publike por pranë individit pronar të sendit.

Për sa i takon trajtimit të ankesave për Agjencinë e Trajtimit të Pronave në përputhje me ligjin nr. 133/2015 *"Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e proçesit të kompesimit të pronave",* konstatohet se procesi i kompensimit financiar vazhdon të jetë mjaft i ngadaltë. Ky proces nuk është realizuar në të tërë elementët e tij dhe mbi të gjitha subjektet e kompesuara nuk arrijnë të marrin kompensimin financiar. Referuar parashikimit të nenit 16, pika 6, të ligjit nr.133/2015, afati i kryerjes së pagesës për të gjitha vendimet përfundimtare që kanë njohur të drejtën e kompesimit duhet të përfundojë brenda 10 viteve nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit, ndërkohë

[81] Raporti për planin e veprimit për 5 prioritetet e KE-së, https://.drejtësia.gov.al/raportim-per-planin-e-veprimit-[er-5-prioritetet-e-komisionit-Europian/.

referuar të dhënave të ATP-së[82], numri i vendimeve të vlerësuara për kompesim është 26.092, në një vlerë të përgjithshme prej 857.068.720 Euro. Numri vendimeve për të cilat është kryer pagesa e kompesimit për periudhën 2018-2022 është gjithsej 398. Ky numër, sikurse konstatohet është tepër i ulët referuar numrit të përgjithshëm të vendimeve të vlerësuara si dhe afatit ligjor prej 10 vitesh të vendosur për pagesën apo kompesimin në natyrë të tyre. Vijimi i kompesimit me këtë ritëm nuk pritet të sjellë përfundimin e proçesit brenda afatit ligjor sikurse është parashikuar në nenin 16, pika 6, e ligjit nr.133/2015.

- Në proçesin e shqyrtimit të rasteve, të inicuara kryesisht apo regjistruar mbi bazë ankese të subjektit, të cilat lidhen me respektimin e së drejtës së pronës në proçesin e shpronësimit të saj, janë konstatuar problematika. Kjo sepse gjatë shpronësimeve për interes publik të pronës private, në shumë raste, konstatohet se organet e administratës shtetërore sillen në mënyrë arbritare me titullarët e së drejtës së pronës/pronarët, por edhe poseduesit, duke qenë se i zhveshin këta të fundit nga e drejta e pronësisë dhe nuk i dëmshperblejnë/kompensojnë paraprakisht, kundrejt një shpërblimi të drejtë dhe brenda afateve ligjore. Institucioni ynë mbetet i qëndrimit se shteti, nëpërmjet organeve të administratës publike, duhet të kujdeset për interesat pronësore të qytetarëve, në rast shpronësimi, duke pasur në konsideratë procesin e rregullt ligjor dhe nevojat social-ekonomike të tyre. Vërtet Kushtetuta, KEDNJ, apo edhe ligje të tjera, parashikojnë kufizime të së drejtës së pronësisë, por këto kufizime duhet të jenë të ligjshme, të bëhen vetëm në rast të një interesi publik, kundrejt shpërblimit të drejtë, si dhe të kenë në themel parimin e proporcionalitetit. Koncepti i shpronësimit dhe shpërblimit të pronës nuk përfshihet vetëm për pasuritë e regjistruara por edhe për ato që i janë nënshtruar një procesi të ligjshëm, sikurse pasuritë në proces legalizimi. Nga ankesat e depozituara pranë institucionit tonë, konstatohet se shpërblimi njihet vetëm kundrejt atyre individëve të cilët e kanë regjistruar pasurinë.[83] Subjekteve përfitues në proçesin e "shpronësimit" të pasurive nga legalizimi i ndërtimeve informale nuk iu dorëzohet tërësisht vlera në të holla sikurse përcaktuar.

Një problematikë tjetër e ndeshur edhe gjatë vitit 2022 nga ankesat që ka shqyrtuar institucioni i Avokatit të Popullit, është fakti që edhe pse individëve u merren pasuritë për interes publik, konstatohet zvarritje e procedurave administrative nga ana e institucioneve që kanë për detyrim plotësimin e dokumentacionit për marrjen e shpërblimit. Për sa më sipër në lidhje më këtë pikë, përsërisim se shpronësimi për interes publik i pronës private duhet të trajtohet me kujdesin e duhur dhe të jetë në vëmendjen e institucioneve shtetërore, në mënyrë që të mos jetë apo perceptohet arbitrar nga individët. Po kështu përsërisim se institucionet shtetërore gjatë procedurave të shpronësimit duhet të kenë parasysh edhe vendimmarrjet e Gjykatës të të Drejtave të Njeriut me objekt shqyrtimin e çështjeve që lidhen me problematikat e procesit të kompensimit[84], pasi kjo Gjykatë ka bërë të qartë se e drejta për strehim përfshin edhe rastin e godinave të ndërtuara në

[82] Workshop agenda, zhvilluar datë 11.11.2022 pranë Ministrisë së Drejtësisë.
[83] Qëndrim i organeve publike (si atyre në varësi të pushtetit vendor, ashtu edhe atyre në varësi të pushtetit qendror) vazhdon të sjellë pasoja negative për individë posedues të ndërtimeve informale. Nëse shqyrtimi i vetëdeklarimeve do të kryhej në afatin ligjor të përcaktuar, çdo subjekt posedues i ndërtimit informal për zonat e përmendura, do të ndodhej në kushtet e disponimit të lejes së legalizimit për ndërtimin informal, e për rrjedhojë, të përfitimit të të drejtës që vjen nga shpronësimi i objektit në zbatim të projektit publik.
[84] Affaire Bagdonavicius dhe të tjerë kundër Rusisë, (kërkesa nr.19841/06), Strasburg 11 tetor 2016.

mënyrë të paligjshme, ose që ju u mungon dokumenti i pronësisë.[85] Mosrespektimi i këtyre parimeve, ndër vite ka rënduar buxhetin e shtetit dhe për pasojë atë të taksapaguesve shqiptar.

Çështja e respektimit të pronës, apo parimit për zhvillimin e një proçesi të rregullt ligjor ka qenë dhe është objekt shqyrtimit prej institucionit të Avokatit të Popullit në rastin e kryerjes së veprimtarisë administrative prej organeve publike në zbatim të projekteve të ndryshme publike, të cilat pavarësisht se kanë nisur disa vite më parë, kanë mbartur efektet dhe pasojat edhe gjatë vitit 2022. Kështu psh në qytetin e Tiranës, për projektet e zonave të reja për zhvillim, në Bashkinë Tiranë, njësitë administrative nr. 4, 6 dhe 8 të zonës së Kombinatit, zona "5 Maj", vazhdon hetimi administrativ për këto çështje, por një nga arsyet kryesore përse këto çështje kanë zgjatur, ka qenë edhe mungesa e shpjegimeve të sakta dhe të plota nga organet publike, si Bashkia Tiranë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Kjo mungesë bashkëpunimi, (ku baza ligjore për detyrimin e bashkëpunit institucional është e njëjtë me atë që referuam gjatë komunikimit më DVASHK-të, ndaj nuk po e ripërsërisim), ka penguar punën e institucionit tonë në nxjerrjen e raportit përfundimtar, rreth situatës në të cilën ndodhet respektimi i së drejtës të pronësisë apo parimit për zhvillimin e një proçesi të rregullt ligjor për çështjet që shqetësojnë individët ankues, si dhe përfundimin e procedurës administrative në një afat të arsyeshëm.

Vlen të theksohet se pavarësisht disa ndërhyrjeve të bëra edhe nga GJEDNJ-ja vijon të mbetet problemi i justifikimit ligjor të parashikuar në ligj për shpronësimet publike, aplikimi korrekt i procedurave dhe afateve të ligjit.

3.11 Rregullimi i marrëdhënieve të punës dhe respektimi i të drejtës për një proçes të rregullt ligjor në procedurën administrative.[86]

Institucioni i Avokatit të Popullit, vazhdon të trajtojë marrëdhëniet e punës si një nga problematikat kryesore dhe të rëndësishme të shqyrtimit të ankesave për largimet nga puna në administratën shtetërore të depozituara nga persona që gëzojnë ose jo statusin e nëpunësit civil si dhe hartimin e rekomandimve, për garantimin e stabilitetit dhe mbrojtjes së të drejtave që burojnë nga marrëdhënia e punës, në nivel vendor dhe qendror.

Menaxhimi i marrëdhënieve të punës në administratën publike dhe respektimi i të drejtës për një proces të rregullt ligjor në procedurat administrative, kanë qenë ndër fushat për të cilat institucioni i Avokatit të Popullit vazhdon të investohet nëpërmjet kryerjes së hetimeve të thelluara administrative dhe adresimit të rekomandimeve, për shkak të ankesave të depozituara nga vetë punonjësit të cilët janë liruar, transferuar, pezulluar apo kanë marrë masë disiplinore. Lidhur me rastet e regjistruara/ankesa të administruara pranë institucionit të Avokatit të Popullit që lidhen me marrëdhëniet e punës për vitin 2022, nga trajtimi i këtyre rasteve rezulton se shumica e tyre janë raste të zgjidhura në favor të punonjësve dhe pjesa tjetër është ende në proces të hetimit administrativ.

Lidhur me problematikën sa më sipër, konkretisht për vitin 2022 janë trajtuar *33 ankesa/kërkesa*. Në respektim të parimit të shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritokracisë, transparencës,

[85] Thelbi i konstatimit të gjykatës ishte që autoritetet shtetërore nuk shqyrtuan faktin nëse prishja e shtëpive të ankuesve ishte në përputhje me parimin e propocionalitetit, para se të vijonin me prishjej e objekteve.
[86] Kjo fushë e së drejtës trajtohet prej Seksionit për organet e administratës qendrore, pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre.

profesionalizmit dhe paanësisë politike, vlerësohet se për të garantuar ndërtimin, funksionimin dhe qëndrueshmërinë e një administrate publike është tepër e rëndësishme çështja e rregullimit dhe menaxhimit të duhur të marrëdhënieve të punës në administrate. Kjo vlen si për punonjësit marrëdhënia e punës së të cilëve rregullohet sipas dispozitave të Kodit të Punës, ashtu dhe për nëpunësit marrëdhënia e punës së të cilëve rregullohet sipas legjislacionit në fushën e shërbimit civil.

Në disa raste nga organet e administratës publike kemi konstatuar se ka kuptueshmëri dhe zbatueshmëri të pamjaftueshme lidhur me respektimin e parimeve dhe procedurave përkatëse ligjore të cilat janë të detyrueshme të ndiqen në kuadër të garantimit të respektimit të të drejtës për një proces të rregullt ligjor në procedurën administrative.

Përgjatë procesit të shqytimit administrativ të kryer nga ana e institucionit tonë, kemi evidentuar faktin se procedurat administrative të ndjekura kanë qenë të paqarta dhe të paplota, duke mos krijuar garanci për respektimin e parimit të qartësisë dhe sigurisë juridike. Ky parim si një nga parimet më të rëndësishme administrative bëhet akoma më kuptimplotë dhe domethënës, veçanërisht në rastet kur procedura administrative cënon drejtpërdrejt një interes dhe të drejtë të ligjshme të pales së cënuar, siç është e drejta për punësim, e rrjedhimisht, për mirëqenie shoqërore dhe ekonomike. Procesi i rregullt ligjor, i garantuar si e drejtë themelore e njeriut zbatohet edhe në procedurat administrative, ndonëse ai nuk është i parashikuar në mënyrë eksplicide në ligjin horizontal për procedurat administrative (Kodi i Procedurave Administrative).

Në kuadër të planit të hetimit në rastet kur, nga ana e institucioneve të administratës të cilat ne i kemi adresuar kërkesat tona për shpjegime si dhe përcjelljen e dokumentacionit përkatës lidhur me rastet objekt hetimi, nga kthimi i përgjigjeve përkatëse të dërguara nga institucionet, pas analizimit me kujdes të përmbajteve të tyre, si edhe të dokumentacionit shoqërues, institucioni i Avokatit të Popullit ka vlerësuar se ka vend për përmirësim të procedurës administrative si dhe për pasojë ka adresuar rast pas rasti problematikat respektive, si dhe ka rekomanduar marrjen e masave me qëllim që problematika të tilla mos të përsëriten më në vijimësi. Konkretisht kemi adresuar kryerjen nga ana e institucioneve të një analize të rasteve konkrete (të rrethanave të faktit) si dhe hartimin e relacioneve të plota e të detajuara me qëllim nxjerrjen e masës së përgjegjësisë në nivel hierarkik ndërmjet strukturave të institucionit lidhur me emërimet dhe lirimet/largimet e punonjësve/ankuesve në kundërshtim me ligjin.

Largimi nga puna qoftë në shkelje të respektimit të procedurës ligjore, ashtu edhe në rastet kur ky largim bëhet pa ndonjë shkak të arsyeshëm ligjor, mbart në vetëvete problematikën që këta subjekte të jenë potencialisht gjyqfitues në çështjet që ata paraqesin në gjykatë ku kundërshtojnë zgjidhjen e marrëdhënieve të punës në mënyrë jo të drejtë dhe në shkelje të ligjit si në planin procedural ashtu edhe në atë material.

Në vijim sa sipër, kjo shoqërohet me një faturë me vlerë monetare të konsiderueshme për buxhetin e shtetit, dëm ky i shkaktuar nga institucionet respektive të cilat me veprimet ose mosveprimet e tyre nuk kanë zbatuar në mënyrë korrekte ligjin. Në frymën e ligjit sa sipërcituar, nga ana e institucioneve përgjegjëse, vihet re se ka mosveprime prej këtyre të fundit, për të konkluduar qartësisht të paktën lidhur me masën e përgjegjësisë në nivel hierarkik të institucionit, duke adresuar drejt përgjegjësinë tek personat përkatës. E drejta për një proces të rregullt në procedurat

administrative e sanksionuar nga Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut[87], Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë[88], është një parim themelor kushtetues i konfirmuar tashmë nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese.

Edhe pse ka një kuadër të plotë ligjor që saksionojnë procesin e rregullt ligjor, i cili përshkohet përmes elementëve thelbësorë të këtij parimi, siç janë ligjshmëria, transparenca, informimi, proporcionaliteti, drejtësia dhe paanësia, objektiviteti, përdorimi i gjuhës të njohur nga subjekti, e drejta e aksesit dhe përfaqësimit, e drejta e informimit, e drejta për t'u dëgjuar, kontradiktoriteti, koha e arsyeshme, arsyetimi i vendimmarjes, e drejta e ankimit administrativ dhe gjyqësor etj, në praktikë konstatohet se në disa raste këto elemente nuk respektohen dhe nuk gjejnë zbatim në ndjekjen e procedurave administrative gjatë ushtrimit të detyrës nga ana e organeve të administratës publike.

Në këtë kontekst, rezulton se ka munguar bashkëpunimi efektiv i këtyre institucioneve me Avokatin e Popullit, i cili ka sjellë si pasojë mos pasjen e mundësisë për të mundësuar hetime të plota dhe të shpejta. Ndër problematikat kryesore të evidentuara nga ankesat e depozituara apo nga rastet e ndjekura me iniciativë nga institucioni i Avokatit të Popullit lidhur me marrëdhënien e punës në administratën publike, nënvizojmë se ato kanë qenë ankesa/raste lidhur me lirim/largim të padrejtë nga detyra; ankesa/raste lidhur me procedurat e emërimit në administratën publike; ankesa/raste për transferim të padrejtë në një tjetër pozicion; ankesa/raste lidhur me zbatimin e institutit të pezullimit të marrëdhënies në shërbimin civil; ankesa/raste lidhur me procedurat e ristrukturimit të institucioneve të administratës publike kërkesë/ankesa për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për rikthimin e nëpunësve civilë në detyrë.

Veçanërisht, çështja e largimeve nga puna do të vijojë të mbetet një nga pikat kyçe për punën e Avokatit të Popullit, me qëllim dhënien e kontributeve në përmirësimin e punës dhe krijimin e një administrate publike funksionale në përputhje me standartet Europiane.

3.12 Mbrojtja e konsumatorit[89]

Sigurimi i një niveli sa më të lartë të mbrojtjes së konsumatorëve është një ndër prioritetet e institucionit të Avokatit të Popullit, pasi edhe paraqitja e numrit të ankesave është i lartë. Për të mundësuar trajtimin në një kohë sa më të shkurtër të ankesave si dhe marrjes së përgjigjeve respektive, në përmbushje të rolit proaktiv janë ndërmarë edhe takime bilaterale me organet përkatëse dhe këto komunikime të herë pas hershme kanë patur si qëllim orientimin dhe adresimin sa më drejt të rasteve të paraqitura.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka analizuar me kujdes shpjegimet e dërguara nga institucionet përgjegjëse si edhe dokumentacionin e përcjellë duke vlerësuar se në disa raste ka pasur vend për përmirësim të procedurës dhe mundësimin e rivënies në vend të të drejtave të shkelura.

---

[87] Neni 6.
[88] Neni 42.
[89] Kjo fushë e së drejtës trajtohet prej Seksionit për organet e administratës qendrore, pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre.

Sa më sipër cituar sjellim në vëmëndje, takimet e herë pas hershme të zhvilluar me drejtues të Furnizuesit të Shërbimit Universal sh.a dhe UK sh.a të cilët kanë krijuar një urë komunikimi lidhur me trajtimin e rasteve të paraqitura pranë institucionit tonë. Ky bashkëpunim jo në të gjitha rastet ka rezultuar i suksesshëm dhe kjo është një problematikë në ndjekje e sipër nga ana e Seksionit të Administratës në mënyrë që bashkëpunimi të jetë sa më konstruktiv. Për vitin 2022 janë trajtuar *36 raste* lidhur me pretendimet për moszbatim korrekt të ligjit, ku si subjekt i pretenduar për shkelje ka qenë FSHU sh.a dhe *25 raste* të tjera ku si subjekt i pretenduar ka qenë Ujësjellës Kanalizime sh.a.

Gjatë vitit 2022, Seksioni i Administratës ka dhënë kontributin institucional për çdo rast me iniciativë dhe ankesë/kërkesë në mënyrë që të garantojë hapësirën e individëve për ushtrimin e të drejtave dhe lirive të tyre themelore. Siç e theksuam edhe më sipër, është konstatuar në disa raste mungesa e bashkëpunimit nga Ujësjellës Kanalizime sh.a dhe FSHU sh.a, çka ka sjellë pengesë të punës duke shkaktuar vështirësi për shqyrtimin brenda një afati sa më të shpejtë kohor të rasteve lidhur me problematikat e referuara.
Pranë institucionit të Avokatit të Popullit vazhdojnë të adresohen ankesa të cilat lidhen kryesisht me pretendime për mbi faturime të energjisë elektrike dhe ujit, ndërprerje të energjisë/ujë, mbifaturime, aforfe, mosveprime të operatorëve kundrejt ankesave të qytetarëve, mungesë e vendosjes së aparatëve matës, pamundësi ekonomike për të paguar shërbimin, cilësinë e shërbimeve që ofrohen prej tyre etj. E drejta për të pasur disa shërbime elementare si shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm dhe me energji elektrike është një nevojë bazike mungesa e së cilës përbën një shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut. Rritja e investimeve në këtë fushë si dhe zhvillimi i modeleve të shërbimeve të ofruara në përputhje me nevojat në zhvillim të komunitetit do të mundësojnë arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm si për sa i përket UK sh.a[90] ashtu edhe për FSHU sh.a.[91]

Në veçanti duhet të sigurohen masa për mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë, duke përfshirë masat për të ndihmuar dhe për të shmangur ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike dhe ujë, veçanërisht në zonat rurale.

Në disa ankesa operatorët e furnizimit me energji dhe ujë e orientojnë qytetarin për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura me këste duke lidhur një aktmarrëveshje midis tyre të cilën e shohin si të vetmen mundësi lehtësuese për të shlyer detyrimet e akumuluara, por pa i analizuar dhe zgjidhur problematikat në thelb duke lënë të hapur propabilitetin e përsëritjes së tyre në kohë.

Pas përfundimit të hetimit administrativ është adresuar marrja e masave si dhe është bërë orientimi dhe këshillimi ligjor i qytetarëve, për trajtimin e ankesave të lidhura me këto problematika. Duhet theksuar se në vitin 2022 krahasimisht me vitin 2021, bashkëpunimi midis institucionit të

[90] Qëllimi 6. Sigurimi i disponueshmërisë dhe menaxhimit të qëndrueshëm të ujit dhe kanalizimeve për të gjithë.
6.1 Deri në vitin 2030, të arrihet një qasje universale dhe e barabartë në ujë të pijshëm të sigurt dhe të përballueshëm për të gjithë.
[91] Qëllimi 7. Sigurimi i qasjes në energji të përballueshme, të besueshme, të qëndrueshme dhe moderne për të gjithë.
7.1 Deri në vitin 2030, siguroni qasje universale në shërbime të përballueshme, të besueshme dhe moderne të energjisë.

Avokatit të Popullit dhe organeve respektive ka ndikuar në ngritjen e efikasitetit të punës, për pasojë rritjen e numrit të rasteve të zgjidhura në favor të ankuesve.

3.13 Respektimi i të drejtave që lidhen me pushtetin vendor[92]

Zhvillimet e ndodhura në situatën social ekonomike përgjatë kësaj periudhë kohore në Shqipëri, ka gjetur një pasqyrim edhe në një qasje më kritike të institucionit të Avokatit të Popullit përkundrejt veprimtarisë së qeverisjes lokale, me qëllim mbrojtjen e të drejtave të njeriut si për parandalimin e pabarazisë ashtu edhe për promovimin e tyre.

Veprimet e tyre janë apo duhet të jenë thelbësore për të ruajtur hapësirën qytetare dhe lirinë e shprehjes, për të siguruar qasjen në shërbimet themelore dhe për të përmirësuar planifikimin urban dhe synuar në arritjen e objektivave socialë të shtetit. Ky rol i qeverisjes vendore është tashmë i njohur dhe konfirmuar në shumë akte të organizmave ndërkombëtare, përfshirë dhe rezolutat e miratuara nga Këshilli i të Drejtave të Njeriut të OKB.

• *E drejta për strehim*[93]

Një prej të drejtave më të rëndësishme, objekt i trajtimit nga pushteti lokal, është e drejta për strehim. Kjo e fundit është një prej të drejtave themelore më të rëndësishme të njeriut, që lidhet drejtpërdrejt me të drejtën për jetën dhe shëndetin. Shteti duhet të garantojë mbrojtje ligjore për strehim dhe të ofrojë një bazë për realizimin progresiv të të gjitha aspekteve të së drejtës për strehim të përshtatshëm. Ajo që duhet evidentuar është roli proaktiv i Avokatit të Popullit në mbrojtjen e kësaj të drejte, ku evidentohet se pjesa më e madhe e rasteve që i përkasin të drejtës për strehim,[94] të trajtuara për vitin 2022, është iniciuar nga vetë institucioni.

Këto raste i përkasin problematikave të ndyshme, ku peshën më të madhe e zënë problematikat ende të pazgjidhura, të ardhura si pasojë e tërmetit të nëntorit 2019, por jo vetëm. Në mënyrë analitike ka rezultuar se numri i rasteve të trajtuara lidhur me problematikën sa më sipër në total është *54*. Sikurse parashtruam më sipër një pjesë e këtyre rasteve i përkasin të drejtës për strehim e lidhur kryesisht me pasojat e ardhura nga dëmtimet e tërmetit, ndërsa pjesa tjetër i përket problematikave që kanë të bëjnë me banesat sociale, kredi të buta dhe bonus qiraje, si dhe problematikat lidhur me përmirësimin e kushteve të jetesës, shpronësime, nevojë për rikonstruksion të menjëhershëm, përmbytje etj.

Ndërmjet rasteve që kanë të bëjnë me të drejtën për strehim përfshihen edhe ato që i përkasin komunitetit Rom dhe atij Egjiptian. Gjatë hetimit administrativ të procesit të rindërtimit në tërësinë e tij por edhe të rasteve konkrete, kemi hasur në pengesa nga vetë organet shtetërore

---

[92] Kjo fushë e së drejtës trajtohet prej Seksionit për organet e administratës qendrore, pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre.

[93] Kjo fushë e së drejtës trajtohet prej Seksionit për organet e administratës qendrore, pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre.

[94] Qëllimi 11. Bëni qytetet dhe vendbanimet njerëzore gjithëpërfshirëse, të sigurta, elastike dhe të qëndrueshme.

11.1 Deri në vitin 2030, siguroni qasje për të gjithë në strehim të përshtatshëm, të sigurt dhe të përballueshëm dhe shërbime themelore dhe azhurnoni vendet e varfëra.

përgjegjëse për trajtimin e këtyre problematikave. Evidentojmë me shqetësim të vazhdueshëm faktin se do të kërkonim një bashkëpunim më të frytshëm nga ana e organeve kompetente në dhënien e shpjegimeve pasi edhe në rastin e kthimit të përgjigjeve ato nuk janë ezauruese në të gjitha kërkimet e parashtruara nga ana jonë.

Duhet theksuar se bashkëpunimi gjatë hetimit administrativ është i lidhur ngushtësisht me parimin e transparencës dhe atë të llogaridhënies. Misioni i institucionit të Avokatit të Popullit në këtë drejtim është të kontribuojë në transparencën dhe llogaridhënien e organeve publike sa i përket ushtrimit të drejtë të veprimtarisë administrative nga ana e tyre, lidhur me të drejtat dhe interesat e ligjshme të individëve.

Në kërkesat tona kemi kërkuar vazhdimisht informacion lidhur me kohëzgjatjen e procesit administrativ, transparencën e këtij procesi në tërësinë e tij dhe në raste të caktuara e konkrete, fazën në të cilën gjenden, aktet administrative të nxjerra për këtë qëllim. Përgjigjet e marra për këto raste nuk kanë qenë ezauruese si dhe në disa raste kemi konstuar një qëndrim jo transparent nga institucionet përgjegjëse. Konstatohet se organet përgjegjëse nuk kanë treguar kujdes të shtuar ndaj grupeve në nevojë duke mos i orientuar drejt ato si për familjet që jetojnë në çadra apo mjedise të tjera të përshtatura për strehim ashtu edhe për problematikat e tjera të lartpërmënduara të cilat bëjnë pjesë në fushën e strehimit.

Kjo edhe në kuadër të programeve sociale të strehimit siç është ai i banesave sociale me qira, programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese, deri në një ndërtim të ri; programi i banesave me kosto të ulët; programi për zhvillimin e zonës me qëllim strehimi; programi për krijimin e banesave të përkohshme; si dhe programi i banesave të specializuara. Nga trajtimi i problematikave kemi orientuar Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore që në rastin e skualifikimit të familjeve ose individit, si përfitues në njërin program, ata të kenë mundësi për të kaluar dhe përfituar në një program tjetër strehimi social, kur plotësojnë kushtet ligjore.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka patur në fokusin e trajtimit të tij edhe rastet të kategorive e familjeve të cilët në përbërjen e tyre familjare kanë pjesëtarë të sëmurë, invalidë të grupeve të ndryshme, fëmijë, gra shtatzëna apo të divorcuara me fëmijë, të moshuar, etj.

Ligji "Për strehimin" në dispozitat e tij sanksionon parimin e strehimit të pështatshëm duke parashikuar edhe kushtet që duhet të plotësohen për t'u konsideruar një strehim i përshtatshëm. Strehimi konsiderohet i përshtatshëm atëherë kur garanton privatësinë, një jetesë të sigurt, të qetë dhe me dinjitet si dhe ka hapësira të mjaftueshme banimi sipas normave të strehimit dhe standardeve të ndërtimit, të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, shërbime bazë, brenda këtyre mjediseve të banimit. Gjithashtu duhet të ketë qasje në shërbimet publike, si furnizimi me ujë të pijshëm dhe energji elektrike, largimi i ujërave të ndotura dhe menaxhimi i mbetjeve, akses në shërbimet e punësimit, shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe social, në arsim dhe në shërbime të tjera komunitare.

Në disa raste të cilat vazhdojnë të ndiqen nga institucioni i Avokatit të Popullit lidhur me dëmtimet e tërmetit, është evindentuar se akordimi i fondeve të unifikuara sipas nivelit të dëmit,

nuk përmbush nevojën për të siguruar riparimin e dëmeve efektive në ndërtesat ku mund të bëhen riparime dhe riforcime sipas specifikës së rastit. Për shumë familje, sidomos ato me të ardhura minimale kjo sjell përkeqësim të gjendjes ekonomike të tyre në kushtet kur shihet domosdoshmëria e sigurimit të të ardhurave shtesë për të mundësuar një banesë të sigurt dhe me një standard normal për jetesë. Kjo situatë është reflektuar ndjeshëm edhe tek banorët e zonave rurale të cilët vazhdojnë të jetojnë në kushte të vështira jetese për shkak të pamundësisë së largimit nga zonat e banimit, në kushtet e emergjencës, pasi duhet të kujdesen për ekonominë bujqësore dhe gjënë e gjallë, si të vetmet mjete jetese.

Gjithashtu, duhet të ketë një strategji të qartë komunikimi dhe një mekanizëm për shqyrtimin e ankesave të qytetarëve dhe trajtimit të tyre me shpejtësi dhe korrektesë ligjore e cila të gjejë pasqyrimin e saj në trajtimin e rastit si në planin procedurial (konform KPRA) ashtu edhe në planin material për zgjidhje në thelb të çështjes.
Sa më sipër, në një situatë të tillë të vlerësohet nga çdo bashki, njësi e qeverisjes vendore apo institucionet e tjera kompetente, situata social-ekonomike rast pas rasti për të krijuar mundësinë e strehimit të përshtatshëm në përputhje me normat ligjore. Duhet të merren masat e duhura edhe për përmirësimin e kushteve të jetesës, veçanërisht për subjektet e veçanta dhe në nevojë për shkak të mundësive të pakta buxhetore që ata kanë. Gjithashtu duhet një kujdes i shtuar ndaj banorëve të zonave rurale të cilët janë të predispozuar për t'u varfëruar akoma më shumë, pasi në pjesën më të madhe të rasteve burimi i vetëm i të ardhurave të tyre për përballimin e jetesës së përditshme janë prej gjësë së gjallë. Avokati i Popullit ka marrë në shqyrtim dhe po vijon hetimin administrativ për një numër çështjesh, për të cilat do të shprehim qëndrimin tonë në përfundim të hetimit administrativ.

E drejta për ofrimin e shërbimeve publike

Në kuadër të shkeljes të të drejtave të njeriut në ofrimin e shërbimeve publike, institucioni i Avokatit të Popullit ka kërkuar në mënyrë të vazhdueshme nga organet e qeverisjes vendore respektim të këtyre të drejtave. Në këtë aspekt për t'u përmendur kanë qenë ankesat drejtuar institucionit tonë lidhur me problematikën që haset më së shumti në fushën e infrastrukturës[95] ku një nga problematikat kryesore ka qenë ajo e mungesës së parametrave e standardeve të përcaktuara të rrugëve, mirëmbajtjes së tyre, ambienteve të përbashkëta, jo vetëm në kuadër të të drejtës së individit por edhe të drejtës së këtij të fundit në raport me komunitetin ku ai banon.

Nga trajtimi në tërësi i rasteve të cilat për vitin 2022 kanë qenë *84 raste*, kemi konstatuar se e drejta për ofrimin e shërbimeve publike në praktikë rezulton e kornizuar si një e drejtë e cila thuajse vuan më tepër për t'u përmbushur sidomos në zonat rurale apo qytete të vogla në ndryshim nga ato që konsiderohen të mëdha. Këto problematika të parashtruara më lart mbeten në hije për shkak të mungesës së fondeve të alokuara për rrugët, kanalizimet, mbetjet shtëpiake dhe jo vetëm,

[95] Qëllimi 9. Ndërtimi i infrastrukturës elastike, promovimi i industrializimit gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm dhe nxitja e inovacionit.
9.1 Zhvillimi i një infrastrukture cilësore, të besueshme, të qëndrueshme dhe elastike, duke përfshirë infrastrukturën rajonale dhe ndërkufitare, për të mbështetur zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien njerëzore, me një fokus në qasje të përballueshme dhe të barabartë për të gjithë.

por edhe në qytetet kryesore shfaqen problematika të infrastrukturës. Kjo situatë ngre shumë pikëpyetje nëse janë vërtetë zëra të paparashikuara si zëra në buxhet të njësisë vendore, apo këto fonde janë të pamjaftueshme për të mbuluar nevojat bazike për një jetë të shëndetshme në shërbim të rritjes së cilësisë së qytetarit.

Institucioni i Avokatit të Popullit risjell në vëmendje rëndësinë kyçe të jetesës në ambiente normale dhe të përshtatshme si një mënyrë shprehje e një prej parakushteve për përmbushjen e detyrimit që shteti ka për ofrimin dhe garantimin e shërbimeve publike. Për këtë, gjatë trajtimit të rasteve nëpërmjet komunikimeve zyrtare i'u është kërkuar institucioneve që të veprojnë pozitivisht në ndërmarrjen e hapave të nevojshëm për garantimin dhe sigurimin e ofrimit të shërbimeve të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në sigurinë dhe mbrojtjen e jetës së qytetarëve.

3.14 Mbrojtja dhe të drejtat e fëmijës[96]

Avokati i Popullit shërben si një zë i shtuar për fëmijët dhe të drejtat e tyre, ose thënë ndryshe për t'i dhënë zë me theks të veçantë pjesës më të brishtë dhe vulnerabël të shoqërisë. Edhe gjatë vitit 2022, në kontekstin e të drejtave të fëmijës, institucioni e ka ushtruar veprimtarinë për përmbushjen e funksioneve të mbrojtjes dhe të promovimit të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri.

Sfidat e institucionit, si institucion kombëtar i mbrojtjes së të drejtave të njeriut, në funksion të mbrojtjes dhe garantimit të të drejtave të fëmijëve sot janë shumëplanëshe, siç mund të përmendim:

- ✓ Proaktiviteti në qasje të ngushtë me ruajtjen e pavarësisë;
- ✓ Dëgjimi i zërit të fëmijëve dhe qasja miqësore ndaj tyre;
- ✓ Ndërgjegjësimi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve.

Fëmijët duhet të kenë qasje dhe akses në mekanizmat, që sigurojnë dhe garantojnë gëzimin e të drejtave të tyre, në përputhje me parimet bazë të KDF-së. Avokati i Popullit do të vijojë edhe më fuqishëm misionin e tij, në drejtim të mbrojtjes, promovimit të të drejtave dhe, monitorimit të zbatimit të të drejtave të fëmijëve në mbarë vendin.

Trajtimi i ankesave/kërkesave

Garantimi i respektimit të të drejtave të fëmijëve, në kuadër të mbrojtjes së veçantë që fëmijët gëzojnë nga shteti, si dhe bazuar në parimin e interesit më të lartë të fëmijës përbën fokusin në trajtimin e çdo rasti. Rastet që janë trajtuar gjatë këtij viti, në formën e ankesave dhe kërkesave, nga Seksioni i Mbrojtjes dhe Promovimit të të Drejtave të Fëmijëve, të Avokatit të Popullit, kanë ardhur me postë, kontakt të drejtëpërdrejtë në zyrën e pritjes të institucionit, në ditët e hapura në institucionet e edukimit, inspektimet në shkolla, komisariate, etj.

Në sistemin e regjistrimit të rasteve gjatë këtij viti janë trajtuar rreth *223 raste, ankesa, kërkesa, raste me iniciativë, me objekt të drejtat e fëmijëve, prej të cilave 79 raste me iniciativë perfshire*

[96] Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Mbrojtjes së Fëmijëve në institucionin e Avokatit të Popullit.

dhe 3 raportev të veçanta. Edhe gjatë këtij viti është vijuar me përmbushjen e njërës nga sfidat, atë të arritjes së një numri të konsiderueshëm ankesash dhe kërkesash drejtëpërsëdrejti nga vetë fëmijët, konkretisht, *92.* Nga dëgjimi i zërit të fëmijëve, si dhe garantimi i së drejtës së tyre të ankimimit mund të evidentojmë në këtë raportim që çdo rast i veçantë i trajtuar me organet e administratës publike prek në vetvete një numër të konsiderueshëm subjektesh-fëmijë, të cilët mund të përfitojnë nga trajtimi dhe dhënia zgjidhje e problematikave të ngritura.

Gjatë vitit 2022, Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve, pas kryerjes së hetimeve administrative të pavarura, ju ka drejtuar institucioneve shtetërore të administratës publike në nivel qendror dhe vendor, *30 rekomandime*, kryesisht në fushat si vijon.

E drejta e fëmijës për arsim - Në funksion të zbatimit të parimit të interesit më të lartë të fëmijës, për t'i ofruar një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe në mbështetje të legjislacionit "Për vetëqeverisjen vendore", bashkitë janë përgjegjëse në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar. Gjithashtu, referuar kuadrit ligjor për pushtetin vendor, bashkitë mundësojnë organizimin e aktiviteteve sportive, çlodhëse e argëtuese, nëpërmjet krijimit të kushteve infrastrukturore në institucionet arsimore për zhvillimin e këtyre aktiviteteve. Nga ankesat e ardhura janë evidentuar probleme si: mungesa e mjeteve, laboratorëve të shkencës dhe kabineteve shkollore në disa lëndë të caktuara, riparimi i palestrave, mungesa e ngrohjes në shkolla, mungesa e bankave dhe tavolinave në shkolla etj. Ndaj gjatë këtij viti, Avokati i Popullit ka adresuar disa rekomandime për marrjen e masave për krijimin e mjediseve të përshtatshme për nxënie efektive, nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës shkollore, në disa institucione të edukimit në vend. Po ashtu, Avokati i Popullit ka rekomanduar edhe pajisjen e e këtyre institucioneve arsimore me mjetet e duhura didaktike, për funksionimin normal të procesit të edukimit e arsimimit[97].

Aksesi i fëmijëve në shkollë – Avokati i Popullit ka trajtuar disa raste ankesash nga prindër fëmijësh (kryesisht, probleme me transportin dhe sigurinë fizike në shkolla) me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në fushën e arsimit, dhe u ka rekomanduar institucioneve përgjegjëse[98] vendore marrjen e masave për realizimin e një procesi edukimi pa pengesa, cilësor, efektiv dhe gjithëpërfshirës të fëmijëve/nxënës, duke garantuar të drejtën e tyre për t'u arsimuar dhe në të njëjtën kohë, aksesin dhe sigurinë fizike në institucionet shkollore, pavarësisht kushteve apo rrethanave[99].

E drejta e fëmijës për mbrojtje dhe ofrimi i kujdesit shoqëror - Legjislacioni shqiptar përcakton strukturat përgjegjëse, procedurat, fazat për masat e mbrojtjes së menjëhershme dhe vendosjen në kujdes alternativ[100], duke parashikuar të drejtën e fëmijës për të qëndruar me prindërit dhe për të mos u ndarë prej tyre kundër vullnetit të tyre, me përjashtim të rasteve kur gjykata vendos se

[97]Rekomandimi me nr.doc.202200185, rekomandimi me nr.doc.202101426 drejtuar DAR Lezhë dhe Bashkisë Kurbin, rekomandimi me nr.doc.202101614, rekomandimi me nr.doc.202200217.
[98] Rekomandimi me nr.202200726 me objekt" Marrjen e masave që në fillim të vitit të ri shkollor 2022-2023, nga Bashkia Dimal, për garantimin e aksesit në arsim dhe vënien në dispozicion të mjetit të transportit për frekuentimin e mësimit nga fëmijët e nxënësit e fshatit Malas Breg, në funksion të një procesi edukimi pa pengesa, cilësor, efektiv dhe gjithëpërfshirës, në/dhe për zbatim të parimit të interesit më të lartë të fëmijës".
[99] Rekomandimi me nr.doc.202101409 drejtuar DAR Lezhë.
[100] Rekomandimi me nr.doc.202200668 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të SHSSH.

ndarja është në interesin më të lartë të fëmijës. Avokati i Popullit ka dhënë rekomandime në frymën e legjislacionit të të drejtave të fëmijës që garanton mbrojtjen e tyre sa i përket ofrimit të shërbimeve sociale dhe për një qasje bashkëpunimi, bashkërendimi dhe koordinimi ndërsektorial në nivel qendror dhe vendor, në këtë drejtim[101]. Shqetësimi i institucionit të Avokatit të Popullit vazhdon të jetë në fragmentizimin e punës nga strukturat përgjegjëse për zbatimin korrekt të legjislacionit, për të pasur një vlerësim gjithëpërfshirës, të detajuar, të shtrirë në kohë, dhe të mbështetur në gjendjen faktike aktuale të fëmijës. Në rekomandimet e Avokatit të Popullit është evidentuar gjithashtu mungesa e tipologjive të reja të shërbimeve sociale, të cilat do të mundësonin dhe rrisnin progresin e familjes me qendër fëmijët. Ndaj edhe gjatë këtij viti, gjatë shqyrtimit administrativ të ankesave/kërkesave, Avokati i Popullit ka vënë theksin në zbatimin korrekt të kuadrit ligjor për mbrojtjen e fëmijës, fuqizimin e familjes, programet gjithëpërfshirëse e me tipologji të reja të shërbimeve sociale[102].

Liria e fëmijës për organizim dhe grumbullim paqësor- Avokati i Popullit ka theksuar se organet e rendit duhet të sigurojnë gëzimin nga ana e fëmijëve të së drejtës së tyre për tubime paqësore, pa ndërhyrje dhe duke iu garantuar pjesëmarrësve-fëmijë mbrojtje nga rreziku i dëmtimit. Institucionet duhet të marrin masa në drejtim të sigurisë së fëmijëve dhe informimit të tyre mbi rreziqet që mund të sjellin grumbullimet/tubimet. Veçanërisht, në protesat ku kemi një prezencë të lartë të fëmijëve, autoritetet duhet të planifikojnë se si të menaxhojnë situatën dhe të sigurojnë që teknikat e përdorura nga policia nuk ndikojnë në mënyrë joproporcionale tek fëmijët (p.sh. përdorimi i gazit lotsjellës, etj.) Strukturat e policisë duhet të trajnohen mbi të drejtën e fëmijës për të protestuar dhe mbi sfidat e veçanta me të cilat përballen ata, si grupi më i prekshëm ndaj teknikave të caktuara të policimit[103].

Të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuar- Lidhur me të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuar, Avokati i Popullit ka evidentuar se procesi për identifikimin, referimin dhe akomodimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara deri në 21 vjeç në shërbimet e përkujdesit social, duhet të bëhet në praktikë në frymën e legjislacionit të shërbimeve sociale. Sipas Avokatit të Popullit, megjithëse ligji i ri i shërbimeve sociale solli një qasje të re të llojit të shërbimeve sociale dhe rregullave për sigurimin dhe ofrimin e tyre, këto detaje ende nuk janë përcaktuar tërësisht dhe nuk janë harmonizuar aktet nënligjore me frymën e ligjit. Prandaj, ky institucion ka rekomanduar, ndër të tjera, marrjen e masave nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për: rishikimin e kuadrit ligjor të shërbimeve shoqërore dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, për të harmonizuar procesin administrativ për identifikimin, referimin, ofrimin e shërbimeve të përkujdesit social dhe, integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar në shoqëri, në përputhje me parimet e konventave të ratifikuara nga shteti shqiptar; vlerësimin e përfituesve të qendrave të zhvillimit mbi 21 vjeç, bazuar në parimin e de-institucionalizimit, ku shërbimet e kujdesit shoqëror sigurohen dhe ofrohen, për aq sa është e mundur, pranë familjes ose komunitetit të përfituesit të shërbimit, me

[101] Rekomandimi me nr.doc.202200937 drejtuar Drejtuar SHSSH.

[102] Rekomandimi me nr.doc.202101707 "Rekomandim për fuqizimin e familjes së shtetasit B. P. në interesin më të lartë të fëmijëve me inicialet E.P. dhe E.P, për të bërë të mundur vlerësimin e nevojave të fëmijëve të familjes dhe hartimin e planit të mbrojtjes, për të siguruar një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe gëzimin e një jetese normale e pa privime" drejtuar Bashkisë Vau i Dejës dhe DRSHSSH Shkodër.

[103]Rekomandimi me nr. doc 202003372 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë dhe komisariateve nr 1, nr 2, nr 3, nr 4, nr 5, nr 6 Tiranë.

qëllim sigurimin e mirëqenies shoqërore dhe përdorimin me efikasitet të fondeve; indeksimin e kuotës financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve të përfituesve të shërbimeve të përkujdesit social, vit pas viti, në përputhje me ndryshimin e normave të inflacionit[104].

Inspektimet/monitorimet/hetimet administrative

Në vitin 2022 janë trajtuara, me iniciativën e Avokatit të Popullit, *79 raste* me objekt të drejtat e fëmijëve. Burimi kryesor i këtyre rasteve kanë qenë njoftimet dhe raportimet e ndryshme në mediat e shkruara, ato elektronike dhe rrjetet sociale.

Kryesisht objekt i përbashkët i shumicës prej tyre kanë qenë problematikat sociale, trajtimi i familjeve me shumë fëmijë me shërbime të kujdesit shoqëror, por edhe probleme të tjera si, ndotja mjedisore apo bullizmi. Ato janë vlerësuar nga Avokati i Popullit për t'i dhënë zë pjesës më vulnerabël të shoqërisë, siç janë: fëmijët në situata nevoje e vështirësie ekonomike, fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët që jetojnë në varfëri, fëmijët në përkujdesje sociale, fëmijët romë, fëmijët në lëvizje, etj. Nëpërmjet trajtimit të rasteve me iniciativë, nga korrespondencat e shkëmbyera me organet e administratës shtetërore vendore dhe qëndrore, kemi synuar jo vetëm zgjidhjen e problematikave të parashtruara mediatikisht, por edhe promovimin dhe nxitjen e kulturës së respektimit, si primar, të interesit më të lartë të fëmijëve dhe të përcaktimeve që përmban ligji 18/2017. Gjatë këtij viti institucioni i Avokatit të Popullit[105] ka monitoruar, ndër të tjera, efektet që situata e emergjencës civile, të shkaktuar nga tërmeti i 26 nëntorit 2019, ka passjellë në mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të fëmijëve, duke evidentuar problematikat dhe adresuar rekomandimet përkatëse për përmirësimin e veprimeve të organeve të administratës publike, në nivel qendror dhe vendor, në interesin më të lartë të femijeve.

Drejtësia miqësore për fëmijët dhe të drejtat e tyre[106]

Avokati i Popullit, si institucion kombëtar i mbrojtjes së të drejtave të njeriut, në vijimësi ka vënë theksin në detyrimin, që kanë aktorët kyç të administrimit të drejtësisë penale për të mitur karshi të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve, të akuzuar për shkelje të ligjit penal[107]. Në ditët e sotme fëmijët mund të ketë kontakt me sistemin e drejtësisë në një mënyrë ose në një tjetër (divorci, kujdestaria, birësimi, migrimi etj). Disa nga problematikat që janë evidentuar nga Avokati i Popullit, lidhur me drejtësinë miqësore për fëmijët, janë si vijon:

- ✓ mungesa e besimit të fëmijëve ndaj sistemit të drejtësisë;

[104]Rekomandimi me nr. doc.202200111 drejtuar Qendrës së Zhvillimit Shkodër dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
[105] Me mbështetjen e UNICEF-it.
[106]***"Drejtësia miqësore për fëmijët***" *i referohet sistemeve të drejtësisë që garantojnë respektimin dhe zbatimin efektiv të të gjitha të drejtave të fëmijëve në nivelin më të lartë të arritshëm, mbështetur në parimet e legjislacionit ndërkombëtar duke i kushtuar vëmendjen e duhur nivelit të pjekurisë dhe mirëkuptimit të fëmijës dhe rrethanat e rastit. Është, në veçanti, drejtësia që është e aksesueshme, e përshtatshme për moshën, e shpejtë, e zellshme, e përshtatur dhe e fokusuar në nevojat dhe të drejtat e fëmijës, duke respektuar të drejtat e fëmijës duke përfshirë të drejtat për një proces të rregullt ligjor, për të marrë pjesë dhe për të kuptuar procedurat, për respektimin e jetës private dhe familjare dhe të integritetit dhe dinjitetit"* përcaktuar në Udhëzimet të Këshillit të Europës për drejtësinë miqësore për fëmijët miratuar në 17 nëntor 2010, nga Komiteti i Ministrave.
[107]Ligji nr.37/2017 "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur".

✓ mungesa e informacionit dhe shpjegimeve të përshtatshme gjatë proceseve gjyqësore në përputhje me nevojat dhe zhvillimin e fëmijëve;
✓ mungesa e mjediseve miqësore dhe gjuhës së thjeshtë dhe të kuptueshme ndaj fëmijëve;
✓ qasje jo të uniformizuara të organeve të drejtësisë ndaj fëmijëve (p.sh. gjykatat bazohen në parimin e mbrojtjes së interesit të fëmijëve, si interesi më i lartë gjatë vendimarrjes, por *praktikat kanë qenë të ndryshme dhe nuk ka ndonjë unifikim të të gjithë faktorëve, tek të cilët duhet të bazohet gjykata për të dhënë masën e detyrimit për ushqim.* Kjo mangësi krijon vështirësi sidomos kur kërkohet ndryshimi i masës së detyrimit ushqimor për fëmijët.
✓ proceset gjyqësore të tejzgjatura, të cilat mund të krijojnë probleme jo vetëm, tek prindërit, por edhe në gjendjen emocionale e psikologjike të fëmijës;
✓ mungesa e disa përcaktimeve/parashikimeve ligjore specifike në Kodin e Familjes në përputhje me parimin e interesit më të lartë të fëmijës (si p.sh. mungesa e parashikimit ligjor në Kodin e Familjes që *vendimi i gjykatës për caktimin e detyrimit ushqimor të jetë automatikisht titull ekzekutiv. Gjithashtu, legjislacioni ynë i brendshëm nuk mundëson kompensimin e detyrimit ushqimor);*
✓ pyetja e fëmijëve disa/shpesh herë gjatë procesve gjyqësore të divorcit, kujdestarisë etj., gjë e cila mundësisht duhet shmangur nga gjyqtarët, bazuar në interesin më të lartë të fëmijës dhe mirëqenien e tyre.

Për të garantuar akses efektiv të fëmijëve dhe trajtimin e duhur të tyre në sistemin e drejtësisë, Avokati i Popullit i ka adresuar rekomandimet përkatëse Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Gjykatës së Apelit Tiranë, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ndër të cilat si më të qenësishme, përmendim:

✓ Marrjen e masave për respektimin e afateve të përcaktuara në kodet procedurale sa i përket përfundimit të shqyrtimit të çështjeve dhe veçanërisht për shqyrtimin me prioritet të çështjeve që lidhen me të drejtat e fëmijëve apo kanë ndikim tek fëmijët e mitur nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë.
✓ Marrjen e masave nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për të mbështetur gjykatat me ngarkesë të madhe, përmes delegimit të gjyqtarëve në këto gjykata me qëllim realizimin e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve, si dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve për një gjykim brenda afateve të arsyeshme.
✓ Marrjen e masave për të hartuar një strategji konkrete lidhur me pasqyrimin e plotë të gjendjes së ekzekutimit të vendimeve gjyqësore për detyrimin ushqimor ndaj fëmijëve, dhe të publikojnë të dhëna të sakta për situatën e zbatimit të tyre. Për këtë është e nevojshme që Ministria e Drejtësisë, të njohë dhe të monitorojë situatën e shërbimit përmbarimor shtetëror dhe privat, lidhur me ekzekutimin apo mosekzekutimin vendimeve gjyqësore për detyrimin ushqimor ndaj fëmijëve.
✓ Marrjen e masave nga Ministria e Drejtësisë për ngritjen e një grupi pune për të vlerësuar nevojën e hartimit të akteve ligjore ose nënligjore, si dhe forcimit të kapaciteteve të strukturave të specializuara brenda Ministrisë, me qëllim përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga konventat ndërkombëtare, specifikisht KDF-ja dhe Konventa e Hagës (2007), në drejtim të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore me objekt "detyrimin ushqimor ndaj fëmijës", nga prindërit apo personat e tjerë që kanë përgjegjësi financiare për fëmijët, të cilët ndodhen jashtë vendit.

✓ Marrjen e masave për nënshkrimin e një marrëveshjeje bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme me qëllim ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për detyrimin ushqimor, kur prindërit apo persona të tjerë që kanë këtë detyrim ndodhen jashtë vendit. Bazuar në këtë marrëveshje, Ministria e Drejtësisë të hartojë listën e debitorëve me objekt "detyrimin ushqimor ndaj fëmijëve" dhe Ministria e Punëve të Brendshme të kërkojë respektimin e vendimeve gjyqësore gjatë kalimit të kufirit nga ana e debitorëve.

✓ Marrjen e masave nga gjyqësori për aplikimin e nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile, i cili citon rastet e dhënies së vendimeve me ekzekutim të përkohshëm. Gjykatat i kanë të gjitha mundësitë ligjore duke u nisur edhe nga natyra shumë specifike e këtyre konflikteve gjyqësore, që të aplikojnë dhënien e këtyre vendimeve me ekzekutim të përkohshëm. Kjo do të eleminonte të gjitha zvarritjet që do të sillte ankimimi në themel i vendimit për zgjidhje martese dhe pasojave që rrjedhin prej saj.

✓ Përmirësimin e legjislacionit të brendshëm për të mundësuar kompensimin e detyrimit ushqimor nga Shteti dhe vendosjen e marrëdhënies debi-kredi, midis prindit që detyrohet dhe Shtetit. Përmirësimi i legjislacionit në këtë drejtim për rastet kur burimet e të ardhurave të prindërve nuk i përmbushin nevojat e fëmijës, do të mundësonte që shteti të merrte masa për të kompensuar pjesën e të ardhurave që duhet për të përballuar nevojat e fëmijës.

Të drejtat e fëmijëve dhe ndryshimet klimatike

Kriza klimatike është tashmë një problem ndërkombëtar, sidomos për fëmijët dhe të rinjtë që ndjejnë rritjen e temperaturave dhe ngjarjet e pafavorshme të motit nga viti në vit. Në një peticion klimatik përpara Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut (*Duarte Agostinho*), aplikantët fëmijë dhe të rinj përshkruajnë shqetësimin mendor të efekteve aktuale të krizës klimatike duke theksuar, se humbasin shkollën dhe sportin për shkak të valëve të të nxehtit, si dhe shqetësimet e tyre për të ardhmen.[108]Avokati i Popullit, brenda mandatit promovues, ka sjellë në vëmendje se fenomene të tilla, si ngrohja globale, ngjarjet e shpeshta dhe të rënda të motit, mungesa e ushqimit dhe ujit, rritja e transmetimit të infeksioneve virusale të transmetueshme, ndotja e ajrit, rritja e nivelit të detit kanë një ndikim joproporcional dhe shkatërrues në shëndetin dhe mirëqenien e fëmijëve. Ndaj, problematikat lidhur me ndryshimet klimatike të konstatuara nga vetë fëmijët dhe të trajtuara nga Avokati i Popullit, janë si vijon:

✓ pamjaftueshëria e rolit të bashkive në parandalimin dhe përmirësimin e ndryshimeve klimatike dhe aspekteve të tjera mjedisore në qytetin e tyre, për të garantuar të drejtën e fëmijës për t'u argëtuar në kënde sportive dhe mjedise të gjelbërta;

✓ rreziku i shtuar i fatkeqësive natyrore që vijnë për shkak të ndryshimeve klimatike, si përmbytje, zjarre, rrëshkitje dherash etj., për kategoritë e fëmijëve në nevojë, duke cënuar të drejtën e jetës për një zhvillim normal të tyre;

✓ anashkalimi i fëmijëve gjatë zhvillimit të procesit të hartimit dhe zbatimit të politikave në fushën e ndryshimeve klimatike, duke cënuar të drejtën e tyre në vendimarrje;

✓ burimi më i shpeshtë i informacionit për ndryshimet klimatike janë mediat sociale, OJF-të, dhe programe të fragmentizuara në kurrikulat mësimore, duke cënuar të drejtën e fëmijës për informacion të sigurt;

[108]Shiko peticionin në faqen e internetit të Rrjetit Global të Veprimit Ligjor (GLAN) https://youth4climatejustice.org/ aksesuar më 3 qershor 2021.

✓ kuadri ligjor i miratuar për ndryshimet klimatike është ende i paplotë dhe si rezultat, në një pjesë të madhe të tij i pazbatueshëm.

Avokati i Popullit, me kompetencat e dhëna nga ligji, ka adresuar rekomandimet përkatëse gjatë realizimit të aktivitetit për prezantimin e raportit "*Vlerësimi i Ndikimit të Ndryshimeve Klimatike në të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri*", në të cilin morën pjesë përfaqësues nga Ministritë e Mjedisit, Arsimit dhe Sportit, Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ndër të cilat, si më të rëndësishme, përmendim:

Adresimi i ndryshimeve klimatike duhet të fillojë nga edukimi - Edukimi nuk duhet të konsiderohet vetëm në kuptimin e ngushtë të edukimit të fëmijëve në shkollë, por edhe në aspektin e edukimit në shtëpi dhe në komunitet. Vetëm në këtë mënyrë, do të arrihet që fëmijët dhe të rinjtë të aftësohen për të ndërtuar një mënyrë jetese në përputhje me mjedisin, duke dhënë kontributin e tyre aktiv në uljen e rrezikut të ndryshimeve klimatike. Njëkohësisht, përmes edukimit, do të arrihet që fëmijët të kenë mundësi të ushtrojnë efektivisht të drejtat e tyre për t'u bërë pjesë e vendimmarrjes, për t'u dëgjuar, për të kërkuar respektimin e të drejtave të tyre mjedisore në rrugë administrative dhe gjyqësore.

Adresimi i çështjeve të mjedisit është i lidhur ngushtësisht me çështjet e fëmijëve - Është e rëndësishme të rriten përpjekjet në vend për t'i adresuar çështjet e mjedisit si të lidhura ngushtësisht me çështjet e fëmijëve dhe respektimin e të drejtave të tyre, të garantuara nga Kushtetuta, ligjet e brendshme, KDF-ja, dhe nga akte të tjera ndërkombëtare. Ndërtimi i kornizës ligjore dhe qasja institucionale duhet të funksionojnë në mënyrë paralele me qëllim përmirësimin dhe sigurimin e një impakti social të qëndrueshëm. Në këtë dimension, Avokati i Popullit me kompetencat e dhëna nga ligji ka potencialin për të qenë një mekanizëm thelbësor në nivel të përmbushjes së objektivave të ligjeve mjedisore dhe të monitorimit të zbatueshmërisë së tyre.

Advokim në nivel kombëtar, rajonal dhe global - Duhet rritur advokimi në nivel kombëtar, rajonal dhe global për të siguruar respektimin e të drejtës së patjetërsueshme të fëmijëve për një mjedis të shëndetshëm. Kjo mund të arrihet vetëm nga një bashkëpunim, koordinim dhe ndërveprim i të gjithë aktorëve të përfshirë dhe gjithmonë me pjesëmarrjen e fëmijëve dhe të rinjve, si zëdhënësit kryesorë të këtyre të drejtave.

Zhvillim i proceseve administrative të posaçme, të konsultimit dhe të dëgjimit të këtyre grupmoshave - Veçanërisht për çështje të cilat prekin drejtpërdrejt dhe thelbësisht të drejtat e fëmijëve, është thelbësore që pikëpamjet dhe mendimet e tyre të merren në konsideratë dhe t'u jepet pesha e duhur nga ana e aktorëve shtetërorë vendimmarrës. Kjo mund të bëhet vetëm nëpërmjet zhvillimit të proceseve administrative të posaçme, të konsultimit dhe të dëgjimit të këtyre grupmoshave.

Rritje e pjesëmarrjes së fëmijëve dhe të rinjve – Duhet të rritet pjesëmarrja e fëmijëve dhe të rinjve të të gjitha moshave në çështje që kanë të bëjnë me ndryshimet klimatike. Në kuadër të angazhimit është e nevojshme të përfshihen:

✓ seminare të përshtatshme për moshën në mjedise arsimore formale dhe joformale;

- ✓ pyetësorë dhe sondazhe;
- ✓ rritje e ndërgjegjësimit për aktivizmin e të rinjve dhe fëmijëve;
- ✓ punë me palët e përfshira që mbështesin fëmijët dhe të rinjtë.

Mbrojtja e fëmijëve në situata të emergjencave civile

Institucioni i Avokatit të Popullit, realizoi monitorimin e strukturave përgjegjëse në njësitë e qeverisjes vendore të prekura nga tërmeti i 26 nëntorit të 2019, fokusuar në mbrojtjen e fëmijëve në situatat e emergjencës civile[109]. Procesi u përqëndrua në bashkitë më të prekura nga ky tërmet si Shijaku, Durrësi, Kruja, Tirana, Kamza, Kurbini dhe Lezha. Ndaj, për këtë qëllim Avokati i Popullit ka adresuar rekomandimet përkatëse ndër të cilat si më të rëndësishme, veçojmë:

✓ Përditësimin dhe zbatimin në vijim të "Planit Vendor për Emergjencat Civile" të hartuar dhe miratuar, duke marrë në konsideratë trajtimin me prioritet të fëmijëve, si dhe parashikimin e masave konkrete që duhet të merren në rast fatkeqësie natyrore (evakuimi, garantimi i kujdesit shëndetësor, arsimimi në vazhdim, sistemimi në banesë të përshtatshme, mbrojtja nga çdo lloj dhune, etj), në çdo situatë të mundshme fatkeqësie natyrore ose emergjence civile.[110]

✓ Bashkërendimin e punës të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjëndjes Civile me Zyrat e Gjëndjes Civile në nivel vendor për të bërë të mundur identifikimin e të dhënave sasiore të numrit të fëmijëve për çdo bashki dhe vënien e tyre në dispozicion të Njësive për Mbrojtjen e Fëmijës, me qëllim plotësimin e standardit ligjor minimalisht 1 (një) punonjës i dedikuar për 3000 fëmijë. [111]

✓ Miratimin e një rregulloreje nga kryetari i bashkisë Lezhë[112], për koordinimin e brendshëm institucional, si dhe shkëmbimin e informacionit midis zyrës së gjendjes civile dhe njësisë për mbrojtjen e fëmijëve në bashkinë Lezhë, ku të përcaktohet lloji dhe mënyra e shkëmbimit të informacionit, procedurat dhe afatet, me qëllim që NJMF të ketë në çdo kohë një listë të përditësuar të fëmijëve që ndodhen në territorin e bashkisë.

✓ Hartimin dhe përditësimin e listës me të gjithë fëmijët që ndodhen në territorin e njësisë administrative përkatëse, nga Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës në bashki, si dhe dërgimin e kësaj liste pranë Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, brenda 24 orëve nga ndodhja e çdo fatkeqësie natyrore ose emergjence civile, me qëllim mbrojtjen dhe mbikqyrjen e posaçme të fëmijëve. [113]

✓ Përditësimin e bazës së të dhënave për individët dhe familjet që kanë mbetur të pastrehë si pasojë e fatkeqësisë natyrore tërmetit të nëntorit 2019, duke evidentuar në mënyrë të posaçme

[109] Ky monitorim u realizuar me mbështetjen financiare të UNICEF-it.
[110] Ligji 45/2019, "Për mbrojtjen civile", neni 30 "Bashkitë", pika 1/ ç) hartojnë, miratojnë dhe përditësojnë planin vendor për emergjencat civile dhe ia dërgojnë Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe prefektit të qarkut, për qëllime analizimi dhe planifikimi. Neni 14 "Planet për emergjencat civile", pika 6.
[111] Ligji nr.18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".
[112] Në mbështetje të kompetencave dhe detyrave të përcaktuara në gërmën "j" të nenit 64, të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".
[113] Ligji nr.18/2017 "Për të drejtat e fëmijës", neni 28: - "Mbrojtja nga përfshirja në konflikte të armatosura dhe në situata të emergjencave civile".

fëmijët dhe familjet me fëmijë që kanë mbetur të pastrehë, si dhe masat përkatëse të marra hap pas hapi deri në sistemimin e plotë të tyre me banesë.[114]

✓ Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar të mundësojë nëpërmjet psikologëve të shkollave vlerësimin psiko-social të fëmijëve të institucioneve të edukimit (dëme psikologjike të shkaktuar nga tërmeti) dhe të marrë masa për referimin e problematikave të evidentuara strukturave përgjegjëse në nivel vendor.

✓ Garantimin e transportit falas në shkolla dhe kopshte të tjera të përshtatshme, ekzistuese ose ambiente të marra me qera, të fëmijëve që preken nga fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile, në mënyrë që të garantohet aksesi në arsim i fëmijëve.[115]

✓ Forcimin e kapaciteteve dhe burimeve njerëzore në nivel vendor, për përballimin e situatave të emergjencave civile ose rasteve të fatkeqësive natyrore, nëpërmjet trajnimeve dhe kualifikimeve, kryesisht të stafit përgjegjës të ngarkuar për mbrojtjen e fëmijëve dhe garantimin e të drejtave të tyre në këto situata.

✓ Fuqizimin e strukturave të mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor, për parandalimin, identifikimin, referimin dhe menaxhimin e rasteve të fëmijëve që nuk iu garantohen të drejtat ose që kanë nevojë për mbrojtje, gjatë periudhave të situatave të fatkeqësive natyrore ose emergjencave civile.

✓ Garantimin e kapaciteteve dhe logjistikës së nevojshme, për përballimin e situatave të emergjencave civile ose rasteve të fatkeqësive natyrore, në drejtim të strehimit të përkohshëm të sigurt e të përshtatshëm.

✓ Miratimin e akteve nënligjore të parashikuara në tabelën e Ministrisë së Mbrojtjes në VKM nr.850, datë 29.12.2021, "Për miratimin e planit analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2022", e korrigjuar. Konkretisht, këto tre projekt-vendime janë: "Për vlerësimin e riskut në nivel qendror", "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë" dhe "Për miratimin e Planit Kombëtar për Emergjencat Civile", të cilat ishin parashikuar të miratoheshin në katërmujorin e tretë të vitit 2022.

✓ Marrjen e masave nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për përmirësimin e ligjit 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës" duke kryer një vlerësim të thelluar të situatës reale të njësive administrative të bashkive për të patur një PMF pavarësisht numrit të fëmijëve në juridiksion të saj, i cili mundet të jetë edhe më i ulët.

✓ Marrjen e masave për përfundimin e procesit të ri-ndërtimit të institucioneve arsimore të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019, në përputhje me vendimin nr.319, datë 12.4.2017 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e standardeve të projektimit të shkollave".

Veprimtaritë promovuese për të drejtat e fëmijëve

Gjatë vitit 2022, Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve, në bashkëpunim me stafet e shkollave 9-vjeçare dhe të mesme në vend, ka realizuar veprimtari promovuese me nxënësit, mësuesit dhe prindërit. Qëllimi i këtyre veprimtarive/aktiviteteve ishte njohja me katalogun e të drejtave të fëmijëve, si dhe edukimi për/rreth këtyre të drejtave. Janë realizuar gjithsej *40 veprimtari* të tilla "Ditë të Hapura" me theks konsolidimin e njohurive të nxënësve, prindërve dhe stafit pedagogjik mbi veprimtarinë e Avokatit të Popullit dhe rëndësinë e njohjes së të drejtave të fëmijëve. Veprimtaria e Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të

114 Akti Normativ nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", neni 17/1/c.
115 Ligji nr.18/2017 "Për të drejtat e fëmijës", neni 18: - "E drejta për arsim".

Drejtave të Fëmijëve, pranë Avokatit të Popullit, në kontekstin e promovimit, mund të përmblidhet në këto drejtime kryesore:

- ✓ Ditë të hapura, veprimtari ndërgjegjësuese në shkollat në qytete të ndryshme të vendit;
- ✓ Tryeza, webinare dhe takime;
- ✓ Deklarata promovuese dhe ndërgjegjësuese.

Nga këto mund të përmendim më konkretisht:

Ditë të hapura

✓ Organizimin e veprimtarive "Ditë të hapura", në institucione arsimore në disa qytete si: Shijak, Krrabë, Paskuqan, Vorë, Marqinet, Kamëz, Tiranë, Elbasan, Durrës, Burrel, Peshkopi etj.
✓ Veprimtari e organizuar nga Avokati i Popullit "Të festojmë së bashku ditën Ndërkombëtare të 1 Qershorit" me fëmijët që marrin shërbim të përkujdesit social tek organizata jofitimprurëse "Orët Fatlume", në Bashkinë Elbasan, datë 1.06.2022.

Tryeza/webinare/takime

✓ Pjesëmarrja e Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve, në datën 5.11.2022, në tryezën/trajnimin me temë "Të drejtat tona: Edukimi të drejtave të fëmijëve në shkollë", në qytetin e Krujës. Ky trajnim u realizua nga CRCA/ECPAT Shqipëri në bashkëpunim me institucionin e Avokatit të Popullit dhe Bashkinë Krujë, me mbështetjen e Ambasadës së Republikës së Sllovenisë.
✓ Pjesëmarrja e Komisionerit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve, në datën 8.11.2022, në takimin e grupit parlamentar "Miqtë e fëmijëve"-"Shqipëria 30 vjet, Konventa për të Drejtat e Fëmijës". Ky takim u zhvillua nga Kuvendi i Shqipërisë, nëpërmjet Grupit Parlamentar Miqtë e Fëmijëve, në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile dhe me pjesëmarrje të institucioneve të pavarura që veprojnë ne fushën e të drejtave të njeriut. Gjatë këtij takimi u dëgjuan pikëpamjet e fëmijëve mbi gjendjen e të drejtave të tyre, të prezantuara edhe gjatë Sesionit të 93-të të Komitetit për të Drejtat e Fëmijës të OKB-së, përmes tre grupimeve të fëmijëve, respektivisht, CRCA Shqipëri, *Save the Children*, SOS Fshatrat e Fëmijëve.
✓ Pjesëmarrja e Komisionerit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve në dy tryeza të organizuara nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, përkatësisht, në datën 8.7.2022 në *workshop*-in me temë: "Bashkëpunimi për drejtësinë për të mitur", si dhe në datën 15.12.2022 në tryezën konsultative me temë: "Roli i NJMF-ve në Drejtësinë për të Mitur".
✓ Pjesëmarrja e Komisionerit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve në datën 13.7.2022 në Tryezën Kombëtare të organizuar nga OSCE me temë: "Institucionet e të Drejtave të Njeriut dhe Gjyqësori".
✓ Pjesëmarrja e Komisionerit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve në datën 3.11.2022 në konferencën e përbashkët të organizuar nga Qendra Europiane për të Drejtat e Romëve dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi me temë: "Mbrojtja e romëve në Shqipëri-identifikimi i mjeteve juridike për të luftuar kundër diskriminimit".

✓ Në datën 19 korrik 2022 u prezantua raporti i vlerësimit të ndikimit të ndryshimeve klimatike në të drejtat e fëmijëve në Shqipëri me mbështetjen e organizatës *Save the Children*. Ky raport ka vlerësuar dhe analizuar ndikimin që kanë politikat në fushën e mbrojtjes klimatike mbi fëmijët, qoftë në këndvështrim të ndikimit që kanë ato mbi jetën dhe shëndetin e fëmijëve, ashtu edhe nga perspektiva e pjesëmarrjes së tyre në proceset vendimmarrëse dhe konsultuese.

✓ Në datën 18 nëntor 2022, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Fëmijës (20 nëntor), institucioni i Avokatit të Popullit, me mbështetjen e UNICEF-it, organizoi veprimtarinë promovuese lidhur me prezantimin e raportit të veçantë "Vlerësimi i Ndikimit të të Drejtave të Fëmijëve (CRIA-Covid-19)".

✓ Në datën 23 dhjetor 2022, në bashkëpunim me organizatën "Të Ndryshëm & Të Barabartë", institucioni i Avokatit të Popullit organizoi tryezën e rrumbullakët "Përfshirja e të Mbijetuarve të Dhunës Seksuale dhe Trafikimit në Përmirësimin e Sistemit të Drejtësisë". Kjo është një qasje e re pune në kuadër të fuqizimit të bashkëpunimit të institucionit të Avokatit të Popullit me shoqërinë civile duke bërë të mundur për herë të parë ngritjen e Panelit Këshillimor të të Mbijetuarve të Dhunës Seksuale pranë institucionit tonë.

Deklarata promovuese dhe ndërgjegjësuese

✓ Publikim nga Avokati i Popullit i deklaratës së përbashkët të ENOC-ut të titulluar: "Thirrje për veprime të menjëhershme për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Ukrainë" në datën 3.03.2022.

✓ Deklaratë e Avokatit të Popullit, në datën 4.11.2022, lidhur me dhunën dhe ngacmimin në shkollë, duke përfshirë bullizmin kibernetik, i cili është i përhapur dhe prek një numër të konsiderueshëm fëmijët dhe adoleshentët. Avokati i Popullit u ka bërë thirrje nxënësve, prindërve, autoriteteve arsimore partnerëve, dhe aktorëve të përfshirë në sektorët e industrisë e teknologjisë, për t'i inkurajuar të gjithë që të marrin pjesë në parandalimin e dhunës në internet për sigurinë dhe mirëqenien e fëmijëve dhe të rinjve.

✓ Deklaratë e Avokatit të Popullit, pas transmetimit në median vizive të lajmit për ushtrimin e dhunës ndaj të tre fëmijëve të mitur në një institucion publik rezidencial për fëmijët pa kujdes prindëror, lidhur me të drejtën e çdo fëmije për jetë, mbijetesë dhe zhvillim në shkallën më të lartë të mundshme.

✓ Deklaratë ndërgjegjësuese e Seksionit të Mbrojtjes dhe Promovimit të të drejtave të Fëmijëve/Avokati i Popullit, në datën 20.05.2022, në ditën kombëtare të jetimëve, për respektimin e dinjitetit të çdo fëmije, veçanërisht fëmijëve jetimë.

Të gjitha veprimtaritë e zhvilluara me karakter informues, ndërgjegjësues, dhe promovuese janë të pasqyruara edhe në faqen zyrtare të rrjetit social *Facebook* të institucionit të Avokatit të Popullit /Seksioni i Fëmijëve, nëpërmjet të cilës institucioni përcjell mesazhin për respektimin e dinjitetit, integritetit dhe realizimit të të drejtave të femijeve, si dhe reagon për rastet kur këto të drejta cenohen.

3.15 Respektimi i të drejtës për kujdes shëndetësor[116]

E drejta e shëndetit është afirmuar në nivel ndërkombëtar me Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, neni 25, që në vitin 1948. Në të, mes të tjerash, thuhet se "*Çdo njeri ka të drejtë për një standard jete të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqenien e tij dhe të familjes së tij*.

Preambula e kushtetutës së Organizatës Botërore të Shëndetësisë gjithashtu konfirmon se është e drejtë themelore e çdo njeriu të gëzojë standartet më të larta të arritshme të shëndetit. E pandarë nga e drejta e shëndetit është e drejta e kushteve themelore të shëndetit dhe të kujdesit shëndetësor. Të drejtat e njeriut janë të ndërvarura, të pandashme dhe të ndërthurura. Kjo do të thotë se shkelja e të drejtës së shëndetit shpesh, mund të pengojë gëzimin e të drejtave të tjera të njeriut si të drejtën për arsim, të drejtën për punë ose anasjelltas.

Ndërmjet të drejtave kryesore të shtetasve të sanksionuar në Kushtetutë dhe në konventa ndërkombëtare të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë është e drejta për të gëzuar nga shteti, në mënyrë të barabartë, të drejtën për kujdes shëndetësor, si dhe sigurim shëndetësor, sipas procedurës së caktuar në ligj.

Kushtetuta përcakton, gjithashtu, se një nga objektivat socialë të shtetit është që, nëpërmjet ushtrimit të kompetencave kushtetuese si dhe nëpërmjet zhvillimit të iniciativës private, të mundësojë standardin më të lartë shëndetësor, fizik e mendor të mundshëm për shtetasit e vet. Një sistem shëndetësor duhet të jetë i dizenjuar për të adresuar nevojat e ndryshme të popullatës në mënyrë të drejtë, efikase dhe të përgjegjshme.

Qëllimi kryesor për të arritur një akses të barabartë në kujdesin shëndetësor të të gjitha grupeve shoqërore, është për të reduktuar, ose të paktën jo për të thelluar më tej, pabarazitë shëndetësore ekzistuese. Faktet tregojnë se njerëzit në grupet më vulnerabël të popullsisë, kanë më shumë nevojë për kujdesin shëndetësor, p.sh. ata që kanë përqindje të larta të sëmundshmërisë dhe shëndet të keq, të cilët nuk marrin gjithmonë atë kujdes shëndetësor për të cilin kanë nevojë. Pabarazia është e pranishme pothuajse kudo dhe mund të shpjegohet me një sërë pengesash gjeografike, financiare dhe social-kulturore. Barra e pagesës për kujdesin shëndetësor, është një shqetësim në rritje për njerëzit vulnerabël, si nga ana shoqërore, ashtu dhe ekonomike.

Avokati i Popullit vlerëson se parimi mbi të cilin duhet të mbështet funksionimi i kujdesit shëndetësor është cilësia e shërbimit dhe efiçenca duke garantuar sigurinë e pacientit dhe pa anësinë. Në këtë mënyrë zbatohet një tjeter standard ndërkombëtar që e ka fillesën që në Deklaratën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, si dhe ka konfirmuar objektivin social kushtetues sipas të cilit shteti synon standartin më të lartë shëndetësor, fizik e mendor, të mundshëm.[117]

---

[116] Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Përgjithshëm në institucionin e Avokatit të Popullit.

[117] Deklarata Ndërkombëtare e të drejtave te njeriut, neni 25: "Gjithkush ka të drejtë për një nivel jetese të mjaftueshëm i cili t'i përgjigjet shëndetit dhe jetës së përshtatshme si tëatij personalisht , ashtu edhe të familjes së tij, duke përfshirë ushqimin, veshmbathjen, banesën, kujdesin mjeksor dhe shërbimet e nevojshme sociale, si dhe të drejtën për të qenë i siguruar në rast sëmundjeje, papunësie, vejanie, pleqërie dhe raste të tjera të humbjeve të mjeteve për jetesë për shkak të rrethanave

Referuar ankesave të regjistruara nga institucioni i Avokatit të Popullit për vitin 2022, rezulton të jenë regjistruar *41 ankesa*, nga të cilat 21 rezultojnë të jenë raste të bazuara në investigimet "*ex-offico",* si pasojë e implementimit me sukses të mekanizmit të monitorimit mbi bazë ditore dhe konstatimit të problematikave të bëra publike në mediat tradicionale dhe ato online, përmes grupeve të punës të ngritura posaçërisht. Nga numri total i ankesave të shqyrtuara, rezulton se për *34 ankesa* është përmbyllur shqyrtimi, ndërsa të tjerat vijojnë ende të jenë në proces hetimi administrativ. Në numrin e ankesave apo rasteve me inisitivë të shqyrtuara, *25* prej tyre rezultojnë të jenë zgjidhur në favor të qytetarëve dhe problematikave të parashtruara nga ata në objektin e ankesës apo inisiativës tonë.

Ankesat/rastet me inisiativë evidentuan ekzistencën e problematikave kryesore të tilla si: (i) trajtimi mjekësor jo konform standardeve për shumë sëmundshmëri të ndryshme, (ii) burokracira lidhur me rradhët e pritjes në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza"(QSUT), (iii) mungesa e ofrimit të shërbimeve shëndetësore në shumë Spitale rajonale, qendra shëndetësore në vend për shkak të mungesës së mjekëve, amortizimit dhe mosfunksionimit të godinave të emërtuara si qendra shëndetësore, si dhe (iv) mungesa e personelit të mesëm infermieror, si dhe mjekëve specialist e thelluar kjo vit pas viti.

Referuar rasteve specifike të shqyrtuara nga institucioni i Avokatit të Popullit, për të cilat hetimi administrativ është përmbyllur me hartimin e rekomandimit përkatës, evidentojmë rekomandimin adresuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale **("MSHMS"), si më poshtë:**

Në referim të Udhëzimit nr.415, datë 27.09.2021"*Për mënyrën e kryerjes së testit të antigenit nga laboratorët jopublikë të njohur nga MSHMS për kryerjen e testimeve molekulare RT-PCR për SARS-COV-2 për nevoja administrative, raportimit të të dhënave nga laboratorët publik dhe jopublik në sistemin elektronik E-VIZITA të testimeve molekulare RT-PCR për SARS-COV-2 dhe testit të antigenit*", mbetet e paqartë nëse numri i shtetasve të infektuar me COVID-19, që diagnostikohen të tillë pas testeve të shpejta, pasqyrohet ose jo në numrin e përgjithshëm të të infektuarve në rang vendi, duke krijuar kështu konfuzion në të dhënat e raportuara. Udhëzimi nr.415, datë 27.09.2021 nuk përmban parashikime për mënyrën e veprimit në rastet e testeve të shpejta.

Sjellim në vëmendje se nuk është pacienti ai që zgjedh se çfarë lloj testi do të bëjë, por është mjeku i familjes që në rast të dyshimeve për infektim me virusin COVID-19, i rekomandon pacientit kryerjen e testit të shpejtë (dhe jo PCR). Në sistemin e-Albania hidhen të dhënat e personave të infektuar vetëm në rastet e testeve PCR, por jo për testet e shpejta. Në këtë kushte, Avokati i Popullit rekomandoi:

✓ *Marrjen e masave të menjëherëshme për përfshirjen në Udhëzimin nr. 415, datë 27.09.2021, edhe të dispozitave në lidhje me procedurën që duhet ndjekur në rastet e veprimeve*

---

të pavarura nga vullneti i tij. Nëna dhe fëmijët kanë nevojë për kujdes dhe ndihmë të posacme. Të gjithë fëmijët, të lindur brenda ose jashtë martese, gëzojnë të njëjtat mbrojtje sociale."

të kryerjes së testeve të shpejta, për qytetarët dhe hedhjes së të dhënave të tyre në sistemin E-Vizita.

Për këtë rekomandim nuk kemi marrë asnjë pergjigje.

Një tjetër rekomandim, që vlerësojmë se duhet sjellë në vemendje është edhe ai adresuar Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor, me objekt mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit, në zbatim të dispozitave që ndalojnë duhanpirjen në mjedise të caktuara.

Sipas të dhënave të publikuara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë,[118]epidemia e duhanit është një nga kërcënimet më të mëdha të shëndetit publik me të cilat është përballur ndonjëherë bota, duke vrarë më shumë se 8 milionë njerëz në vit, duke përfshirë rreth 1.2 milionë vdekje nga ekspozimi ndaj tymit të dorës së dytë (SHS[119]).Të drejtat e njeriut mund të jenë 'pozitive' ose 'negative'[120].

Ekspozimi ndaj tymit të dorës së dytë mund të interpretohet si shkelje e të drejtave negative të një joduhanpirësi. Një nga efektet më të zakonshme të këtij ekspozimi janë komplikacionet shëndetësore. Për më tepër, mosparandalimi i ekspozimit të fëmijëve ndaj SHS ndikon në të drejtat e tyre themelore për jetë dhe shëndet, dhe të drejtën e tyre për 'një mjedis të pastër dhe të sigurt'. Në këtë kushte, Avokati i Popullit rekomandoi:

- ✓ *Intensifikimin e veprimtarisë administrative për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit në zbatim të dispozitave që ndalojnë duhanpirjen në mjedise të caktuara;*
- ✓ *Vlerësimin e efektivitetit të metodologjisë së inspektimit/monitorimit në zbatim të neneve 15 e 19 të ligjit nr. 9636, datë 6.11.2006, "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit";*
- ✓ *Vlerësimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore të trupave inspektuese përfshirë dhe masat e nevojshme për rritjen e këtyre kapaciteteve.*

Për këtë rekomandim nuk kemi marrë asnjë pergjigje.

Gjithashtu institucioni i Avokatit të Popullit ka trajtuar edhe ankesën e adresuar nga shtetasi F.S, ankesë që përfaqësonte problematikën edhe të shumë studentëve të tjerë të cilët kanë përfunduar studimet bachelor për Kimi, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe më pas Masterin Profesional për "Teknik i Lartë Laboratori". Për të punuar si Teknik i Lartë Laboratori, studenti duhet të pajiset me liçensën përkatëse nga Urdhri i Infermierëve të Shqipërisë (UISH) pas dhënies së provimit për marrjen e saj, e më pas të ushtrojnë profesionin e teknikut të laboratorit.

Urdhri i Infermierëve të Shqipërisë njofton studentin se për të dhenë provimin për marrjen e licences, ky i fundit duhet të ketë përfunduar studimet "Bachelor" për teknik të lartë laboratori.

---

[118] https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/tobacco.

[119] Ekspozimi ndaj tymit të dorës së dytë ndodh kur njerëzit që nuk pinë duhan thithin tymin e nxjerrë nga njerëzit që pinë duhan ose nga djegia e produkteve të duhanit.

[120] Të drejtat pozitive janë ato të drejta që individi i ushtron lirisht në mënyrë proaktive teksa të drejtat negative janë ato të drejta që individi i gëzon nga mosveprimet e palëve të treta që do të cënonin këto të drejta.

Theksojmë se shume stundentë të cilët kanë përfunduar studimet në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, pranohen në Fakultetin e Shkencave Mjeksore Teknike, për të bërë masterin profesional për "Teknik i Lartë Laboratori", pa u informuar mbi mundësinë e një ndalese ligjore.

Përjashtimi studentëve nga e drejta e dhënies së provimit të liçensës për ushtrimin e profesionit si teknik i lartë, rezulton të jetë e pabazuar shprehimisht në ligj, duke rezultuar në kosto morale dhe financiare për këta studentë. Në përfundim të hetimit Avokati i Popullit i rekomandoi Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si dhe Urdhrit të Infermierit të Shqipërisë:

✓ *Marrjen e masave të menjëherëshme për lejimin e studentes F. S.si dhe të gjithë studentëve me të njëjtën problematikë për të dhënë provimin e liçensës dhe për tu pajisur rregullisht me liçensë si teknik laboratori.*

Për këtë rekomandim nuk kemi marrë asnjë pergjigje.

Institucioni i Avokatit të Popullit, gjatë vitit 2022, ka kryer inspektim në mjediset e Spitalit Rajonal, Korçë, i cili u përmbyll me hartimin e rekomandimeve përkatëse, adresuar pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Spitalit Rajonal, Korçë për:

✓ *Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e nevojave me personel të Spitalit Korçë, specifikisht me 16 mjek specialistë që mungojnë në organikën e këtij spitali. Konkretisht 3 mjekë urgjence, 1 infeksionist , 2 kardiologë, 4 mjekë kirurg, 1 ortoped, 1 anestezi reanimator, 1 mjek obsetër-gjinekolog, 1 neonatolog, 1 pneumolog, 1 hematolog, 1 otorinolaringolog, 1 onkolog, 1 imazherist ,1 pediatër;*
✓ *Marrjen e masave për ngritjen e Pavionit të Hemodinamikës, si pavioni më i rëndësishëm dhe i veçantë për trajtimin e pacientëve me sëmundje kardiovaskulare, për të gjithë Qarkun e Korçës;*
✓ *Marrjen e masave dhe plotësimin e nevojave për investime dhe rikonstuksione të godinave të Spitalit Korçë. (Përveç maternitetit).*

Për këtë rekomandim nuk kemi marrë asnjë pergjigje.

Institucioni i Avokatit të Popullit, vlerëson të gjitha përpjekjet e MSHMS për ndërtimin e qendrave të reja shëndetësore, spitaleve rajonale dhe investimeve në QSUT në pajisje moderne mjeksore. Megjithatë, Avokati i Popullit thekson se mekanizmat e përgjegjësisë janë thelbësore për të siguruar se janë respektuar detyrimet e shtetit që rrjedhin nga zbatimi i të drejtës së shëndetit. Monitorimi nëpërmjet mekanizmave administrative, politike, mekanizmave institucional përfshin një sërë aktorësh siç është vetë shteti, OJQ-të, institucionet kombëtare kushtetuese dhe jo vetëm duhet të forcohet dhe intensifikohet në shërbim të respektimit të së drejtës për një shërbim shëndetësor dinjitoz dhe cilësor.

3.16 Respektimi i të drejtës për arsimim[121]

Arsimimi është një e drejtë njerëzore themelore dhe thelbësore për ushtrimin e të gjitha të drejtave të njeriut. Ai promovon lirinë individuale dhe fuqizimin, dhe prodhon përfitime të rëndësishme zhvillimore. Instrumentet normative të Kombeve të Bashkuara dhe UNESCO-s përcaktojnë detyrimet ligjore ndërkombëtare për të drejtën për arsim. Këto instrumente promovojnë dhe zhvillojnë të drejtën e çdo individi të gëzojë akses te arsimi i një cilësie të mirë, pa diskriminim ose përjashtim.

Duke ndjekur qëllimet kombëtare dhe reformat strategjike të lidhura me përmirësimin e paanësisë, barazisë, gjithëpërfshirjes dhe cilësisë dhe duke nxitur mundësitë për të mësuarit gjatë të gjithë jetës për të gjithë[122], Shqipëria po hap rrugën për reforma afatgjata të sistemit të arsimit në rrugën e saj drejt integrimit në BE dhe për një përputhje më të madhe me axhendën ndërkombëtare të arsimit, Objektivin 4 të Axhendës për Zhvillim të Qëndrueshëm Arsimi 2030.[123]

E njëjta qasje evidentohet edhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e cila e ka përfshirë atë si të drejtë kushtetuese në kreun e lirive dhe të drejtave ekonomike e social-kulturore. E drejta kushtetuese për t`u arsimuar shihet si e drejtë detyrë, ku në njërën anë të gjithë gëzojnë mundësinë për t`u arsimuar, e në anën tjetër parashikohen disa detyrime për ta jetësuar këtë të drejtë, detyrime të cilat bien mbi shtetin, prindërit por dhe vetë fëmijët.

E parë në këndvështrimin e aksesit në arsimin e lartë, Shqipëria vëren përparime të herë pas hershme, edhe pse diskriminimet e dikurshme edhe ligjore që ekzistonin nuk evidentohen, një sërë diskriminimesh më të fshehura por po aq problematike vijojnë të shfaqen.

Studentët potencialë nga komunitetet e margjinalizuara, personat me aftësi të kufizuara si dhe ato që vijnë nga grupe social-ekonomike të varfra e të izoluara përballen me pengesa të qenësishme për të pasur akses në arsimin e lartë. Vënia në zbatim e politikave specifike për të adresuar vështirësitë e tyre mbetet domosdoshmëri dhe detyrim, megjithë vështirësitë financiare, si një hap i rëndësishme në rrugën e konsolidimit dhe zgjerimit të aksesit në arsimin e lartë në Shqipëri.
Avokati i Popullit vlerëson se sfidat më të spikatura me të cilat ndeshet arsimi i lartë në Shqipëri mbetet (i) cilësia me të cilën studentët pranohen në universitet, (ii) mungesa e bazës materiale dhe shkencore që shkollat e larta ofrojnë për këta studentë, si edhe (iii) mungesa e bazës shkencore për pedagogët.

Arsimi i lartë dhe reforma arsimore universitare ka qenë dhe mbetet një nga temat më të rëndësishme publike në vend. Reforma e Arsimit të Lartë është adresuar në një sërë tryezash dhe debatesh publike përgjatë viteve, të cilave iu shtuan dhe protestat studentore të herëpas herëshme. Prej vitit 1990 ligjet e miratuara kanë synuar reformimin e sistemit universitar, por përvoja tregon se ky reformim mund të ketë zgjidhur problemet afatshkurtra por nuk ka pasur vizion për një

[121] Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Përgjithshëm në institucionin e Avokatit të Popullit.
[122] Kombet e Bashkuara (2015). Të transformojmë botën tonë: Axhenda për Zhvillimin e Qëndrueshëm 2030. Marrë nga https://sustainabledevelopment.un.org/post2015/transformingourworld/publication e aksesueshme në dhjetor 2015.
[123] Arsimi 2030, axhenda e re ndërkombëtare për arsimin, është njëri nga 17 objektivat e OZHQ-ve.

legjislacion të qëndrueshëm. Megjithëse prej vitit 1990 arsimi i lartë ka pasur 3 reforma të thella, kuadri ligjor nuk e ka nxitur në masën e duhur reformimin e brendshëm të jetës universitare duke përfshirë kurrikulat, kërkimin shkencor dhe rolin e studentit brenda jetës universitare.[124]

Arsimi përveç se është një e drejtë themelore, për çdo njeri është edhe faktori kryesor për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të çdo kombi. Ndryshimet që po ndodhin sot në botë nga njëra anë fatkeqësitë natyrore, pandemia, kriza ekonomike, luftëra, ndryshimet klimatike e nga ana tjetër zhvillimet e vrullshme të teknologjisë, digjitalizimi, dhe nevojat e tregut të punës për profesione të reja, sjellin nevojën për një vizion të ri arsimor.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka monitoruar përgjatë vitit 2022 e në vijim, problematikat sa i përket të drejtës për arsim, të bëra prezent, qoftë nëpërmjet ankesave të ndryshme të adresuara pranë Institucionit, por edhe ato të evidentuara në rastet e bëra publike në median e shkruar dhe online.

Referuar ankesave të regjistruara nga institucioni i Avokatit të Popullit për vitin 2022, rezulton të jenë regjistruar *54 ankesa*, nga të cilat 14 rezultojnë të jenë raste të bazuara në investigimet "*ex-offico",* si pasojë e implementimit me sukses të mekanizmit të monitorimit mbi bazë ditore dhe konstatimit të problematikave të bëra publike në mediat dhe ato online, përmes grupeve të punës të ngritura posaçërisht përgjatë vitit 2022.

Nga numri total i ankesave të shqyrtuara, rezulton se për *48 ankesa* është përmbyllur shqyrtimi, ndërsa të tjerat vijojnë ende të jenë në proces hetimi administrativ. Në numrin e ankesave apo rasteve me inisiativë të shqyrtuara, *reth 40* prej tyre rezultojnë të jenë zgjidhur në favor të qytetarëve dhe problematikave të parashtruara nga ata në objektin e ankesës, apo inisiativës tonë.

Problematikë serioze, e trashëguar edhe nga viti pararendës, dhe e evidentuar në një pjesë të konsiderueshme të ankesave idividuale të depozituara pranë institucionit tonë, vijon të jetë punësimi jo mbi bazë meritokracie e arsimtarëve, moszbatimi i procedurave për largimet nga puna të mësuesve si dhe vonesat në marrjen e kuotës financiare të mësuesve që punojnë larg vendbanimit të tyre, për shkak të burokracive të procedurave të tenderimit.

Gjithashtu vërehet se fenomeni i largimit të të rinjve nga Shqipëria po kthehet në një trend shumë shqetësues. Largimi i të rinjve është një realitet që po ndodh, jo vetëm për shkak të politikave liberale të punësimit të ndjekur nga shtete të tjera, por dhe se të rinjtë shqiptarë vendosin të largohen nga Shqipëria edhe nga pamundësia e arsimimit dhe punësimit të denjë në vendin e tyre.

Në fokus të veçantë të punës së Institucionit janë vënë edhe pretendimet e shumta në numër të studentëve të cilët për shkak të rritjes së çmimeve u përballën me kosto të larta financiare qoftë për jetën studentore ashtu edhe për pagesat e tarifave të shkollimit.

[124] https://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/18537.pdf.

Vijon të raportohet, edhe përgjatë vitit 2022, si problematik, procesi i akordimit të bursave të studentëve, të parashtruar në ankesat individuale të depozituara pranë institucionit të Avokatit të Popullit, ankesa të cilat janë adresuar për zgjidhje në administratat e Rektoratit, Universiteteve dhe Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Në kuadër të detyrave të lëna nga Kuvendi i Shqipërisë në Rezolutën e tij, institucioni i Avokatit të Popullit ka zhvilluar përgjatë vitit 2022 takime në Universitetin e Gjirokastrës dhe Korçës për të qënë sa më pranë studentëve dhe për të diskutuar më ta problematikat e ndryshme lidhur me jetën studentore dhe bërjen me dije të kompetencave dhe rolit të AP-së në mbështetje të të drejtave të tyre. Në këto takime me student e staf akademik u morën mjaft ankesa të cilat u adresuan rast pas rasti për zgjidhje pranë organeve përkatëse.

Referuar rasteve më specifike të shqyrtuara nga institucioni i Avokatit të Popullit për të cilat hetimi administrativ është përmbyllur me hartimin e rekomandimit përkatës, për vitin 2022, do specifikonim rekomandimin drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ("MAS") mbi rastin e mësueses E.G., mësuese që prej vitit 1990 pranë shkollës 9-vjeçare "Avni Rustemi", në Tiranë. Kjo shtetase pretendonte se për shkak të përballjes me një situatë të kundërligjshme, absurde, fyese dhe denigruese në këtë shkollë, e organizuar nga drejtoresha e shkollës, ka adresuar problematika ligjore por edhe morale që veprojnë në këtë institucion arsimor. Institucioni i Avokatit të Popullit rekomandoi:

✓ *Shfuqizimin e aktit administrativ konkretisht të Vendimit të shkollës 9-vjeçare "Avni Rustemi", "Për zgjidhjen e menjëherëshme të kontratës së Punës" për znj.E. G.*

Ky rekomandim nuk u pranua.

Një problematikë e cila vlen të evidentohet, pasi ka marrë trajtën e një problematike përfaqësuese për maturantët, e trajtuar dhe përmbyllur me *rekomandim të pranuar* dhe të konsideruar si rast suksesi nga institucioni ynë, është edhe ankesa e znj. G.Q, avokate në profesion, në përmbajtjen e së cilës ajo parashtroi shqetësimin sa i përket një padrejtësie me të cilën po ballafaqohen maturantët ndër vite. Ministria e Arsimit dhe Sportit ("MAS"), në cilësinë e organit kompetent miraton Rregulloren për Zhvillimin e Maturës Shtetërore, rregullore në të cilën është e parashikuar shprehimisht ndalimi i rivlerësimit të testit të maturantëve (të drejtën e ankimimit). Për këtë rast, institucioni i Avokatit të Popullit rekomandoi:

✓ *Marrjen e masave të menjëhershme për ndryshimin e pikës 11 të nenit 26, të Rregullores "Për Zhvillimin e Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë", miratuar me Urdhrin nr.108, dt.04.03.2022, e cila ndalon të drejtën e ankimit;*

✓ *Garantimin e së drejtës efektive të ankimit për rezultatet e testimit dhe për informimin e maturantëve në lidhje me këtë çështje.*

Avokati i Popullit vlerëson *pranimin dhe zbatimin e këtij Rekomandimi* pasi në Rregulloren e maturës shtetërore 2022-2023 "E drejta e ankimimit", u përfshi në nenin 27 të saj.

Një problematikë tjetër e trajtuar nga institucioni i Avokatit të Popullit ishte ajo e moszbatimit të ligjit nr. 79/2017 "Për Sportin", i ndryshuar, nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, për shpërblimin

dhe trajtimin e sportistëve elitarë që kanë arritur rezultate të larta në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar nëpërmjet marrjes së medaljeve nga Kampionati Botëror. Për këtë rast, institucioni i Avokatit të Popullit rekomandoi:

✓ *Marrjen e masave të menjëhershme për vijimin e proçedurës për njohjen e të drejtës dhe shpërblimin e z. M.M në përputhje me nenin 27 të ligjit nr. 79/2017 "Për Sportin", i ndryshuar, dhe VKM-në nr. 687, datë 14.11.2018 "Për kriteret, mënyrën e shpërblimit dhe përfitimin e trajtimit për përgatitjen sportive të sportistëve, që përfitojnë statusin e nivelit të lartë".*
Ky rekomandim nuk u pranua.

Në vijimësi vlen të përmendim edhe ankesën e shtetasti V.R, në lidhje me vendimmarrjen e Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA), për njësimin e diplomës së tij. Ai është diplomuar në "State College", në kampusin e Athinës, në vitin 2009. Në vitin 2017, ankuesi shprehet se ka aplikuar për njësimin e diplomës, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe diploma e studimeve të larta, e përfituar jashtë vendit, i është njësuar në nivelin "Bachelor", nga ana e kësaj ministrie.

Në muajin Mars 2021, pasi është vënë në dijeni të ndryshimit të bazës ligjore për njësimin e diplomës, dhe njëkohësisht, bazuar edhe në njësime të kryera ndërkohë nga kolegë të tjerë në të njëjtin nivel studimesh me të, ai i është ridrejtuar QSHA-së, duke i kërkuar nxjerrjen e një vendimi të ri për njësimin e diplomës së tij, sepse ai gjykonte se i ishte njësuar gabim. Më konkretisht ankuesi ka kërkuar këtë herë që diploma e tij të njësohej si "Master Shkencor". Lidhur me këtë problematikë, institucioni i Avokatit të Popullit rekomandoi:
✓ *Rivlerësimin e duhur dhe trajtimin e drejtë e në përputhje me ligjin të objektit të kërkesës së shtetasit V.R, të datës 17.08.2021, drejtuar Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (protokolluar pranë kësaj ministrie, me nr.3981/1 prot., datë 18.08.2021), sipas përcaktimit dhe kuptimit të neneve 113 deri 118, të Kodit të Procedurave Administrative;*
✓ *Mospërsëritjen e kësaj praktike të kryer në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, në të ardhmen, gjatë veprimtarisë së Komisionit të Njohjes së Diplomave, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.*
Ky rekomandim nuk u pranua.

Në funksion të mandatit të tij të promovues, institucioni i Avokatit të Popullit, ka vijuar dhe konsoliduar bashkëpunimin me Organizatat e Shoqërisë Civile që zhvillojnë veprimtarinë e tyre në fushën e së drejtës për arsim, përmes pjesëmarrjes aktive në shumë aktivitete online, ashtu edhe në shumë tryeza e takime, në të cilat janë bërë prezente studime, raporte dhe monitorime në institucione arsimore.

Institucioni i Avokatit të Popullit duke vlerësuar përpjekjet e shtetit shqiptar për rritje të pagave të mësuesve dhe pegagogëve, vlerëson se mbetet ende sfidë mbështeja financiare për motivimin e mëtejshëm të tyre. Përmes angazhimit të efektshëm me mekanizma për zhvillim, Shqipëria duhet të jetë e përgatitur të sigurojë arsim cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë me vendet e zhvilluara me përfitime më të mëdha për nxënësit dhe studentët në tërësi.

3.17 Respektimi i të drejtës për kujdes social[125]

Programi që shënjestron varfërinë është Ndihma Ekonomike (NE) përkufizuar në ligjin nr.57/2019 si "*pagesa që u jepet individëve dhe familjeve vulnerabël të përcaktuara në ligj*". Ndihma ekonomike përbën mbështetjen në para që u jepet një herë në muaj nga shteti familjeve dhe individëve në nevojë, si dhe kategorive në nevojë të përcaktuara si të tilla në legjislacionin që rregullon asistencën sociale.

Masa e ndihmës ekonomike përcaktohet me Vendim të Këshillit të Ministrave.[126]Ajo reflekton strukturën e familjes dhe skema e saj bazohet në një vlerësim të testimit të mjeteve dhe burimeve dhe familjet mund të jenë përfitues edhe nëse kanë disa burime të ardhurash. Pjesë e asistencës sociale janë dhe përfitimet e aftësisë së kufizuar, transfertat "cash" që adresojnë personat me aftësi të kufizuara dhe, në rastet e paaftësisë së plotë, kujdestarët e tyre si dhe familjet në nevojë etj.

Sfidë e reformës për ndihmën ekonomike, vijon të mbetet (i) masa e ulët e saj, nxjerrja nga skema të familjeve në rrezik të varfërisë, (ii) mos mbulimi i të gjitha kategorive vunerabël, përfituese të ndihmnës ekonomike dhe (iii) mangësia e akteve nënligjore që përcaktojnë masën e minimumit jetik dhe përshtatjen e kësaj mase në planin kohor, si një normë kufizuese për mbrojtjen e burimit të të ardhurave të qytetarëve.[127]

Referuar rasteve të trajtuara nga institucioni i Avokatit të Popullit, jo vetëm ankesa por dhe raste me iniciativë, të cilat burimin e kishin nga publikimi në mediat vizive, të shkruara, por edhe online, për vitin 2022, rezulton të jenë trajtuar gjithsej *37 raste*, të cilat evidentuan ekzistencën e problematikave kryesore, të tilla si: mospërfitimi i ndihmës ekonomike, pezullimi dhe ndërprerja e përfitimit të ndihmës ekonomike, si dhe paqartësia e qytetarëve për arsyet e mospërfitimit apo mospërfshirjes së tyre në skemën e përfitimit të ndihmës ekonomike, në disa raste të ndërthurura me çështjet e strehimit social apo të pagesave paralele.

Trajtimi i këtyre ankesave dhe/ose rasteve me iniciativë me organet e administratës vendore ka përfshirë hetimin administrative të kryer nga institucioni, i cili është përmbyllur me zgjidhjen e tyre në favor të qytetarëve (54% e rasteve) dhe/ose sqarimin e ankuesve lidhur me shkaqet ligjore të ndërprerjes apo të mospërfitimit të ndihmës së kërkuar, shoqëruar me sugjerimet përkatëse mbi periudhën e riaplikimit.

Sjellim në vëmendje se rezultati i Indeksit të Raportit të Zhvillimit të Qëndrueshëm 2021, sugjeron se Shqipëria është në më shumë se dy të tretat e rrugëtimit të saj drejt arritjes së statusit të rangut më të lartë të përmbushjes së 17 objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, me një pozicion të 64-të nga 165 vende. Pavarësisht këtij progresi, varfëria[128] mbetet e lartë, mbi 23.3

---

[125] Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Përgjithshëm në institucionin e Avokatit të Popullit.

[126] Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 597/2019.

[127] https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Minimumi%20jetik%20ok.pdf.

[128] Varfëria përkufizohet si një person që jeton me më pak se 5.5 dollarë amerikanë në ditë bazuar në fuqinë blerëse të rishikuar të vitit 2011 (PPP). Në maj 2020, PPP 2011 ky vlerësim u rishikua duke rezultuar në 5,5 dollarë amerikanë në ditë. Ky rishikim pasqyron një rivlerësim të krahasimeve të kostos së jetesës midis vendeve, por nuk nënkupton një ndryshim real të varfërisë brenda vendeve (https://openknowledge.worldbank.org/bitstream/ handle/10986/33623/9781464815300.pdf),

%.[129] Sipas INSTAT (AANJ 2020) vlerësohet se niveli i përjashtimit social në Shqipëri, pra i individëve në rrezik varfërie, ose thellësisht të privuar materialisht, ose me intensitet shumë të ulët në punësim, është rreth 46.2% e popullsisë, ndërsa rritja ekonomike për periudhën afatmesme 2022-2024 parashikohet e moderuar në nivelet nga 4.1 në 3.9%. Kjo do të thotë se pothuajse gjysma e popullsisë jetojnë në kushte shumë të vështira ekonomike.

Në këtë kontekst, nisur edhe nga ankesat e paraqitura pranë institucionit të Avokatit të Popullit dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi u ndërmor iniciativa e hartimit të një Raporti të Veçantë "*Vlerësim mbi qasjen dhe përdorimin familjar të transfertave të mbrojtjes sociale"*[130], i cili u mbështet me ekspertizë teknike në kuadrin e projektit "Shtrirja e shërbimit ligjor për burrat dhe gratë në Shqipëri", zbatuar nga PNUD Shqipëri në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe me mbështetjen financiare të Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim.

Hartimi i këtij raporti synoi vlerësimin e zbatimit në praktikë të legjislacionit dhe programit të ndihmës ekonomike me qëllim identifikimin e pengesave që cenojnë aksesin e familjeve në nevojë dhe individët me status të veçantë si dhe përdorimin e transfertave të ndihmës ekonomike. Vlerësimi synon të shërbejë për të nxitur përmirësimin e cilësisë dhe efektivitetin e mbrojtjes sociale, duke theksuar nevojën për rritjen e kapaciteteve të strukturave përgjegjëse të administratës për zbatimin dhe vlerësimin periodik të politikave sociale në zbatim.[131]
Viti 2022 u karakterizua nga një rritje e vazhdueshme e inflacionit në Shqipëri për shkak të ekspozimit të ekonomisë shqiptare ndaj asaj Europiane drejt rritjes së kostos së jetesës duke përkeqësuar vulnerabilitetin e shtresave në nevojë.

Qeveria shqiptare, në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 dhe Dokumentin Politik për Përfshirjen Sociale 2016-2020[132], në muajin Mars të 2022, nëpërmjet rishikimit të buxhetit me synimin kryesor mbështetjen buxhetore për sektorin e energjisë, realizoi financimin e një fondi kontigjencë për paketën e rezistencës sociale ndaj pasojave të krizës (paketa e pare e rezistencës), me afat tremujor. Me përkeqësimin e treguesve të inflacionit në muajt në vazhdim[133], Qeveria Shqiptare prezantoi paketën e dytë të rezistencës sociale me qëllim indeksimin e pensioneve, pagave dhe rritjen e ndihmës ekonomike, në Shtator 2022.

Duke analizuar me kujdes këto masa, ndonëse vërehen ndryshime pozitive dhe konkrete për përballimin e krizës, duke ju referuar analizës dhe gjetjeve të raportit "*Vlerësim mbi qasjen dhe përdorimin familjar të transfertave të mbrojtjes sociale*", sipas parashikimeve të buxhetit të vitit 2022 në të cilin qeveria parashikoi që përfitues të ndihmës ekonomike të jenë rreth 66 mijë familje, ku familjet me 4 anëtarë përbëjnë 33.8% të totalit, ndjekur nga 22.3% familjet me 5 anetarë dhe 19.1 % familjet me 3 anëtare, vërehet që paketat nuk sigurojnë mbështetje për një grup të madh individësh/ familjesh në nevojë.

---

[129] https://albania.un.org/sites/default/files/202204/UN%20Albania%20Annual%20Progress%20Report%202021.pdf.
[130] https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Vler%C3%ABsim%20mbi%20qasjen%20dhe%20perdorimin%20familjar%20te%20transfertave%20te%20MS.pdf..
[131] Më shumë informacion në lidhje me përmbajtjen e këtij raporti do të gjeni në Kreu IV "*Angazhime të tjera institucionale"*.
[132] Aktualisht është në proces konsultimi publik strategjia e re për Zhvillim dhe Integrim 2021-2030.
[133] http://www.instat.gov.al/media/10394/ick_korrik_2022.pdf; http://www.instat.gov.al/media/10394/ick_gusht_2022.pdf

Për më tepër, duke ju referuar studimit për "Transfertat e Mbrojtjes Sociale drejt Familjeve të Varfëra",[134]ku janë listuar kategoritë e shpenzimeve për familjet e varfëra, ushqimi zë pjesën më të madhe të shpenzimeve (rreth 96%) duke mos lënë hapësirë për shpenzime të tjera si komunikimi, kultura etj. Në këto kushte, rritja e masës së përfitimit të ndihmës ekonomike me 10% për të gjitha familjet, nuk mbulon rritjen e kostos reale për shkak të inflacionit.

Nga ana tjeter, nga viti 2018 deri në vitin 2022, nuk është kryer asnjë ndryshim në aktet nënligjore të nivelit të kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore, në përputhje me indeksimin e çmimeve të shportës bazë në vlerësim të ndryshimit të normave të inflacionit për çdo vit, ku kuota ushqimore e përfituesve të akomoduar në institucionet e përkujdesit social duhet të rritet mjaftueshëm aq herë sa ndryshojnë dhe këto norma.

Për sa më sipër, Avokati i Popullit në vijim të kryerjes së misionit ligjor në rolin e nxitësit të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend, i ka rekomanduar[135] Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale:

- ✓ *Marrjen e masave për rritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike, për të gjitha kategoritë që janë pjesë e skemës së ndihmës ekonomike dukë përfshirë dhe pensionin social, në vlerësim të ndryshimit të normave të inflacionit për çdo vit për grupet kryesore: ushqim, transport, me qëllim mbulimin e rritjes së çmimeve të këtyre grupeve dhe përballimin e shpenzimeve mujore më të domosdoshme që i duhen familjes, ose një individi të vetëm për të mbijetuar;*
- ✓ *Marrjen e masave për indeksimin e kuotës financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve të përfituesve të shërbimeve të përkujdesit social në vlerësim të ndryshimit të normave të inflacionit për çdo vit për grupet kryesore: ushqim, transport, me qëllim mbulimin e rritjes së çmimeve të këtyre grupeve;*
- ✓ *Marrjen e masave për përfshirjen në paketën e rezistencës sociale të studentëve që vijnë nga familjet në nevojë për t'u mundësuar jetesën normale/dinjitoze, në kushtet e krizës globale dhe asaj lokale;*
- ✓ *Marrjen e masave për vlerësimin e mundësive qe kjo paketë në terma të kohështrirjes, të jetë e disponueshme deri në përmirësimin e treguesve ekonomike dhe në kalimin e situatës se krizës;*
- ✓ *Marrjen e masave për rritjen e shenjëstrimit të familjeve të varfëra dhe ekstremisht të varfëra, për të mundësuar përftimin e tyre nga skema e ndihmës ekonomike.*

Shqipëria vijon të mbetet një ndër vendet që nuk e ka të përcaktuar ligjërisht minimumin jetik, e thënë ndryshe sa i duhen minimalisht një shqiptari për të jetuar. Institucioni i Avokatit të Popullit, duke e konsideruar si të pajustifikueshme në qasjen e tij, mungesën e përcaktimit të një minimumi jetik, i cili duhet të qëndrojë në themel të hartimit të politikave sociale që ndjek shteti për grupet në nevojë, ka përgatitur raportin e veçantë "*Për Standardin e Minimumit Jetik në Shqipëri*", (2020) i cili është i aksesueshmën në faqen zyrtare të Avokatit të Popullit.[136]

---

[134] https://www.unicef.org/albania/media/3161/file/Mapping%20Social%20Protection%20Transfers.pdf. UNICEF 2019.

[135] Rekomandimi nr. 202200966, datë 07/10/2022.

[136] https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Minimumi%20jetik%20ok.pdf. .

Minimumi jetik duhet të sigurojë jetesë dinjitoze me shërbimet bazike dhe duhet t'u mundësojë njerëzve që të marrin pjesë aktive në shoqëri, pavarësisht nga aftësia e tyre për të punuar.[137] Legjislacioni duhet të parashikojë format dhe mjetet se si duhet të aplikohet ky minimum, deri sa të mundësojë që çdo qytetar të përfitojë lehtësisht një garanci të tillë dhe të mos mjaftohet vetëm me përcaktimin e vlerës shifrore të këtij koncepti. Përllogaritja e minimumit jetik dhe masa e tij duhet të jetë bazë për masën e ndihmës ekonomike. Rritja e pagesës së ndihmës ekonomike është e nevojshme të bëhet dhe të reflektojë nevojat e individëve dhe familjeve jo vetëm për ushqim, por edhe për aktivitete të tjera të zhvillimit njerëzor. Me synimin e mospërjashtimit të kategorive që mund të përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike, kemi sugjeruar thjeshtëzimin e kategorizimit të individëve dhe familjeve dhe që minimumi jetik të përdoret në themel të hartimit të Politikave Sociale për shtresat në nevojë dhe si referencë, për të përcaktuar edhe ndihmën ekonomike dhe pagesën e papunësisë.

Avokati i Popullit vlerëson iniciativat ligjore për përmirësimin e sistemit të mbrojtjes shoqërore të Qeverisë Shqiptare, gjatë vitit 2022, si investim në ndërtimin e mekanizmave për të siguruar një sistem të mbrojtjes sociale, në kuadër të menaxhimit të situatës emergjente energjetike në shkallë të gjerë, me fokus primar akomodimin e financimit të nevojshëm për mbështetjen e sektorit energjetik, krahas mbështetjes për shtresat dhe sektorët e tjerë të impaktuar nga situata e krizës. Por, gjithsesi ndërhyrjet janë të kufizuara në kohë dhe masa e ndihmës ekonomike vijon të raportohet nga qytetarët në ankesat e tyre edhe përgjatë këtij viti, si vlerë e ulët në raport me shpenzimet mujore më të domosdoshme për të mbijetuar, e pamjaftueshme të zbusë varfërinë dhe të mundësojë integrimin social të individëve dhe familjeve në nevojë.

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se varfëria nuk është vetëm mungesë e të ardhurave, por edhe mungesë shërbimesh dhe pjesëmarrjeje në shoqëri, të cilat janë thelbësore për gëzimin e të drejtave të njeriut. Varfëria si shkak, por edhe si pasojë e shkeljeve të të drejtave të njeriut, duhet të adresohet në kontekstin e detyrimeve të shtetit për respektimin e garantimin e të drejtave të njeriut. Një qasje e bazuar në të drejtat e njeriut, do të thotë që standartet dhe parimet e të drejtave të njeriut të jenë në thelbin e planifikimit dhe politikave shtetërore.

3.18 Respektimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuar[138]

Personat me aftësi të kufizuar, si të gjithë shtetasit shqiptarë, padyshim që duhet të konsiderohen si persona të mundësive, si persona të barabartë mes të barabartëve, persona me dinjitet të lindur dhe me të drejta të patjetërsueshme. Nga ky këndvështrim, personat me aftësi të kufizuar, janë ajo pjesë e shoqërisë, e cila e ka të domosdoshme mbështetjen e vazhdueshme nga shteti, për t'iu respektuar e garantuar të drejtat dhe liritë themelore, si dhe aksesin dhe përshtatjen e arsyeshme në çdo fushë të jetës.

Referuar çështjeve të trajtuara gjatë vitit 2022, rezulton të jenë trajtuar *87 çështje (74 ankesa dhe 13 raste të marra me iniciativë)*. Është përbyllur hetimi administrativ për *76 çështje*, ndërsa 11 të

[137] Raporti sugjeron ndryshimin e ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" dhe përfshirjen si dispozitë të veçantë të përkufizimit të minimumit jetik.
[138] Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Përgjithshëm në institucionin e Avokatit të Popullit.

tjera janë ende në proces shqyrtimi. Nga numri total i çështjeve të shqyrtuara, rezultojnë *49 çështje të zgjidhura në favor të qytetarëve*.
Konstatohet se problematikat më të spikatura, të shprehura në përmbatjen e çështjeve të shqyrtuara edhe gjatë këtij viti kanë qenë të tilla si: (i) mungesa e aksesit në infrastrukturën ndërtimore të kategorisë së personave që kanë probleme në lëvizje dhe shikim, përgjithësisht në institucione publike ku ofrohen shërbime për qytetarët, (ii) mospërfitim të kompensimit financiar të transportit urban dhe interurban, (iii) ndërprerje e grupit të invaliditetit, (iv) mosmarrje përgjigje për datën e komisionimit, (v) mosdhënie të grupit të invaliditetit/ ndryshim të grupit të invaliditetit, (vi) heqja e statusit të invalidit paraplegjik/tetraplegjik dhe për pasojë mospërfitim të mbulimit të shpenzimeve për paketën higjieno-sanitare, etj.

Më specifikisht, institucioni i Avokatit të Popullit, evidenton dhe shtjellon sa më poshtë, problematikat më përfaqesuese, të cilat afektuan një numër të konsiderueshëm të personave me aftësi të kufizuar gjatë vitit 2022.

✓ *Mosratifikimi nga shteti shqiptar i Protokolli Opsional të Konventës së OKB-së "Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara".*

Komiteti Drejtues për zbatimin e Konventës së OKB-së "*Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara*", në rezolutën e datës 25.09.2019, pika 10, ka rekomanduar për Shtetin Shqiptar, ratifikimin e Protokollit Fakultativ të Konventës pa vonesë të mëtejshme.
Për hapat e ndërmarra për këtë proces, iu drejtuam Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, e cila na informon se:...*Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes sociale, do të vijojë proceset dhe do të merren masa në lidhje me Protokollin Opsional të Konventës së Kombeve të Bashkuara "Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar".*

✓ *Mosmarrje përgjigje nga ana e personave me aftësi të kufizuar për datën e komisionimit të tyre nga Komisioni Mjekësor i Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar, si strukurë kompetente për vlerësimin e tyre, me qëllim përfitimin e grupit të invaliditetit.*

Pas ndërhyrjes sonë institucionale pranë Shërbimit Social Shtetëror (SHSSH), konstatohet një sjellje e përmirësuar administrative e këtij institucioni, duke njoftuar rregullisht ankuesit për datën përkatëse të komisionimit në KMCAP-in Epror/ SHSSH-së. Për kategorinë e personave, të cilët me vendim të komisionit në KMCAP-in Epror/ SHSSH-së, rezultojnë jo përfitues të grupit të invaliditetit, është përcjellë informacioni i detajuar ligjor për të drejtën e tyre të rikomisionimit.[139]

✓ *Mospërfitim të mbulimit të shpenzimeve për paketën higjieno-sanitare.*

Referuar ankesave të trajtuara për këtë problematikë, të kategorisë së personave, të cilët janë përfitues të Statusit të Invalidit Parapelegjik dhe Tetraplegjik, kemi kryer një korrespondencë intensive me Komisionin Mjekësor për Vlerësimin e Aftësisë së Kufizuar (Niveli i Parë dhe atij Epror) pranë Shërbimit Social Shtetëror, nga ku jemi informuar se diagnoza "*paraplegji inferiore nga sëmundje neurodegjenerative pa ç'rregullime sfinkteriane*", nuk renditet e përfshihet në kriteret për të përfituar paketën higjieno-sanitare, duke informuar se kjo kategori ka të drejtë të

[139] Rregullore ''*Për Organizimin, të Drejtat, detyrat dhe Funksionimin e Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, për vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe Komisionit Mjekësor të Përcaktimit të Verbërisë''*.

asistohet nga një kujdestar, por nuk shoqërohet me pajisjen e kësaj kategorie me paketën higjieno-sanitare.

Avokati i Popullit duke gjykuar se në kushtet kur personi është përfitues i statusit të invalidit para-tetraplegjik (grupi i parë), pavarësisht faktit që për t'i shërbyer i është caktuar një kujdestar, për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore dhe pamundësisë që paraqet, i ka sugjeruar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale marrjen në konsideratë të përfshirjes së diagnozës "*Paraplegji inferiore nga sëmundje neurodegjenerative pa ç'rregullime sfinkteriane"* në përfitimin e paketës higjieno-sanitare.

Sa i përket sugjerimeve të adresuara, MSHMS-ja informon se i ka në fokusin e saj çështjet e aftësisë së kufizuar dhe ka ndërmarrë reforma në këtë fushë duke adresuar çdo problematikë në bashkëpunim edhe me institucionet e tjera përgjegjëse për implementimin e tyre.

✓ *Mosdhënien e së drejtës për të përfituar Statusin e Invalidit Paraplegjik dhe Tetrapelgjik.*

Referuar numrit të lartë të ankesave të adresuara dhe të trajtuara nga institucioni ynë, ka rezultuar se diagnoza "*paraparezë*", diagnoza *"hemiplegji"*, janë paraliza, të cilat nuk përbëjnë kriter për përfitim të Statusit të Invalidit Paraplegjik dhe Tetrapelgjik, por janë diagnoza të cilat i klasifikojnë mbajtësit e tyre si persona me aftësi të kufizuar, me grup të parë të invaliditetit.

Në kushtet kur edhe diagnoza "*hemiplegji*" dhe "*paraparezë*" klasifikohet si një ndër format e paralizës, i sugjeruam Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale marrjen në konsideratë të përfshirjes të diagnozave të sipërcituara në përfitimin e Statusit të Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik.

Nga përgjigjet e dhëna prej MSHMS-së, informohemi se aktualisht këto diagnoza nuk mund të përfshihen si diagnoza për përfitimin e Statusit të Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik, duke na sjellë në vëmendje për mundësinë e përfshirjes së tyre në një fazë të dytë, pas kryerjes së një studimi, sa i përket vlerësimit mbi diagnozat që shkaktojnë hemiplegjinë, një vlerësim mbi numrin e hemiplegjikëve në Shqipëri dhe një vlerësim i kostove financiare, të cilat kërkojnë ndryshime në legjislacion, për sa sugjerohet nga institucioni ynë.

✓ *Mosdhënia e detyrimeve të prapambetura për periudhën 2005-2010, personave me aftësi të kufizuar në qytetin e Gjirokastrës, për shkak të mosindeksimit të pagesës së aftësisë së kufizuar.*

Institucioni i Avokatit të Popullit, edhe këtë vit ka trajtuar një problematikë të raportuar ndër vite nga qytetarët, ende e pazgjidhur, siç është ajo e mosdhënies së detyrimeve të prapambetura për periudhën 2005-2010 personave me aftësi të kufizuar në Bashkinë Gjirokastër, për shkak të mosindeksimit të pagesës së aftësisë së kufizuar. Deri në vitin 2004, indeksimi i pagesave të aftësisë së kufizuar, i ardhur si pasojë e rritjes së pagës minimale, është zbatuar plotësisht. Për periudhën 2005-2010, ky indeksim rezulton se është llogaritur me shumë mangësi, duke krijuar rrjedhimisht diferenca të papaguara. Pavarësisht depozitimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë me objekt*: "Saktësim dhe njohje detyrimi të prapambetura, duke përllogaritur vlerat*

taksuese për çdo paditës për shkak të aftësisë së kufizuar të kujdestarisë, papunësisë dhe shkollimit, verbërisë si dhe shpërblim dëmi", kjo e drejtë e tyre nuk është zbatuar nga ana e pushtetit vendor.

Në korrespondencën intensive të zhvilluar për këtë çështje, Bashkia Gjirokastër konfirmonte faktin se disponon vendim gjykate të formës së prerë, sipas së cilës Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) dhe Bashkia Gjirokastër duhet të paguajnë diferencën e pagesës për shkak të aftësisë së kufizuar si dhe dëmin e shkaktuar nga moslikujdimi në kohë të detyrimeve të lindura për qytetarët dhe se kishte marrë të gjitha masat e nevojshme për ekzekutimin e vendimit të gjykatës. Më tej kjo Bashki informon se është në pritje për çeljen e fondit nga MSHMS-ja për shlyerjen e pagesave të prapambetura për personat me aftësi të kufizuar, brenda juridiksionit të Bashkisë Gjirokastër.

Ndërsa, pas ndërhyrjes sonë institucionale, pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, jemi informuar nga ky institucion se "….. *gjatë vitit 2022, në varësi të situatës buxhetore, do bëjë përsëri një përmbledhje të vendimeve gjyqësore të formës së prerë të palikujduara deri në fund të vitit 2021 si dhe vendimet që mund të dalin gjatë këtij viti dhe do të veprojë në të njëjtën mënyrë dhe në fund të vitit 2022….".*

✓ *Mospërfitim i kompensimit të shpenzimeve për transportin urban (100%) dhe interurban (50%) të invalidëve të punës dhe personat që përfitojnë statusin e të verbërit.*

Kjo është një problematikë e raportuar ndër vite, e cila është evidentuar edhe gjatë këtij viti në ankesat e qytetarëve, për të cilën institucioni i Avokatit të Popullit është angazhuar rigorozisht me shkresa zyrtare me institucionet përgjegjëse, në funksion të zgjidhjes së kësaj problematike.

Nga korrespondenca e zhvilluar me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, na konfirmohet fakti se kjo Ministri është në proces të ngritjes së grupit ndërinstitucional të punës për vlerësimin e legjislacionit përkatës në fushën e transportit, për kategoritë e invalidëve që përfitojnë lehtësira në transport.

✓ *Mosdhënie e dy-fishit të pagesës për shkak të verbërisë, të personave që kanë probleme me shikimin, të cilët ndjekin shkollën e Avokatisë.*

Duke marrë shkas nga ankesa e një qytetari, i cili në objektin e ankesës së tij parashtronte faktin se ishte përfitues nga ligji nr.8098, datë 28.03.1996, "Për Statusin e të Verbërit", dhe ndiqte shkollën e Avokatisë, kemi konstatuar një problematikë përfaqësuese për personat me aftësi të kufizuar në shikim, që ndjekin një kurs kualifikimi të licencuar ose të akredituar, të cilët rezultonin se nuk përfitonin pagesën në masën 200%.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.182 datë 26.02.2020, "*Për përcaktimin e masës, të kritereve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar, si dhe të ndihmësit personal*", i ndryshuar, në Kreun III, pika 2, ka përcaktuar se: *"Personat me*

aftësi të kufizuar, që ndjekin një kurs kualifikimi të licencuar ose të akredituar, dhe nxënësit, të cilët ndjekin arsimin e mesëm e të lartë, përfitojnë pagesë në masën 200% të pagesës si person me aftësi të kufizuar gjatë kohës që ndjekin kursin e kualifikimit/vitin shkollor vetëm për një dhe gjatë një kursi kualifikimi/viti shkollor, brenda afatit të përcaktuar për kryerjen e kursit të kualifikimit/vitit shkollor".

Qytetarit nuk i është dhënë e drejta e përfitimit të dy-fishit të pagesës për shkak të verbërisë, pasi nuk disponohet asnjë dokument që të vërtetojë liçensimin apo akreditimin e Shkollës së Avokatisë. Në këto kushte i kemi sugjeruar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale marrjen në konsideratë të sugjerimit tonë për rregullimin ligjor të kësaj situate. Në përgjigje të sugjerimit të adresuar nga institucionin ynë, ky institucion informon se:

"Në përgjigje të shkresës me anë të së cilës keni përcjellë rekomandimet e shtetasit BM, i cili kërkon që periudha e ndjekjes së shkollës së Avokatisë t'i njihet si kurs formimi profesional, për efekt përfitimin e 2-fishit të pagesës së aftësisë së kufizuar për personat me aftësi të kufizuar që ndjekin këtë program 1-vjeçar për ushtrimin e profesionit të avokatit, ju bëjmë me dije se këto rekomandime po vlerësohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale...." .

✓ *Mungesa e përshtatshmërisë ndërtimore për personat me aftësi të kufizuara në lëvizje si dhe sinjalistikën me shiritat e posaçme për personat me aftësi të kufizuar në shikim në institucionet shtetërore, të cilat ofrojnë shërbime për qytetarë si dhe në rrugët e trotuaret në territorin e RSH.*

Komiteti Drejtues për zbatimin e Konventës së OKB-së "*Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara*", në rezolutën e datës 25.09.2019, ka rekomanduar për Shtetin Shqiptar, marrjen e masave mbi të drejtën e personave me aftësi të kufizuar për të jetuar të pavarur dhe për t'u përfshirë në komunitet. Një nga shqetësimet e shprehura, është mungesa e aksesit, ku theksi vihet në standardet për heqjen e barrierave mjedisore dhe infrastrukturore në ofrimin e shërbimeve.

Përpos rekomandimeve të dërguara në vitin 2021 disa institucioneve shtetërore,[140]pas monitorimeve të kryera, institucioni ynë vijoi edhe gjatë vitit 2022 me hartimin dhe dërgimin e rekomandimeve për marrjen e masave të menjëhershme për realizimin e infrastrukturës ndërtimore, sipas standardeve të elementëve të përshtatshmërisë, duke përfshirë në këtë proces edhe vetë personat me aftësi të kufizuar.[141]

Në përgjigje të rekomandimeve të përcjella, informohemi se *rekomandimet tona janë pranuar plotësisht* dhe po merren masat e duhura për krijimin e lehtësirave për personat me aftësi të kufizuara në lëvizje dhe shikim.

[140] Raporti vjetor i Avokatit të Popullit për vitin 2021, faqe 114.

[141] Rekomandim drejtuar Furnizuesit të Shërbimit Universal Sh.a, Tiranë, Operatorit të Kujdesit Shëndetësor, Tiranë, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Prokurorisë së Përgjithshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, Agjensisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), Pogradec, Bashkisë Pustec, Qendrës Shëndetësore Pustec, Filialit të Postës, Lezhë, Bashkisë Durrës.

✓ *Mospërjashtimi nga pagesa e taksës së ndërtesës për invalidët e punës.*

Sa i përket problematikës së mospërjashtimit nga taksa e ndërtesës, të kategorisë së invalidëve të punës, pas korrespondencës intensive me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë si dhe me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për adresimin e kësaj problematike, rezultoi si domosdoshmëri, ndërmarrja e nismave ligjore për rregullimet e nevojshme në ligjin specifik "*Për invalidët e punës*", i ndryshuar, me qëllim përshtatjen e tij me ndryshimet që legjislacioni tatimor ka bërë ndër vite.
Edhe përgjatë këtij viti, kemi insistuar me kërkesa të vazhdueshme për rregullimin adekuat ligjor të kësaj situate dhe nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë jemi informuar se:

"Në kuadër të reformës për taksën e pasurisë së paluajtshme që ka për qëllim taksimin e pasurisë së paluajtshme bazuar tërësisht në vlerën e tregut, Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me projektin "ProTaxAlbania", është në proces draftimi të projektligjit "Për taksën e pasurisë së paluajtshme" dhe ka për qëllim taksimin e pasurisë së paluajtshme bazuar tërësisht në vlerën e tregut……. .Në procesin e konsultimit të projektligjit "Për taksën e pasurisë së paluajtshme" që ka në fokus shtresat në nevojë dhe ato me më pak të ardhura, do të jetë i hapur procesi i diskutimit edhe për kategorinë e invalidëve të punës…".

✓ *Mungesa e aksesit nga personat me aftësi të kufizuar në platformat online.*

Për krijimin e përshtatshmërisë së platformave online në marrjen e informacionit nga persona me aftësi të kufizuar, iu drejtuam Agjensisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit për marrjen e masave me programe specifike të nevojshme për krijimin e lehtësirave për këtë kategori personash. Në përgjigje të kërkesës sonë, AKSHI, ndër të tjera, informon si më poshtë:

"*....AKSHI është duke punuar intensivisht me Bankën Botërore për të përmirësuar platformën e-Albania dhe infrastukturat mbështetëse të saj, duke e përshtatur atë për personat me nevoja të veçanta, duke sjellë funksionalitete të reja për qytetarët dhe bizneset në përfitimin e shërbimeve publike si dhe do të investohet në rritjen e aftësive bazë dhe atyre të avancuara digjitale për popullatën.....Kjo do të rregullohet edhe me aktet ligjore përkatëse sipas direktivës së BE-së mbi aksesueshmërinë e faqeve të internetit dhe aplikacioneve mobile të organeve të sektorit publik, planifikuar të miratohet brenda vitit 2024..".*

✓ *Monitorimi i zbatimit të standardeve ligjore të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për qendrat rezidenciale, ku janë të akomoduar persona me aftësi të kufizuar si dhe për monitorimin e mjediseve dhe kushteve të jetesës së tyre.*

Aktiviteti ynë është shtrirë në disa aspekte konkrete të monitorimit të nivelit të zbatimit të drejtave të personave me aftësi të kufizuar, me një qasje proaktive dhe të dedikuar, duke zhvilluar në mënyrë të vazhdueshme me iniciativë, inspektime në Institucione Rezidenciale të Përkujdesjes Sociale, ku janë të akomoduar persona me aftësi të kufizuar dhe konkretisht në Qendrën e Zhvillimit në Korçë dhe Qendrën e Zhvillimit "Unë jam si Ju", Berat.

Avokati i Popullit konstaton se pavarësisht punës të përkushtuar të bërë në këto institucione të përkujdesjes shoqërore, kërkohet një angazhim më i madh dhe një bashkëpunim më i mirë ndërinstitucional, ndërmjet pushtetit qëndror dhe atij vendor, për përmbushjen e standardeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuar të akomoduar në këto institucione. Për këtë qëllim, për t'iu përgjigjur nevojave të aftësimit dhe zhvillimit të personave me aftësi të kufizuara, kemi hartuar rekomandime për Shërbimin Social Shtetëror dhe Bashkitë Korçë e Berat.[142]
Në Ditën Ndërkombëtare të të drejtave të personave me aftësi të kufizuar, Avokati i Popullit me anë të një Deklarate, ka kërkuar ndërgjegjësim të të gjithë shoqërisë, në mbrojtje të të drejtave të personave me aftësi të kufizuar, me qëllim integrimin në jetën politike, sociale, ekonomike e kulturore.

Avokati i Popullit do të vijojë të punojë për të promovuar respektimin e vazhdueshëm të të drejtave të personave me aftësi të kufizuar, promovimin e të drejtave të tyre si pjesë përbërëse e shoqërisë shqiptare, për të nxitur garantimin e gjithpërfshirjes, mirëqenies dhe përmirësimit të cilësisë së tyre të jetës.

3.19 Barazia gjinore[143]

Avokati i Popullit si një institucion, i cili ka në themel të punës së tij promovimin dhe mbrojtjen e të drejave të njeriut, pjesë integrale e të cilave janë dhe të drejtat e grave e të vajzave, edhe gjatë vitit 2022 ka përforcuar konstatimin se gratë dhe vajzat shqiptare janë pre e të gjitha formave të dhunës, ç'ka përbën dhe një nga problematikat kryesore, që çon në mosrespektimin e të drejtave njerëzore të tyre.

Edhe pse vitet e fundit ka patur përmirësime të rëndësishme në kuadrin ligjor për viktimat e dhunës në familje apo janë hartuar politika specifike për barazinë gjinore vazhdojnë të mbeten çështje të rëndësishme për t'u adresuar.

Nga perspektiva e insitucionit të Avokatit të Popullit, në ushtrim të mandatit të tij, si mbrojtës i të drejtave dhe lirive të individit, konstatohen si problematika më të spikatura përgjatë këtij viti, të identifikuara dhe që vijojnë edhe nga viti pararendës të tilla si; - Mbështetja me shërbime

---

[142] Rekomandimet për Qendrën e Zhvillimit Korçë lidhen me*:* Marrjen e masave përkatëse për shtim në organikë të pozicionit të punës me infermier; Marrjen e masave për shtim në organikë me 2 (dy) kujdestarë, 1 (një) sanitare, 1 (një) psikolog, dhe 1 (një) punonjës social; Marrjen e masave për vendosjen e shkallëve të emergjencës; Marrjen e masave për zëvendësimin e krevateve ekzistues me krevate të përshtatura për të sëmurët paraplegjikë e tetraplegjikë; Marrjen e masave për riparimin e sistemit të kaldajës; Marrjen e masave për mundësimin e vendosjes në godinë të një ashensori, si dhe Marrjen e masave për rritjen e kuotës ushqimore ditore. Rekomandimet për Qendrën e Zhvillimit "Unë jam si Ju', Berat lidhen me: Marrjen e masave për miratimin e Rregullores së Brendshme të Qendrës së Zhvillimit "Unë jam si Ju", Berat; Marrjen e masave për shtimin në organikën e Qendrës të pozicionit të punës me infermier, kujdestarë, psikolog dhe roje objekti; Marrjen e masave për zëvendësimin e një krevati ekzistues me krevat të përshtatur për përfituesin, i cili është i sëmurë për shkak të verbërisë si dhe para/ tetraplegjik; Marrjen e masave për trajnimin e stafit për përdorimin e mjeteve kundër zjarrit;
Marrjen e masave për izolimin e plotë të tarracës; Marrjen e masave për mundësimin e vendosjes në godinë të një ashensori; Marrjen e masave për pajisjen e Qendrës me aparatura të elektroterapisë: Tens, Ultratinguj, Pistë vrapimi; Marrjen e masave për vendosjen ne funksionim të tharëses së rrobave; Marrjen e masave për realizimin e përshtatshmërisë së tualeteve për përfituesit e qendrës; Marrjen e masave për vënien në dispozicion të një automjeti., si dhe Marrjen e masave për rishikimin e buxhetit të institucionit për të adresuar problematikat e vëna re.

[143] Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Përgjithshëm në institucionin e Avokatit të Popullit.

sociale për të gjitha kategoritë e grave dhe vajzave që përballen me diskriminim të shumëfishtë. – Alokimi i buxheteve në mbështetje të të mbijetuarave të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje si dhe strukturave që punojnë për këtë qëllim; -Mosrespektimi i dinjitetit të punonjëseve dhe legjislacionit të punës lidhur me shpërblimet, - Mosrespektimi i të drejtave pronësore të grave; - Kushtet e vështira social- ekonomike, etj.

Referuar ankesave të rregjistruara nga institucioni i Avokatit të Popullit për vitin 2022, ankesat e depozituara nga individët, organizata të shoqërisë civile, si dhe rastet me inisiativë, gjithsej *35 raste*, vërehet se ato kanë patur në fokus pretendimet në lidhje me a) dhunën ndaj grave dhe vajzave me probleme të shëndetit mendor dhe shërbime të munguara për këtë kategori b) ngacmimin seksual në vendin e punës c) përjashtimin e grave si bashkëpronare për përfitim të banesave me dhurim nga programi i rindërtimit d) mospunësimin dhe mosdhënien e shpërblimit sipas legjislacionit të punës në fuqi e) strehimin social dhe mospërfitimin e bonusit të qerasë për viktimat e dhunës në familje f) mospërfitimin e pensionit social g) kushtet e vështira social-ekonomike.

Krahasuar me një vit më parë ka patur një zgjerim të gamës së çështjeve për të cilat është kërkuar asistencë dhe ndërhyrje ligjore nga ana e insitucionit të Avokatit të Popullit.

Një problematikë e spikatur dhe e trajtuar gjerësisht nga institucioni i Avokatit të Popullit përgjatë vitit 2022, trajtimi i së cilës u përmbyll me hartimin e rekomandimit përkatës është edhe ajo e rritjes së aksesit të grave në të drejtat pronësore.
Rritja e aksesit të grave në të drejtat pronësore ka qenë vazhdimisht një nga fushat shqetësuese në kuadër të fuqizimit ekonomik të grave dhe reduktimit të varfërisë. Tërmeti i vitit 2019, solli pasoja të rënda social ekonomike për zonat dhe banorët që u prekën, duke humbur dhe banesat e tyre. Qeveria ndërmorri masa për të siguruar strehimin e banorëve, nëpërmjet programit të rindërtimit dhe akteve nënligjore të miratuara.

Në kuadër të bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile,[144] pasi Avokati i Popullit u vu në dijeni nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, konsatatoi problematikën në lidhje me garantimin e të drejtës së pronësisë për gratë bashkëshorte mbi pasuritë e paluajtshme, që përfitohen me programet e rindërtimit të shtëpive të dëmtuara nga tërmeti i vitit 2019.

Sipas procedurave të parashikuara, kontratat e dhurimit do të realizohen ndërmjet palës dhuruese, institucionit shtetëror përgjegjës (Bashkisë) dhe palës pranuese të dhurimit, qytetarëve që kanë aplikuar dhe përftojnë nga granti për rindërtimin e shtëpive të dëmtuara si pasojë e tërmetit. Kjo kontratë do të hartohet nga noteri dhe do të regjistrohet nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK), drejtoria rajonale vendore përkatëse.[145] Por, *në kontratën e dhurimit, nuk janë parashikuar klauzola që të garantojnë respektimin e barazisë gjinore në përfitimin e pronësisë*.

[144] Në zbatim të nenit 30 të ligjit nr.8554, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, i cili shprehimisht parashikon se, "*në kryerjen e funksioneve të veta, Avokati i Popullit bashkëpunon ngushtë me organizatat joqeveritare, duke marrë periodikisht mendimet e tyre për gjendjen e të drejtave dhe të lirive të njeriut*".
[145] VKM nr.904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit".

Është konstatuar se në kontratat e dhurimit që realizohen nga pushteti vendor kundrejt familjeve të dëmtuara nga tërmeti, përfitues i dhurimit është vetëm kryefamiljari (i cili përgjithësisht është bashkëshorti ose vjehrri i saj). Në këtë mënyrë kjo pasuri konsiderohet pasuri vetjake e përfituesit të pasurisë dhe në rast konflikti familjar, divorcit ose në rast transaksioni të asaj pasurie, përfituesi i saj (kryefamiljari) e tjetërson pasurinë i vetëm pa marrë pëlqimin e bashkëshortes. Shtëpia që është dëmtuar apo shkatërruar nga tërmeti ka qenë një shtëpi e përfituar me blerje gjatë martesës me kontributin e të dy bashkëshortëve, por në kontratat e dhurimit nuk specifikohet një fakt i tillë, duke sjellë *pasoja të rënda sociale për gruan, të cilës i mohohet bashkëpronësia.*
Nisur nga analiza e fakteve dhe dokumentave ligjore të miratuara, Avokati i Popullit përgatiti dhe dërgoi pranë insitucioneve përgjegjëse[146] rekomandimin për*"Marrjen e masave për respektimin e të drejtave gjinore të bashkëpronësisë mbi banesat e përfituara nga grantet e rindërtimit si pasojë e dëmtimeve të tërmetit të vitit 2019"*, me anën e të cilit rekomandohet:

✓ *Marrjen e masave që, të gjitha kontratat e dhurimit, ku përfitues i dhurimit është aplikuesi që në datën 26.11.2019 ka pasur statusin civil "i martuar" në bashkësi ligjore, të kryhen në favor të bashkësisë ligjore edhe në rast se njëri bashkëshort nuk është i pranishëm në çastin e nënshkrimit të kontratës, si dhe të dy bashkëshortët të jenë bashkëpronarë në tërësi të pasurisë së paluajtshme me 1/2 pjesë ideale të pandarë;*
✓ *Përcjelljen Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe Bashkive përkatëse, të modelit të kontratave të dhurimit, në të cilin të përcaktohet se të dy bashkëshortët janë bashkëpronarë në tërësi të pasurisë së paluajtshme me 1/2 pjesë ideale të pandarë, gjë që pasqyrohet në aktet noteriale.*

Sugjerime dhe rekomandime të rëndësishme janë përcjellë edhe nëpërmjet raporteve të veçanta, të përcjella pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nga institucioni i Avokatit të Popullit, për problematikat e ndeshura në respektim të të drejtave të grave dhe vajzave.

Më kokretisht, raporti i iniciuar gjatë vitit 2021, lidhur me "*Dhunën ndaj grave në politikë*" dhe raporti lidhur me "*Vlerësim mbi qasjen dhe përdorimin familjar të transfertave të mbrojtjes sociale"*, u përmbyllën gjatë vitit 2022. Gjetjet e këtyre raporteve u përkthyen në sugjerime dhe rekomandime të rëndësishme drejtuar insitucioneve në nivel qendror dhe vendor, organizatave të grave, partive politike, medias, etj. Ndërkohë që Avokati i Popullit do të vijojë të ushtrojë funksionin e tij monitorues për zbatueshmërinë e rekomandimeve të përfshira në këto raporte edhe përgjatë vitit 2023.[147]

Një tjetër problematikë e trajtuar gjerësisht nga institucioni i Avokatit të Popullit përgjatë vitit 2022 është edhe buxhetimi i përgjigjshëm gjinor (BPGJ), si një element i rëndësishëm për arritjen e barazisë gjinore.

Buxheti është instrumenti kryesor që pasqyron mënyrën se si një qeveri administron përparësitë dhe demonstron seriozitetin e saj në përgjigje të sfidave të vazhdueshme të zhvillimit të tilla si: pabarazia gjinore, varfëria, përjashtimi dhe padrejtësia ekonomike.

[146] Rekomandimi me Nr.K1/Q3-2 Prot, datë 17.10.2022, iu është dërguar Zv/kryeminsitres dhe Ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrit të Drejtësisë, Agjensisë Shtetërore të Kadastrës, Bashkive: Tiranë, Durrës, Shijak, Krujë, Kamëz, Vorë, Rrogozhinë, Kurbin, Mirditë, Lezhë.
[147] Më shumë informacion në lidhje me përmbajtjen e këtyre raporteve do të gjeni në Kreu IV "*Angazhime të tjera institucionale*".

Nga ana tjetër monitorimi i shpenzimeve publike sipas gjinisë në secilën prej këtyre fushave është me rëndësi në kuadër të analizës së ndjeshmërisë dhe përgjegjshmërisë së qeverisë në nivel qëndror dhe vendor për përmbushjen e angazhimeve të ndërmarra.

Në këtë kontekst, Avokati i Populli është angazhuar gjatë vitit 2022 në përgatitjen e një raport monitorimi **"***Mbi shpenzimet publike gjinore në fushën e shërbimeve sociale",* mbështetur nga UN WOMEN, i cili pritet të diskutohet me grupet e interesit dhe të lançohet gjatë vitit 2023.

Në këtë raport janë analizuar programet buxhetore të 3 ministrive, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe 6 bashkive: Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë, Elbasan, Korçë. Objektivi kryesor i këtij raporti është të vlerësojë shkallën e shpenzimeve të realizuara gjatë vitit 2021, për përmirësimin e situatës dhe gjendjes së grave si edhe për rritjen e aksesit të grave në shërbimet sociale të ofruara nga institucionet përgjegjëse në nivel qëndror dhe lokal, të identifikojë nivelin e arritjeve si edhe të ngrejë çështjet më problematike të kësaj fushe në drejtim të strukturave shtetërore në nivel qëndror dhe vendor.

Në kuadër të tagrit të tij ligjor monitorues, gjatë vitit 2022, janë kryer inspektime në **(**i) Qendrën Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje (ii) Qendrën për menaxhimin e krizës për rastet e dhunës seksuale "LILIUM" dhe (iii) 4 strehëza emergjente në nivel bashkie për viktimat e dhunës në familje (përkatësisht në Kukës, Vlorë, Pogradec, Sarandë), të cilat janë ngritur dhe funksionojnë në bazë të legjislacionit për shërbimet e përkujdesit shoqëror dhe standarteve të miratuara[148].

Avokati i Popullit ndërsa mirëpret të gjitha përpjekjet dhe masat e ndërmarra nga Qeveria dhe Njësitë e Vetqeverisjes Vendore për t'ju përgjigjur nevojave të viktimave të dhunës me shërbime të specializuara, duke alokuar edhe fonde nëpërmjet mekanizmit të Fondit Social, konstaton se ende këto shërbime duhet të përmirësohen, të shtohen në numër dhe të shtrihen në të gjithë vendin, të jenë të aksesueshme dhe të arritshme për të gjitha grupet e grave së bashku me fëmijët e tyre.

i) Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje është një qendër rezidenciale publike kombëtare, në vartësi të Shërbimit Social Shtetëror, që fron një sërë shërbimesh, përfshirë: shërbime bazë (ushqim, veshje, strehim të përkohshëm), asistencë psiko sociale, asistencë ligjore, asistencë mjekësore, edukim arsimor për fëmijët, kualifikime dhe trajnime profesionale/punësimi, aktivitete okupacionale, rehabilituese, referim për riintegrim, përgatitje për riintegrim, ndërmarrja e negociatave për riintegrim, monitorim dhe vlerësim i rasteve pas referimit pranë qendrave riintegruese apo komunitet.

Qëllimi i inspektimit ishte të monitorohej zbatimi i rekomandimeve të lëna nga Avokati i Popullit në vitin 2021[149]dhe gjendja aktuale e respektimit të të drejtave të banorëve/banoreve (gra dhe fëmijë), të akomoduar në këtë qendër, në përputhje me standartet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje.

---

[148] Ligji nr.121, datë 21.11.2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror".
VKM nr.505, datë 13.7.2011 "Për miratimin e standarteve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për viktimat e dhunës në familje, në Qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike".

[149] Për rekomandimet e dhëna gjatë inspektimit të vitit 2021, shih Raportin Vjetor 2021. https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/list/publications/rraporte-vjetore-2/.

Analiza e informacionit të grumbulluar gjatë inspektimit të realizuar, u përmbyll me përcjelljen pranë institucioneve përkatëse (MSHMS dhe SHSSH) të rekomandimit për:

✓ *Marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e kushteve të jetesës dhe trajtimit, si dhe për garantimin e të drejtave të përfituesve në Qendrën Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje.*[150]
Në kohën e hartimit të këtij raporti vjetor, rezulton se ky *rekomandim është pranuar nga SHSSH dhe nga MSHMS.*

ii) Qendra për menaxhimin të krizës për rastet e dhunës seksuale "LILIUM"- Kjo qendër funksionon si një qendër e specializuar për menaxhimin e rasteve të dhunës seksuale, afatshkurtër dhe funksionon 24/7. Qendra është në vartësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", dhe financohet nga buxheti i shtetit.

Qëllimi i inspektimit ishte për verifikimin e respektimit të standardeve të ofrimit të shërbimeve për viktimat e dhunës seksuale në Qendrën LILIUM, si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit [151]pas inspektimit të bërë në datën 03.12.2021.

Avokati i Popullit vlerëson ngritjen dhe funksionimin e kësaj qendre dhe po ashtu idendifikon nevojën për ngritjen e qendrave të tjera në vend, ashtu siç parashikohet edhe në Qëllimin e III[të] Strategjik të Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore 2021-2030. Analiza e informacionit të grumbulluar gjatë inspektimit të realizuar, u përmbyll me përcjelljen pranë institucioneve përkatëse të rekomandimit për:

✓ *Marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e kushteve të trajtimit, si dhe për garantimin e të drejtave të përfituesve në Qendrën e menaxhimit, për rastet e dhunës seksuale, LILIUM*[152]
Në momentin e hartimit të këtij raporti vjetor, QSUNT ka *pranuar rekomandimin dhe ka filluar zbatimin e masave rekomanduese.*

---

[150] 1. Plotësimin e organikës së QKTVDHF me punonjës me kohë të plotë kujdestarë që të mbulohen të tre turnet; 2. Plotësimin e organikës së QKTVDHF me 1 jurist 3. Sigurimin e fondeve për blerjen e veshmbathjeve (veshje të brendshme, mbathje, kanatjere, veshje të ndryshme, etj) për gratë dhe fëmijët 4. Sigurimin e fondeve për instalimin e sistemit të ngrohjes qendrore të objektit 5. Sigurimin e fondeve për blerjen e materialeve didaktike, edukative e argëtuese si dhe librave për fëmijët 6. Sigurimin e të gjitha medikamenteve të protokollit bazë në Qendër 7. Punësimin e një shoferi.

[151] Për rekomandimet e dhëna gjatë inspektimit të vitit 2021, shih Raportin Vjetor 2021. https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/list/publications/rraporte-vjetore-2/.

[152]1.Buxhetimin nga QSUT për Qendrën LILIUM, në zbatim të Urdhërit nr.817, datë 27.11.2018, të Sekretarit të Përgjithshëm të MSHMS "Për ngritjen dhe funksionimin e Qendrës së Menaxhimit për rastet e dhunës seksuale", për të plotësuar nevojat specifike që kanë viktimat e dhunës seksuale për veshmbathje, paketa higjeno-sanitare, si dhe shpenzime të tjera operative të domosdoshme për ekzaminimin e rasteve.
2. Përcaktimin e një liste të infermierëve të trajnuar për të ofruar shërbime shëndetësore për viktimat e dhunës seksuale.
3. Sigurimin dhe trajnimin në vazhdimësi të stafit përgjegjës për ofrimin e mbështetjes emergjente dhe vlerësimit psikologjik të viktimave të dhunës seksuale.
4. Për punonjësit social dhe psikologët që ofrojnë këtë shërbim në Qendrën LILIUM pas orarit zyrtar (24 orë), të paguhen sipas procedurave dhe rregullave të përcaktuara nga QSUT për mjekët dhe infermierët.
5. Shtimin e stafit të Qendrës LILIUM me një punonjës me pozicion menaxher rasti.

iii) Inspektime u kryen gjatë vitit 2022 në 3 strehëza emergjente afatshkurtra, Sarandë, Kukës dhe Pogradec dhe pranë Strehëzës Vatra në Vlorë, qendër që ofron shërbime afatgjata për gratë viktima të dhunës në familje dhe trafikimit.

Inspektimet në këto qendra, kishin si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje, gra viktima të dhunës dhe fëmijët e tyre.

Pas verifikimit të dokumentacionit, analizës së të dhënave dhe informacioneve të marra, për të 4 subjektet e inspektuara u dhanë rekomandimet përkatëse *"Për marrjen e masave të menjëhershme të përmirësimit të kushteve të jetësës dhe trajtimit të përfituesve në qendrat e emergjencave*", drejtuar bashkive dhe qarqeve respektive, Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, dhe për dijeni Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Shërbimit Social Shtetëror.

Rekomandimet e përcjella i referoheshin kryesisht plotësimit të organikave me punonjës socialë, respektimit të legjislacionit të punës për oraret shtesë, sigurimin e qëndrueshmërisë së këtyre qendrave nëpërmjet mekanizmit të Fondit Social si dhe nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit midis bashkive në nivel qarku.[153]

Promovimi i të drejtave dhe lirive të njeriut, ndërgjegjësimi për të drejtat, që grave dhe vajzave u takojnë, është realizuar nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme si dhe deklaratave të Avokatit të Popullit në faqen zyrtare të insitucionit, me një synim të qartë për të treguar, se adresimi i ankesave pranë insitucionit të Avokatit të Popullit, është një mjet i rëndësishëm në duart e publikut dhe veçanërisht të grave dhe vajzave për të vënë në vend të drejtat e shkelura ose të mosrepsektuara.

Në këtë kontekst sjellim në vëmendje organizimin e tryezave tematike në ditët e shënuara për të drejtat e grave, por jo vetëm, si psh. në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Gruas (8 Mars) apo dhe pjesmarrja në aktivitete të organizuara gjatë Fushatës së 16 ditëve të aktivizmit kundër dhunës ndaj grave *25 nëntor- 10 dhjetor*, si dhe takime gjatë ditëve të hapura që organizon Avokati i Popullit në bashki të ndryshme.

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson punën e institucioneve përgjegjëse në drejtim të parandalimit dhe luftës kundër dhunës më bazë gjinore dhe dhunës në familje, dhe do të vijojë të jetë i angazhuar në nxitjen e këtyre institucioneve për të bërë akoma edhe më shumë në respekt të standardeve më të larta të garantimit të të drejtave të grave e vajzave.

3.20 Mbrojtja e të drejtave të komunitetit LGTBIQ[154]

Avokati i Popullit në fokus të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, ka edhe mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komunitetit LGBTIQ. Për këtë, insitucioni i Avokatit të Popullit ndërvepron prej kohësh me shoqërinë civile dhe aktivistë të saj tepër aktivë që punojnë në këtë

[153] Në momentin e hartimit të këtij raporti, bashkitë dhe insitucionet përgjegjëse, kanë pranuar rekomandimet dhe janë shprehur për masat që do të ndërmarrin.
[154] Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Përgjithshëm në institucionin e Avokatit të Popullit.

fushë, insitucionet dhe të gjithë aktorët e përfshirë, si dhe është pjesë e Aleancës Kundër Gjuhës së Urrejtjes, për t'i thonë JO krimeve dhe gjuhës së urrejtjes, si dhe për të realizuar pa diskriminim të drejtat, që këtij komuniteti i takojnë.

Avokati i Popullit vlerëson se, janë shënuar hapa pozitivë vitin e fundit, nëpërmjet miratimit të Planit të Veprimit për LGBTI+, 2021-2027, ngritjes së kapaciteteve të disa strukturave shtetërore përgjegjëse, ndërgjegjësimit të vazhdueshëm të publikut, nëpërmjet aktiviteteve në kuadër të ditës Kundër Homofobisë, Transfobisë dhe Bifobisë.
Në monitorim të kujdesshëm të situatës së përditshme në vend, përgjatë gjithë vitit 2022, Avokati i Popullit konsaton se pavarësisht hapave pozitivë që janë bërë në Shqipëri, jemi ende shumë larg përfshirjes së plotë të personave LGBTIQ, të cilët vazhdojnë të përballen me diskriminim, stigmatizim, gjuhë urrejtjeje dhe madje edhe dhunë fizike. Avokati i Popullit ka konstatuar se gjuha e urrejtjes është shtuar sidomos dy vitet e fundit në mediat dhe platformat online.

Nëpërmjet deklaratave zyrtare, gjatë tryezave të rrumbullakëta, aktiviteteve të ndryshme të organizuar nga vetë insitucioni apo dhe aktorë të tjere brenda dhe jashtë vendit, publikimi i qëndrimeve në faqen zyrtare të insitucionit, Avokati i Popullit ka qenë gjithmonë në mbështetje të anëtarëve të komunitetit.

Në muajin maj, pas një sulmi të përsëritur brutal ndaj një anëtari të komunitetit David Cuka, për shkak të idenditetit gjinor, Avokati i Popullit u kërkoi insitucioneve përgjegjëse për të zbardhur pa vonesë ngjarjen dhe të gjithë viktimave të kësaj dhune të urryer të mos heshtin.

Duke vlerësuar gjithashtu kontributin në vite të shoqërisë civile, Avokati i Popullit përshëndeti vendimin[155]e organizatës "Civil Rights Defenders", për dhënien e çmimit ndërkombëtar si Mbrojtëse e të Drejtave të Njeriut 2022, aktivistes Xheni Karaj, duke njohur dhe vlerësuar kështu kontributin e saj ndër vite, në një shoqëri patriarkale dhe jo pranuese ndaj komunitetit.

Avokati i Popullit është pjesë e fushatës IDAHOT, të organizuar çdo vit, e cila i paraprin datës 17 maj, e cila shënon ditën Ndërkombëtare kundër Homofobisë, Transfobisë dhe Bifobisë. Në këtë kuadër më datë 6 maj 2022, aktiviteti që shënoi dhe hapjen e IDAHOT 2022, ishte eventi për prezantimin e studimit "Programi i Angazhimit Qytetar LGBTI: Politika dhe Përfaqësimi për Avancimin e të Drejtave të Komunitetit LGBTI në Shqipëri", i organizuar bashkarisht midis Avokatit të Popullit dhe organizantës Open Mind Spectrum Albania, me mbështetjen e Fondacionit Friedrich Ebert Stifftung në Shqipëri.[156]

Ky studim përfaqëson një raport vlerësimi të çështjeve të komunitetit LGBTI në spektrin e gjerë të medias shqiptare pas zgjedhjeve të 25 prillit 2021, me synimin për të gjetur mënyra për të përmirësuar situatën e përgjithshme të komunitetit LGBTI në vend. Nëpërmjet sondazheve të zhvilluara, rezultoi se komuniteti LGBTI dhe grupet e tjera të margjinalizuara në shoqërinë shqiptare vazhdojnë të mos përfaqësohen siç duhet në jetën politike dhe shoqërore në Shqipëri, më së shumti për faktin se partitë politike dhe grupet dhe aleancat e tjera të orientuara politikisht,

[155] https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles-layout-1/media/news/this-article-is-available-only-in-albanian-779/.
[156] https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles-layout-1/media/news/this-article-is-available-only-in-albanian-788/.

si dhe mediat kanë bërë shumë pak për të përfshirë shqetësimet dhe çështjet e komunitetit në zgjidhjet dhe axhendën e tyre politike.

Nëpërmjet deklaratës zyrtare në faqen zyrtare të institucionit, Avokati i Popullit bën thirrje për një shoqëri të themeluar mbi vlerat e barazisë dhe mosdiskriminimit ku njerëzit vlerësohen në sajë të kontributit dhe jo identitetit seksual apo llojeve të tjerë të identitetit. Avokati i Popullit vëren se mbeten domosdoshmëri: përmirësimi i mëtejshëm i legjislacionit në përputhje me SOGI (Orientimi Seksual dhe Identiteti Gjinor); zbatimi i legjislacionit ekzistues dhe Planit Kombëtar të Veprimit për përparimin e të drejtave të personave LGBTI; dhe forcimi i përkrahjes dhe partneritetit me organizatat LGBTI dhe organizatat e shoqërisë civile për të drejtat e njeriut për ndërgjegjësimin e shoqërisë për njohje dhe respektim të të drejtave të njeriut.

Avokatja e Popullit, Erinda Ballanca, në tryezën e rrumbullakët mbi rishikimin tematik të Këshillit të Europës me temë "Mbi Krimin e Urrejtjes ndaj personave LGBTI", të organizuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me mbështetjen e Bashkimit Europian dhe Këshillit të Europës, *më 24 shtator 2022*, theksoi ndër të tjera se ".....në Shqipëri kemi ligje të mira por zbatim të pamjaftueshëm. Krimi i urrejtjes jo vetëm ndaj komunitetit LGBTI, por në përgjithësi krimi i urrejtjes është i pranishëm tek ne, jo sepse nuk ka ligje që specifikisht e ndalojnë atë, por sepse siç duket, përveç ligjeve duhet dhe një kulturë e caktuar, një kuadër emancipimi shoqëror, që të mos e lërë ligjin vetëm në dorë të masave shtrënguese, ndërgjegjësimit të organizatave të të drejtave të njeriut, apo rekomandimeve të shqetësuara të miqve tanë ndërkombëtarë"[157]. Avokatja e Popullit theksoi gjithashtu se: "Puna në këtë drejtim është e madhe" dhe beson se "... shoqëria dhe insitucionet tona e kanë vullnetin, dëshirën dhe mundësinë, ta fitojnë këtë luftë".

3.21 Të drejtat e minoriteteve (pakicave) kombëtare[158]

Gjendja e të drejtave të minoriteteve kombëtare edhe gjatë vitit 2022, ka qënë pjesë e vëmendjes institucionale, me një konsiderim të veçantë ndaj të drejtave të ligjshme të minoritetit kombëtar Rom dhe atij Egjiptian i cili paraqet problematika më të spikatura.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka vijuar të jetë proaktiv në ndërhyrjet e kryera me anë të rekomandimeve, në nivelin sistemik të zgjidhjes së çështjeve dhe të mënyrës se si administrata publike dhe shoqëria jonë duhet të konsiderojnë dhe ofrojnë zgjidhje, për barazinë, përfshirjen dhe integrimin e pakicave kombëtare jo vetëm në një situatë normale por edhe në kushte të pazakonta dhe sfiduese për vet shtetin dhe shoqërinë. Rol të rëndësishëm në këtë konsiderim ka luajtur identifikimi i çështjeve konkrete nga media dhe shtypi i shkruar dhe shqyrtimi i tyre me iniciativë nga ana jonë.

Gjatë vitit 2022, janë filluar me iniciativë *9 çështje*, për problematika që i përkasin komuniteteve përkatëse apo edhe individëve pjestarë, të minoriteteve (pakicave) kombëtare, në të gjithë vendin, si dhe janë marrë në shqyrtim *4 ankesa individuale*.

---

[157] https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles-layout-1/media/news/this-article-is-available-only-in-albanian-840/.

[158] Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Përgjithshëm në institucionin e Avokatit të Popullit.

Problematikat dhe sfidat me të cilat vijojnë të përballen sot minoritetet kombëtare Rome dhe Egjiptianë në Shqipëri mbeten ato të lidhura me nevojën për: (i) përmirësimin tërësor të kushteve të jetesës; (ii) përmirësimin e dispozitave ligjore që do të sigurojnë akses të lehtësuar ndaj individëve dhe familjeve Rome dhe Egjiptiane, në sistemin e mbrojtjes dhe përfshirjes sociale; (iii) apo edhe të stimulimit për pjesëmarrje dhe standarde gjithëpërfshirëse në procesin mësimor-edukativ të fëmijëve dhe të të rinjve Rom dhe Egjiptianë, (iv) ecurinë e procesit të legalizimit për banesat e familjeve Rome dhe Egjiptiane, etj.

Gjatë vitit 2022, vend të rëndësishëm kanë zënë rekomandimet, në kuadër të një qasje sistemike ndaj problematikave të konstatuara. Më konkretisht janë hartuar dhe dërguar këto rekomandime:

✓ *Rekomandim nr. K1/I1-2, datë 17.11.2022 drejtuar Bashkive mbi bazë qarku, për hartimin dhe miratimin e dokumenteve strategjikë në nivel vendor, në kuadër të Planit Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025;*
✓ *Rekomandim nr.K1/I48-2, datë 06.12.2022 për ushtrimin e plotë dhe efektiv të funksioneve dhe kompetencave të Bashkisë Elbasan për të mundësuar përmirësimin e kushteve të jetesës së komunitetit Rom që banon në zonën e Rrapishtës, Elbasan, në mënyrë të vazhdueshme dhe të qëndrueshme.*

Sjellim në vëmendje faktin se, vijon të mbetet aktual në objektin e tij, rekomandimi i Avokatit të Popullit, për përmbylljen e procesit të nxjerrjes së akteve nënligjore, në bazë dhe për zbatim, të ligjit nr.96/2017 "Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë", drejtuar me shkresën Nr. K1/I10-2 datë 25.02.2020, Kryetarit të Këshillit të Ministrave dhe Kryetarit të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve. Sikurse kemi konstatuar në vazhdim, me miratimin dhe hyrjen në fuqi, të ligjit nr.96/2017 "Për mbrojtjen e pakicave kombëtare", deri në fund të vitit 2022, janë hartuar dhe miratuar 8 akte nënligjore nga 12 të parashikuara si të tilla nga ligji.

Më konkretisht, katër vendime në fushën e arsimit, dy vendime mbi pjesëmarrjen në jetën publike, sociale, kulturore dhe dy vendime mbi krijimin dhe funksionimin e Komitetit të Pakicave Kombëtare. Ndërkohë mbeten ende për t'u miratuar dhe hyrë në fuqi edhe 4 akte të tjera nënligjore, si më poshtë:
Projektvendimi "Për përcaktimin e përbërjes, funksioneve dhe procedurës së Komisionit për shqyrtimin e kërkesës për njohjen e pakicës kombëtare (pakicave të reja, krahas pakicave të njohura me ligjin nr.96/2017)";
✓ *Projektvendimi "Për mënyrën e përdorimit të gjuhës së pakicave kombëtare në marrëdhëniet ndërmjet personave që i përkasin pakicave kombëtare dhe organeve të vetëqeverisjes vendore";*
✓ *Projektvendimi "Për përcaktimin e dokumentacionit dhe procedurave për mbledhjen/verifikimin e të dhënave për përkatësinë e personave në një pakicë kombëtare". Ky projektvendim ka si qëllim garantimin e parimit të vetë-identifikimit të personave që u përkasin pakicave dhe verifikimi i të dhënave mbi përkatësinë në një pakicë kombëtare, lidhet me kriteret objektive të identitetit të pakicave kombëtare dhe shërben për të bërë të mundur ushtrimin e të drejtave të parashikuara nga ligji;*

✓ *Projektvendimi "Për kriteret e mbështetjes së nismave, projekteve që synojnë mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare, ruajtjen dhe promovimin e identitetit të tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, tradicional dhe fetar dhe kriteret e përzgjedhjes për financimin dhe administrimin e "Fondit për pakicat kombëtare".*

Theksojmë se, në shumë ankesa të tjera të trajtuara nga ana e Avokatit të Popullit, janë identifikuar çështje të tjera të ngritura nga individë pjesëtarë të minoriteteve kombëtare, por që nuk identifikohen drejtëpërdrejtë në kuadër të të drejtave komunitare të minoriteteve kombëtare, apo edhe të të drejtave të ligjshme individuale, për shkak të qënies pjestar në një minoritet kombëtar. Këto ankesa vazhdojnë të vijnë me objekt ankimi, të drejtën për strehim, të drejtën për punësim, të drejtën për të përfituar nga sistemi i përkujdesjes shoqërore, si dhe përmirësimin e kushteve të jetesës në tërësi.

Fenomen shqetësues i cili mbetet në fokusin e veprimtarisë sonë është edhe fenomeni i antixhipsizmit, si manifestim i shprehjeve dhe akteve individuale si dhe i politikave institucionale dhe praktikave të marxhinalizimit, përjashtimit, dhunës fizike, zhvleftësimit të kulturës dhe stilit të jetesës së Romëve, në gjuhën e urrejtjes të drejtuar ndaj Romëve, si dhe ndaj individëve të tjerë apo grupeve të tjera të perceptuara, stigmatizuara apo persekutuara gjatë periudhës naziste, si edhe sot, të njohura si "gypsies". Ky fenomen shqetësues për një shoqëri demokratike, prodhon një sërë stereotipesh negative dhe imazhe të deformuara që përfaqësojnë një formë specifike të racizmit, për individët dhe komunitetet Rome por jo rrallë edhe për ato Egjiptiane.

Sikurse kemi theksuar në qëndrime tonat të mëparshme, të shprehura në rekomandimet dërguar njësive të vetëqeverisjes vendore por edhe organeve publike, përgjegjëse, të qeverisjes qëndrore, do të duhet që nën dritën e kuadrit të ri strategjik ndërkombëtar, për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrje, të projektojmë vizionin tonë të ri, që krahas luftës ndaj "antixhipsizmit", të projektojmë politika konkrete integrimi dhe përfshirjeje reale të Romëve dhe Egjiptianëve, jo vetëm në nivelin e qeverisjes qëndrore por specifikisht edhe në nivelin e vetëqeverisjes vendore, për ti bërë ata të ndihen pjesë e një shoqërie me diversitet, gjithëpranuese dhe demokratike.

Gjatë vitit 2022, institucioni i Avokatit të Popullit ka vijuar ushtrimin e rolit proaktiv duke marrë pjesë në tryeza të rrumbullakëta, në takime me organizatat e shoqërisë civile si dhe me partnerët ndërkombëtarë. Ndër to përmendim takimin e zhvilluar me përfaqësues të Komitetit Këshillimor të Këshillit të Europës për Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, të cilët në kuadër të përgatitjes së një opinioni për vitin 2022/23, si pjesë e ciklit të pestë të monitorimit, zhvilluan një mision në Shqipëri, ku takuan përfqësues të institucioneve të ndryshme, organizata të shoqërisë civile dhe partnerë të pavarur.

Në këtë takim, i cili u zhvillua më *datë 14 nëntor 2022*, u prezantua këndvështrimi i institucionit të Avokatit të Popullit për gjendjen e të drejtave të pakicave kombëtare, problematikat më thelbësore si dhe çështjet e adresuara nëpërmjet rekomandimeve ndër vite, çështjet e parashtruara në ciklin e pestë të monitorimit të Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, si dhe u parashtruan planet afatgjata institucionale në drejtim të monitorimit të respektimit të të drejtave të pakicave kombëtare.

Nga ana tjetër, edhe gjatë vitit 2022, ka vijuar ushtrimi i mandatit promovues si një nga instrumentat më të rëndësishëm për ndërgjegjësimin e qytetarëve lidhur me të drejtat e tyre dhe rolin e institucionit në këtë drejtim përmes kryerjes në vazhdimësi të disa aktivitete ndër të cilat mund të përmenden:

- ✓ takime dhe pjesëmarrje në një sërë aktivitetesh me përfaqësues nga organizata të ndryshme të shoqërisë civile në nivel vendor përfshirë dhe përfaqësues të shoqatave të komuniteteve egjiptiane e rome;
- ✓ përfaqësime aktive në aktivitete promovuese dhe ditë të hapura në bashkitë dhe njësitë administrative të qarqeve përkatëse, ku janë shpërndarë ndër të tjera edhe fletëpalosje të posaçme që institucioni i Avokatit të Popullit ka përgatitur lidhur me të drejtat e anëtarëve të komuniteteve egjiptiane e rome;
- ✓ mediat e shkruara dhe audiovizive në nivel lokal për promovimin e zyrave rajonale dhe të mandatit të institucionit;
- ✓ promovimi i aktivitetit të zyrave rajonale në rrjetet sociale.

Disa nga aktivitetet e lidhura me promovimin e zyrave rajonale dhe të institucionit të Avokatit të Popullit për komunitetet egjiptiane dhe rome janë si më poshtë:

- ✓ Organizimi i ditëve të hapura dhe takime me përfaqësues të shoqatave të komuniteteve egjiptiane dhe rome në nivel vendor në qarkun e Beratit, Gjirokastrës, Vlorës;
- ✓ Pjesëmarrje në aktivitetin e zhvilluar nga Bashkia Berat, në partneritet me UNDP Shqipëri, në Ditën Ndërkombëtare Rome;
- ✓ Pjesëmarrje në takimet me Anëtarët e Grupit të Task Forcës Bashkiake ROMACTED në Bashkitë e Pogradecit dhe Vlorës;
- ✓ Pjesëmarrje në takimin e organizuar në Vlorë nga organizata "Drejtësi Sociale" mbi mundësitë e përfitimit të ndihmës ligjore, parësore dhe dytësore, me anëtarë të komunitetit Rom dhe Egjiptian;
- ✓ Takim në Zyrën Rajonale Vlorë me Kryetaren e Komunitetit Rom të Njësisë Administrative Novoselë për të diskutuar mbi problematikat e komunitetit si dhe krijimin e urave lidhëse për referimin e rasteve.

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se mbrojtja e ekzistencës së minoriteteve dhe akomodimi i diversitetit në shoqëri duhet të jetë një objektiv i përhershëm i shtetit shqiptar për të ndërmarrë masa shtesë si për t'u paraprirë, ashtu edhe për t'i zgjidhur problemet sa herë që ato lindin.

Vizioni i Avokatit të Popullit bazohet në frymën shumë të mirë ekzistuese të bashkëjetesës ndërmjet, popullsisë mazhoritare me atë minoritare dhe konsideron se, minoritetet në Shqipëri janë një pasuri kombëtare e çmueshme për të shkuarën dhe të ardhmen e vendit ndaj dhe respekti ndaj të drejtave të minoriteteve nuk është një privilegj që shteti dhe shoqëria jonë u bën atyre por një detyrim dhe një proces i natyrshëm që bazohet tek dinjiteti njerëzor dhe diversiteti, duke prezantuar kështu një investim madhor që një shoqëri i rezervon vetvetes për të ardhmen.

3.22 Respektimi i të drejtave në fushën e sigurimeve shoqërore[159]

E drejta e sigurimeve shoqërore është një e drejtë kushtetuese, e cila bën pjesë në grupin e lirive dhe të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.[160]

Sigurimet shoqërore në Shqipëri mbrojnë në mënyrë të detyrueshme gjithë shtetasit ekonomikisht aktivë, në rastin e pakësimit të të ardhurave si pasojë e barrëlindjes, pleqërisë, invaliditetit dhe humbjes së mbajtësit të familjes, i japin mbrojtje të detyrueshme gjithë personave të punësuar në rastin e pakësimit të të ardhurave si pasojë e paaftësisë së përkohshme të shkaktuar nga sëmundja, aksidenti në punë, sëmundja profesionale dhe papunësia.

Referuar ankesave të regjistruara e administruara për vitin 2022, rezulton të jenë trajtuar *66 raste*, nga të cilat *63* rezultojnë me statusin e çështjes së mbyllur dhe *3* janë në proces shqyrtimi. Në favor të qytetarëve, janë zgjidhur pa rekomandim *25 raste.*

Nga perspektiva e insitucionit të Avokatit të Popullit, në ushtrim të mandatit të tij, si mbrojtës i të drejtave dhe lirive të individit, konstatohet se problematikat më të spikatura të parashtruara në objektin e ankesës së qytatarëve, vijojnë të jenë identike apo të ngjashme me problematikat e raportura në vitet pararendës, ku spikasin: (i) masa e ulët e përfitimit të pensionit të pleqërisë, (ii) mosnjohja e vjetërsisë në punë, mosdhënia e grupit të invaliditetit nga Komisionet përkatëse të Caktimit të Aftësisë për Punë, (iii) mospërfitimi i shtesave të pensionit të pleqërisë, për datën e lidhjes së pensionit të pleqërisë, (iv) mosvënie në dispozicion të kopjeve të dokumentacionit të dosjes të pensionit, (v) zvarritje në lidhjen e pensionit të pleqërisë, për punë të bërë në profesion të vështirë etj.
Gjithashtu, vërehet përgjatë procesit të trajtimit të ankesave të depozituara nga qytetarët, identifikimi i një numri të konsiderueshëm ankesash si të pabazuara. Në tagrin e tij ligjor si këshillues, Avokati i Popullit, ka orientuar qytetarët se si ti qasen zgjidhjes së problematikës, përmes ndjekjes se ankimit administrativ në Komisionet Rajonale të Apelit pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore si dhe në Komisionin Qëndror të Apelit pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Më specifikisht, institucioni i Avokatit të Popullit, evidenton dhe shtjellon sa më poshtë, problematikat më përfaqësuese, të cilat afektuan një numër të konsiderueshëm qytetarësh gjatë vitit 2022, në fushën e sugurimeve shoqërore:

✓ *Masa e ulët e pensionit të pleqërisë si pasojë llogaritjeve të pasakta nga ana e Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore*.

Një numër i konsiderueshën ankesash, janë referuar pranë institucionit tonë me objekt llogaritje jo të drejtë të pensionit të pleqërisë. Për të përmirësuar situatën e përfituesve, gjatë shqyrtimit të çështjeve, u kemi sugjeruar Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, rillogaritje të masës së pensionit të pleqërisë, duke rishqyrtuar dokumentacionin e depozituar në dosjen e pensionit.

[159] Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Përgjithshëm në institucionin e Avokatit të Popullit.
[160] Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 52, pika 1.

Qytetarëve, pas rillogaritjeve të kryera, u ka ndryshuar masa e pensioneve dhe njëkohësisht kanë përfituar shtesa kreditore.

✓ *Mosnjohja e viteve të punës në llogaritjen e pensionit të pleqërisë.*

Në këtë aspekt, për t'u ardhur në ndihmë qytetarëve, të cilët i janë drejtuar institucionit tonë për mosnjohje të viteve të punës nga Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, duke sjellë si pasojë masë me të ulët përfitimi të pensionit të pleqërisë, veprimtaria e institucionit të Avokatit të Popullit ka konsistuar në ndërhyrjen institucionale pranë Arkivit Qendror të Sigurimeve Shoqërore si dhe institucioneve të tjera shtetërore, duke i mundësuar pajisjen me vërtetimin të vjetërsisë në punë.
Me dërgimin e dokumentacionit të vjetërsisë në punë, kemi orientuar qytetarët për t'i paraqitur pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, ku ata kanë vendbanimin, me qëllim përfitimin e një masë pensioni më të lartë apo dhe plotësimin e dokumentacionit të munguar për aplikim të përfitimit të pensionit të pleqërisë.

✓ *Mosnjohja e të viteve të punës në kohën e vuajtjes së dënimit jopolitik, në llogaritjen e pensionit të pleqërisë.*

Për mospërfitim të një mase më të lartë pensioni pleqërie, disa qytetarë i janë drejtuar institucionit tonë, pasi nuk u njihen vitet e punës së bërë në kohën e vuajtjes së dënimit jopolitik. Pretendimi i tyre qëndron në faktin se ata kanë kryer dënimin duke punuar në interes publik dhe me punën e tyre kanë kontribuar në dobi të shoqërisë.

Me marrjen në shqyrtim të kësaj çështje kemi zhvilluar korrespondencë intensive me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë si dhe Institutin e Sigurimeve Shoqërore. Në mungesë të një akti ligjor apo nënligjor rregullues të kësaj çështje dhe në kushtet kur nuk konfirmohen me dokumentacion zyrtar periudhat e punës (me të gjithë elementët respektive, si data e fillimit dhe e mbarimit të punës, orët ditore, paga, kualifikimi, prefesioni etj) të deklaruara nga të dënuarit si të kryera gjatë vuajtjes së dënimit për arsye jopolitike, Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka refuzuar kërkesat për njohjen e periudhave të tilla të deklaruara.
Në këto kushte i kemi sugjeruar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë marrjen në konsideratë të kërkesës për rregullimin ligjor me njohjen e viteve të punës së bërë gjatë vuajtjes së dënimit me burg, për të dënuarit jopolitikë, kryesisht në nëntokë. Informojmë se kjo çështje është ende në proces shqyrtimi nga ana e këtij institucioni.

Problematikë edhe për këtë vit vijon të mbetet pajisja e qytetarëve me aktet e ndodhura në dosjen e tyre të pensionit. Ankuesit kanë adresuar institucionin tonë duke kërkuar ndihmën e Avokatit të Popullit për vënien në dispozicion të tyre. Pas ndërhyrjeve tona institucionale, ankuesve i është bërë e mundur pajisja me dokumentat e kërkuara.
Avokati i Popullit konstaton se qytetarët problemin e masës së pensionit që ata përfitojnë, e shohin në këndvështrimin e një diskriminimi që u bëhet atyre nga shteti për punën dhe kontributin e dhënë ndër vite. Ata kërkojnë të ketë edhe një bazë më të mirë për politikat që ndjek shteti në fushën e sigurimeve shoqërore.

Megjithëse kohe pas kohe janë bërë përmirësime ligjore në këtë fushë, përsëri vihet re se ka diferenca të masës së pensioneve të qytetarëve. Pensionet e ulta mbeten një çështje e ndjeshme publike. Shuma e pensionit për shumicën e përfituesve është nën nivelin e duhur për të përmbushur nevojat bazë të jetës.

Për të gjithë shtetasit shqiptarë, të cilët sot janë kontribues, si dhe ata që janë përfitues, apo edhe për ata që porsa kanë hyrë në këtë skemë, është me rëndësi të marrin atë përfitim për të cilën ata kanë kontribuar ndër vite.

3.23 Të drejtat e të moshuarve[161]

Institucioni i Avokati i Popullit, si një institucion që garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, ka në prioritetet e punës së tij edhe mbrojtjen e të drejtave të të moshuarve, të cilët kategorizohen si një ndër grupet më vunerabël dhe më të ekspozuar ndaj riskut të mosrespektimit dhe garantimit të të drejtave të tyre, te saksionuara në legjislacionin vendas dhe atë ndërkombëtar.

Për të garantuar të drejtat e tyre, për siguri sociale, për akses në shërbimet e kujdesit shëndetësor, për një transport falas etj, ndër vite institucioni ka artikuluar kërkesën e tij, në formën e rekomandimeve për administratën shtetërore dhe, veçanërisht për ministritë e linjës, në lidhje me miratimin e statusit të moshës së tretë.

Në ushtrim të mandatit të tij kushtetues për promovimin, parandalimin e shkeljes dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të ligjshme të individëve, nga veprimet e paligjshme dhe të parregullta të administratës publike dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, Mekanizmi Kombëtar në rolin e Avokatit të Popullit ka monitoruar, promovimin dhe garantimin e të drejtave të personave të moshuar.

Në zbatim të detyrimeve ligjore, MKPT-ja ka monitoruar përgjatë vitit 2022, nivelin e respektimit të drejtave të të moshuarve, të cilët janë të akomoduar në institucionet e përkujdesit social, nëpërmjet inspektimeve përkatësisht, në shtëpitë e të moshuarve Gjirokastër, Shkodër, dhe Fier. Nga këto inspektime problematikat kryesore të konstatuara janë:

- ✓ Mungesa e kapaciteteve të mjaftueshme njerëzore, të domosdoshme për të ofruar shërbimet sipas standardeve të përkujdesit shoqëror. Pavarësisht shtimit të personelit me kujdestar, rezulton se është punësuar me kohë të pjesshme.
- ✓ Krevatet ekzistuese për kategorinë e të moshuarve me probleme të rënda shëndetësore në lëvizje, nuk janë të përshtatura në funksionalitet për këta përfitues. Ky fakt përbën burim për gjenerimin e vështirësive/problematikave konkrete jo vetëm për këtë kategori përfituesish, por edhe për stafin punonjës, i cili i shërben përfituesve të kësaj kategorie.
- ✓ Konstatohet se për kryerjen e aktiviteteve të ndryshme jashtë institucionit, nuk ka fonde të mjaftueshme. Aktivitetet social-kulturore, zakonisht zhvillohen brenda institucionit.

[161] Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Përgjithshëm në institucionin e Avokatit të Popullit.

Pas inspektimeve të kryera dhe evidentimit të problematikave, janë hartuar rekomandime konkrete të cilat i janë dërguar strukturave përkatëse shtetërore, kryetarëve të bashkive dhe Shërbimit Social Shtetëror dhe, fokusi i tyre ka qenë i orientuar drejt përmirësimit të kushteve të jetesës e zbatimin sa më cilësor të standardeve të përkujdesit social për këtë kategori.

3.24 E drejta për një mjedis të shëndetshëm[162]

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e ka paraparë të drejtën "*për një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm*", si synim të objektivave sociale dhe përgjegjësi të shtetit, brenda kompetencave të tij. Kushtetuta parashikon gjithashtu të drejtën për informim si e drejtë dhe liri themelore e njeriut. Kjo mbrojtje vjen më e plotë referuar ligjit nr.10431, datë 09.06.2011 'Për Mbrojtjen e Mjedisit', i ndryshuar, i cili parashikon si një parim të rëndësishëm të drejtën për informim dhe pjesëmarrjen e publikut në procedurat e vendimmarrjes mbi çështjet mjedisore.

Në kuadër të të drejtës për akses në një mjedis të pastër, të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm, Avokati i Popullit në veprimtarine e tij për vitin 2022, ka nënvizuar rëndësinë që duhet t'i kushtohet gjendjes së mjedisit dhe mbrojtjes së ambientit në Shqipëri, duke ndjekur me prioritet, monitorimin e situatës mjedisore në Republikën e Shqipërisë, si edhe zbatimin e legjislacionit respektiv për këtë fushë nga institucionet qendrore dhe organet e qeverisjes vendore.
Institucioni i Avokatit të Popullit i ka kushtuar ndër vite një vëmendje të veçantë trajtimit të ankesave dhe problematikave që kane të bëjnë me mbrojtjen e qytetarit dhe garantimin e cilësisë se jetës dhe shëndetit të tyre, duke sensibilizuar dhe ndërgjegjësuar ndër të tjera edhe organet e administratës publike për ushtrimin rigoroz të funksioneve dhe përgjegjësive ligjore.

Në kuadër të tagrit të tij ligjor, institucioni i Avokatit të Popullit ka monitoruar përgjatë vitit 2022 e në vijim, problematikat sa i përket të drejtës për një mjedis të shëndetshëm, të bëra prezent, qoftë nëpërmjet ankesave të ndryshme të depozituara pranë institucionit, por edhe ato të evidentuara në rastet e bëra publike në median e shkruar dhe online.

Referuar rasteve të trajtuara nga institucioni i Avokatit të Popullit, jo vetëm ankesa por dhe raste *me iniciativë*, të cilat burimin e kishin nga publikimi në mediat vizive, të shkruara, por edhe *online*, për vitin 2022, rezulton të jenë trajtuar gjithsej *41 raste, 14 ankesa individuale të qytetarëve të depozituara pranë institucionit dhe 27 raste të filluar me iniciativë, të cilat evidentuan ekzistencën e problematikave kryesore, të tilla si: (i) ndotja e bregdetit, (ii) ndotja akustike, (iii) ndotja e ajrit, (iv) ndotja e mjedisit pranë lumenjve si dhe shkarkimi i ujërave të zeza të papërpunuara në to.*

Përgjithësisht, ankesat e qytetarëve të paraqitura pranë Avokatit të Popullit pasqyrojnë problematikat me të cilat ata ballafaqohen sa i përket sistemit aktual të menaxhimit të mbeturinave dhe mbrojtjen joadekuate të komponentëve të ndryshëm mjedisor, të cilët mund të kenë efekt të drejpërdrejtë në cilësinë e shëndetit të tyre.

[162] Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Përgjithshëm në institucionin e Avokatit të Popullit.

Referuar rasteve më specifike të shqyrtuara nga institucioni i Avokatit të Popullit për të cilat hetimi administrativ është përmbyllur me hartimin e rekomandimeve[163] përkatëse për vitin 2022, do specifikonim rekomandimin drejtuar Bashkisë Durrës dhe Ujësjellës Kanalizimeve sh.a Durrës[164] mbi rastin e ndërmarrë me iniciativë me objekt**:** *Banorët e Durrësit ankohen për ndotjen e zonës Currila.* Duke analizuar specifikën e këtij rasti dhe korespondencën zyrtare të dërguar nga ana e Ujësjellës Kanalizimeve Durrës, ku shprehet se, "*banorët e Durrësit vazhdimisht ankohen për ndotjen e zonës dhe se kjo problematikë ende nuk është zgjidhur në mënyrë afatgjatë dhe përfundimtare"*, institucioni ynë rekomandoi sa më poshtë:

✓ Marrjen e masave të menjëhershme për planifikimin në buxhet për ndërtimin e një sistemi të ri kanalizimesh në zonën e Currilave Durrës me qëllim zgjidhjen përfundimtare të situatës së krijuar e cila do të ndikonte në uljen e rrezikut të efekteve serioze në shëndetin publik dhe mjedisit në tërësi;

✓ Marrjen e masave për aplikuar në progame të ndryshme ndërkombëtare që ofrojnë mbështetje për trajtimin e ujërave të ndotura.

Në vlerësim të përgjigjeve të dhëna nga institucionet përgjegjëse si Bashkia Durrës dhe Ujësjellës Kanalizime sh.a Durrës, *informohemi se problematika është pranuar dhe se në buxhetin e vitit 2023 është parashikuar investimi për zgjidhjen afatgjatë dhe me efikastitet të situatës së krijuar përgjatë rrugës 'Currila'. Në këtë kuadër evidentojmë se ky rekomandim është pranuar plotësisht dhe po merren masat e duhura për zbatimin e tij*.

Në veprimtarinë e tij përgjatë vitit 2022, Avokati i Popullit konstaton, se njësitë e qeverisjes vendore në bashkëpunim me autoritetet qëndrore përgjegjëse për fushën e mjedisit, vijojnë mospërmbushjen e detyrimeve ligjore që rrjedhin nga e drejta për mjedis të pastër dhe të shëndetshëm. Më konkretisht, kjo problematikë është trajtuar në rastin e ndërmarrë me iniciativë me objekt**:** ndotja e lumit Gjanica në nivele alarmante, për të cilën hetimi administrativ është përmbyllur me hartimin e rekomandimit drejtuar Bashkisë Fier, Bashkisë Mallakastër, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit si edhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë[165].

Në këtë rekomandim, gjetjet e Avokatit të Popullit treguan se qëllimi kryesor i parashikuar në ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit, mbrojtja e jetës dhe shëndetit nuk është realizuar, ndër të tjera në përgjigjet e institucioneve, vërehet mungesa e masave parandaluese për shkarkimin e ujërave të pa trajtuara, në veçanti atyre industriale dhe mbeturinave. Zbatimi i parimit të parandalimit kërkon një nivel më të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit. Pra, institucionet duhet të bëjnë shumë më tepër përpjekje në mënyrë që të arrihet mbrojtja efikase e së drejtës për një jetë të shëndetshme dhe mbrojtjes së mjedisit. Në lidhje me këtë rast, institucioni ynë rekomandoi sa më poshtë:

✓ Marrjen e masave në një kohë sa më të shpejtë, të mundshme, duke shfrytëzuar të gjitha mjetet ligjore që, Bashkisë Fier dhe Mallakstër, i jepen nga ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", për eliminimin e ndotjes së shkaktuar në ujrat e lumit Gjanicë dhe mjedisit përreth;

---

[163] Gjatë vitit 2022 janë hartuar 5.rekomandime që lidhen me fushën e mbrojtjes së mjedisit.

[164] Nr. Dok. 202200931 17.11.2022. Rekomandohet marrja e masave të menjëhershme për investime në infrastrukturë në zonën e Currilave Durrës.

[165] Nr. 202200631 datë 27.12. 2022. Rekomandohet marrja e masave të menjëhershme për eliminimin e ndotjes së shkaktuar në ujrat e lumit Gjanicë dhe mjedisit përreth.

✓ Marrjen e masave në një kohë sa më të shpejtë, të mundshme nga Ministria e Turizimit dhe e Mjedisit në rritjen dhe forcimin e monitorimeve nga inspektoriatet përkatëse me synim zbatimin rigoroz të ligjit;

✓ Marrjen e masave të menjëhershme për ngritjen dhe vendosjen në funksion të një sistemi të përshtatshëm për menaxhimin e mbetjeve për të shmangur ndotjen masive nga ky fenomen;

✓ Marrjen e masave nga Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për planifikimin në buxhetin afatmesëm të një fondi të dedikuar për përmirësimin e infrastrukturës për menaxhimin e integruar të mbetjeve;

✓ Marrjen e masave nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore për hartimin e planit lokal të menaxhimit të mbetjeve shoqëruar me aktivitete dhe buxhetet përkatëse;

✓ Marrjen e masave nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, përkatësisht bashkëpunim ndërmjet disa bashkive, për vlerësimin e zonave të mbulimit për vend depozitimet e reja;

✓ Marrjen e masave nga institucionet përgjegjëse në nivel qëndror dhe vendor, për hartimin dhe implementimin e një plani të mirëfilltë menaxhimi të mbetjeve të ngurta urbane në gjithë territorin e Bashkisë Fier dhe Mallakastër;

✓ Marrjen e masave për koordinimin dhe bashkërendimin e punës dhe veprimtarisë ndërmjet organeve të administratës publike në nivel qëndror dhe vendor në ushtrimin e kompetencave të tyre për menaxhimin e mbetjeve.

Në vlerësim të përgjigjeve të dhëna nga institucionet përgjegjëse, Avokati i Popullit konstaton se *ky rekomandim është pranuar pjesërisht nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore ndërsa Ministria e Turizmit dhe Mjedisit përmes AKM informon se në hetimin e programit vjetor të vitit 2023 do të merret parasysh hetimi i zonave të ndotura apo potencialisht të ndotura, duke vlerësuar gjëndjen e ndotjes nga rezultatet e monitorimit të mjedisit për vitin 2022*. Ndërsa, është e rëndësishme të theksohet, se institucioni i Avokatit të Popullit, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore do të monitorojë në vijimësi, zbatimin e rekomandimit dhe përmbushjen e detyrave dhe kompetencave ligjore, lidhur me garantimin dhe mbrojtjen e të drejtës për mjedis të shëndetshëm dhe ushtrimin efektiv kësaj të drejte në praktikë.

Gjithashtu, Avokati i Popullit vëren se një nga sfidat në sektorin e mjedisit mbetet dhe menaxhimi i mbetjeve, më konkretisht në raportet për "gjëndjen e mjedisit", nënvizohen si probleme kryesore, mungesa e një pjese të infrastrukturës për menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane, mungesa në shkallë kombëtare e landfilleve për mbetjet e rrezikshme dhe për mbetjet inerte.

Në lidhje me menaxhimin e integruar të mbetjeve. Avokati Popullit konstaton se ky sektor vazhdon të paraqesë problem serioz në mbrojtjen e mjedisit, në këtë kuadër, kjo problematikë është trajtuar në rastin e ndërmarrë me iniciativë me objekt**: "***Ndotje ekologjike, lumi Ishëm mbulohet nga shishet dhe mbetjet plastike",* për të cilën hetimi administrativ është përmbyllur me hartimin e rekomandimit drejtuar ; Bashkisë Tiranë, Bashkisë Kamëz, Bashkisë Fushë-Krujës, Bashkisë Durrës, Bashkisë Kurbin, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.[166]

[166] Nr. Dok. 202200667, datë 13.12.2022. Rekomandohet marrja e masave të menjëhershme për eliminimin e ndotjes së shkaktuar në ujrat e lumit Ishëm dhe mjedisit përreth.

Në rastin e trajtuar me iniciativë, konstatohet se problematika është tepër serioze në drejtim të shëndetit të qytetarëve dhe megjithëse ekziston prej disa kohësh ende nuk nuk janë marrë masat e duhura për të arritur rezultate konkrete në garantimin e të drejtës për një mjedis të shëndetshëm. Në lidhje me këtë rast, institucioni ynë rekomandoi sa më poshtë:

- ✓ Marrjen e masave nga Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit për përafrimin e plotë të kuadrit ligjor me direktivat e BE-së për mbetjet, në kuadër të kapitullit 27 për fushën e Mjedisit dhe Ndryshimeve Klimatike;
- ✓ Marrjen e masave nga Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për planifikimin në buxhetin afatmesëm të një fondi të dedikuar për përmirësimin e infrastrukturës për menaxhimin e integruar të mbetjeve;
- ✓ Marrjen e masave nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore për hartimin e planit lokal të menaxhimit të mbetjeve shoqëruar me aktivitete dhe buxhetet përkatëse;
- ✓ Marrjen e masave nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, përkatësisht bashkëpunim ndërmjet disa bashkive, për vlerësimin e zonave të mbulimit për vend depozitimet e reja;
- ✓ Marrjen e masave të menjëhershme për ngritjen dhe vendosjen në funksion të një sistemi të përshtatshëm për menaxhimin e mbetjeve për të shmangur ndotjen masive nga ky fenomen;
- ✓ Marrjen e masave nga Institucionet përgjegjëse në nivel qëndror dhe vendor, për hartimin dhe implementimin e një plani i mirëfilltë menaxhimi të mbetjeve të ngurta urbane në gjithe territorin e Bashkisë Tiranë dhe Kamëz, Fushë-Krujë, Durrës dhe Kurbin ku është dhe Zona e Grykëderdhjes Ishëm;
- ✓ Marrjen e masave për koordinimin dhe bashkërendimin e punës dhe veprimtarisë ndërmjet organeve të administratës publike në nivel qëndror dhe vendor në ushtrimin e kompetencave të tyre për menaxhimin e mbetjeve.

Në vlerësim të përgjigjeve të dhëna nga institucionet përgjegjëse, Avokati i Popullit vlerëson se Bashkia Durrës, Bashkia Kamëz dhe Bashkia Fushë-Krujë *kanë pranuar rekomandimin duke na informuar se janë angazhuar për zbatimin e tyre*. Ndërsa Bashkia Tiranë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit *nuk kanë kthyer asnjë përgjigje* në lidhje me marrjen e masave për zbatimin e rekomandimit. Po ashtu Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë informon se nuk e ka në fushën e saj të përgjegjësisë menaxhimin e mbetjeve dhe është në proces të transferimit të përgjegjsive tek MTM. Në këtë konteks konstatojmë se *ky rekomandim është pjesërisht i pranuar*.

Avokati i Popullit vlerëson se, situata emergjente që ndodhet dhe vendi ynë, sa i përket ndotjes së mjedisit, sistemit aktual të menaxhimit të mbeturinave dhe mbrojtjes joadekuate të komponentëve të ndryshëm mjedisor, me efekt të drejtpërdrejtë në cilësinë e shëndetit të tyre, përpos ndryshimeve klimaterike të shkaktuara nga aktiviteti i dëmshëm njerëzor, kërkojnë bashkëpunim sistematik dhe të koordinuar të të gjithëve autoriteteve përgjegjëse në të gjitha nivelet për të ruajtur mjedisin për brezat aktual dhe ato të ardhshëm.

Avokati i Popullit konfirmon rëndësinë që duhet t'i kushtohet gjendjes së mjedisit dhe mbrojtjes së tij në Shqipëri. Kjo fushë kërkon një vëmendje të shtuar sa i përket ushtrimit rigoroz dhe me efektivitet të përgjegjësive ligjore nga organet e ngarkuara me ligj, veçanërisht sa i përket zbatimit me rigorozitet të dispozitave të akteve ligjore dhe nënligjore, me qëllim krijimin e një

impakti pozitiv në drejtim të përmirësimit të gjendjes së mjedisit në Shqipëri, si edhe garantimin e standardeve të një mjedisi sa më të shëndetshëm i cili mundëson cilësi të mirë të jetesës dhe të shëndetit të qytetarëve.

KREU 4

Angazhime të tjera institucionale

4.1 Studimi "Dhuna ndaj grave në politikë"[167]

Studimi "Dhuna ndaj grave në politikë"[168], është një studim i cili u iniciua gjatë vitit zgjedhor 2021, duke u nisur nga problematika të tilla si përdorimi i gjuhës seksiste dhe diskriminuese gjatë fushatës zgjedhore. Studimi u krye në partneritet midis Avokatit të Popullit dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur me ekspertizë teknike nga UNDP në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara "*T'i japim fund Dhunës ndaj Grave në Shqipëri*", financuar nga Qeveria e Suedisë. Ky studim u lançua më 6 prill 2022 në ambientet e Kuvendit të Shqipërisë, ku morrën pjesë deputetë, përfaqësues të institucioneve shtetërore, organizatave ndërkombëtarë, shoqërisë civile etj.

Dhuna ndaj grave në politikë është një fenomen botëror dhe përbën shkelje të të drejtave të njeriut. Studimet ndërkombëtare tregojnë se format e dhunës si ajo fizike, psikologjike, seksuale dhe ekonomike ndërveprojnë me njëra-tjetrën duke qenë prezente në politikë. Vetëm në vitet e fundit, studiuesit janë fokusuar në dimensionet gjinore të dhunës në politikë. Studimet tregojnë se gratë politikane, në raport me burrat politikanë, kanë më shumë gjasa të përjetojnë dhunë të padukshme (Bjarnegård, 2018), të përballen me dhunën pas dyerve të mbyllura (Krook, 2020), si dhe të bëhen shënjestër e dhunës psikologjike (Bardall et al., 2020). Studime të tjera tregojnë se gratë kanë më shumë gjasa se burrat që të jenë objekt i kërcënimeve dhe akuzave me natyrë seksuale (Bjarnegård et al., 2020). Autorët e dhunës shënjestrojnë në veçanti gratë të cilat mbajnë pozicione të rëndësishme në politikë dhe janë të pranishme në media (Håkansson, 2021).

Në kontekstin shqiptar ka patur pak studime të lidhura me dimensionin gjinor në politikë. Gratë dhe vajzat, gjatë proceseve të kandidimit për të qenë pjesë e politikës shqiptare shpesh përballen me sfida të vështira, duke kandiduar në kushte të pabarabarta me burrat si dhe në një luftë të vazhdueshme për të ruajtuar dinjitetin. Ndërkaq mekanizma të tilla rregullatore si kuotat gjinore, të parashikuara në ligjin nr.9970, datë 24.07.2008 dhe Kodin Zgjedhor në masën mbi 30% për gjininë më të nënpërfaqësuar, nuk kanë arritur të sigurojnë barazinë reale në vendimarrjen politike, ndërkohë që shpesh përdoren si një argument që gratë i fitojnë postet si rezultat i aplikimit të kuotave dhe jo i aftësive të tyre. Ndaj një analizë e thelluar ishte mëse e domosdoshme, duke konsideruar se dhuna ndaj grave në politikë përbën shkelje të të drejtave të njeriut dhe përforcon margjinalizimin e grave në politikë.

Gjetjet kryesore të idendifikuara:

---

[167] https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/VIOLENCE%20AGAINST%20WOMAN%20IN%20POLITIC.pdf. https://www.undp.org/albania/publications/violence-against-women-politics.

[168] Për qartësi ky studim është realizuar në kuadër të rolit tone si promovues e nuk është një studim i realizuar në kuptim të nenit 27, të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 " Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar.

Analiza tematike identifikoi forma të ndryshme të dhunës që përjetojnë gratë: Përçmim dhe gjuhë ofenduese; ndërprerje e fjalës, tallje, fyerje, batuta; akuza të rreme në media; kërcënime; vënie në dyshim e aftësive të grave; heqja e grave nga listat e kandidatëve të partisë; refuzimi i aksesit në financat e partisë gjatë fushatave zgjedhore; shkarkimi ose kërcënimi për shkarkimin e grave (dhe anëtarëve të familjes së tyre) nga poste shtetërore; akuza të rreme dhe thashetheme të natyrës seksuale; ngacmim seksual; injorimi i grave gjatë takimeve; konsiderimi i kontributit të grave si pak ose aspak i rëndësishëm; kufizimi i rolit të grave në votimin e vendimeve të paracaktuara; manipulimi i votës së grave gjatë procedurave të votimit; përjashtimi i grave nga informacioni.

Për gratë, veçanërisht për gratë të cilat janë përpjekur të arrijnë pozicione drejtuese në parti – partia ku ato aderojnë është burimi kryesor i dhunës. Gratë u shprehën se drejtuesit e partive zgjedhin të preferuarit e tyre, persona të cilët nuk janë gjithmonë të kualifikuar ose nuk kanë lidhje të forta me bazën, injorojnë opinionet e anëtarëve të partisë, heqin nga listat e kandidatëve anëtarë të partisë me kontribut afatgjatë, paracaktojnë rezultatet zgjedhore, shpërndajnë burimet në mënyrë të padrejtë (p.sh. fondet gjatë fushatave zgjedhore), si dhe nuk janë transparentë gjatë vendimmarrjes. Gratë e reja në moshë thanë se, në publik, drejtuesit e partive duket sikur i mbështesin gratë, por "në prapaskenë" i kërcënojnë dhe i diskriminojnë ato. Gratë e cilësuan dhunën me të cilën janë përballur në parti si "të padukshme, të fshehtë dhe të vështirë për t'u trajtuar".

Një përqindje më e lartë e kandidatëve politikë thanë se gjuha poshtëruese dhe lajmet e rreme (55,56%) janë pjesë normale e politikës, pasuar nga frikësimi (intimidimi) dhe dhuna (42,16%), kërcënimi ndaj politikanëve (30,16%), dëmtimi i pronës (16,34%) dhe dhuna fizike (6,86%).

Kandidatët politikë raportuan se u ishte mohuar mbështetje financiare nga partia (18,52%), ishin përballur me kërcënime për largimin nga puna për shkak të përfshirjes në politikë (12,79%), si dhe me kërcënime nga anëtarët e familjes – kërcënime për shkëputjen nga burimet ekonomike apo pronat – për shkak të përfshirjes në politikë (6,89%).

Gjuha poshtëruese dhe lajmet e rreme shënjestrojnë kryesisht gjininë (23,40%), moshën (21,28%), statusin social (21,28%) dhe statusin ekonomik (17,02%). Përqindja e grave që thanë se gjuha poshtëruese apo lajmet e rreme me të cilat ishin përballur ishin të një natyre seksuale, ishte më e lartë në krahasim me burrat. 43,18% e grave që ishin përballur me gjuhë poshtëruese apo lajme të rreme u shprehën se kjo lloj dhune ishte e një natyre seksuale. Ndërkohë, vetëm 8% e burrave raportuan të njëjtën gjë.

Kandidatët politikë i kanë ndarë përjetimet e dhunës kryesisht me familjen (80,70%) dhe me miqtë (78,95%). Një numër i vogël i të anketuarve thanë se kishin komunikuar me Policinë e Shtetit (n = 5), Avokatin e Popullit (n = 1) dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi (n = 2).
58 kandidatë politikë (18,95% e të anketuarve ose 57,42% e personave që kishin përjetuar dhunë) thanë se i kishin ndarë përvojat e tyre me partinë. Strukturat kryesore me të cilat kandidatët politikë i kanë ndarë përvojat e tyre ishin drejtuesit e partive (68,42%) dhe koordinatorët politikë (52,63%).

Kandidatët politikë priren të nënraportojnë eksperiencat e dhunës në politikë. Një nga shqetësimet e tyre, midis të tjerave, ishte se ndarja e informacionit do të ndikojë negativisht në karrierën e tyre politike.

Sugjerime dhe rekomandime i janë adresuar, në përfundim të këtij studimi, partive politike, organizatava politike të grave, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, organizatave të shoqërisë civile, instituicioneve të të drejtave të njeriut, mediave, si më poshtë:

✓ Trajtimi i dhunës ndaj grave në politikë kërkon që para së gjithash partitë të demokratizohen. Nëse partitë demokratizohen, gratë do të përjetojnë më pak dhunë psikologjike. Përgjithësisht, klima politike do të jetë më pak agresive. Një sistem drejtësie më efikas dhe që reagon, do të rrisë besimin e grave në institucionet shtetërore dhe do t'i nxisë ato që të denoncojnë rastet e dhunës. Partitë politike dhe drejtuesit e e tyre duhet që të krijojnë mekanizma ligjore dhe instrumenta për trajtimin e dhunës në politike, para, përgjatë dhe pas zgjedhjeve.

✓ Organizatat politike të grave duhet të bashkëpunojnë me njëra- tjetrën (Aleanca e Grave Deputete, Aleanca e Grave Këshilltare dhe forumeve politike të tyre) dhe duhet të fokusohen te dhuna me të cilën përballen gratë politikane pas dyerve të mbyllura, si dhe duhet të krijojnë mekanizma dhe rregullore për trajtimin e dhunës politike.

✓ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të luajë një rol proaktiv për të parandaluar dhunën ekonomike (p.sh. shpërndarjen e pabarabartë të fondeve gjatë fushatave zgjedhore) dhe për të monitoruar partitë politike.

✓ Miratimi dhe zbatimi i ligjeve që ndëshkojnë autorët e dhunës (duke përfshirë median), angazhimin e burrave në diskutimin e dhunës politike dhe zhvillimin e shërbimeve sociale për mbështetjen e viktimave të dhunës politike. Sugjerime të tjera përfshinin rritjen e ndërgjegjësimit rreth dhunës politike dhe përfshirjen e konceptit të dhunës politike në sistemin arsimor fillor.

✓ Organeve mbikëqyrëse si Organizatat e shoqërisë civile, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Avokati i Popullit duhet të angazhohen gjatë fushatave zgjedhore për të identifikuar dhe denoncuar rastet e dhunës politike.

Projektet e ardhshme të organizatave të shoqërisë civile duhet të përqendrohen te nxitja e përfshirjes, transparencës dhe drejtësisë në partitë politike, te krijimi i aleancave me forumet politike të grave, te bashkëpunimi me komunitetet për të sfiduar stereotipet gjinore, si dhe tek organizimi i fushatave që nxisin rritjen e pjesëmarrjes së grave në politikë.

✓ Mediat nuk duhet të publikojnë artikuj që përdorin gjuhë poshtëruese, që përforcojnë stereotipet gjinore apo që përjetësojnë dhunën, si dhe, në raste dhune, duhet të reagojnë nëpërmjet botimit të editorialeve. Për të mbështetur përpjekjet për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave në politikë, mediat duhet t'i kushtojnë vëmendje përbërjes së paneleve të diskutimit dhe të evitojnë panelet që përbëhen vetëm nga burra.

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) duhet të ndërmarrë hapa për të garantuar që gratë të cilat kandidojnë për poste politike shfaqen në media dhe atyre u lejohet një minutazh i drejtë televiziv për t'u komunikuar votuesve mesazhin dhe axhendën e tyre politike.

4.2 Raporti "Vlerësim mbi qasjen dhe përdorimin familjar të transfertave të mbrojtjes sociale"[169]

Iniciativa për të kryer këtë raport u nxit nga rastet e paraqitura pranë dy institucioneve, Avokatit të Popullit dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimit dhe u mbështet me ekspertizë teknike në kuadrin e projektit "*Shtrirja e shërbimit ligjor për burrat dhe gratë në Shqipëri*", zbatuar nga PNUD Shqipëri në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe me mbështetjen financiare të Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim. Konkretisht studimi synon vlerësimin e zbatimit në praktikë të legjislacionit dhe programit të ndihmës ekonomike me qëllim identifikimin e pengesave që cenojnë aksesin e familjeve në nevojë dhe individët me status të veçantë si dhe përdorimin e transfertave të ndihmës ekonomike. Vlerësimi synon të shërbejë për të nxitur përmirësimin e cilësisë dhe efektivitetin e mbrojtjes sociale, duke theksuar nevojën për rritjen e kapaciteteve të strukturave përgjegjëse të administratës për zbatimin dhe vlerësimin periodik të politikave sociale në zbatim.

Disa nga gjetjet kryesore të identifikuara janë[170]:

✓ Informacioni mbi të drejtat dhe mundësitë e mbështetjes që ofrohen për secilën kategori është i pamjaftueshëm. Mungon një qasje e njëjtë për ndarjen e informacionit me publikun përmes institucioneve që ofrojnë shërbime e aksesohen më shpesh nga kategoritë në nevojë. Më tej, kategoritë e veçanta nuk kanë informacion që mund të përfitojnë mbështetje përmes dy modaliteteve (si familje në nevojë dhe si kategori e veçantë).

✓ Për viktimat e dhunës që janë larguar në një bashki tjetër, aplikimi pranë bashkisë së origjinës, ku figurojnë të regjistruar është një barrierë që hasin për t'iu qasur mbështetjes. Po ashtu, personat që janë strehuar në strehëza të financuara nga buxheti i shtetit, nuk mund të përfitojnë ndihmë ekonomike gjatë kohës që trajtohen në institucionet publike të përkujdesit (ligji nr. 597/2019).

✓ Kufizimi për të aplikuar brenda 10 ditëshit të parë të muajit sjell vonesa në përftimin e ndihmës ekonomike, ndërkohë që sistemi apo edhe vetë bashkitë nuk kanë parashikuar fleksibilitet për të adresuar raste emergjente që i përkasin kategorive të veçanta.

✓ Gjithashtu, janë identifikuar sfida që lidhen me Urdhrat e Mbrojtjes, konkretisht: varësia e përfitimit të ndihmës ekonomike nga disponimi i Urdhrit të Mbrojtjes (UM) shkakton vonesa të konsiderueshme për marrjen e mbështetjes. Ndërsa, Urdhri i Menjëhershëm i Mbrojtjes (UMM) nuk njihet nga administratorët shoqërorë si dokument i vlefshëm për të nisur procesin e aplikimit për ndihmë ekonomike.

✓ Aplikimi i pagesave paralele nuk është i njëjtë në shumë bashki të vendit. Zbatimi i programeve të mbrojtjes, në pasigurinë e interpretimit të qartë ligjor, duket se udhëhiqet nga praktika më e shpeshtë. Viktima e dhunës në familje mund të aplikojë si familje në nevojë vetëm nëse është në procedurë të zgjidhjes së martesës; ndërkohë detyrimi i pagesës për shërbimin e

[169] Ky raport gjendet në linkun: https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Vler%C3%ABsim%20mbi%20qasjen%20dhe%20perdorimin%20familjar%20te%20transfertave%20te%20MS.pdf.

[170] Ky studim është realizuar para miratimit të hartës së re gjyqësore e disa probleme që lidhen vecanerisht me aksesin në gjykatë të viktimave të dhunës në familje dhe përfitimet në kohë të benefiteve mund të rezultojnë të shtuara.

psikologut në nisjen e procedurës së zgjidhjes së martesës është një kosto e konsiderueshme për këtë kategori.

✓ Vërtetimi i situatës si kategori në nevojë bie në kurriz të qytetarëve, çka kthehet në kosto në momentin që kërkojnë mbështetje juridike falas, pra sistemi kthehet në një qark vicioz në momentin kur duhet të aktivizojë mbështetjen konkrete. Shërbimet që duhet të ofrohen të mirëkoordinuara për kategoritë përfituese janë thelbësore për të siguruar një mbështetje ndërsektoriale e për të mundësuar riintegrimin social të individëve e familjeve në nevojë.

✓ Për viktimat e dhunës në familje, strehimi, punësimi e aksesi në institucionet arsimore për fëmijët e tyre mbeten nevoja prioritare. Masa e pagesave të ndihmës ekonomike është shumë e ulët e nuk ndihmon në daljen nga cikli i mbyllur i varfërisë, duke i mbajtur grupet e cënueshme në të njëjtat kushte, pa u krijuar mundësi për t'u arsimuar apo zhvilluar që të mund të dalin nga cikli i varfërisë.

✓ Ndihma ekonomike përkufizohet në ligjin nr.57/2019 si "pagesa që u jepet individëve dhe familjeve vulnerabël të përcaktuara në ligj". Pavarësisht miratimit të kuadrit ligjor, zbatimi në praktikë i programit të ndihmës ekonomike ka rezultuar problematik nga këndvështrimi i përfitimit të pagesës së ndihmës ekonomike nga ana e kategorive përfituese.

✓ Gjithashtu, raportet dhe të dhënat vjetore të institucioneve të pavarura kombëtare të të drejtave të njeriut si Avokati i Popullit (AP) dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), duke synuar një standard të arsyeshëm jetese që përputhet me dinjitetin njerëzor dhe të drejtat e njeriut, argumentojnë se kriteret për përfitimin e ndihmës ekonomike bien ndesh me nevojat e kategorive vulnerabël dhe nuk marrin parasysh kufirin e varfërisë, çka ka çuar në përjashtimin e mëtejshëm të këtyre kategorive nga mbrojtja sociale.

Nga rastet lidhur me përjashtimin apo skualifikimin për të përfituar paralelisht pagesën e ndihmës ekonomike që janë referuar pranë Avokatit të Popullit nga grupe vulnerabël në përgjithësi, përfshirë viktimat e dhunës në familje, u gjykua e nevojshme kryerja e një vlerësimi mbi zbatimin në praktikë të legjislacionit të ndihmës ekonomike dhe programit të ndihmës ekonomike në përgjithësi me qëllim identifikimin e çështjeve/pengesave kryesore që cënojnë aksesin e familjeve dhe individëve në nevojë e individët me status të veçantë si dhe përdorimin e transfertave në para (cash) të ndihmës ekonomike.

Adresimi i varfërisë përmes ndihmës ekonomike dhe zbatimi në praktikë. Disa nga gjetjet janë:

➢ Informacioni mbi të drejtat dhe mundësitë e mbështetjes që ofrohen për secilën kategori është i pamjaftueshëm. Mungon një qasjeje e njëjtë për ndarjen e informacionit me publikun përmes institucioneve që ofrojnë shërbime e sportelet që aksesohen më shpesh nga kategoritë në nevojë;

➢ Kategoritë e veçanta nuk kanë informacion që mund të përfitojnë mbështetje si familje në nevojë dhe si kategori e veçantë. Ka raste kur administratorët shoqërorë kërkojnë të paraqiten të dy bashkëshortët në aplikim si familje në nevojë edhe pse aplikantja është me urdhër mbrojtjeje e ka një procedurë të zgjidhjes së martesës në proces;

➢ Familjet e individët në nevojë që banojnë në njësitë e largëta e me terren të vështirë hasin vështirësi për të aplikuar për ndihmës ekonomike, si pasojë e mungesës së një transporti publik funksional të shtrirë në zonat rurale dhe pamundësisë për të mbuluar kostot e transportit privatisht;

- Forcimi i kapaciteteve të njësive administrative dhe aktorëve pjesë e mekanizmit referues do të shërbente për garantimin e zbatueshmërinë e kuadrit ligjor dhe ofrimin e informacionit për kategoritë në nevojë;
- Përmirësimi i informacionit dhe aksesit në programet e mbrojtjes sociale. Informacioni mbi të drejtat dhe mundësitë e mbështetjes që ofrohen për secilën kategori është i pamjaftueshëm;
- Përdorimi i regjistrit elektronik (MIS NE) për analizën e profilit të aplikuesve dhe përfituesve si dhe përmirësimi i vazhdueshëm i të dhënave të këtij regjistri. Regjistri elektronik i ndihmës ekonomike përmban informacione me vlerë mbi situatën sociale dhe ekonomike të aplikantëve dhe përfituesve. Analiza e mëtejshme e periodike e këtyre të dhënave mund të shërbejë më mirë për të kuptuar nevojat e individëve e familjeve në nevojë si dhe për të informuar politikëbërjen dhe planifikimin më të mirë të ndërhyrjeve integruese në bashku me punonjësit sociale;
- Forcimi i kapaciteteve të strukturave publike. Është e nevojshme të hartohet një plan për ngritjen e kapaciteteve për të gjithë bashkitë mbi të drejtat dhe udhëzimet lidhur me aksesin dhe aplikimin në pagesat e asistences sociale të kategorive të ndryshme.

Adresimi i sfidave që lidhen me proceset e aksesit dhe zbatimit të pagesave të ndihmës ekonomike. Disa nga sfidat janë:

- Mungesa e informacionit dhe kuptimit të qartë të të drejtës, kritereve të pranueshmërisë dhe aplikimit për të përfituar pagesa të ndihmës ekonomike, si nga ana e administratorëve të sistemit dhe kategorive në nevojë;
- Sfida logjistike që lidhen me aksesin si mobiliteti e kostot e transportit, vështirësia për t'u paraqitur personalisht në bashkinë e origjinës (në rastin e viktimave të dhunës në familje);
- Sfida që lidhen me paragjykimin dhe stigmatizimin e kategorive në nevojë, sidomos viktimave të dhunës në familje, PAK e grupe të tjera të margjinalizuara ndikojnë në dekurajimin e aplikantëve e në besimin e tyre ndaj institucioneve;
- Sfidat lidhur me kuptimin dhe zbatimin e kuadrit rregullator, përfshirë procedurat e Urdhërit të Mbrojtjes.

Studimi identifikoi një sërë sfidash e rekomandimesh lidhur me proceset për të përfituar nga pagesat e Asistences Sociale (NE dhe PAK), dhe konkretisht:

- Mundësimi i aplikimit të viktimave të dhunës të regjistruar si rezidente në bashki tjeter;
- Ofrimi i ndihmës ekonomike për viktimat e dhunës, si kategori të veçanta, në strehëza (publike apo jo-publike). Të ndryshohet neni 11, pika 'dh' e ligjit nr. 597/2019, "Për Asistencën Sociale". Gjithashtu, është i nevojshëm përmirësimi i sistemit që të legjitimojë pagesat e ndihmës ekonomike si viktimë e dhunës në familje edhe mbi bazën e urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes; konkretisht, të pranohen edhe vendime të cilat kanë vetëm datë dhe nuk kanë numër për efekte identifikimi të urdhrit përkatës;
- Sistemi i mbrojtjes sociale duhet të mishërojë, edhe në praktikë, një qasje tërësore të trajtimit të vulnerabilitetit. Sikurse njihet dhe në dokumente politike të sektorit, grupet në nevojë kanë vulnerabilitete të shumëfishta në të cilat gjenden pa zgjedhjen e tyre, ndaj sistemi nuk mund

të jetë përjashtues, por të sigurojë një qasje përfshirëse për sigurimin e aksesit në tërë programet që adresojnë situata të ndryshme, qoftë dhunën në familje, aftësinë e kufizuar apo varfërinë. Është e nevojshme të bëhen ndryshime ligjore përkatëse për të qartësuar, në veçanti, përmbajtjen e nenit 12, pika 6, të ligjit nr. 597/2019, "Për Asistencën Sociale". Po kështu, është e nevojshme të udhëzohen strukturat vendore mbi zbatueshmërinë e ligjit lidhur me pagesat paralele në mënyrë që kategoritë e veçanta të mund të përfitojnë nga masat e ndryshme të mbrojtjes që ofrohen nga sistemi;

- Administratorët shoqërorë, duhet të nxiten të kryejnë vlerësimin socioekonomik dhe verifikimet e nevojshme sipas përcaktimeve ligjore, për aplikimet e kategorive të veçanta si individe/familje në nevojë. Zbatimi i hapave sipas parashikimeve ligjore mund të sigurojë që ndihma të shkojë te më të varfërit, pa cenuar të drejtën e individëve për të aplikuar.

Përmbledhje e ndryshimeve të mundshme ligjore dhe rekomandime:

- Të lejohen shprehimisht pagesat paralele që legjislacioni ndalon për statuse të caktuara të ndryshme juridike të të njëjtit person, si VDF, PAK, individ/ pjesëtar i familjes në nevojë, etj., për pagesa të asistencës sociale (Ndihmë Ekonomike, PAK, etj.) dhe përfitime shtesë paralele në përmbushje të të drejtave dhe standardeve kushtetuese dhe ndërkombëtare, mbi të gjitha, për jetë dinjitoze. Pagesat paralele të lejohen mbi bazën e parimit që duhet të sigurohet mbrojtje sociale për çdo status i cili krijon pasoja të veçanta dhe të shumëfishta për personat që kategorizohen njëkohësisht si përfitues të mbrojtjes sociale e shumë statuseve ligjore në nevojë e vulnerabël;
- Po kështu, të ndryshohen dispozita të caktuara të legjislacionit në fuqi për të mundësuar jo vetëm pagesa paralele brenda skemës të ndihmës ekonomike por, edhe përfitime në natyrë e shërbime paralele. Për këtë qëllim, të rishikohet neni 11, pika 'dh', e ligjit nr. 597/2019, "Për Asistencën Sociale";
- Të parashikohen kritere e metoda të besueshme per llogaritjen e minimumit jetik për qëllime të lejimit të pagesave paralele. Konkretisht, të bëhet ndryshim në ligjin nr. 597/2019, "Për Asistencën Sociale", ku të përfshihen kritere të përcaktimit të minimumit jetik për qëllime të plotësimit të këtij minimumi nëpërmjet pagesave paralele të ndihmës ekonomike, pavarësisht nga lloji, për të përmbushur në menyrë efektive të paktën standardin e minimumit jetik;
- Të thjeshtëzohet kategorizimi i individëve dhe familjeve në nevojë e vulnerabël, përfshirë por pa u kufizuar në Viktimat e Dhunës në Familje (VDF), si dhe vetë skema e ndihmës ekonomike, duke synuar aksesin efektiv të kategorive në nevojë e vulnerabël për shkak të komplikimit dhe/ose moskuptimit të skemës së ndihmës ekonomike (të pagesave dhe përfitimeve të kësaj skeme) dhe të kujdesit social. Për mbështetjen dhe mbrojtjen efektive të VDF-ve me pagesat e skemës së ndihmës ekonomike, rekomandohet ndryshimi ligjor i nenit 12, pika 6, në ligjin nr. 597/2019, "Për Asistencën Sociale": më konkretisht, të ndryshohet formulimi i pikës 6, në nenin 12, për të lejuar shprehimisht pagesat e ndihmës ekonomike për individët dhe pjesëtarët/familjet në nevojë dhe pagesat për VDF dhe pagesat PAK në rastet kur i njëjti individ kualifikohet si kategori përfituese për secilën nga kategoritë që përfitojnë nga pagesat dhe ndihmës ekonomike;
- Të hartohet akt nënligjor/udhëzim i veçantë për administratorin shoqëror me synimin për të shmangur diskrecionin në përfitimin e pagesave dhe përfitimeve të ndihmës ekonomike. Kjo

të pararendet me ndryshim ligjor në ligjin nr. 597/2019, “Për Asistencën Sociale” (neni 23 dhe neni 32);

- Pas ndryshimeve ligjore, të rishikohet formulari dhe Regjistri Elektronik Kombëtar që sistemi të pasqyrojë dhe verifikojë saktësisht kërkesat e ligjit në fuqi. Më tej, të bëhen ndryshime në lidhje me integrimin ligjor të Regjistrit Elektronik të NE dhe Regjistrit Elektronik të PAK në Regjistrin Elektronik Kombëtar. Integrimi të synojë mundësimin e pagesave paralele pas ndryshimeve/saktësimeve përkatëse ligjore.

Integrimi i aktiviteteve informuese dhe advokimit në planet vjetore të punës:

- Kontaktet periodike me komunitetet do të lehtësonin dhe shpërndarjen e informacionit mbi procesin e aplikimit, përfitimin dhe dokumentacionin e nevojshem;
- Administratorët shoqërorë duhet të ndajnë informacionin mbi kushtet e kualifikimit, rregullat e procesit të aplikimeve dhe mbështetjen paralele;
- Duhet të ofrohet informacion lehtësisht i kuptueshëm mbi aplikimin dhe aksesin e mbështetjes në çdo zyrë vendore e hapësira të tjera publike, përfshirë mediat sociale.

Vlerësimi dhe rishikimi i masës së ndihmës ekonomike:

- Strukturat vendore duhet të informohen mbi programet dhe masën e përfitimit që u takon kategorive të veçanta aplikuese si individe/pjestare të familjes në nevojë, duke garantuar shmangien e zbritjes së masës për viktimën e dhunës e llogaritjen e masës vetëm për fëmijët apo anëtarët e tjerë në varësi, të cilët nuk përfshihen në urdhrin e mbrojtjes;
- Masa e ndihmës ekonomike nuk reflekton asnjë lidhje me koston minimale të jetesës. Për më tepër, sistemi duket se llogarit përfitimet si familje në nevojë duke u bazuar në strukturën e familjes dhe të ardhurat e deklaruara e, si rrjedhojë, familjet e kualifikuara me strukturë të njëjtë marrin të njëjtën masë të ndihmës ekonomike edhe nëse nivelet e tyre aktuale të të ardhurave mund të jenë të ndryshme. Procesi i rishikimit të programit të ndihmës ekonomike duhet të përfshijë dhe rishikimin e formularit të vlerësimit socio-ekonomik;
- Deri më sot nuk është gjykuar e përshtatshme të përcaktohet minimumi jetik në Shqipëri; presionet e mundshme ndaj financave publike mund të kenë frenuar miratimin e minimumit jetik. Ndaj edhe përcaktimet e masës së ndihmës ekonomike, pagesave në rastet e dhunës në familje etj, mbeten të palidhura me njëra tjetrën, dhe të llogaritura me metoda të ndryshme, ose dhe arbitrare, edhe pse të gjitha synojnë mbrojtjen sociale të kategorive në nevojë;
- Pjesë e diskutimeve duhet të jetë dhe mundësimi i lidhjes mes masës së ndihmës ekonomike me nivelin e varfërisë apo me pagën minimale. Mungesa e një reference nxit arbitraritetin e cënon synimin e zbutjes së varfërisë e sigurimit të një jetë dinjitoze që asnjë të mos mbetet pas. Ndihma ekonomike dhe përfitimet e tjera duhet të bëhen pjesë e indeksimit periodik, bashkë me pagat.

Llogaritja e masës së ndihmës duhet të mbështetet në vlerësime të plota e mbi analizë të thelluar bazuar në minimumin jetik, e nevojat reale të një familjeje. Si rregull i përgjithshëm, ndryshimet në skemën e përfitimeve duhet të sigurojnë koherencë me qasjen dhe programet e mbrojtjes

sociale dhe standardet ndërkombëtare të pranuara nga Shqipëria dhe të drejtat e standardet kushtetuese.

Ky raport është depozituar në Kuvendin e Shqipërisë më datë *28.12.2022* dhe jemi në pritje të diskutimit të tij në komisionin parlamentar.

4.3 Raporti i veçantë "Politikat e pensionit ushqimor, detyrimit për ushqim, për fëmijët"[171]

Raporti i veçantë "*Politikat e pensionit ushqimor, detyrimit për ushqim, për fëmijët*", është bazuar në numrin e konsiderueshëm të rasteve të trajtuara nga institucioni ynë, ku është konstatuar shkelja e të drejtës së fëmijëve për një nivel jetese të mjaftueshme për një zhvillim fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror si pasojë e mosmarrjes së detyrimit ushqimor që duhet të paguajë prindi, të cilit nuk i është lënë fëmija për rritje dhe edukim. Raporti u hartua me mbështetjen financiare të Save the Children dhe me kapacitetet e brendshme të institucionit.

Ndër vite, Avokati i Popullit ka pasqyruar në raportet vjetore problematikën e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, me objekt detyrimin ushqimor ndaj fëmijëve. Megjithatë, situata nuk rezulton të jetë përmirësuar. Mosekzekutimi i këtyre vendimeve gjyqësore, praktikisht e bën mjetin ankimor gjyqësor të paefektshëm dhe gjithashtu passjell pasoja negative edhe në cilësinë e standardin e jetesës të fëmijëve.

Raporti është bazuar në:

- ✓ analizën e kuadrit ligjor kombëtar dhe standardet nderkombetare;
- ✓ analizimin e detajuar të vendimeve të gjykatave, mbi përcaktimin e pagesave të detyrimit ushqimor, pas zgjidhjes së martesës;
- ✓ caktimin e pagesave për plotësimin e detyrimit për ushqim të fëmijëve, nga prindërit e tyre;
- ✓ faktorët që marrin në konsideratë këto gjykata në përcaktimin e detyrimit ushqimor.

duke e parë në kontekstin e ndikimit që kanë patur këto vendimmarrje në garantimin e një zhvillimi të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror dhe social, si dhe gëzimin e një jetese të shëndetshme dhe pa privime në interesin më të lartë të fëmijës.

Konkretisht, detyrimi për ushqim i prindit ndaj fëmijës është një detyrim ligjor pa kundërshpërblim dhe me karakter vetjak, në bazë të të cilit i ati dhe/ose nëna detyrohen t'u sigurojnë mjetet e jetesës fëmijëve të tyre. Prindërit e kanë këtë detyrim edhe kur ata nuk jetojnë bashkë apo janë të divorcuar. Në legjislacionin tonë të brendshëm *nuk është përcaktuar një shumë konkrete (fikse)*, për të treguar se sa do të jetë detyrimi për ushqim i prindit në plotësim të nevojave të fëmijës së tij, por *është lënë në vlerësimin e gjykatës.*

[171] Ky raport gjendet në linkun: https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Raporti%20mbi%20politikat%20e%20pensionit%20ushqimor%20-%2012.1.2023[12595].pdf.

1. Detyrimi për ushqim, pavarësisht përmbajtjes së tij ekonomike dhe sociale, kualifikohet si një e drejtë vetjake, pasi është në funksion të realizimit të vlerave parësore të individit. Për shkak të natyrës së veçantë dhe karakterit ngushtësisht vetjak, detyrimi ushqimor synon të plotësojë nevojat jetësore të fëmijës, i cili nuk ka kapacitete dhe aftësi ligjore për të punuar, deri në moshën kur ai bëhet i aftë për punë[172].

Ndërkohë, legjislacioni ynë i brendshëm nuk mundëson kompensimin e detyrimit ushqimor nga Shteti dhe vendosjen e marrëdhënies debi-kredi, midis prindit që detyrohet dhe Shtetit. Përmirësimi i legjislacionit në këtë drejtim për rastet kur burimet e të ardhurave të prindërve nuk i përmbushin nevojat e fëmijës, do të mundësonte që shteti të merrte masa për të kompensuar pjesën e të ardhurave që duhet për të përballuar nevojat e fëmijës.

2. Gjykatat në rastet e caktimit të kontributit për pension ushqimor duhet të kenë parasysh *jo vetëm burimet e të ardhurave të prindërve*, por mbi të gjitha *nevojat e vetë fëmijës***,** në mënyrë që të realizohet efektivisht interesi më i lartë i tij. Konkretisht:

✓ duhet t'u referohen akteve ndërkombëtare, pasi në to paraqiten disa kritere, mbi mënyrën e vlerësimit dhe caktimit të pensionit ushqimor për fëmijën. Kritere këto, në funksion të fëmijës që t'i krijohen mundësi për të pasur cilësi dhe standardin më të mirë të mundshëm, edhe pse prindërit janë të divorcuar dhe mund të mos kenë një raport të mirë mes tyre;

✓ duhet të investohet fort për të vlerësuar mundësitë reale financiare të prindit debitor, me qëllim që fëmijës t'i ofrohet një cilësi dhe standard jetese të mirë dhe jo të ndryshëm nga i mëparshmi.

3. Në vlerësim të vendimmarrjeve nga gjykatat për caktimin e detyrimit ushqimor, rezulton se gjykatat janë bazuar në parimin e mbrojtjes së interesit të fëmijëve, në mënyrë deklarative dhe jo përmbajtësore, ndërkohë vërehet se nuk ka ndonjë unifikim të faktorëve, tek të cilët duhet të bazohet gjykata për të dhënë masën e detyrimit për ushqim. Ky fakt krijon vështirësi sidomos kur kërkohet ndryshimi i masës së detyrimit ushqimor për fëmijët.

4. Një element tjetër lidhet me mungesën e parashikimit ligjor në Kodin e Familjes që gjykata të vendosë masën e detyrimit për ushqim si detyrim paraprak të ekzekutueshëm përgjatë kohëzgjatjes së procesit gjyqësor. Këto efekte mund të evitohen nga aplikimi i nenit 317 i K.Pr.Civile, i cili citon rastet e dhënies së vendimeve me ekzekutim të përkohshëm. Gjykatat i kanë të gjitha mundësitë ligjore duke u nisur edhe nga natyra shumë specifike e këtyre konflikteve gjyqësore, që të aplikojnë dhënien e këtyre vendimeve me ekzekutim të përkohshëm. Kjo do të eleminonte të gjitha zvarritjet që do të sillte ankimimi në themel i vendimit për zgjidhje martese dhe pasojave që rrjedhin prej saj.

[172] Në përputhje me nenin 197, të ligjit nr.9062, datë 8.5.2003, Kodi i Familjes, i ndryshuar. Sipas këtij neni, detyrimi për ushqim mund të vazhdojë edhe pasi fëmijët janë madhorë deri në moshën 25 vjeç.

5. Një çështje tjetër është afati shumë i shkurtër i parashkrimit për të kërkuar ekzekutimin e detyrueshëm të detyrimit ushqimor.[173] Problematika e evidentuar lidhur me këtë përcaktim ligjor ka passjellë pjesëzime të mëdha në përmbushjen e detyrimeve. Për arsye të ndryshme, prindërit debitorë e shtyjnë ekzekutimin e pagesave të pensionit ushqimor ose e bëjnë ekzekutimin me vonesë. Për zgjidhjen e kësaj problematike kemi rekomanduar përmirësimin e kësaj dispozite ligjore.

6. Një ndër të drejtat e fëmijës është e drejta për pjesëmarrje në vendimmarrje. Garantimi i kësaj të drejte fokusohet në ekzistencën e proceseve efektive ku *zëri i fëmijëve dëgjohet, vlerësohet dhe respektohet në vendimmarrje që lidhen me të drejtat e tyre*, ku përfshihen dhe proceset gjyqësore bazuar në udhëzimet e Këshillit të Europës, Drejtësia Miqësore për Fëmijët, publikuar në vitin 2010[174]. Legjislacioni i brendshëm i ka harmonizuar këto dispozita në ligjin nr. 37/2017 "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur".

Ky legjislacion forcon konsiderueshëm sistemin e drejtësisë *por institucionet e drejtësisë duhet të jetë të aksesueshëm, të përshtatshëm për moshën dhe nevojat e fëmijës, me procedura të shpejta, të fokusuara në nevojat dhe të drejtat e fëmijës.*

Për sa i përket problematikave lidhur me mosekzekutimin këtyre vendimeve, Avokati i Popullit konkretisht rekomandon për Ministrinë e Drejtësisë që:

✓ të angazhohet për të hartuar një strategji konkrete lidhur me pasqyrimin e plotë të gjendjes së ekzekutimit të vendimeve gjyqësore për detyrimin ushqimor ndaj fëmijëve, dhe të publikojnë të dhëna të sakta për situatën e zbatimit të tyre. Për këtë është e nevojshme që Ministria e Drejtësisë, *të njohë dhe të monitorojë situatën e shërbimit përmbarimor shtetëror dhe privat,* lidhur me ekzekutimin apo mosekzekutimin vendimeve gjyqësore për detyrimin ushqimor ndaj fëmijëve;
✓ *të angazhohet për hartimin e një manuali shpjegues* në lidhje me procedurat përmbarimore që duhet të kryhen për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për caktimin e detyrimit ushqimor për fëmijën dhe të sigurojë rritjen e kapaciteve të burimeve njerëzore në vazhdimësi për këtë çështje.

Gjithashtu, në zbatim të Konventave Ndërkombëtar,[175]shteti Shqiptar mund të kërkojë ekzekutimin e vendimit të një gjykate shqiptare për detyrimin ushqimor, në një shtet tjetër. Praktikat e mira të punës në këtë drejtim duhet të promovohen në vazhdimësi rast pas rasti.

Për një trajtim të detajuar referohuni raportit të plotë.

[173] Shih nenin 211 të Kodit të Familjes.
[174] *Udhëzimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës për drejtësinë miqësore për fëmijët,* miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës më 17 nëntor 2010.
[175] Shih neni 27/4 KDF. Shih Konventën e Hagës **"***Për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor ndaj fëmijëve dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes" (Ligj nr. 63/2012).*

4.4 Raporti veçantë "Vlerësimi i Ndikimit të të Drejtave të Fëmijëve (CRIA)"[176]

Raporti i veçantë "Vlerësimi i Ndikimit të të Drejtave të Fëmijëve (CRIA)", është hartuar dhe dorëzuar nga Avokati i Popullit pranë Kuvendit të Shqipërisë në datën 02.06.2022[177]. Qëllimi i këtij raporti është të vlerësojë dhe evidentojë se si aktet normative të miratuara përgjatë pandemisë Covid–19 dhe masat kufizuese të ndërmarra për shkak të saj kanë ndikuar fëmijët dhe të rinjtë me një fokus të veçantë në këto tre (3) aspekte:

- ✓ e drejta dhe aksesi në arsim;
- ✓ drejtësia për të miturit dhe të drejtat e fëmijëve në konflikt me ligjin; dhe
- ✓ aksesi në kujdes e shërbime shoqërore në këndvështrimin e përgatitjes së njësive të vetëqeverisjes vendore për menaxhimin e situatave të emergjencës.

Gjetjet e veçanta të raportit:

Nisur nga situata e krijuar nga covid-19, shpallja e situatës së emergjencës i gjeti institucionet shtetërore të papërgatitura në miratimin e akteve normative, pasi synimi kryesor i tyre u fokusua në mbrojtjen e shëndetit nëpërmjet masave kufizuese, për të parandaluar përhapjen e virusit. Më konkretisht, disa akte normative të miratuara dhe masa që janë marrë në kuadër të situatës së pandemisë të shkaktuar nga virusi covid-19 nuk përmbanin rregullime të dedikuara për fëmijët edhe në rastet kur zbatimi i tyre ndikonte në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë tek të drejtat dhe mbrojtja e tyre, si p.sh, në rastin e akteve normative me fuqinë e ligjit për qëndrimin e përkohshëm të të dënuarve në shtëpi, gjithnjë në lidhje me të miturit në konflikt me ligjin;

Gjetjet kryesore për tre fushat e përzgjedhura[178]:

- ✓ aktet e miratuara nga MAS u përpoqën të garantonin të drejtën dhe aksesin e tyre për arsim gjatë pandemisë. Këto akte janë rishikuar vazhdimisht në përputhje me situatën dhe janë bazuar në qasje gjithëpërfshirëse, marrin parasysh pasojat për situatën psiko-emocionale të fëmijës, duke mundësuar kështu akses të gjerë në arsim në distancë për fëmijët, mbështetje të vazhdueshme për mësuesit dhe nivel të lartë kënaqësie të nxënësve;
- ✓ megjithatë, aktet e nxjerra lidhur me mësimin në distancë nuk adresuan kategori të tjera të veçanta të fëmijëve ndonëse mjetet dhe platformat e disponueshme ishin projektuar për të mbuluar zona të gjera gjeografike;
- ✓ institucionet përkatëse nuk e kanë trajtuar në mënyrë të mjaftueshme kategorinë e fëmijëve në konflikt me ligjin dhe nuk respektuan interesin më të lartë të fëmijës dhe mbrojtjen e tyre gjatë procesit të hartimit dhe zbatimit të akteve dhe planeve në përgjigje të pandemisë, pavarësisht deklaratave dhe dokumenteve udhëzuese të organizatave ndërkombetare;
- ✓ akte të tilla nuk janë shoqëruar me parashikime buxhetore shtesë;

[176] Raporti kryhet në kuadër të një nisme të përbashkët midis ENOC dhe UNICEF ECARO për një vlerësim që përfshin shtetet anëtare të ENOC.
[177] Shkresa zyrtare me nr.331 Prot, datë 2.6.2022, të institucionit të Avokatit të Popullit.
[178] Ky raport gjendet në linkun: https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/CHILD%20RIGHTS%20IMPACT%20ASSESSMENT%20(CRIA).pdf

✓ Shqipëria nuk ka vepruar në përputhje me parimin e përdorimit të paraburgimit vetëm si masë e fundit dhe as me rekomandimet ndërkombëtare për lirimin e të gjithë fëmijëve që mund të liroheshin në mënyrë të sigurtë dhe vendosjen e një moratoriumi për fëmijët e tjerë të rinj që hynin në institucionet e burgimit. Kjo gjetje mbështetet nga luhatjet e numrit dhe statusit të fëmijëve që vuanin dënimin në Institutin e të Miturve në Kavajë;

✓ NjMF hasën vështirësi për të përmbushur rolin dhe funksionet e tyre edhe gjatë pandemisë për shkak të burimeve të pamjaftueshme për menaxhimin e rasteve në situata normale, e aq më shumë në situata emergjence;

✓ megjithatë nga ana e njësive të vetëqeverisjes vendore u bënë përpjekje për prioritizimin e ndërhyrjeve dhe optimizimin e burimeve duke dyfishuar edhe masën e fondit të emergjencës por duke i dhënë prioritet mbështetjes së familjeve në nevojë, të paktën në tentative për të përmbushur nevojat bazë.

Rekomandimet kryesore të këtij raporti janë:

✓ Garantimi i të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës është përgjegjësi shtetërore me rëndësi parësore dhe si e tillë duhet të adresohet në mënyrë adekuate;

✓ Nevojitet ndërgjegjësimi i institucioneve përgjegjëse për marrjen e masave dhe kryerjen e përgatitjeve të duhura për t'iu përgjigjur me efektivitet situatave emergjente, sikurse ishte rasti i pandemise;

✓ Sugjerohet përmbushja adekuate e përgjegjësive institucionale të të gjithë autoriteteve të përfshira në përputhje dhe në zbatim të parimit të interesit më të lartë të fëmijës dhe të gjitha aktet normative duhet të parashikojnë rregullime të posaçme në të gjitha rastet që prekin të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, drejtpërdrejt ose tërthorazi;

✓ Zbatimi i këtyre rregullimeve kërkon gjithashtu buxhetim të mjaftueshëm për të siguruar zbatimin e tyre me efektivitet;

✓ Ministritë, në përputhje me nenin 39/c të ligjit "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës", që u kërkon ta shoqërojnë çdo projektligj apo projekt-akt normativ që hartojnë me një analizë të ndikimit të tij te fëmijët, djem dhe vajza, duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë mbrojtjes së fëmijëve dhe të drejtave të tyre në të gjitha aktet që miratojnë ose që i propozojnë Këshillit të Ministrave, të cilat synojnë rregullimin e situatave të zakonshme dhe në veçanti ato emergjente;

✓ Në kuadër të qasjes së sistemit të integruar të mbrojtjes, miratimi i akteve normative në të gjitha fushat veçanërisht në fushën e mirëqenies sociale, arsimit, shëndetësisë, sigurisë dhe drejtësisë duhet të parandalojë sa më shumë të jetë e mundur rreziqet që mund të vijnë nga situatat emergjente;

✓ Institucionet, në nivel qendror dhe vendor duhet të marrin masa konkrete për bashkëpunimin, ndarjen e përgjegjësive dhe koordinimin në të gjitha nivelet, midis aktorëve shtetërore dhe joshtetërorë;

✓ Në kuadrin e përgatitjes ndaj situatave të emergjencës, rekomandohet që të hartohen, konsultohen, miratohen dhe buxhetohen plane të emergjencës të cilat hyjnë automatikisht në veprim në situata të tilla dhe sigurojnë përmbushjen e të drejtave dhe mbrojtjen e fëmijëve në çdo kohë, veçanërisht në situata emergjente që i vë ato në rrezik të shtuar;

✓ Ka shumë rëndësi të shtohen kapacitetet në të gjitha fushat dhe të përgatiten strukturat përgjegjëse të përfshira në nivel qendror dhe vendor, për të fituar aftësi në menaxhimin e situatave

emergjente në përputhje me standardet e garantimit të të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës dhe rëndësinë e situates;

✓ NjVQV të miratojnë protokolle emergjencash, si dhe fonde emergjencash që në këto situata aktivizohen automatikisht. Këto protokolle duhet të përfshijnë jo vetëm proceset e punës lidhur me rolin e NjMF-së, por edhe të gjithë aktorët e tjerë të përfshirë në menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe më gjerë, veçanërisht strukturat e shërbimeve sociale, policisë, arsimit, shëndetësisë dhe drejtësisë. Përndryshe, marrja e veprimeve mbi metodën standarde administrative merr kohë dhe shkakton vonesa të cilat mund të sjellin pasoja serioze dhe të pandreqshme;

✓ Gjatë procesit të hartimit dhe zbatimit të planeve në përgjigje të situatave emergjente, mbrojtja e fëmijëve si grup më vete duhet konsideruar si prioritet dhe masat kufizuese duhet të parashikojnë një qasje të diferencuar për menaxhimin, rehabilitimin dhe riintegrimin e fëmijëve.

Raporti u dërgua në Kuvendin e Shqipërisë dhe është prezantuar për shoqërinë civile dhe autoritetet shtetërore në një event të veçantë të organizuar me mbeshtetjen e UNICEF, ndërkohë që ky raport nuk është diskutuar në komisionet parlamentare deri në momentin e hartimit të këtij raporti.

4.5 Raporti i veçantë "Vlerësimi i ndikimit të ndryshimeve klimatike në të drejtat e fëmijëve në Shqipëri".[179]

Raporti i veçantë "*Vlerësimi i ndikimit të ndryshimeve klimatike në të drejtat e fëmijëve në Shqipëri*", shqyrtoi ndikimet e mundshme mbi të drejtat e fëmijëve të kuadrit ligjor dhe akteve nënligjore të ndryshimeve klimatike fokusuar në dy shtylla kryesore:

✓ dimensioni ligjor duke evidentuar specifikisht kornizën ligjore për ndryshimet klimatike në vendin tonë dhe qasjen që ky kuadër ka kundrejt të drejtave të fëmijëve në vend, specifikisht ato të garantuara nga Konventën e të Drejtave të Fëmijëve;

✓ qasjen institucionale të adresuar nga ligji, me vëmendje të veçantë në rolin dhe veprimtarinë e Avokatit të Popullit në këtë fushë.

Gjetjet dhe rekomandimet lidhur me mbrojtjen të drejtave të fëmijëve nga ndryshimet klimatike:

✓ Në një nivel të përgjithshëm marrja e masave për uljen e shkarkimeve të gazrave me efekt serë dhe përshpejtimi i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, *pritet që të ketë ndikime pozitive në jetën e fëmijëve dhe gëzimin e të drejtave të tyre sipas Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës* (KDF). Nga ndryshimet do të përfitojnë brezat që do të pasojnë, kështu që ato vlerësohet se janë në interesin më të mirë të fëmijës;

[179]Ky raport është hartuar në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet institucionit të Avokatit të Popullit dhe organizatës jofitimprurëse Save the Children, Tiranë, me mbështetjen financuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillimin Ndërkombëtar dhe gjendet në linkun: https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/VLER%C3%8BSIMI%20I%20NDIKIMIT%20T%C3%8B%20NDRYSHIMEVE%20KLIMATIKE%20N%C3%8B%20T%C3%8B%20DREJTAT%20E%20F%C3%8BMIJ%C3%8BVE%20N%C3%8B%20SHQIP%C3%8BRI.pdf.

✓ *Kuadri ligjor i miratuar është ende i paplotë* dhe si rezultat, në një pjesë të madhe të tij i pazbatueshëm. Me përjashtim të akteve nënligjore të miratuara më herët, lidhur me kufizimin e emetimit të gazrave serë, aktet e tjera që do të plotësojnë kuadrin dhe do të bëjnë ligjin efektiv do të miratohen brenda 4 (katër) vitesh nga hyrja në fuqi e ligjit, duke ulur në këtë mënyrë ndjeshëm efektivitetin e ligjit. Konstatohet që angazhimet ligjore janë më shumë retorike, në vend që të përfshijnë angazhime praktike, një fenomen ky jo vetëm shqiptar, pasi është konstatuar edhe në shumë vende të tjera;[180]

✓ *Mungesa e një VNDF (Vlerësimi i Ndikimit të të Drejtave të Fëmijëve*) nuk është një rast i izoluar për këtë ligj, pasi në vend ky mekanizëm nuk është i përfshirë në procedurat e vendimmarrjes ligjore;

✓ *Mungesë e njohurive të femijeve.* Përfshirja në kurrikulat mësimore shqiptare e kompetencës për jetën, mjedisin dhe sipërmarrjen, vlerësohet si një arritje pozitive. Pavarësisht kësaj, nga fokus grupet e zhvilluara, u konstatua një mungesë e rezultateve konkrete në njohuritë e fëmijëve në këtë fushë;

✓ *Fëmijët dhe të rinjtë janë të përjashtuar nga proceset e vendimmarrjes publike*. Adresimi i ndryshimeve klimatike duhet të fillojë domosdoshmërisht nga edukimi. Jo vetëm në kuptimin e ngushtë të edukimit të fëmijëve në shkollë, por edhe në shtëpi dhe në komunitet.

✓ *Adresimi i problematikave që shkakton ngrohja globale dhe ndryshimet klimatike, duhet të kenë një analizë të posaçme përsa i përket fëmijëve*. Si kategori me specifika dhe veçori të ndryshme nga kategoritë e tjera, është thelbësore që masat lehtësuese ndaj tyre të jenë të analizuara dhe të dedikuara posaçërisht;

✓ *Fëmijët dhe të rinjtë nuk kanë mundësi të votojnë dhe kanë kompetenca të kufizuara për të advokuar për interesat e tyre, përveçse nëpërmjet të rriturve*. Prandaj është thelbësore, që veçanërisht për çështje të cilat prekin drejtpërdrejtë dhe thelbësisht të drejtat e tyre, ata të merren në konsideratë seriozisht. Përgjegjësia e qeverisë për fëmijët priret të jetë e fragmentuar nëpër departamente dhe agjenci, duke bërë që shpesh të jetë e vështirë, si identifikimi i problemeve ashtu edhe adresimi i duhur tyre;

✓ *Fëmijët janë përfitues të shërbimeve publike, arsimore, shëndetësore, në kuadër të emergjencave civile, shërbimeve sociale, por nuk kanë mekanizma ankimues të përshtatshëm për ta.* Kjo vlen për të gjitha fushat e politikës shtetërore dhe shtrihet edhe për çështje të lidhura me ndryshimet klimatike, si e tillë ka nevojë për një adresim për të mundësuar garantimin dhe respektimin e të drejtave që KDF dhe legjislacioni shqiptar ju njeh.

Rekomandimet e adresuara:

✓ *Përfshirja e VNDF-së në çdo vendimmarrje politike apo ligjore.*Vlerësohet se është e rëndësishme në çdo vendimmarrje politike apo ligjore, e cila ndikon në respektimin e të drejtave të fëmijëve, me qëllim që të garantohet parimi i *interesit më të lartë të fëmijës*;

✓ *Gjetja e mekanizmave efektiv* për realizimin konkret të objektivit të vendosur nga kurrikula dhe zgjerimi i konceptit të edukimit, nëpërmjet përfshirjes dhe të aktorëve të tjerë jashtë shkollës.

[180] ENOC Synthesis Report, *Children's Rights and Climate Justice*, përgatitur nga Aoife Daly, Laura Lundy, University College Cork, Maj 2022.

✓ *Advokimi në nivel kombëtar, rajonal dhe global* për të siguruar respektimin e të drejtës së patjetërsueshme të fëmijëve për një mjedis të shëndetshëm. Është e rëndësishme të rriten përpjekjet në vend për t'i adresuar çështjet e mjedisit si të lidhura ngushtësisht me çështjet e fëmijëve dhe respektimin e të drejtave të tyre, të garantuara nga Kushtetuta, nga KDF, por edhe nga akte të tjera ndërkombëtare dhe të legjislacionit të brendshem;

✓ *Zhvillim i proceseve administrative të posaçme, të konsultimit dhe të dëgjimit të këtyre grupmoshave*. Për këtë është detyrë e organeve të posaçme që mbikqyrin respektimin e të drejtave të fëmijëve që të kontribuojnë në koherencën e politikave dhe në koordinimin e zbatueshmërisë së tyre;

✓ *Rritje e pjesëmarrjes së fëmijëve dhe të rinjve.* Vetëm në këtë mënyrë, do të arrihet që fëmijët dhe të rinjtë të aftësohen për të ndërtuar një mënyrë jetese në përputhje me mjedisin, duke dhënë kontributin e tyre aktiv në uljen e rrezikut të ndryshimeve klimatike duke mundësuar që fëmijët të kenë mundësi të ushtrojnë efektivisht të drejtat e tyre për t'u bërë pjesë e vendimmarrjes, për t'u dëgjuar, për të kërkuar respektimin e të drejtave të tyre në rrugë administrative dhe gjyqësore.

Raporti është dërguar në Kuvendin e Shqipërisë më datë *02.06.2022*. Ai është prezantuar për shoqërinë civile dhe autoritetet publike në një event të vecantë të zhvilluar më datë *19.07.2022*. Deri tani raporti nuk është shqyrtuar në seancë degjimore në ndonjë nga komisionet përkatëse në Kuvend.

4.6 Monitorimi i institucioneve në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të Komitetit Europian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor dhe Degradues (CPT)

Bazuar në Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë datë 9.7.2020, "*Për vlerësimin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit për vitin 2019*", Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2020, i kërkoi Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, *të monitorojë zbatimin e rekomandimeve të Komitetit Europian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor dhe Degradues (KPT),* si dhe të raportojë në kohë pranë Kuvendit të Shqipërisë për nevojën e adresimit të problematikave të përsëritura ose për të cilat kërkon angazhim nga ana e tij.

Duke mbajtur në konsideratë masat që institucionet përgjegjëse ishin angazhuar të ndërmarrin gjatë hartimit të përgjigjes së Qeverisë Shqiptare, datë 27 Shkurt 2020, mbi raportin e Komitetit Europian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor dhe Degradues (KPT), gjatë vizitës së tyre në Shqipëri në datat 20 - 30 Nëntor 2018[2], kemi kërkuar nga institucionet përgjegjëse të na informonin sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, mbi rekomandimet të cilat më pas janë renditur jo sipas rëndësisë por sipas radhës së gjetjeve në këtë raport. Duke mbajtur në konsideratë në rekomandimet për masat që duhet të ndërmerren nga organet kompetente për zbatimin e tyre, Avokati i Popullit ka adresuar edhe përgjigjen e dhënë nga qeveria Shqiptare në lidhje me rekomandimet e KPT-së dhe ka vlerësuar si mision të tij edhe monitorimin e zbatimit apo efektshmërisë të masave të marra sipas kësaj përgjigje[181], e cila përbën një fakt pozitiv për adresimin e çështjeve të ngritura në këtë raport.

[181] Përgjigjja e qeverisë Shqiptare është dërguar në datë 27 Shkurt 2020.

Metodologjia e hartimit të këtij raporti konsistoi në studimin e Raportit të KPT-së dhe në vijim bërjen e tij pjesë të metodologjisë sonë të inspektimit në observim, në dokumentim, në komunikimet me shkresa dhe emaile zyrtare, si dhe në takimet me zyrtarët e lartë të sistemit të burgjeve, Policisë së Shtetit, Ministrisë së Drejtësisë dhe sistemit shëndetësor, si dhe në inspektimet e vazhdueshme pranë institucioneve të sistemeve të burgjeve, policor, si dhe të atyre shëndetësor. Institucioni i Avokatit të Popullit nëpërmjet Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka nisur shkresat përkatëse me lëndë: *"Kërkesë për informacion mbi zbatimin e rekomandimeve të Komitetit Europian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor dhe Degradues*", drejtuar Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë (për dijeni Ministrisë së Brendshme) dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve (për dijeni Ministrit të Drejtësisë).

Për sa më lart dhe në vijim të kërkesave të mësipërme bëjmë me dije se pas marrjes së përgjigjeve nga institucionet e mësipërme dhe mbi bazën e gjetjeve faktike kemi hartuar këtë raport të ndarë sipas seksioneve me gjetjet të ndara *"a. Rekomandimet e KPT-së"*[182]; *"b. Përgjigjja zyrtare"*[183]; *"c. Përgjigjja e Institucionit përgjegjës"; "d. Komentet e MKPT-së".*
Pas marrjes së përgjigjeve nga institucionet e mësipërme dhe mbi bazën e gjetjeve faktike kemi hartuar një *Raport të Veçantë* mbi zbatimin dhe problematikat e tyre sipas gjetjeve të vetë MKPT-së gjatë monitorimeve të njëpasnjëshme, raport i cili u publikua në datën 14.07.2022.

Raporti i KPT-së është i një rëndësie të veçantë për shtetet të cilat kanë ratifikuar "*Konventën Europiane kundër Torturës dhe Dënimeve, dhe Trajtimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore, ose Degraduese*". KPT kryen vizita në vendet ku privohet liria, në mënyrë që të monitorojë se si trajtohen personat të cilëve ju është privuar liria, në institucionet si: burgje, qendrat e paraburgimit për të miturit, komisariatet e policisë, qendrat e mbajtjes së migrantëve, spitalet psikiatrike, shtëpitë e kujdesit social, etj.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT), që nga momenti i bërjes publike të raportit të KPT-së (Shtator 2019), në inspektimet periodike të kryera pranë këtyre institucioneve ka monitoruar në vijimësi hapat e ndjekura nga institucionet për zbatimin e rekomandimeve të KPT-së, si dhe ka kërkuar nga këto institucione informacion sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, mbi rekomandimet të cilat i kemi renditur në këtë raport.
Nga ana jonë u hartua raporti "*Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna për Shqipërinë nga Komiteti Europian për parandalimin e torturës dhe trajtimit çnjerëzor dhe degradues*", i cili përmbledh gjetjet dhe konkluzionet më të rëndësishme në qasjen e institucioneve shqiptare, të cilat me anë të politikave të tyre duhet të respektojnë të drejtat e personave të privuar nga liria.

Ky raport u bë publik në Korrik të vitit 2022 dhe ju dërgua menjëherë për njohje Presidentit të Republikës, Kryeministrit, Prokurorit të Përgjithshëm, Ministrit të Drejtësisë, Ministrit të

[182] *shih: https://rm.coe.int/168097986b. "Report to the Albanian Government on the visit to Albania carried out by the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT)" from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf (2019).*
[183] *shih: https://rm.coe.int/16809cb571 "Response of the Albanian Government to the report of the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT on its visit to Albania)" from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf (2020).*

Brendshëm, Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Burgje dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.

Informacioni i marrë tregoi se nga shumica e institucioneve të monitoruara, janë ndërmarrë disa hapa lidhur me zbatimin e rekomandimeve të KPT-së për të mbrojtur të drejtat e personave të privuar liria, megjithatë rezulton se institucionet shqiptare ju duhet ende punë për të kuptuar dhe përvetësuar këto rekomandime duke i bërë ato pjesë të pandashme të filozofisë së tyre të punës. Kjo gjë mungon, pasi kuptohet edhe nga përgjigjet që ne kemi marrë nga institucionet përkatëse duke vërejtur se nuk kemi zbatim thelbësor, por zbatimi është krejtësisht formal.
Avokati i Popullit, nëpërmjet monitorimit të këtij Raporti ka risjellë në vëmendjen e institucioneve rëndësinë thelbësore të këtyre gjetjeve dhe rekomandimeve të dala nga ky monitorim për institucionet shtetërore lidhur me parandalimin e keqtrajtimit në vendet e privimit të lirisë në fokusin e respektimit të të drejtave të njeriut.

Ndër problematikat thelbësore të trajtuara në këtë raport mund të veçojmë: kushtet në burgje, situata e pacientëve me masë mjekësore, të dënuarit me probleme të shëndetit mendor, mungesa e stafit mjekësor, mungesa e medikamenteve, mjetet mjekësore të amortizuara ose në mungesë, mbajtjes në polici të personave me masë sigurie "arrest me burg", aktivitetet jashtë qelisë për të burgosurit, kontakti me botën e jashtme, trajnimi fillestar i stafit etj.
Në përfundim të këtij Raporti, Avokati i Popullit ka dalë me disa rekomandime të përgjithshme për të gjitha institucionet të përfshira në këtë proces, ku ndër të tjera theksojmë:

- ✓ Nevojën për koordinim më të mirë nga institucionet eprore në marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të KPT-së nga institucionet përkatëse sipas përgjegjësisë;
- ✓ Mungesën e kuptimit thelbësor të Raportit nga organet zbatuese dhe në mos angazhimin maksimal në dhënien e rëndësisë së duhur zbatimit të këtyre rekomandimeve;
- ✓ Nevojën emergjente për trajnimin e punonjësve të cilët janë të angazhuar në zbatimin e këtyre rekomandimeve;
- ✓ Zbërthimin në detyra specifike të këtyre rekomandimeve nga institucionet përgjegjëse dhe marrjen e masave konkrete për zbatimin e tyre;
- ✓ Hartimin e një plani masash për zbatimin e tij në vijimësi dhe ngritjen e një mekanizmi përgjegjës dhe efikas për ndjekjen e zbatimit të këtyre rekomandimeve nga institucionet përgjegjëse dhe kontrollin e tyre të herëpashershëm nga institucioni epror;
- ✓ Marrjen e masave për zbatimin efektiv dhe real të rekomandimeve të KPT-së, pasi vetëm dërgimi i shkresave për njohjen dhe zbatimin e këtij raporti nuk ka arritur qëllimin për realizimin e tyre;
- ✓ Njohjen e menjëhershme të drejtuesve të emëruar rishtaz në institucionet zbatuese me këtë raport, pasi ndryshimet e shumta në struktura kanë sjellë për pasojë standarde të ndryshme në realizimin e tyre;
- ✓ Rekomandimet e KPT-së janë një garanci për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për rrjedhojë duhet të bëhen pjesë integrale e punës së përditshme të institucioneve përgjegjëse për zbatimin e tyre;

✓ Implikimet buxhetore në shumicën e rasteve kanë sjellë një ritëm të ulët ose dhe pamundësinë në zbatimin e rekomandimeve dhe për pasojë kanë sjellë kushte dhe trajtim çnjerëzor në respektimin e të drejtave të njeriut;
✓ Institucionet në të shumtën e rasteve kanë reaguar mbi zbatimin e rekomandimeve pas kërkesave të përsëritura nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit pa i kushtuar vëmendjen e duhur dhe rëndësisë së këtij raporti;
✓ Monitorimet e institucionit të Avokatit të Popullit sjellin në mënyrë të vazhdueshme në vëmendjen e autoriteteve përgjegjëse rëndësinë e marrjes së masave dhe zbatimit të rekomandimeve të KPT-së, zbatimi i të cilave mbetet në masë të ulët;
✓ Niveli i zbatimit të rekomandimeve të KPT-së është i ulët duke mbajtur në konsideratë se ka kaluar një kohë e mjaftueshme nga zbardhja e këtij Raporti, dhe se masat e marra deri më tani nuk kanë sjellë rezutatet e kërkuara;
✓ Moszbatimi i përpiktë i rekomandimeve të KPT-së sjell për pasojë mosrespektimin/shkeljen e standardeve të kërkuara dhe gjithëpranuara të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;
✓ Rishikimi i Rregullores të Regjimit të Posaçëm të Sigurisë së Lartë në IEVP, miratuar me urdhër nr.380, datë 19.07.2019 të Ministrit të Drejtësisë, e cila duhet të sqarojë, në përputhje me ndryshimet e reja ligjore të qershorit 2020, të drejtat bazë, përgjegjësitë, kushtet e zbatimit dhe monitorimit të brendshëm të regjimit të posaçëm, si dhe garantimin e një sistemi efektiv ankimor;
✓ Miratimin e programit individual të këshillimit psiko-social të të burgosurve në regjimin e posaçëm, njoftimin e të dënuarit dhe marrjen e pëlqimit me shkrim për pjesëmarrjen në këtë program;
✓ Pasurimin e bibliotekave të të burgosurve në regjimin e posaçëm, me larmi titujsh të librave të cilët duhet të vihen në dispozicion të të burgosurve.

Ky raport përmbledh gjetjet dhe konkluzionet më të rëndësishme në qasjen e institucioneve shqiptare, të cilat me anë të politikave të tyre duhet të respektojnë të drejtat e personave të privuar nga liria. Avokati i Popullit vlerëson se ky është një proces dhe se ka nevojë thelbësore që standardet e vendosura të ruhen dhe kushtet të përmirësohen në vijimësi.

4.7 Opinione Amicus Curia në Gjykatën Kushtetuese

➢ *Për çështjen me kërkues Shoqata "Diaspora për Shqipërinë e lirë"*

Institucioni i Avokatit të Popullit në kuadër të detyrave të tij Kushtetuese e ligjore ka realizuar mbrojtje Amicus Curia në Gjykatën Kushtetuese për çështjen me kërkues Shoqata "Diaspora për Shqipërinë e lirë" me objekt "*Konstatimi i cenimit të së drejtës kushtetuese të votës së emigrantëve në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë më 25.04.2021. Deklarimi i urdhrit nr. 219, datë 19.04.2021 "Për karantinimin e personave që vijnë në Republikën e Shqipërisë nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Greqia" të ministrit së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë".*

Instuticioni i Avokatit të Popullit ka mbajtur qëndrimin ndër të tjera se "*argumentat pro, të artikuluar nga GJEDNJ në jurisprudencën e saj dhe nga Komisoni i Venecias, konsistojnë në*

faktet se: E drejta për të votuar është një e drejtë që ekziston për shkak të shtetësisë jep ndjesinë e shtetëtësisë dhe të drejtave të lidhura me të. Vazhdimësia e pjesëmarjes në jetën politike të vendit, pavarësisht largësisë. Barazon ata që jetojnë në vend me ata që janë jashtë - pra vendos në pozitë të njëjtë shtetasit. Shtetasi mban lidhje me vendin e origjinës, forcon lidhjen dhe ndjesinë e përkatësisë, pavarësisht gjendjes ekonomike, etj. Neni 3, i Protokollit nr.1, të KEDNJ parashikon se shtetet palë organizojnë zgjedhje të lira në intervale kohe të arsyeshme, me votim të fshehtë, në kushte që mundësojnë shprehjen e lirë të mendimit të njerëzive në zgjedhjet legjislative. Megjithatë, ky Protokoll nuk parashikon asgjë lidhur me të drejtën për të votuar jashtë. Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës ka inkurajuar shtetet që të lejojnë shtetasit e tyre që jetojnë jashtë të marrin pjesë në mënyrë sa më të plotë të jetë e mundur në procesin elektoral. Kjo është parashikuar në dy dokumente: Rezoluta e vitit 1459 (2005) dhe Rekomandimi nr. 1714 (2005) për të drejtën e votes".

Pavarësisht se nuk është përcaktim kushtetues, tashmë Kodi Zgjedhor krijon pritshmëri për migrantët lidhur me lehtësira potenciale për votimin jashtë vendit. Garantimi i votës jashtë vendit nënkupton zbatimin e masave dhe procedurave që u mundësojnë të gjithë zgjedhësve që gjenden jashtë vendit përkohësisht, ose në mënyrë të përhershme dhe që kanë shtetësinë shqiptare. Kjo kërkon që Kodi Zgjedhor dhe aktet nënligjore normative që duhet të nxirren në bazë dhe për zbatim të tij, të marrin parasysh pikat e mëposhtme:

- ✓ modelin e përfaqësimit politik për votën jashtë vendit;
- ✓ procedurat e votimit;
- ✓ krijimin e listave për votuesit e jashtë vendit;
- ✓ ngritjen e strukturave që do të administrojnë procesin;
- ✓ buxhetin për të mbuluar kostot e votimit jashtë vendit.

Në vlerësimin e të gjithë këtyre komponentëve duhet të konsiderohen specifikisht çështjet e logjistikës zgjedhore, sigurisë së procesit, afateve kohore të zbatimit, apo edhe të kostove financiare.

Në gjykimin e Avokatit të Popullit, legjislatori me miratimin e ndryshimeve në Kodin Zgjedhor, që përcaktuan dhe garantuan të drejtën e votimit nga jashtë të zgjedhësve, shtetas shqiptarë me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, nuk ka qënë realist për pasojat dhe pritshmëritë e ligjshme që do të krijonte ky ndryshim ligjor, për proceset e afërta zgjedhore, sikundër edhe procesi zgjedhor për Kuvendin e Shqipërisë, me datë votimi 25 Prill 2021. Jo vetëm kaq por kjo mungesë koherence dhe vizioni nga ana e legjislatorit është pasuar nga mosveprimi në vazhdim nga ana e KQZ-së, për nxjerrjen e akteve nënligjore normative, të cilat do ta mundësonin praktikisht këtë proces.

Për më tepër, Avokati i Popullit ndan qëndrimin se edhe nëse këto akte nënligjore do të ishin nxjerrë nga ana e KQZ-së, në përmbushje të kushteve komplekse të kërkuara për zbatimin efektiv të procesit të votimit nga jashtë, si dhe në kushtet e pandemisë globale të Covid-19, ku mbarë bota u përball me kufizimin e një sërë të drejtave të njeriut, do të ishte shumë e vështirë që procesi

të kishte sukses dhe aq më pak të respektohej plotësisht e drejta e votës së zgjedhësve, shtetas shqiptarë me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
Për këto arsye, Avokati i Popullit mendon se, së pari, zhvillimi i procesit legjislativ për ndryshimin e Kodit Zgjedhor dhe së dyti, mungesa e ndërhyrjeve pozitive nga ana e shtetit në procesin administrativ që duhej të zhvillohej nga ana e KQZ-së, *kanë cënuar të drejtën themelore të votës dhe ushtrimit efektiv të saj në zgjedhjet për Kuvendin e shqipërisë, me datë votimi 25 Prill 2021, për zgjedhësit, shtetas shqiptarë me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë..... Efektivisht, mosnxjerrja e akteve nënligjore normative, nga ana e KQZ-së, për mundësimin e ushtrimit efektiv të së drejtës së votës, për zgjedhësit, shtetas shqiptarë me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, përbën cënim të parimit kushtetues të shtetit të së drejtës dhe të parimit të sigurisë juridike. Rrjedhimisht dhe për pasojë, mosveprimi nga ana e KZQ-së në këto rrethana, në kuadër të zhvillimit të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë, me datë votimi 25 Prill 2021, përbën cënim të së drejtës themelore të votës dhe ushtrimit efektiv të saj në këto zgjedhje, për zgjedhësit, shtetas shqiptarë me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë***.

Në mbështetje të këtij qëndrimi të Avokatit të Popullit, vlen të theksohet fakti se ushtrimi efektiv i të drejtave dhe lirive të ligjshme, të qytetarëve, nuk mund të konsiderohet si i realizuar vetëm me afirmimin formal "në letër" të tyre por kërkon ndërmarrjen e të gjitha masave dhe dhënien e të gjitha garancive ligjore dhe administrative, të nevojshme nga ana e shtetit, për mundësimin real të ushtrimit të tyre. Nëse masat e marra dhe garancitë ligjore dhe administrative mungojnë, apo janë të pamjaftueshme në kuadër të garancive minimum të afirmuara në akte dhe traktate ndërkombëtare në të cilat shteti është palë, atëherë shteti ka cënuar ushtrimin efektiv të këtyre të drejtave të qytetarëve.

Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 38 datë 09.12.2022 ka vendosur: **"***Pranimin e pjesshëm të kërkesës.Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese të votës së emigrantëve në zgjedhjet për Kuvendin, për shkak të boshllëkut ligjor.Detyrimin e Kuvendit për plotësimin e boshllëkut ligjor brenda një viti. Pushimin e gjykimit lidhur me urdhrin nr. 219, datë 19.04.2021 të Ministrisë së Shëndetësisë"*[184].

➢ *Për çështjet e prezantuara nga dy kandidatë të skualifikuar nga Këshilli Emërimeve në Drejtësi*

Avokati i Popullit në kuadër të ligjit 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" ka realizuar mbrojtje Amicus Curia në dy çështje të prezantuara në Gjykatën Kushtetuese nga kandidatë të skualifikuar nga Këshilli Emërimeve në Drejtësi[185] në garën për vende vakant në Gjykatën Kushtetuese nga ankuesit Shaqir Hasani[186] dhe Vjosa Bodo Mujo[187].

Avokati i Popullit ka mbajtur qëndrimin në rastin e prezantuar nga ankuesja Vjosa Bodo Mujo se: "*Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj vlerëson edhe mënyrën se si rivendoset e drejta*

[184] Shih vendimin nr. 38 datë 09.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese.
[185] Vendimet e të cilit janë lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit.
[186] Shih vendimin nr. 27 datë 27.10.2022 të Gjykatës Kushtetuese.
[187] Shih vendimin nr. 26 datë 27.10.2022 të Gjykatës Kushtetuese.

e shkelur, gjatë gjykimit të një ankimi individual kushtetues, duke shfuqizuar vendimet si të papajtueshëm me Kushtetutën, rikthyer çështjen për rishqyrtim në gjykatën përkatëse, apo duke konstatuar cënimin e së drejtës kushtetuese. Ndërkohë, në kuadër të rivendosjes të së drejtës, është parashikuar mjeti i posaçëm për ankimim për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, përshpejtimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit. Në pamje të parë duket se paditesja nuk provon interesin e ligjshëm që do të mund të rivendosë në vend pas përfundimit të këtij procesi në kushtet kur vendimi nr.69 datë 10.08.2020, i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, është një vendim gjyqësor përfundimtar dhe i formës së prerë, e për më tepër sipas përcaktimit të nenit 238, të ligjit nr. 115/2016, i ndryshuar, ankimimi që paraqitet në këto raste në gjykatë, nuk pezullon procedurat në zhvillim të KED-së, procedura ku ka konkuruar kerkuesja ka pèrfunduar. Duket se rikthimi i çështjes për rishqyrtim në gjykatën përkatëse, si një mënyrë e rivendosjes të së drejtës të shkelur në këtë gjykim nga ana e Gjykatës Kushtetuese, nuk do të përbënte respektim të parimit të proporcionalitetit të arsyeshëm në masën e marrë, nëpërmjet ndërhyrjes në një proces ku, interesi publik për funksionalitetin e Gjykatës Kushtetuese në plotësimin e saj me numrin e plotë të gjyqtarëve është shumë i lartë, në raport me, interesin vetjak të një pjesëmarrësi kandidat, në procedurat e hapura nga organet kushtetuese për vende vakante në Gjykatën Kushtetuese, por Avokati i Popullit ne rastin konkret mban qendrimin se kerkuesja legjitimohet në këtë kërkesë në kushtet kur interesi i saj është që vendimmarrja nga Gjykata Kushtetuese të mund të përdoret prej saj (pra ka pritshmëri), në një procedure të re kandidimi që në të ardhmen me shpalljen e vakancave për në Gjykatën Kushtetuese ajo të mund të paraqesë kërkesën e saj tashmë nën dritën e vendimmarrjes së GJK dhe arsyetimit që do të marrë kjo gjykatë. Kërkueses nuk i është mohuar e drejta për t'u dëgjuar, pasi gjatë gjithë procedurës administrative, të kryer nga KED-ja, ka marrë dijeni për veprimet procedurale e verifikuese të kryera, si dhe ka ushtruar të drejtën e paraqitjes së pretendimeve ose kërkimeve me shkrim për çdo çështje të dalë gjatë kësaj veprimtarie. Pretendimet e parashtruara janë analizuar prej saj nga ana ligjore, në mungesë pothuajse të plotë të argumenteve kushtetuese. Shkeljet e pretenduara kanë të bëjnë me interpretimin, kuptimin dhe zbatimin e ligjit nga KED-ja dhe jo me shkelje të rënda procedurale. Kërkuesja kërkon të zgjerojë rrethin e subjekteve të parashikuara nga Kushtetuta dhe ligji për të kandiduar në vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese, përmes interpretimit të tyre në mënyrë të tillë që i lejon asaj hyrjen në këtë garë. Ajo është e paqartë nëse shkeljet e rënda procedurale kanë të bëjnë me interpretimin e kriterit "përvojë pune" ose me mosdhënien e mundësisë nga KED-ja për të provuar periudhat dhe përvojat e punës. Ligjvënësi nuk ka përcaktuar afat kohor për shqyrtimin e kandidaturave nga KED-ja dhe vlerësimi i procesverbalit audio i përket gjykatës administrative, e cila e vlerëson atë së bashku me provat e tjera. Vlerësimi i provave të paraqitura dhe të administruara në procedurën administrative është e drejtë e organit publik që kryen procedurën. Pretendimet e kërkueses për mungesën e arsyetimit të vendimeve të KED-së dhe të Gjykatës Administrative të Apelit janë haptazi të pabazuara. Gjykata Administrative e Apelit i ka dhënë përgjigje çdo pretendimi të saj.Duke i trajtuar pretendimet e saj për procesin e rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së mbrojtjes, vlerësohet se ato kanë mbetur në nivel kërkimi të paargumentuar dhe të paprovuar. Kërkuesja nuk ka arritur të provojë se si, gjatë procedurës së verifikimit të përvojës së punës në procesin administrativ e më pas atë gjyqësor, është vendosur në pozitë të tillë që e ka bërë të pamundur realizimin e kësaj të drejte. Për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës për mosdiskriminim, për shkak të qëndrimit të mbajtur ndaj saj nga KED-ja, nuk rezulton që kërkuesja t'i jetë drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Kushtet ligjore të parashikuara në pikën 4 të nenit 125 të Kushtetutës dhe në pikën 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 janë proporcionale, të nevojshme në një shoqëri demokratike dhe përbëjnë një kufizim të arsyeshëm, në përputhje me nenin 17 të Kushtetutës. Përfshirja e kriterit të përvojës 15-vjeçare të punës nuk e cenon procesin, përkundrazi e bën atë më parimor, të besueshëm dhe objektiv. Dispozitat kushtetuese dhe ligjore, për të cilat kërkuesja ka kërkuar interpretimin përfundimtar nga Gjykata, janë të qarta e nuk lënë shteg për kuptime të ndryshme. Ajo nuk ka arritur të provojë se zbatimi i tyre në praktikë ka qenë i pamundur ose ka sjellë vështirësi. Kriteret ligjore të përcaktuara në nenin 125 të Kushtetutës dhe pikën 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 janë në përputhje me nenin 17 të Kushtetutës".

Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 26 datë 27.10.2022 ka vendosur rrëzimin e kërkesës së bërë nga ankuesja Vojsava Bodo Mujo.

Avokati i Popullit ka mbajtur qëndrimin në rastin e prezantuar nga ankuesi Shaqir Hasani se: "*Gjykata Kushtetuese nuk ka juridiksion për të shqyrtuar vendimin nr. 46, datë 16.11.2020 të KED-së, pasi bazuar në nenin 238 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" (ligji nr. 115/2016) juridiksionin për të vlerësuar ligjshmërinë e këtij vendimi e ka vetëm Gjykata Administrative e Apelit. Kjo pjesë e kërkesës së paraqitur në Gjykatë ka të bëjë vetëm me ligjshmërinë e aktit administrativ të nxjerrë nga KED-ja dhe jo me pajtueshmërinë e tij. Pretendimi i kërkuesit për të shfuqizuar vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit, duke lejuar vazhdimin e procedurës, është i pabazuar në ligj. Vendimi është përfundimtar dhe i formës së prerë, dhe paraqitja e tij nuk pezullon procedurat në zhvillim në KED. Rikthimi i çështjes për rishqyrtim si mënyrë për rivendosjen e së drejtës në vend, nuk respekton parimin e proporcionalitetit, pasi në këtë proces interesi publik për funksionalitetin e Gjykatës është shumë i lartë në raport me interesin vetjak të kandidatit. Pretendimet e parashtruara nga kërkuesi lidhen me zbatimin e ligjit nga ana e gjykatës për zgjidhjen e themelit të çështjes dhe mungon paraqitja e argumenteve për shkeljet kushtetuese. Për pretendimin për cenimin e parimit të mosdiskriminimit, mungojnë argumentet në nivel kushtetues dhe për të provuar lidhjen me nenin 14 të KEDNJ-së. Kërkuesi nuk ka provuar ardhjen e pasojave në jetën private që lidhen me mirëqenien e tij, të familjes ose reputacionit shoqëror dhe profesional. Kërkuesi nuk ka parashtruar asnjë argument në nivel kushtetues për të provuar cenimin e së drejtës për jetë familjare dhe private ose cilat kanë qenë masat shtetërore që kanë ndikuar ose cenuar këtë të drejtë. Kërkuesit nuk i është mohuar e drejta për t'u dëgjuar, pasi gjatë të gjithë procedurës administrative të zhvilluar nga KED-ja ka marrë dijeni për veprimet procedurale dhe verifikuese, si dhe ka ushtruar të drejtën për të paraqitur parashtrime e kërkime me shkrim për çdo çështje. Pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të sigurisë juridike është i pabazuar. Vendimi i KED-së është një akt administrativ individual i nxjerrë nga një organ i parashikuar shprehimisht në Kushtetutë. Pritshmëritë e palës pjesëmarrëse në një procedurë administrative nuk duhet të barazohen me vendimmarrjen e ligjshme dhe në respektim të Kushtetutës të organeve të parashikuara shprehimisht në Kushtetutë".*

Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 27 datë 27.10.2022 ka vendosur rrëzimin e kërkesës së bërë nga ankuesi Shaqir Hasani.

- *Për çështjen e paraqitur nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH)*

Avokati i Popullit ka dhënë mendim me kërkesë të Gjykatës Kushtetuese për çështjen e paraqitur nga kërkuesi Komiteti Shqiptar i Helsinkit, me objekt:

- *"Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të: a) Nenit 89/b të ligjit nr. 7895, datë 27.01.1995, Kodi Penal i RSH, i ndryshuar, shtuar me nenin 3 të ligjit nr. 35/2020, datë 16.04.2020; b) Nenit 242/a të ligjit nr. 7895, datë 27.01.1995, Kodi Penal i RSH, i ndryshuar, shtuar me nenin 2 të ligjit nr. 35/2020, datë 16.04.2020".*

Lidhur me kushtetutshmërinë e neneve 89/b dhe 242/a të Kodit Penal, të ndryshuar, *shtuar me nenet 3 e 2 të ligjit nr. 35/2020, datë 16.04.2020*, objekt kërkese, Institucioni i Avokatit të Popullit opinionin e tij e trajtoi në 3 aspekte: së pari, norma duhet të konsiderohej nga Kuvendi në kuptim të nenit 170 pika 5 si një ligj për një masë të jashtëzakonshme i cili nuk mund të ndryshohet gjatë kohëzgjatjes së vetë gjendjes, së dyti si një akt në shkelje të procedurës legjislative, dhe së treti u argumentua përse ndryshimet e propozuara përveç rritjes së pasigurisë juridike, në këndvështrimin tonë, përbënin edhe një ashpërsim të politikës penale në mënyrë joproporcionale. Sipas mendimit tonë, ndryshimet në Kodin Penal duhet të bëheshin mbi bazën e një diskutimi shumë të gjerë publik, të ishin të mirëmenduara dhe me një optikë afatgjatë.

Këtë qëndrim, më herët, pas shqyrtimit të propozimeve përkatëse, Avokati i Popullit ia ka dërguar në formë shkresore në datë 14.04.2020 Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, lidhur edhe me dy dispozitat e reja të cituara më sipër.

Përpjekja për të shtuar dispozita në Kodin Penal, për më tepër me masa dënimi ekstreme nuk vjen në koherencë as me situatën por as me rrethin e personave që dispozitat ligjore duhet të mbrojnë. Avokati i Popullit vlerësoi se si rregull *nuk mundet që në një situatë të jashtëzakonshme të prodhohen akte me karakter të përhershëm.*

Ne vlerësojmë se gjatë këtij procesi ligjvënës janë shkelur disa parime të rëndësishme të garantuara nga Kushtetuta dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti ynë dhe Rregullorja e Kuvendit sikurse mund të përmendim:
1. Parimi i procesit të rregullt ligjor parashikuar nga nenet 81/2 dhe 81/3 të Kushtetutës.
2. Parimi i sigurisë juridike parashikuar në nenin 4 të Kushtetutës.
3. Parimi i proporcionalitetit i parashikuar në nenin 17/2 të Kushtetutës.
4. Parimi i barazisë parë ligjit parashikuar nga neni 18 i Kushtetutës.

Për sa më sipër, shprehëm mendimin se Neni 89/b i ligjit nr. 7895, datë 27.01.1995, Kodi Penal i RSH, i ndryshuar, shtuar me nenin 3 të ligjit nr. 35/2020, datë 16.04.2020 dhe Neni 242/a të ligjit nr. 7895, datë 27.01.1995, Kodi Penal i RSH, i ndryshuar, shtuar me nenin 2 të ligjit nr. 35/2020, datë 16.04.2020, janë të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe KEDNJ-në.

Pas shqyrtimit të kësaj çështjeje, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, me Vendimin nr. 39 datë 15.12.2022[188] çmoi se pretendimet e kërkuesit, janë pjesërisht të bazuara dhe vendosi pranimin pjesërisht të kërkesës e shfuqizimin e paragrafëve dy dhe tre të nenit 89/b të Kodit Penal.

4.8 Kontributi i dhënë nga institucioni i Avokatit të Popullit gjatë procesit të Reformës në Drejtësi

Në ushtrim të mandatit dhe detyrave bazë që i janë dhënë nga Kushtetuta dhe ligjet e tjera në fuqi, Avokatit të Popullit i janë dhënë kompetenca mjaft të rëndësishme për monitorimin e zbatimit të Reformës në Drejtësi. Duke qenë se Avokati i Popullit e konsideron si jetësore për të gjithë shoqërinë shqiptare kthimin e besimit në sistemin e drejtësisë në vend e cila ka rol kyç në zbatimin efektiv të të drejtave të njeriut, ka dhënë dhe vazhdon të japë kontributin e tij në shumë prej proceseve, të nevojshme për t'u realizuar. Një vend të rëndësishëm në këto procese zë roli kushtetues i Avokatit të Popullit, në vëzhgimin aktiv dhe proaktiv të veprimtarisë së institucioneve që zhvillojnë procedurat e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (më poshtë KED), si dhe monitorimi i vazhdueshëm i veprimtarisë së këtij institucioni, në të gjithë aktivitetin e tij. Ky rol përbën një garanci të shtuar, për transparencën dhe rritjen e besueshmërisë së KED, si një prej organeve shumë të rëndësishme për funksionimin dhe qeverisjen e sistemit të drejtësisë.

Në zbatim të nenit 149/d, pika 3, të Kushtetutës, sipas të cilit: « …*Avokati i Popullit merr pjesë si vëzhgues në procedurën e hedhjes së shortit, si dhe në mbledhjet dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi*", si dhe konform nenit 233, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", sipas të cilit: "*1. Mbledhjet e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi janë të mbyllura. Avokati i Popullit merr pjesë në mbledhjet dhe veprimtarinë e Këshillit. … »*, roli i Avokatit të Popullit është i dyfishtë, jo vetëm si institucion Kushtetues i parashikuar për mbrojtjen dhe garantimin e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut, por edhe si një institucion të cilit Kushtetuta dhe legjislacioni për Reformën në Drejtësi, i kanë dhënë rol dhe kompetenca të posaçme në këtë proces.
Në vijim të sa më sipër, institucioni ynë fillimisht ka qenë prezent në hedhjen e shortit për zgjedhjen e anëtarëve të KED, bazuar në detyrimet e cituara më sipër, por edhe ato të parashikuara nga neni 221, pikat 7 dhe 11, si dhe nenit 284 pika 6, të ligjit nr. 115/2016 "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë", sipas të cilave: "*Presidenti i Republikës, në prani të Avokatit të Popullit, përzgjedh anëtarët e Këshillit me short, midis datës 1 dhe 5 dhjetor të çdo viti kalendarik. ….*", "*Avokati i Popullit bën menjëherë publik në faqen zyrtare të institucionit raportin e monitorimit të procesit të shortit*".

Në përfundim të procesit të hedhjes së shortit, i cili në vlerësimin tonë u krye në përputhje të plotë me ligjin, u hartua dhe publikua nga institucioni ynë edhe raporti përkatës i monitorimit, mbi

[188] Për më tepër, shih:
https://www.gjk.gov.al/include_php/previewdoc.php?id_kerkesa_vendimi=3593&nr_vendim=1

procedurën e hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për vitin 2023, zhvilluar nga Presidenti i Republikës në datën 05.12.2022. [189]
Po sipas detyrimeve kushtetuese dhe ligjore të sipërcituara, institucioni ynë ka marrë pjesë në të 38 (tridhjetë e tetë) mbledhjet e KED-së të zhvilluara gjatë vitit 2022, duke u përpjekur të ushtrojë me përgjegjshmëri të lartë detyrat e përcaktuara nga legjislatori (mendimet e dhëna nga institucioni ynë, janë publikuar të përmbledhura në proces-verbalet e mbledhjeve të KED-së).[190]

Kujtojmë se në raportin vjetor të punës së institucionit tonë për vitin 2021 drejtuar Kuvendit, në pjesën që lidhej me informimin për veprimtarinë e KED për vitin 2021, disa nga çështjet kryesore që kishim evidentuar, ishin: a. Mosparashikimi i buxhetit të nevojshëm për kryerjen si duhet të detyrës; b. Nevoja për burime njerëzore shtesë të stafit ndihmës; c. Kriteret ligjore për tu përzgjedhur anëtar i Gjykatës Kushtetuese.

Me keqardhje konstatojmë se të njëjtat probleme u përsëritën edhe gjatë veprimtarisë së KED 2022. Po kështu vlerësojmë se gjetjet dhe trajtimi i problematikave të konstatuara nga institucioni ynë në raportet vjetore, duhet të konsiderohen si pjesë e sistemit "*check and balance*" dhe të shërbejnë për legjislatorin për të formësuar politikat përkatëse. Mosshqyrtimi i tyre, në rastin më të pakët, mund të sjellë përsëritjen e të njëjtave problematika. Duke qenë se përveç sa më sipër KED për vitin 2022, shfaqi edhe një sërë çështjesh të tjera, po ndalemi më hollësisht në shqyrtimin e secilës prej tyre.

Për sa i përket *buxhetit*: pavarësisht se KED është parashikuar në Kushtetutë si institucion i veçantë i pavarur, për të nuk parashikohet fond direkt dhe i veçantë nga buxheti i shtetit, ashtu siç është parashikuar për organe të tjera që u krijuan me ndryshimet kushtetuese të vitit 2016.[191] Bazuar në nenin 219 pika 3 të ligjit nr. 115/2016 "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë", "*3. Gjykata e Lartë siguron mbështetjen e nevojshme organizative, administrative dhe* ***financiare*** *për realizimin e funksionit dhe të detyrave të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, të parashikuara në Kushtetutë dhe në këtë ligj*". Duke patur parasysh edhe se parashikimi i buxhetit të Gjykatës së Lartë, nuk paraqitet drejtëpërdrejt në Kuvend, por kalon nëpërmjet Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe është ky i fundit që e përcjell në Kuvend, kjo procedurë gjithashtu vështirëson marrjen e buxhetit të nevojshëm për KED.[192] Mungesa e buxhetit të nevojshëm ka sjell pasiguri dhe vështirësi si në: *a.* funksionimin e këtij organi, ashtu edhe *b.* të shpërblimit të drejtë të anëtarëve dhe stafit ndihmës të KED për punën shtesë.

Më konkretisht gjatë vitit 2022 për sa i përket çështjes së parë, nuk ishte parashikuar buxhet për shpenzimet të ndryshme si pagesa e ekspertëve që u thirrën, apo edhe pagesa për mbledhjen e dokumentacionit (kujtojmë se një nga vonesat kryesore në plotësimin e dosjeve të kandidatëve për anëtarë në Gjykatën Kushtetuese, ishte mungesa e përgjigjeve nga Drejtoritë Vendore të

---

[189] Për më shumë referohuni Linkut: https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Raporti%20per%20hedhjen%20e%20shortit%20te%20KED%20-Dhjetor%202022.pdf.
[190] http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Procesverbale_te_mbledhjeve_13841_1.php.
[191] Psh rasti i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, i cili sipas nenit 188 të Kushtetutës, citojmë: "*2. Buxheti vjetor i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, është pjesë e Buxhetit të Shtetit dhe ndjek të gjitha procedurat e hartimit dhe zbatimit të tij, të parashikuara në legjislacionin përkatës*", është parashikuar që të jetë direkt pjesë e buxhetit të shtetit.
[192] KED nuk është në varësinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe rrjedhimisht s'mund të varet për buxhetin e saj nga ky Këshill.

Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, të cilat ndër të tjera refuzonin të kthenin përgjigje, në se nuk kryhej pagesa paraprakisht).

Ndërkohë për sa i përket shpërblimit të drejtë të anëtarëve të KED, legjislacioni aktual ka mangësi në parashikimin e masave adekuate për shpërblim ose ulje të ngarkesës që përballojnë gjyqtarët dhe prokurorët paralelisht me punën në KED. Për më tepër nuk është parashikuar as mbulim i shpenzimeve të udhëtimit, në rastet e anëtarëve të KED nga qytete të tjera.

Institucioni i Avokatit të Popullit përsërit rekomandimin për zgjidhjen e çështjeve buxhetore me akte normative përkatëse dhe jo duke e lënë në shpresën e fondeve rezervë të Këshillit të Ministrave.[193]

Probleme të tjera ishin të natyrës administrative e të lidhura me kapacitetet e kufizuara të KED. Këtu mund të përmenden:

- ✓ Mungesa e dërgimit të materialeve të mbledhjeve në kohë, si institucionit tonë, ashtu edhe anëtarëve të KED-së (detyrim ky i parashikuar si nga neni 11, pika 10 e Rregullores së Brendshme për funksionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi;[194]
- ✓ Mospublikimi në disa raste në kohë i relacioneve të përmbledhura të mbledhjeve të KED-së në faqen e KED-së;
- ✓ Hedhja e shortit në mënyrë manuale dhe jo elektronike;
- ✓ Mungesa e listës (inventarit) të dokumentave të dërguara institucionit të Avokatit të Popullit, në dosjet nominale të kandidatëve për vendet vakante për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese.[195]

Përtej sa më sipër, ky institucion përballoi një volum të madh pune (rreth 635 shkresa të dërguara, 70 vendime të marra) dhe arriti që ti përcjellë organeve të emërtesës kandidaturat përkatësë për 4 (katër) vende vakante. Më pas organet e emërtesës emëruan këta 4 kandidatë në vendet e fundit të mbetur vakante, duke arritur kështu, pas shumë vitesh, plotësimin me numrin e plotë të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese në ushtrim të mandatit 9-vjeçar.

4.9 Monitorimi i pavarur i të drejtave të emigrantëve të huaj si dhe operacionet e përbashkëta me FRONTEX për rikthimin e shtetasve të parregullt nga vendet e BE-së

Monitorimi i pavarur i të drejtave të emigrantëve të huaj

[193] Kemi parasysh zgjidhjen që i është dhënë KED-ve të mëparshme, përkatësisht me VKM nr. 298, datë 10.05.2019 "Për një shtesë fondi, nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për sistemin e drejtësisë, miratuar për vitin 2019" dhe VKM nr. 980, datë 21.10.2020, me efekt financiar prej 14,000,000 lekë, për shpërblimin e anëtarëve të KED-së dhe të personelit mbështetës të caktuar pranë tij nga Gjykata e Lartë. Shtojmë se Avokati i Popullit nuk ka qenë i përfshirë as në rastet e mësipërme dhe në asnjë rast tjetër në këto shtesa fondesh, pavarësisht se ndjekja e veprimtarisë së KED, përbën një ngarkesë të konsiderueshme për institucionin tonë dhe se për këto detyra të reja nuk u parashikua as shtim i stafit dhe as shtim i buxhetit.

[194] Pika 34: "*Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori,i njoftohet kandidatit të verifikuar dhe subjekteve që ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit sipas ligjit.* ***Avokatit të Popullit i dërgohet edhe dokumentacioni i përgatitur nga relatori mbi veprimet e kryera prej tij gjatë procedurës së ndjekur për verifikimin e kandidatit.*** *Ky njoftim bëhet publik edhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi".*

[195] Përcjella kësaj liste ka rëndësinë e saj edhe gjatë procesit të verifikimit të dosjeve të dërguara nga KED-ja në institucionin e Avokatit të Popullit, pasi nuk jep siguri dhe nuk garanton numrin e akteve të administruara nga Relatori gjatë procedurës paraprake të zhvilluar prej tij, si dhe nuk konfirmon vërtetësinë e numrit të dokumentave që janë pjesë e dosjes së kandidatit.

Për shkak të kapaciteteve të kufizuara njerëzore dhe financiare, edhe gjatë vitit 2022, institucioni i Avokatit të Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka vijuar monitorimin e kufijve nëpërmjet zbatimit të marrëveshjes së bashkëpunimit të nënshkruar me UNHCR në kuadër të projektit të përbashkët "*Refugjatët dhe Azilkërkuesit në vendet e Europës Juglindore*"[196], për kontrollin e kufirit dhe mbrojtjen e refugjatëve në Shqipëri, në zonën jugore të Shqipërisë (Gjirokastër, Sarandë, Përmet) dhe në zonën juglindore (Korçë, Devoll Bilisht).[197]

Panorama e prurjeve migratore në territorin e Korçës për periudhën Janar - Dhjetor 2022

Vija kufitare në zonën e Korçës, konsiderohet nga grupet e migrantëve të parregullt, si porta më e madhe dhe më e mundshme për të depërtuar nga territori i Greqisë për në territorin e vendit tonë.
Nga informacioni i punonjësve të policisë në Kapshticë rezulton se, grupet migratore që mbërrijnë në Shqipëri nuk e konsiderojnë vendin tonë si destinacion për qëndrim të përhershëm, ndaj dhe një numër shumë i vogël i tyre kërkojnë azil. Pjesa tjetër, përmes pikave kufitare tokësore në veri të vendit, vazhdojnë rrugëtimin drejt Kosovës apo Malit të Zi, me synimin për të depërtuar në vendet e BE-së.

Migrantët pasi identifikohen në kufi, në afërsi të tij apo brenda në territorin e vendit tonë, shoqërohen nga patrullat e policisë kufitare në bashkëpunim me punonjësit e FRONTEX-it, për në Qendrën e Përkohshme të pritjes së migrantëve të parregullt, e cila ndodhet në afërsi të stacionit të policisë kufitare në Kapshticë. Për periudhën *Janar– Dhjetor 2022*, në këtë Qendër janë shoqëruar dhe akomoduar *6628 persona*, nga të cilët *3856 persona* kanë hyrë për herë të parë në territorin e Shqipërisë dhe *2772 persona* janë përsëritës.
Ndërkohë, *3800 persona* kanë marrë urdhër largimi dhe *32* janë referuar në azil, *2* janë shoqëruar në Kareç dhe *23* në qendrat sociale. Grupet e migrantëve që konsiderohen me risk janë gratë dhe fëmijët nën moshën 18 vjeç. Statistikat tregojnë se, gjatë kësaj periudhe kanë hyrë në mënyrë të parregullt *295 fëmijë* nën moshën 18 vjeç, *41* prej te cilëve femra dhe *254* meshkuj.

Po kështu janë deklaruar *122 gra* mbi moshën 18 vjeç dhe *41 vajza* nën moshën 18 vjeç. Referuar shtetësisë, migrantët në shumicën e tyre kanë qenë nga Siria (2281), Afganistani (264), Iraku, Palestina, Maroku, Algjeria etj.

Krahasuar me të dhënat e tre viteve të fundit, ka patur një rënie të fluksit të migrantëve që kanë hyrë në territorin e Shqipërisë nga kjo pikë kufitare.

---

[196] Në dhjetor 2022, u nënshkrua dhe Marrëveshja e re e Bashkëpunimit për vitin 2023, e cila parashikon shtimin e një eksperti me kohë të pjesshme i cili do të veprojë në qytetin e Tiranës.

[197] Në këtë kuadër, është duke u hartuar një Raport Monitorimi *"Për respektimin e të drejtave dhe lirive të migrantëve të parregullt, refugjatëve dhe azilkërkuesve në Shqipëri"*, për vitin 2022, nisur nga gjetjet e inspektimeve periodike të kryera nga MKPT në Qëndrat e Përkohshme të Pritjes dhe Strehimit të Migrantëve të parregullt në Kapshticë, Korçë dhe në Grehot, Gjirokastër, si dhe nga monitorimi i vazhdueshëm që kryejnë dy ekspertëve të jashtëm për kufirin dhe refugjatët të Avokatit të Popullit, në këto dy zona.

Disa nga gjetjet e monitorimeve në territorin e Korçës

Nisur nga statistikat e periudhës 6-mujore për vitin 2022, nga *2328* persona që kanë hyrë në territorin e Shqipërisë nga kufiri me Greqinë në zonën e Kapshticës, në intervistat e zhvilluara nga ekipet e policisë kufitare në bashkëpunim me FRONTEX, rezulton se, *asnjë nga migrantët e parregullt nuk kishte aplikuar pranë autoritetetit shtetëror në vendin tonë për Azil*.

Ndërkohë, strukturat e policisë për kufirin dhe migracionin në DRKM Korçë, kishin përpiluar *1349 urdhëra largimi* dhe brenda afatit 7 ditor ata ishin larguar vullnetarisht nga territori i vendit tonë. Për 10 persona (kryesisht fëmijë të pashoqëruar dhe gra), janë krijuar kushte për ti sistemuar në qëndrat sociale të Bashkisë Korçë.

Në vlerësimin e institucionit të Avokatit të Popullit, strukturat shtetërore përgjegjëse për kufirin dhe migracionin, si dhe ato për Azilin, gjatë zbatimit të kontrolleve kufitare, intervistimit dhe përzgjedhjes së migrantëve, duhet të konsiderojnë dhe rishqyrtojnë kërkesat e migrantëve të parregullt për Azil.

Kjo, në harmonizim të plotë me ligjet, politikat dhe praktikat ndërkombëtare të parashikuara në Konventën dhe jurisprudencën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, *duke ndaluar me efekt të menjëhershëm prapësimet*, të cilat i pengojnë migrantët që të largohen nga vendi i tyre i origjinës apo që të arrijnë në BE, me qëllim që të ushtrojnë të drejtën e tyre për të kërkuar dhe gëzuar azil.

Panorama e prurjeve migratore në territorin e Gjirokastër për periudhën Janar - Dhjetor 2022

Përgjatë periudhës *janar –dhjetor 2022* në territorin kufitar të Qarkut të Gjirokastrës sipas të dhënave zyrtare të Drejtorisë Rajonale të Kufirit dhe Emigracionit Gjirokastër janë evidentuar *2331 të huaj* të parregullt. Një pjesë e tyre kanë qenë përsëritës *(993)* në hyrjen nga kufiri grek në territorin shqiptar.

Pjesa më e madhe e migrantëve të parregullt kanë hyrë në periudhën *Mars-Qershor 2022*, kohë që përkon me përmirësimin e kushteve të motit dhe që shfrytëzohet nga migrantët për të kaluar në terrene të vështira të kufirit të gjelbër greko –shqiptar. Pjesa më e madhe e migrantëve të parregullt që kanë hyrë nga Greqia në territorin shqiptar kanë qenë meshkuj madhorë *(2216)*, ndërsa vetëm *96* kanë qenë femra dhe *19* të mitur.

Pjesa më e madhe e migrantëve janë evidentuar në territor *(1407)*, ndërsa vetëm *924* migrantë janë evidentuar në kufi. Sipas të dhënave për vitin 2022 janë referuar në azil *35* migrantë dhe janë shoqëruar në Kareç *32* persona.

Rekomandime:

✓ Realizimin e një marrëveshje bashkëpunimi me palën e policisë kufitare greke, për kryerjen e protokollit të rregullt ligjor të kthimit pas të të huajve të parregullt që kanë hyrë nga territori grek, në rastet kur ata janë përsëritës apo atyre nuk u miratohet statusi i azilkërkuesit nga autoritetet shqiptare të përcaktuara në ligj;

✓ Trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve të policisë kufitare, për njohjen me ndryshimet e reja ligjore në ligjin "Për të Huajt" dhe ligjin "Për Azilin në RSH" dhe ngritjen e kapaciteteve të

tyre dhe të specializuar specifikisht, për kryerjen e procedurave të intervistave dhe të përzgjedhjes me migrantët e parregullt, në pikat e kalimit të kufirit ku janë evidente flukset migratore;

- ✓ Sigurimin në mjediset e intervistimit të përkthyesve, kryesisht për gjuhët Dari, Fars, etj., si dhe zhvillimin e përpjekjeve nga policia kufitare për ngritjen e një sistemi të qëndrueshëm të përkthyesve, sipas listës të miratuar nga Ministria e Drejtësisë;
- ✓ Përmirësimi i masave të transportit të migrantëve të parregullt gjatë udhëtimit nën shoqërinë e policisë kufitare;
- ✓ Mbulimi me staf për kryerjen e shërbimit të mirëmbajtjes, pastrimit dhe dezinfektimeve periodike të GOS Kakavijë dhe Qendrës së përkohshme të migrantëve Grehot;
- ✓ Hartimin dhe zbatimin e një projekti rehabilitues për mjediset e GOS Kakavijë, të harmonizuara me nevojat funksionale dhe mundësitë që kanë mjediset ekzistuese;
- ✓ Marrjen e masave për krijimin e tendave mbrojtëse në mjediset e jashtme në Qendrën e Grehotit, kryesisht për stinën e verës për të lehtësuar qëndrimin e emigranteve;
- ✓ Marrjen e masave për ndriçimin e tunelit që përshkon rrugën nga Pika kufitare tek GOS Kakavijë, krijimin e një sistemi të qëndrueshëm për ngrohje në dimër dhe përmirësimin e segmentit rrugor nga Pika doganore tek GOS Kakavijë;
- ✓ Marrjen e masave në bashkëpunim me Bashkinë Gjirokastër dhe Bashkinë Dropull për menaxhimin dhe disiplinimin e mbetjeve urbane, pasi ato hidhen në mjedise të pakontrolluara dhe nuk tërhiqen nga makinat e pastrimit;
- ✓ Marrjen e masave për një vlerësim teknik nga specialistët e ndërtimit, pasi godina në GOS Kakavijë ka çarje tektonike, por edhe probleme me bazamentin e saj.

Operacionet e përbashkëta me FRONTEX për rikthimin e shtetasve të parregullt nga vendet e BE-së

Siç kemi informuar edhe më parë, institucioni i Avokatit të Popullit nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT), në bashkëpunim me Drejtorinë e Policisë Kufitare dhe të Migracionit dhe FRONTEX, është pjesë e grupit të monitorimit në *operacionet e riatdhesimit* vullnetar e të detyruar të shtetasve shqiptarë nga vendet e BE-së dhe konkretisht Francës.

Edhe gjatë vitit 2022, MKPT-së në bashkëpunim me Drejtorinë e Policisë Kufitare dhe të Migracionit dhe FRONTEX ka vazhduar të monitorojë në mënyrë konstante operacionet e riatdhesimit vullnetar e të detyruar të shtetasve shqiptarë nga vendet e BE-së dhe shteteve të zonës Shengen, me qëllim transferimin sipas rregullave të shtetasve shqiptarë me vendim riatdhesimi nga territoret e vendeve anëtare të BE-së, ku për vitin raportues MKPT-ja ka marrë pjesë në *23 operacione riatdhesimi.*

Gjatë këtyre operacioneve të riatdhesimit, përfaqësuesit e MKPT-së kanë zhvilluar intervista të strukturuara me këta shtetas para nisjes dhe gjatë udhëtimit në bord, lidhur me kushtet e trajtimit në qendër. Gjatë intervistimit, shtetasit kanë ngritur shqetësimin për cilësinë e ushqimit gjatë ditëve të qëndrimit në qendër, si dhe pamundësinë e tyre për të apeluar vendimin për largimin apo dëbimin e detyruar nga vendet e BE-së.

Përfaqësuesit e MKPT-së, në takimet e zhvilluara me përfaqësuesit e FRONTEX dhe të Drejtorisë së Policisë Kufitare dhe të Migracionit, kanë rekomanduar marrjen e masave për të garantuar kthimin duke respektuar plotësisht të drejtat themelore të migrantëve shqiptarë sipas standardeve të BE-së, si dhe legjislacionit shqiptar.

Pavarësisht progresit të bërë në këtë drejtim, vazhdon të mbetet problematike fakti që shtetasit shqiptarë që rikthehen, nuk kanë informacion të plotë në lidhje me marrjen vendimit dhe mënyrën e ekzekutimit për rikthimin e detyrueshëm të tyre, nga vendet e BE-së për në vendin tonë. Njëkohësisht, nga intervistat e zhvilluar me këta shtetas, ata kanë ngritur me shqetësim faktin se atyre nuk ju lihet kohë në dispozicion për apelimin e vendimeve të rikthimit apo dëbimit në vendet respektive të BE-së.

4.10 Konferenca vjetore

Konferenca Vjetore e Avokatit të Popullit për vitin 2022 me temë "*Roli i institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut si element themelor i shtetit të së drejtës në Shqipëri*", u organizua në datën 22 dhjetor, me mbështetjen e projektit "Promovimi i Diversitetit dhe Barazisë në Shqipëri", në kuadër të programit të përbashkët të Bashkimit Europian dhe Këshillit të Europës "Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019- 2020".

Komiteti i Ministrave i Këshillit të Europës ka miratuar dy rekomandime shumë të rëndësishme për agjendën e të drejtave të njeriut, ndaj dhe konferenca vjetore e Avokatit të Popullit për vitin 2022 synoi të mbledhë në tryezat e diskutimit përfaqësues nga institucione shtetërore por edhe aktorë të ndryshëm nga shoqëria civile në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, për të ndarë mendime mbi rolin që luajnë institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut në forcimin e shtetit të së drejtës.

Rekomandimi për zhvillimin dhe forcimin e institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (IKDNJ). Duke njohur rolin e tyre si shtylla të shtetit të së drejtës, të drejtave të njeriut dhe demokracisë në Europë, Komiteti i Ministrave i rekomandon çdo shteti anëtar të Këshillit të Europës të krijojë, mbajë dhe forcojë një Instituction Kombëtar të të Drejtave të Njeriut (IKDNJ) të pavarur në përputhje me Parimet e Parisit, të sigurojë një mjedis të favorshëm për to, dhe të bashkëpunojnë me to. Rekomandimi thekson potencialin dhe ndikimin e madh të IKDNJ-ve për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Europë, veçanërisht për zbatimin efektiv të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), duke përfshirë ndërhyrjet e palëve të treta përpara Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe komunikimet në lidhje me mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve.

Rekomandimi gjithashtu inkurajon Shtetet Anëtare të Këshillit të Europës që të eksplorojnë mënyra të reja për të zhvilluar një rol më të fortë dhe pjesëmarrje kuptimplotë të IKDNJ-ve dhe Rrjetit Europian të Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (ENNHRI-t) në Këshillin e Europës. Ky rekomandim përbën një instrument i cili sjell standarde të reja dhe nxit praktikat e mira, duke njohur rolin e institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut por edhe të organizatave të shoqërisë civile si promovues të të Drejtave të Njeriut. Në lidhje me këtë rekomandim, ENNHRI është duke punuar për mbikëqyrjen e zbatimit të tij nga shtetet anëtare të

KiE. Rezultatet e këtij monitorimi do të përkthehen në një raport të pavarur të ENNHRI-t sa i takon zbatimit të rekomandimit, i cili do të prezantohet dhe diskutohet në Komitetin e Ministrave në Qershor 2023.

Rekomandimi i KiE për luftën ndaj gjuhës së urrejtjes, i adresohet qeverive të vendeve anëtare për të zhvilluar strategji të kuptueshme, për të parandaluar dhe luftuar gjuhën e urrejtjes, përfshirë miratimin e një kuadri ligjor efektiv, si dhe implementimin e masave të duhura dhe proporcionale. Udhëzimet rekomandojnë që shtetet anëtare duhet të bëjnë dallimin ndërmjet rasteve më serioze të gjuhës së urrejtjes të cilat nuk janë mjaftueshëm të rënda për t'u kufizuar në mënyrë legjitime sipas Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut por megjithatë bëjnë thirrje për përgjigje alternative; dhe kundër gjuhës së urrejtjes në internet, duke siguruar dispozita të qarta dhe të parashikueshme për heqjen efektive të gjuhës së urrejtjes në internet. Rekomandimi gjithashtu mbulon kërkesat procedurale për heqjen e gjuhës së urrejtjes, mekanizmat e dëmshpërblimit dhe apelit dhe nënvizon nevojën për transparencë dhe proporcionalitet. Teksa i drejtohet kryesisht shteteve anëtare dhe autoriteteve të tyre, rekomandimi përmban gjithashtu udhëzime për aktorë të tjerë duke përfshirë zyrtarët publikë, partitë politike, ndërmjetësit e internetit, mediat dhe organizatat e shoqërisë civile. Në lidhje me këtë çështje, ka disa gjetje interesante ndër të cilat raporti i shtatë organizatave nën ombrellën e KiE në trajtën e "freedom of the media (safety of journalists) platform", i cili evidenton se liria e medias në Shqipëri është në përkeqësim.

Të ftuar në cilësinë e panelistëve në Konferencë ishin Kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, Lindita Nikolla, Ambasadorja e Delegacionit të Bashkimit Europian në Shqipëri, Christiane Hohmann, Zv. Kreu i Zyrës së Këshillit të Europës në Tiranë, Olsi Dekovi, Koordinatorja e Përhershme e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri Fiona McCluney, përfaqësues të tjerë të Kuvendit, institucioneve shtetërore e atyre të pavarura, përfaqësues të trupit diplomatik, organizatave të huaja në vendin tonë, shoqërisë civile e medias.

Konferenca u hap nga Avokatja e Popullit e cila theksoi në mesazhin e saj, nevojën që institucionet e të drejtave të njeriut ta kenë të garantuar pavarësinë e tyre nga çdo lloj ndikimi pasi kjo u jep atyre efektivitetin e peshën për të cilën kanë nevojë institucionet demokratike në vendin tonë.

Konferenca u zhvillua e ndarë në dy sesione diskutimesh ku në sesionin e parë panelistët trajtuan temën e "*Zhvillimit dhe forcimit të Institucioneve kombëtare efektive, pluraliste dhe të pavarura për të drejtat e njeriut*", ndërsa në sesionin e dytë, temën: "*Liria e medias dhe gjuha e urrejtjes online në dritën e Rekomandimit të KiE për luftën ndaj gjuhës së urrejtjes*"

KREU 5
Bashkëpunimi

5.1 Bashkëpunimi me institucionet e administratës publike dhe niveli i zbatimit të rekomandimeve të AP-së

Duhet të theksohet fillimisht se një nga mandatet e Avokatit të Popullit është të shqyrtojë ankesat që rrjedhin nga veprimtaria e administratës publike nëse ato cënojnë të drejtat e tyre kushtetuese. Nëpërmjet rekomandimeve, kërkesave apo propozimeve të tij, ai synon të sjellë përmirësime në standardet dhe cilësinë e shërbimeve si dhe të promovojë ndershmërinë në administratën publike.

Ushtrimi i këtij mandati kërkon që puna e institucionit si dhe sjellja dhe integriteti i stafit të tij të jenë në standard të lart, jo më të ulët sesa ato që ai kërkon të zbatojë administrata publike në punën e saj. Synimi i tij është që individët të realizojnë të drejtat dhe liritë e tyre pa qenë nevoja që çështja e tyre të shkojë e të zgjidhet në rrugë gjyqësore. Avokati i Popullit është një institucion mbi palët i cili i shërben administratës publike për tu vetëkorrigjuar përsa qëllimi i kësaj të fundit është shërbimi sa më i mirë për qytetarët.

Avokati i Popullit, përmes rekomandimeve të tij, kontribuon në edukimin e administrates në fushën e të drejtave të njeriut, duke e bërë atë të kuptojë rolin e saj të vërtetë ndaj qytetarëve, pra të kuptojë se arsyeja e vërtetë e ekzistencës së saj është të jetë shërbëtore për t'u shërbyer qytetarëve që të realizojnë të drejtat e tyre. Fakti i të qenit në një farë mase sfidues të vendimeve të administratës publike kushtëzon një vështirësi tjetër për relativizimin e mëtejshëm të efikasitetit tonë në mirëqeverisje. Në këto kushte, jo vetëm institucioni i Avokatit të Popullit në Shqipëri, por çdo zyrë Ombudsmani në botë, jo rrallë herë ndeshet me rezistencë nga ana e organeve të administratës publike.

Siç e kemi theksuar edhe më parë, krahas bashkëpunimit të mirë dhe të frutshëm ka pasur jo pak raste të neglizhencës apo mungesës së kthimit të përgjigjeve të kërkesave tona nga institucionet e administratës publike qendrore dhe vendore, moszbatimit të rekomandimeve të adresuara nga institucioni i Avokatit të Popullit, herë nga pamundësia e plotësimit të kërkesave për çështje/ankesa të shoqëruara me detyrime financiare dhe herë nga mos angazhimi si duhet i organeve të administrates publike.

Mungesa e dërgimit të informacionit dhe dokumentacionit, apo dërgimi i përgjigjeve të pjesshme ose tej afatit të përcaktuar, ose atij të arsyeshëm ligjor, sjell zvarritjen e procesit administrativ dhe mohimin e të drejtës së qytetarëve për të gëzuar efektivisht të drejtat e tyre kushtetuese dhe për të përdorur mekanizmat kushtetues për garantimin e tyre. Kjo gjithashtu minon besimin e qytetarëve tek shteti dhe administrata shtetërore ndërkohë që të gjitha përpjekjet e institucioneve, janë të drejtuara për nga ruajtja e besimit të publikut. Nga ana tjeter, mosveprimet e këtij lloji, parë në një këndvështrim më të gjerë, përbëjnë si shkelje të parimeve të ligjshmërisë, informimit,

deburokratizimit dhe efiçencës, por edhe cënim të parimit për zhvillimin e një proçesi të rregullt administrativ, si rrjedhojë e mosdhënies së informacionit dhe shpjegimeve brenda afateve ligjore.

Konstatohet gjithashtu se rritja e besimit të publikut tek institucioni i Avokatit të Popullit nuk është në përpjestim të drejtë me rritjen e ndërgjegjësimit të administratës publike për rëndësinë që ka në vetvete zbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit. Rrjedhimisht, përveç vazhdimit të thellimit të punës për të rritur cilësinë e rekomandimeve dhe arsyetimeve të rekomandimeve tona si edhe të kthimit të përgjigjeve për qytetarët për rastet ku nuk konstatohen shkelje apo çështja zgjidhet pa rekomandim, është shumë e rëndësishme forcimi i mëtejshëm i rolit mbikqyrës të Kuvendit të Shqipërisë për të detyruar zbatimin e rekomandimeve që Avokati i Popullit u ka drejtuar ekzekutivit dhe institucioneve të tjera publike.

Në këtë kuptim, siç është theksuar edhe më parë, vlerësojmë se nevojiten përmirësime të mëtejshme që Mekanizmi për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve (Platforma Ndërinstitucionale Online), të bëhet më funksional për të mundësuar zbatimin efektiv të legjislacionit ekzistues dhe përmirësimin e tij në fusha që kanë lidhje me të drejtat e njeriut.

- *Niveli i zbatimit të rekomandimeve*

Gjatë vitit 2022 institucioni i Avokatit të Popullit ka adresuar në total *249 rekomandime* drejtuar organeve të administratës publike duke përfshirë atë qendrore dhe vendore. Nga numri total i rekomandimeve, niveli i zbatimit të tyre deri në muajin Janar të vitit 2023 rezulton si më poshtë:

Rekomandime të pranuara dhe të zbatuara plotësisht	*17%*
Rekomandime të pranuara të zbatuara pjesërisht	*36%*
Rekomandime të pranuara por të zbatuara	*11%*
Rekomandime të refuzuara	*16%*
Rekomandime pa përgjigje	*14%*
Rekomandime në proces	*6%*

Në totalin prej *42 ose 17%* të rekomandimeve të pranuara dhe zbatuara plotësisht, janë përfshirë ato rekomandime për të cilat ka pasur një përgjigje nga institucionet duke adresuar plotësisht të pikat e rekomandimeve të lëna nga institucioni i Avokatit të Popullit, dhe njëkohësisht duke i zbatuar këto rekomandime në tërësinë e tyre.

Në totalin prej *89 ose 36 %* të rekomandimeve të pranuara dhe zbatuara pjesërisht, janë përfshirë ato rekomandime për të cilat ka pasur një përgjigje nga institucionet duke adresuar pikat e rekomandimeve të lëna nga institucioni i Avokatit të Popullit, plotësisht ose vetëm një pjesë të tyre, dhe njëkohësisht duke i zbatuar ato vetëm për një pjesë të rekomandimit.
Në totalin prej *28 ose 11 %* të rekomandimeve të pranuara por të pazbatuara janë përfshirë ato rekomandime për të cilat ndonëse ka pasur një përgjigje nga institucionet duke pranuar parimisht pikat e rekomandimeve, ato nuk kanë gjetur zbatim të plotë ose të pjesshëm.

Në totalin prej *41 ose 16 %* të rekomandimeve të refuzuara janë përfshirë ato rekomandime për të cilat është kthyer përgjigje nga institucionet e administratës publike se refuzohet zbatimi i tyre, si dhe ato rekomandime për të cilat nuk ka pasur një përgjigje nga institucionet e administratës publike ndonëse kanë kaluar më shumë se tre muaj nga dërgimi i rekomandimit, duke i konsideruar këto rekomandimeve *apriori* si të refuzuara. Ky ndryshim në metodologjinë e llogaritjes së këtij indikatori ka sjellë dhe rritjen e ndjeshme të tij, nga *9%* qe ka qënë për vitin 2021 në *16%* për vitin 2022. Nëse ky indikator do të përllogaritej vetëm mbi numrin e rekomandimeve për të cilat ka pasur një përgjigje refuzuese të shprehur, vlera e tij do të ishte rreth *6%*, pra pak a shumë në nivel konstant me vlerën e viteve të fundit.

Në totalin prej *34 ose 14%* të rekomandimeve pa përgjigje janë përfshirë ato rekomandime për të cilat ndonëse kanë kaluar afatet administrative procedurale, nuk ka pasur një përgjigje nga institucionet, por për të cilat nuk ka kaluar ende afati për t'i konsideruar si rekomandime të refuzuara.

Në totalin prej *15 ose 6%* të rekomandimeve në proces janë përfshirë ato rekomandime për të cilat *nuk kanë kaluar afatet procedurale* për kthimin e një përgjigje nga institucionet.

Rekomandimet e adresuara nga institucioni i Avokatit të Popullit, në pjesën më të madhe të rasteve adresojnë zgjidhjen e më tepër se një problematike të caktuar. Për këtë qëllim, brenda një rekomandimi të vetëm, që i adresohet organeve të administratës publike, mund të ketë disa rekomandime të ndryshme për zgjidhjen e çështjeve të caktuara, ose thënë ndryshe disa nën-rekomandime.

Në 249 rekomandimet e adresuara gjatë vitit 2022, janë adresuar gjithsej 1312 nën-rekomandime. Nga këto, vetëm 47 % e tyre janë zbatuar plotësisht, teksa 48 % e tyre mbeten ende të pazbatuar dhe për 5 % prej tyre institucioni nuk ka marrë pergjigje.

➢ *Raporti i rekomandimeve të zbatuara kundrejt rekomandimeve të pranuara nga institucionet;*

Nga numri i rekomandimeve të adresuara në total, (249), rezulton se:

	Nr	%
Rekomandime të pranuara dhe të zbatuara plotësisht	42	17%
Rekomandime të pranuara dhe të zbatuara pjesërisht	89	36%
Rekomandime të pranuara por të pazbatuara	28	11%
Rekomandime të refuzuara	41	16%
Rekomandime pa përgjigje	34	14%
Rekomandime në proces	15	6%

Për efekt të raportimit të këtij indikatori përllogaritja do të bazohet në numrin total të rekomandimeve të *pranuara* dhe atyre të *zbatura plotësisht*. Nga *249* rekomandime të adresuara në total, numri i rekomandimeve të pranuara është *159* teksa numri i rekomandimeve të zbatuara plotësisht është *42*.

Raporti i rekomandimeve të zbatuara kundrejt të rekomandimeve të pranuara nga institucionet, është si më poshtë vijon:

$$\mathbf{R_{ACC}} = \frac{\mathbf{42\ rekomandime\ te\ zbatuara\ plotësisht}}{\mathbf{159\ rekomandime\ te\ pranuara}} * \mathbf{100 = 26\ \%}$$

➢ *Raporti i kërkesave për sqarime të nxjerra nga Avokati i Popullit, për të cilat nuk është dhënë përgjigje nga institucionet;*

Gjatë vitit 2022, institucioni i Avokatit të Popullit ka adresuar në total rreth *2098* kërkesa për shpjegime drejtuar organeve të administratës publike, prej të cilave rreth *145* ose rreth *6.9 %* e tyre nuk kanë marrë përgjigje nga institucionet përkatëse.

$$R_{RfC} = \frac{\text{Numri i Kërkesat për Sqarim që nuk kanë marrë përgjigje}}{\text{Numri Total i Kërkesave}} \times 100\%$$

$$\mathbf{R_{RfC}} = \frac{\mathbf{145\ kerkesa\ per\ sqarime\ pa\ pergjigje}}{\mathbf{2098\ kerkesa\ per\ shpjegime\ ne\ total}} * \mathbf{100 = 6.9\ \%}$$

Për llogaritjen e këtij indikatori i jemi referuar vetëm rasteve kur nuk ka pasur fare përgjigje nga institucionet, pavarësisht kërkesave tona të përsëritura për shpjegime.
Siç vihet re, ky indikator është në të njejtën vlerë me atë të vitit të kaluar, e cila ka qënë *6.7%*. Për vitin 2019 përqindja e kërkesave për shpjegime pa përgjigje ka qënë rreth *8%*, për vitin 2020 ka pësuar një rritje të lehtë, duke shkuar në rreth *9.6%* teksa për vitin 2021 është ulur me rreth *3%*.

Megjithatë, pavarësisht progresit të vërejtur në drejtim të uljes së përqindjes së kërkesave për shpjegime pa përgjigje mbetet për të evidentuar edhe për vitin 2022 e njëjta problematikë e theksuar edhe në raportet e viteve të mëparshme: në shumë raste ka qënë e nevojshme ndërhyrja e institucionit tonë me disa kërkesa të përsëritura, për të marrë një përgjigje, përfshirë këtu edhe rastet e përgjigjeve të dërguara jashtë afateve ligjore dhe të arsyeshme. Konkretisht, gjatë vitit 2022 nga institucioni i Avokatit të Popullit janë adresuar rreth *658* kërkesa të përsëritura për shpjegime.

Thënë ndryshe, në të paktën *658* kërkesa nga *2098* në total (rreth *31% e rasteve*), është nevojitur që kërkesa të adresohet të paktën 2 herë nga institucioni i Avokatit të Popullit, për të mundësuar një përgjigje nga institucionet e administratës publike. Për nga vetë natyra e punës së institucionit të Avokatit të Popullit është e rëndësishme që shpjegimet apo informacionet nga institucionet e

AP të dërgohen brenda afateve të arsyeshme, në koherencë me mundësinë efektive të institucionit tonë për të ndërhyrë në zgjidhjen e çështjeve.

Sa më siper, rrit në mënyrë të paarsyeshme kostot administrative të shërbimit të dhënë nga Avokati i Popullit dhe gjithashtu ul efikasitetin e ndërhyrjes së Avokatit të Popullit. Për rrjedhojë, ka nevojë për të ndërhyrë në ndryshime legjislative korrektuese për sjelljen dëmtuese të administratës publike, duke parashikuar edhe sanksione si në ligje të ngjashme[198]për institucionet e tjera që ushtrojnë mandate ligjore në mbrojtje e garantim të të drejtave të njeriut.

➢ *Bashkëpunimi në kuadër të procesit të integrimit Europian*

Edhe gjatë vitit 2022, institucioni i Avokatit të Popullit si një nga aktorët kyç në sistemin kombëtar të mbrojtjes të të drejtave të njeriut e ka vlerësuar maksimalisht procesit e integrimit Europian duke bashkëpunuar me të gjitha strukturat shtetërore që janë të ngarkuar me ndjekjen dhe zbatimin e detyrimeve, përmes ofrimit të kontributeve domethënëse që luajnë një rol të rëndësishëm në respektimin e të drejtave të njeriut dhe forcimin e shtetit të së drejtës.

Në datat *25 – 28 tetor 2022*, në Tiranë, u realizua një Mision Vlerësimi i Komisionit Europian (Peer review) mbi monitorimin e institucioneve të pavarura dhe funksionimin efektiv të tyre, në kuadër të vlerësimit nga shërbimet e Komisionit Europian për vazhdimin e reformave themelore, të cilat kanë një rëndësi madhore në procesin e anëtarësimit sipas metodologjisë së rishikuar të zgjerimit të shkurtit në vitin 2020. Në fakt, procesi i vlerësimit ka qenë një proces shumë i gjatë i cili filloi që në muajin qershor 2022.

Misioni i vlerësimit kishte si qëllim vlerësimin e kapaciteteve institucionale për trajtimin në mënyrë efektive të rasteve specifike, përmes procesit të rishikimit dhe analizës së kuadrit ligjor dhe institucional, si dhe funksionimit të marrëdhënieve me pushtetin ligjvënës dhe ekzekutiv për tre institucionet e pavarura të përzgjedhura, përfshirë dhe institucionin e Avokatit të Popullit. Ekspertët shqyrtuan në veçanti statusin, autonominë financiare, stafin administrativ, procesin e vendimmarrjes, procedurat e emërimeve dhe shkarkimeve në marrëdhëniet e punës, transparencën dhe llogaridhënien, si dhe angazhimin, ndikimin, dhe besimin e publikut tek pavarësia e institucionit.

Në përfundim të misionit, ekspertët kanë hartuar një raport të përbashkët, i cili është në fazën e konsolidimit në Shërbimet e Komisionit Europian dhe të cilin do ta ndajnë me institucionet shqiptare të përfshira në këtë proces. Për realizimin e këtij vlerësimi janë përdorur kapacitete të rëndësishme institucionale duke qenë se ka pasur një korrespondencë të gjerë e të thelluar në lidhje me aspekte të ligjit dhe praktikës institucionale

Më datë *19 korrik 2022* në Bruksel u mbajt Konferenca e Parë Ndërqeveritare midis Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, që shënoi fazën e hapjes zyrtare të negociatave për anëtarësimin e vendit tonë në Bashkimin Europian. Procesi ka vijuar me shqyrtimin analitik dhe vlerësimin e harmonizimit të legjislacionit kombëtar me legjislacionin e BE-së. Qëllimi kryesor i vlerësimit

[198] E drejta e Komisionerit për të drejtën e informimit për të vendosur gjoba për mosdhënie informacioni.

analitik të legjislacionit është përcaktimi i ndryshimeve midis legjislacionit kombëtar dhe *acquis* të BE-së për secilin kapitull.

Në këtë kuadër, gjatë vitit 2022, institucioni i Avokatit të Popullit ka marrë pjesë dhe kontribuar edhe në kuadër të takimeve të përbashkëta të zhvilluara me BE-në, ku duhet të përmendet takimet e zhvilluara në kuadër të Kapitullit 23 "Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore":

- Takimi shpjegues i mbajtur më datë *27 shtator 2022*, i cili u fokusua mbi zhvillimet e *acquis* që prej shtatorit të vitit 2018 e në vijim, si dhe,
- Takimi i dytë i zhvilluar në Bruksel (Belgjikë) në datat *24-25 nëntor 2022*, ku autoritetet shqiptare paraqitën shkallën e përafrimit me *acquis* dhe planet e ardhshme për përafrimin. Gjatë këtij takimi dy ditor, u relatuan prezantimet e përgatitura për fushat si: *gjyqësori; politikat antikorrupsion; këndvështrimi i përgjithshëm i të drejtave themelore; parandalimi i torturës dhe keqtrajtimit në sistemet e burgjeve; liria e mendimit, ndërgjegjes dhe besimit; masat për të luftuar racizmin dhe ksenofobinë, gjuhën e urrejtjes dhe krimin e urrejtjes; të drejtat e fëmijëve; liria e shprehjes; barazia gjinore dhe dhuna ndaj grave; të drejtat e personave me aftësi të kufizuara; të drejtat e pronësisë* etj.

Gjithashtu, institucionit i Avokatit të Popullit ka dhënë kontributin e tij në kuader të procesit të hartimit të Planit Kombëtar për Integrimin Europian për periudhën 2023-2025 (PKIE 2023-2025), si dhe në hartimin e Kontributit të II të Qeverisë Shqiptare për Raportin e Komisionit Europian për Shqipërinë për vitin 2022.

Avokati i Popullit ka vazhduar të marrë pjesë në mënyrë aktive edhe në kuadër të mbledhjeve dhe raportimeve të zhvilluara nga Këshilli Kombëtar i Integrimit Europian (KKIE) si struktura më e lartë këshillimore kombëtare për integrimin Europian që funksionon pranë Kuvendit, me qëllim nxitjen dhe garantimin e bashkëpunimit gjithëpërfshirës ndërmjet forcave politike, institucioneve publike dhe shoqërisë civile, si dhe rritjen e transparencës në vendimmarrjen për çështjet e integrimit.

5.2 Bashkëpunimi ndërkombëtar

Institucioni i Avokatit të Popullit i kushton një rëndësi të veçantë forcimit të marrëdhënieve në nivel kombëtar e ndërkombëtar me institucionet homologe, organizatat dhe rrjetet për të drejtat e njeriut, me qëllim fuqizimin e rolit të tij në zbatimin e agjendës globale të të drejtave të njeriut dhe garantimin e zbatimit të standarteve ndërkombëtare, jo vetëm në Shqipëri, por edhe më gjerë. Në këtë kuptim, Avokati i Popullit është investuar ndjeshëm në bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar në nivel dypalësh dhe shumëpalësh në fushën e promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut.[199]

Për vitin 2022, vlerësimi i aktivitetit të Avokatit të Popullit të Republikës së Shqipërisë, u rikonfirmua me zgjedhjen unanime edhe për një mandat të ri të Avokates së Popullit të Shqipërisë

[199] Në mënyrë të detajuar, disa nga drejtimet kryesore të veprimtarisë ndërkombëtare të institucionit të Avokatit të Popullit gjenden në linkun: https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Pjes%C3%ABmarrje%20n%C3%AB%20aktivitetet%20nd%C3%ABrkomb%C3%ABtare%20per%20vitin%202022.pdf

znj. Erinda Ballanca si zëvendës-presidente e dytë e Shoqatës së Ombudsmanëve të Mesdheut (AOM). Ky rikonfirmim shkon përkrah detyrës si Anëtar i Këshillit Administrativ të Shoqatës së Ombudsmanëve dhe Mediatorëve Frankofonë (AOMF), dhe anëtarësisë në bordet drejtuese të dy organizmave të rëndësishëm ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut Rrjetit Europian të Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (ENNHRI) dhe Aleancës Globale të Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (GANHRI).

Pjesëmarrja aktive në nivele të tilla të larta përfaqësimi, ka mundësuar ndër të tjera shkëmbimin e eksperiencave të mira në forcimin e Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (IKDNJ) si institucione të forta, efektive e të pavarura, thelbësore për garantimin e promovimit dhe mbrojtjes së këtyre të drejtave. Një shembull domethënës për këtë është përfaqësimi i ENNHRI-it në Forumin e Kombeve të Bashkuara të UNECE-s në seancën plenare të zhvilluar më ***7 Prill 2022***. Avokatja e Popullit të Shqipërisë, në cilësinë e Anëtares së Bordit të Rrjetit Europian të Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (ENNHRI), adresoi Forumin duke theksuar se Institucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut që operojnë në përputhje me Parimet e Parisit të OKB-së janë tregues të shoqërive paqësore që ndihmojnë rimëkëmbjen e qëndrueshme dhe kanë në fokus të drejtat e njeriut e në zbatim të Agjendës 2030. Në Samitin Ndërkombëtar mbi Rolin e IKDNJ-ve në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, e cila u zhvillua në Ankara më *datat 29-30 qershor 2022*, Avokatja e Popullit si e ftuar paneliste ndau përvojën e suksesshme të institucionit përgjatë procesit të akreditimit në përputhje me Parimet e Parisit (Statusi A), si dhe praktikat e mira dhe mësimet e nxjerra.

Sërish në cilësinë e përfaqësuese së ENNHRI-t, Avokatja e Popullit mori pjesë si paneliste në Seminarin e Kombeve të Bashkuara të Europës dhe Azisë Qendrore mbi kontributin e zhvillimit në plotësimim e të drejtave të njeriut, takim i cili u zhvillua në Gjenevë, më *datat 1-2 shtator 2022* në përputhje me rezolutën 47/11, të miratuar në vitin 2021 nga Këshilli i të Drejtave të Njeriut. Gjatë fjalës së saj në sesionin që kishte në fokus kontributin e strategjive të zhvillimit rajonal në gëzimin e të gjitha të drejtave të njeriut, Avokatja e Popullit u fokusua në politikat, praktikat dhe angazhimet konkrete në nivel rajonal, si dhe rolin e Kombeve të Bashkuara dhe aktorëve të tjerë në përmirësimin e këtyre strategjive.

Në konferencën me temë “Shteti i së drejtës, parimet dhe shkëmbimi i praktikave të mira në veprimet e kompetencave të Institucionit të Ombudsmanit, si mjete për promovimin e mbrojtjes të të drejtave të njeriut", e cila u zhvillua në Qipro më *datat 1-2 dhjetor 2022* dhe u organizua nga Shoqata e Ombudsmanëve të Mesdheut (AOM) dhe Komisioneri për Administratën dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (Ombudsmani i Qipros), Avokatja e Popullit mori pjesë dhe ndau eksperiencën e saj në mbështetjen ndaj shtetit të së drejtës.

Institucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (IKDNj), nga gjithë Europa e më gjerë, u mblodhën më datat *5-6 shtator 2022* në Varshavë, Poloni, në një tryezë të organizuar nga Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR), ku u diskutua rreth forcimit të qëndrueshmërisë së IKDNj-ve përballë kërcënimeve. Avokatja e Popullit të Shqipërisë, mori pjesë në konferencë dhe mbajti një fjalim ku ndau eksperiencat e Institucionit të Avokatit të Popullit përballë risqeve dhe kërcënimeve me të cilat përballet qëndrueshmëria e institucionit.

Në kuadër të bashkëpunimit me Rrjetin Europian të Ombudsmanëve (ENO), Avokatja e Popullit në konferencën me temë "Roli i Ombudsmanëve në kohë krize", e cila u organizua më *datat 27-28 prill 2022* në Strasburg, theksoi se Ombudsmanët janë në një pozicion kyç për të monitoruar sesi qeveritë po i trajtojnë çështjet që lidhen me refugjatët, dhe diskutoi se si politikat kombëtare gjejnë zbatim në terren, hapësirat për përmirësime dhe masat që duhen ndërmarrë.

Më *8-10 qershor 2022*, Avokatja e Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve, znj. Olta Aliaj, morën pjesë në Seminarin e organizuar nga Rrjeti Europian i Ombudsmanëve për Fëmijët (ENOC) në Varshavë, Poloni, ku diskutuan për rolin dhe sfidat e institucioneve të pavarura për mbrojtjen e fëmijëve në Europë, etj. Gjatë seminarit pjesëmarrësit diskutuan tema të rëndësishme si gjendja humanitare në Ukrainë, format e mbështetjes së refugjatëve ukrainas në Poloni dhe vende të tjera të ENOC-ut, drejtësia klimatike, etj.

Përfaqësues të Seksionit të mbrojtjes dhe promovimit të fëmijëve, morën pjesë në konferencën vjetore dhe Asamblenë e Përgjithshme të ENOC në datat *19-21 shtator 2022* në Rejkjavik, Islandë si dhe qenë pjesë aktive në forumin e Rrjetit Europian të Këshilltarëve të Rinj (ENYA) me temë "Drejtësia Klimatike", *më datat 28-30 qershor 2022* në Bilbao, Spanjë.

Institucioni i Avokatit të Popullit mori pjesë aktive në Konferencën dhe Asamblenë e Përgjithshme të Institutit Ndërkombëtar të Ombudsmanit për Europën, e cila u organizua më *datat 25-27 maj 2022* nga Instituti ndërkombëtar i Ombudsmanëve (IOI) dhe Institucioni i Ombudsmanit të Greqisë. Eventi kishte në fokus mandatin dhe kuadrin operacional të Ombudsmanit në epokën post moderne.

Avokatja e Popullit të Shqipërisë dhe përfaqësues të institucionit morën pjesë në konferencën ndërkombëtare mbi të drejtat e të moshuarve dhe rolin e institucioneve të të drejtave të njeriut në mbrojtjen e tyre të organizuar nga Shoqata e Ombudsmanëve të Mesdheut (AOM), *më 27 shtator 2022* në Tbilisi të Gjeorgjisë. Avokatja e Popullit trajtoi temën mbi impaktin e pandemisë së Covid-19 tek të drejtat e kësaj shtrese dhe përcolli përvojën e institucionit shqiptar të të drejtave të njeriut në kauzën e mbrojtjes së të drejtave të të moshuarve.

Avokatja e Popullit mori pjesë në kongresin e AOMF, e cila u mbajt në Marrakesh, Marok më *datat 16-19 maj 2022*. Gjatë këtij takimi të rëndësishëm, pjesëmarrësit diskutuan dhe shkëmbyen pikëpamjet dhe përvojat për transformimin digjital, zhvillimin e shërbimeve administrative digjitale dhe ndikimin tek të drejtat e njeriut, aksesin në drejtësi si dhe rolin e ndërmjetësve dhe ombudsmanëve.

Si anëtar i Rrjetit Europian të Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut, institucioni i Avokatit të Popullit, këtë vit ka pritur dhe ka bashkëpunuar për zhvillimin e Akademisë së ENNHRI, një ngjarje e përvitshme kryesore e këtij rrjeti dhe Zyrës së OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut. Akademia me temë 'Inteligjenca artificiale dhe të drejtat e njeriut', e cila u zhvillua në Tiranë *më datat 20-24 qershor 2022*, mblodhi së bashku përfaqësues të Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut në të gjithë zonën e OSBE-së për trajnime praktike se si të adresohen sfidat e veçanta me të cilat përballen këto insitucione në veprimtarinë e tyre. Akademia kishte si synim trajnimin dhe praktikat për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të stafit të Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut, shkëmbimin e praktikave të mira, vlerësimin e ndikimit të inteligjencës artificiale në të drejtat e njeriut,

përdorimi i mandatit të Ombudsmanit për të trajtuar çështjet e të drejtave të njeriut në lidhje me inteligjencën artificiale, si dhe se si mund të përfitohet nga mundësitë që sjell teknologjia dixhitale dhe inteligjenca artificiale për promovimin dhe mbrojtjen më efektive të të drejtave të njeriut.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka vazhduar bashkëpunimin e ngushtë me *Këshillin e Europës* dhe organizma të tjerë që mbrojnë të drejtat e njeriut, me fokus grupet në nevojë, Komisionin Europian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI), Agjencinë e Bashkimit Europian për të Drejtat Themelore (FRA) dhe organizma të tjerë. Bashkëpunimi i frytshëm, ka vijuar me Zyrën e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut (OHCHR). Shembuj të këtyre bashkëpunimeve janë p.sh. pjesëmarrja aktive në konsultimet globale me IKNDJ për përmirësimin e zbatimit të Paktit Global për migracionin, organizuar nga GANHRI dhe OHCHR; takimi ndërsesional të Këshillit të të Drejtave të Njeriut për dialog dhe bashkëpunim për të drejtat e njeriut dhe Agjendën 2030 për zhvillimin e qëndrueshëm, e cila u organizua nga Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut; trajnimi i zhvilluar nga Departamenti i Kartës Sociale Europiane, ENNHRI dhe Rrjeti Europian i Organeve të Barazisë (EQUINET), me temë "Si mund të angazhohen IKDNJ dhe organet e barazisë me Komitetin Europian të të Drejtave Sociale si pjesë e procedurave të monitorimit të Kartës Sociale Europiane"; Paneli i diskutimit në konferencën për të ardhmen e Europës dhe Integrimin Europian në fushën e mbrojtjes. Ky panel u organizua nga Organizata Europiane e Shoqatave Ushtarake dhe Sindikatave. etj.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka patur kontakte të vazhdueshme me *Delegacionin e BE-së* në Tiranë si edhe me përfaqësues të organizatave dhe institucioneve ndërkombëtare që veprojnë në Shqipëri, si p.sh. Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, Zyra e Këshillit të Europës në Tiranë, Zyra e Koordinatorit të Përhershëm të OKB-së dhe agjencitë e OKB-së si UNHCR, UNICEF, UN Women dhe UNFPA. Falë këtyre bashkëpunimeve, edhe në formën e kontributeve, aktiviteteve e projekteve të përbashkëta, Avokati i Popullit ka mundur të rrisë kapacitetet institucionale, të shtojë praninë e vet në terren dhe të kryejë një sërë aktivitetesh ndërgjegjësuese.[200] Në bashkëpunim me programin e përbashkët të Bashkimit Europian dhe Këshillit të Europës (Instrumenti Horizontal II), më *datë 19 dhjetor 2022* u organizua Konferenca vjetore e institucionit të Avokatit të Popullit, me temë "Roli i institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut si element themelor i shtetit të së drejtës në Shqipëri". Konferenca u zhvillua e ndarë në dy sesione diskutimesh ku në sesionin e parë panelistët trajtuan temën e "Zhvillimit dhe forcimit të Institucioneve kombëtare efektive, pluraliste dhe të pavarura për të drejtat e njeriut", ndërsa në sesionin e dytë, temën: "Liria e medias dhe gjuha e urrejtjes online në dritën e Rekomandimit të KiE për luftën ndaj gjuhës së urrejtjes".

Në kalendarin e aktiviteteve ndërkombëtare të vitit 2022, është shënuar një rritje e prezencës së përfaqësuesve të Avokatit të Popullit në veprimtari të ndryshme fizike e online si trajnime, webinare, takime pune, konferenca, etj., të organizuara nga zyrat homologe dhe nga organizatat ndërkombëtare të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut që kanë kontribuuar në formimin e vazhdueshëm të stafit.

[200] Në mënyrë të detajuar, projektet e vëna në zbatim gjatë vitit 2022 gjenden në pikën 5.3 të këtij raporti (Bashkëpunimi në kuadër të projekteve).

Bashkëpunimi rajonal

Në kuadër të bashkëpunimit rajonal dhe forcimit të marrdhënieve ndërinstitucionale, krahas shkëmbimeve në forume të ndryshme, vlen të përmendet vizita zyrtare *më 3 tetor 2022* e delegacionit nga Avokati i Popullit të Kosovës kryesuar nga Avokati i Popullit të Kosovës Z. Naim Qelaj. Takimi u përqendrua në arritjet aktuale të dy institucioneve si dhe në mënyrat e forcimit të bashkëpunimit dhe bashkëveprimit mes tyre edhe në të ardhmen.

Më herët, më *21 Prill 2022*, Avokatja e Popullit të Shqipërisë Znj.Erinda Ballanca priti në një takim një delegacion nga Agjencia për Informim dhe Privaci e Republikës së Kosovës (AIP) të kryesuar nga Komisionerja e AIP të Republikës së Kosovës Krenare Sogojeva-Dermaku ardhur në Tiranë me ftesë nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Shqipërisë Z. Besnik Dervishi i cili ishte po ashtu pjesëmarrës në takim. Gjatë bisedës, Avokatja e Popullit bëri një ekspoze të misionit dhe punës së Institucionit të Avokatit të Popullit në Shqipëri dhe përpjekjet e pale shqipëtare për ta ndihmuar anëtarësimin e Kosovës në institucionet ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Po ashtu, *më 16 Nëntor 2022* një delegacion i kryesuar nga Sekretari i Përgjithshëm Z. Demir Hamiti dhe i përbërë nga përfaqësues të departamenteve të ndryshme të Avokatit të Popullit në Maqedoninë e Veriut vizitoi institucionin e Avokatit të Popullit të Shqipërisë. Për tre ditë rradhazi ata zhvilluan takime e vëzhgime pranë seksioneve e zyrave të ndryshme të Avokatit të Popullit në Shqipëri me qëllim shkëmbimin e përvojës, ndarjen e praktikave më të mira të të dy palëve e forcimin e marrëdhënieve mes dy institucioneve.

Një delegacion i përfaqësuesve të Komisionit për Mbrojtjen ndaj Diskriminimit të Republikës së Bullgarisë kryesuar nga Ana Xhumalieva, kryetare e Komisionit ishte për një takim pune në institucionin e Avokatit të Popullit *më 3 mars 2022*. Përfaqësuesit bullgarë të cilët mbërritën në Shqipëri me ftesë të Komisionerit për Mbrojtjen ndaj Diskriminimit Z. Robert Gajda, u pritën nga Avokatja e Popullit Znj. Erinda Ballanca dhe u njohën prej saj me përvojën e punës së Institucionit më të madh të mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut në Shqipëri dhe bashkëpunimin me institucione partnere si Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Avokatja e Popullit Znj.Erinda Ballanca adresoi me një fjalë përshëndetëse Konferencën Shkencore "Shteti i së Drejtës në Këndvështrimin e Studiuesve të Drejtësisë në Diasporë". Konferenca e zhvilluar në formatin online *me 20 maj 20122*, bëri bashkë personalitete nga fusha e drejtësisë, Akademisë së Shkencave si organizatore e saj, institucioneve shtetërore, institucioneve të pavarura e atyre të drejtësisë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe diaspora. Në fjalën e saj, Avokatja e Popullit ceku nevojën e rritjes së bashkëveprimit midis aktorëve të ndryshëm të mendimit akademik në fushën e drejtësisë dhe trajtoi çështje që lidhen me marrëdhënien e qytetarëve me shtetin e me të drejtën si dhe shprehu shpresën që reforma në drejtësi në Shqipëri dhe institucionet e dala prej saj, ta justifikojnë besimin e qytetarëve dhe arsyen e krijimit të tyre.

5.3 Bashkëpunimi në kuadër të projekteve[201]

Avokati i Popullit, përgjatë vitit 2022 ka vijuar zbatimin e *Marrëveshjes së Bashkëpunimit me UNHCR* për monitorimin e pikave të kalimit të migrantëve, forcimin si dhe respektimin e të drejtave të tyre. Dy ekspertët e Institucionit të Avokatit të Popullit, në pikat e kalimit kufitar, *Gjirokastër* dhe *Kapshticë,* kanë vijuar kryerjen e monitorimit sistematik të kufijve, monitorimin e procedurave të përzgjedhjes së migrantëve të parregullt, raportimin periodik të gjetjeve si dhe trajtimin e zgjidhjes së problematikave të hasura. Në dhjetor 2022, u nënshkrua dhe Marrëveshja e re e Bashkëpunimit për vitin 2023, e cila parashikon shtimin e një eksperti me kohë të pjesshme i cili do të veprojë në qytetin e Tiranës.

Edhe përgjatë vitit 2022 Institucioni i Avokatit të Popullit është përzgjedhur nga *Agjencia e Bashkimit Europian për të Drejtat Themelore (FRA),* për të kontribuar në raportin vjetor të FRA sa i përket situatës të respektimit të të drejtave të njeriut në Shqipëri. Kjo Agjenci publikon çdo vit një raport vjetor mbi çështjet e të drejtave të njeriut në vendet anëtare të Bashkimit Europian, duke përfshirë dhe vendet që kanë statusin e vëzhguesit pranë kësaj Agjencie, siç është dhe rasti i Shqipërisë. Shqipëria bëhet pjesë e këtij raportimi për herë të dytë radhazi.

Për mbledhjen e të dhënave në kuadër të hartimit të këtij raporti, krahas punës kërkimore në mënyrë të pavarur, Institucioni i Avokatit të Popullit ka bashkëpunuar me rreth *41 institucione* të administratës publike nga të cilët janë mbledhur të dhëna dhe informacion në lidhje me zhvillimet gjatë vitit 2022, që përafrojnë ligjin vendas me atë të BE-së ose zhvillimet ligjore të krahasueshme me legjislacionin aktual të BE –së në disa fusha të veçanta si:

- ✓ barazia dhe mosdiskriminimi;
- ✓ racizmi, ksenofobia dhe intoleranca e lidhur me të;
- ✓ barazia dhe përfshirja e romëve;
- ✓ azili, vizat, migrimi, kufijtë dhe integrimi;
- ✓ shoqëria e informacionit, privatësia dhe mbrojtja e të dhënave;
- ✓ të drejtat e fëmijës;
- ✓ aksesi në drejtesi, përfshirë të drejtat e viktimave të krimit;
- ✓ zhvillimet në zbatimin e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Zbatimi i këtij projekti ka filluar në muajin Korrik të vitit 2022 dhe pritet të përfundojë në fillim të vitit 2023, me publikimin e raportit përfundimtar nga Agjencia e Bashkimit Europian për të Drejtat Themelore.

Avokati i Popullit përgjatë vitit 2022 vijoi zbatimin e projektit të financuar nga Programi i Drejtësisë së Bashkimit Europian me titull "*Përforcimi i qasjeve për parandalimin e radikalizimit të të rinjve në burgje dhe në Shërbimin e Provës*". Projekti është bashkëpunim i shtatë vendeve anëtare të BE-së (Itali-Spanjë-Austri-Sllloveni-Gjermani-Francë-Belgjikë) dhe Shqipëri-së, dhe synon të forcojë qasjet për parandalimin e radikalizimit të të rinjve (18-29 vjeç) në burgje dhe

[201] Këtu janë përfshirë projekte afatgjata dhe të strukturuara që ka zbatuar Avokati i Popullit gjatë vitit 2022 dhe nuk ka të perfshirë bashkëpunimet afatshkurtër që kanë rezultuar me raporte dhe që janë paraqitur në pjesë të tjera të raportit vjetor.

shërbimin provës në nivel Europian, sipas standardeve ndërkombëtare dhe rezolutës së Parlamentit Europian të 5 tetorit 2017 mbi sistemet dhe kushtet e burgjeve.[202]

Aktivitetet e planifikuara kërkimore të kombinuara me aktivitetet e parashikuara për ndërgjegjësim si dhe për ndarjen e praktikave më të mira, do t'u ofrojnë grupeve të synuara njohuri mbi nivelin makro dhe mezo (legjislacioni kombëtar dhe praktikat e administratave të burgjeve dhe të shërbimit të provës) dhe mbi nivelin mikro, d.m.th. dimensioni individual i përfshirë në proceset e radikalizimit.

Përgjatë vitit 2022 është realizuar faza e parë e projektit **"***Analiza e të dhënave dhe Vlerësimi*" dhe konkretisht:

- ✓ Raporti mbi koherencën midis legjislacionit ndërkombëtar të BE-së lidhur me të drejtat njerëzore;
- ✓ Raport mbi hapësirat trajnuese të burgjeve dhe stafit civil;
- ✓ Artikull shkencor lidhur me efektshmërinë e programeve ndërhyrëse;
- ✓ Rekomandime bazuar në evidenca politikbërësve për implementimin në ndërhyrjen dhe parandalimin e radikalizmit të të rinjve në burgje dhe shërbimet e provës;
- ✓ Praktikat më të mira lidhur me programet parandaluese të radikalizmit me fokus të drejtat e të rinjve në burgje dhe shërbime të provës;
- ✓ Analiza e legjislacionit kombëtar në 8 vende;
- ✓ Analiza e programeve të trajnimit në 8 vende.

Gjatë vitit 2023 është planifikuar të kryhet faza e dytë e projekti "*Analizë mbi dimensionin individual të radikalizimit të të rinjve"*, e cila do të realizohet nëpërmjet:

- ✓ Intervistimit të të rinjve në burgje;
- ✓ Intervistimin e punonjësve në kontakt të drejtpërdrejt me të dënuarit në burgje;
- ✓ Përgatitjen e një udhëzuesi nga partnerët e ngarkuar.

"Mbështetja për Zyrën e Avokatit të Popullit dhe promovimi i të drejtave të njeriut në Shqipëri" është Projekti i Binjakëzimit, i cili ka filluar të zbatohet që nga muaji qershor 2022, ndërmjet Bordit të Avokatit të Popullit në Austri, Institutit për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut Ludwig Boltzmann, Austri dhe Avokatit të Popullit të Shqipërisë, i financuar nga Bashkimi Europian në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para anëtarësimit në BE.

Projekti synon të mbështesë institucionin e Avokatit të Popullit në Shqipëri në përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit kombëtar dhe konkretisht të ligjit nr.8454, datë 04.02.2022 "*Për Avokatin e Popullit"*, i ndryshuar, me legjislacionin e BE-së në fushën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke promovuar parimet e shtetit të së drejtës, të të drejtave të njeriut dhe mirëqeverisjes nëpërmjet rritjes së efikasitetit të kontrollit të ligjshmërisë në punën e organeve të administratës publike.

Rezultatet e pritshme të Projektit janë*:*

[202] 2015/2062(INI).

✓ Harmonizimi i legjislacionit kombëtar me legjislacionin e BE-së, detyrimet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira të BE-së;
✓ Rritja e kapaciteteve të institucionit të Avokatit të Popullit si një Institucion Kombëtar për të Drejtat e Njeriut në zbatimin e mandatit të tij promovues;
✓ Rekomandime për përmirësimin e sistemit të manaxhimit të çështjeve të Avokatit të Popullit sipas modeleve dhe praktikave të suksesshme të shteteve anëtare të BE-së.

Gjithashtu, për shkak të të qenurit përfitues në këtë projekt, institucioni i Avokatit të Popullit u bë edhe anëtar i Komitetit të Sektorit të Monitorimit të IPA II për vitin 2022 "*Shteti i së drejtës dhe të drejtat themelore"*, duke marrë pjesë dhe në takimin e dytë të zhvilluar më *datë 14 dhjetor 2022*.

Që nga *muaji shtator 2022*, në bashkepunim me UNFPA (United Nation Population Fund) në Shqipëri, është duke u zbatuar projekti për përmirësimin e sistemit të manaxhimit të rasteve (Sistemi Doculive) të Avokatit të Popullit. Ky sistem ka të bëjë me menaxhimin dhe trajtimin e rasteve dhe ankesave që paraqiten pranë institucionit të Avokatit të Popullit, permes përpunimit të të dhenave dhe prodhimit të statistikave të ndryshme që lidhen me të drejtat e shkelura të qytetarëve si dhe institucionet përgjegjëse për mosrespektimin e këtyre të drejtave. Projekti është duke u zbatuar nga kompania indiane Wishtree dhe është parashikuar të përfundojë brenda 6-mujorit të parë të vitit 2023.

5.4 Paraqitjet publike të Avokatit të Popullit në ushtrim të mandatit të tij promovues

Vizibiliteti i Avokatit të Popullit si institucioni më i madh i të drejtave të njeriut në vend, vazhdon të mbetet në terma pozitivë si në vlera sasiore ashtu edhe cilësore. Përgjatë vitit të fundit, Avokati i Popullit e ka shtuar praninë e tij në rrjetet sociale dhe ka mbajtur një qasje të matur por efektive në praninë e tij në mediat tradicionale si ato audiovizive.

Mandati promovues i Avokatit të Popullit i përgjigjet nevojës së shoqërisë për të rritur ndërgjegjësimin mbi jo vetëm veprimtarinë e këtij institucioni, por edhe të edukimit dhe ndërgjegjësimit mbi të drejtat e njeriut, njohjen e këtyre të drejtave, mekanizmat shtetërorë në funksion të tyre por edhe ndihmës e njohurive praktike të qytetarëve mbi të drejtat e tyre dhe marrëdhënien e tyre me institucionet.

Veprimtaritë e komunikimit të Avokatit të Popullit përqendrohen në dy degë kryesore:

a. Prania online;
b. Prania me një qasje proaktive në median tradicionale.

Prania online përfshin publikime të natyrave të ndryshme në rrjetet sociale të Avokatit të Popullit, kryesisht në Facebook si rrjeti me popullaritetin më të lartë në vend, publikime në faqen zyrtare online të institucionit si dhe funksionaliteti i aplikacionit online të Avokatit të Popullit si kanal i testuar komunikimi dhe depozitimi ankesash nga ana e qytetarëve.

Prania në median tradicionale përfshin furnizimin e mediave tradicionale si radiotelevizione, agjenci lajmesh apo media të shtypura, me materiale informuese nga veprimtaritë e institucionit të Avokatit të Popullit, si dhe përgjigjen e interesit të këtyre mediave apo përfaqësuesve të tyre, në lidhje me çështje konkrete që lidhen me pozicionin apo veprimet e Avokatit të Popullit në kontekstin e zhvillimeve të aktualitetit në vend, apo intervista e prani në studiot televizive të përfaqësuesve të Avokatit të Popullit.

Media online

Përgjatë periudhës 1 janar 2022 – 31 dhjetor 2022, faqja zyrtare e Avokatit të Popullit në platformën Facebook ka vijuar trendin pozitiv të rritjes, trend i cili ka përparuar në mënyrë të qëndrueshme në 5 vitet e fundit.



Sikurse rezulton nga statistikat e Facebook insights, reach-i vjetor i faqes "Avokati i Popullit" në Facebook për këtë periudhë *ishte 111.198 me një rritje prej 23.1%* më shumë se viti i mëparshëm.



Numri i vizitave në këtë faqe ka shënuar një rritje të konsiderueshme, sikurse mund të shikohet në tabelë, me një numër prej *49.450 vizitash që korrespondon me një rritje prej 256.8%* më shumë se viti i mëparshëm.



Numri i pëlqimeve për faqen ka shënuar edhe ai një rritje të lehtë, me *619 të tilla* që përkthehet në 2.7% rritje. Duhet mbajtur parasysh se edhe për këtë vit, Avokati i Popullit ndërkohë ka vazhduar politikën e shpenzimeve 0 për të rritur në mënyrë komerciale vizibilitetin dhe pëlqyeshmërinë e përmbajtjes së tij në rrjetet sociale.



Audienca e faqes së Avokatit të Popullit në Facebook, është në kuotën e *9286 ndjekësve*, me një numër më të madh të këtyre ndjekësve që u përkasin grupmoshave 25-34 vjeç dhe 35-44 vjeç. Në lidhje me përkatësinë gjinore të ndjekësve të Avokatit të Popullit, ajo është thuajse e barabartë, me *49.6% femra dhe 50.4% meshkuj*.

Shpërndarja gjeografike e audiencës është e përqendruar në masën më të madhe në Tiranë, prej nga vijnë 38.4% e atyre që ndjekin postimet e Avokatit të Popullit, e pasuar nga Durrësi me 3.8% dhe Prishtina në Kosovë me 2.8%.

Faqja online

Faqja zyrtare e Avokatit të Popullit www.avokatipopullit.gov.al mbahet e përditësuar me informacione që vlerësohen se kanë rëndësi për dokumentimin dhe pasqyrimin e aktiviteteve të institucionit. Në seksionin "Qendra e medias" publikohen në vazhdimësi lajme, të reja, statistika e përditësime mbi punën e institucionit.

Përgjatë vitit 2022 janë publikuar mbi *140 lajme* e informacione në këtë faqe. Gjithashtu në seksionin e multimedias të kësaj faqeje publikohen video nga intervistat e drejtuesve të institucionit në mediat kombëtare e vendore, apo edhe kronika me interes të veçantë për institucionin.

Media tradicionale

Përveç një numri të konsiderueshëm raportimesh në mediat televizive vendase dhe të huaja mbi veprimtarinë dhe qëndrime të Avokatit të Popullit mbi çështje që lidhen me aktualitetin ditor, institucioni ka mbajtur një qasje pozitive dhe bashkëpunuese me median edhe duke qenë i pranishëm përmes titullares së tij në intervista të shumta e debate në studio përgjatë gjithë vitit që lamë pas. Të paktën *13 intervista të zgjeruara* e prani televizive janë shënuar gjatë vitit pa llogaritur reagime, opinione e intervista të shkurtra të dhëna për mediat në aktivitete të ndryshme publike.[203]

[203] Më shume informacion mund të jepet bazuar në kërkesë.

KREU 6

Shërbimet mbështetëse

6.1 Menaxhimi i Burimeve Njerëzore dhe Administrative

Institucioni i Avokatit të Popullit, si një institucion kombëtar për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut, në veprimtarinë e tij duhet të mbështetet nga një infrastrukturë që mundëson realizimin e objektivave dhe qëllimeve të tij, në përputhje të plotë me Parimet e Parisit dhe Parimet e Venecias.

Kjo qasje është nënvizuar në mënyrë të vazhdueshme edhe nga raportet e organizatave ndërkombëtare, në të cilin është theksuar, ndërmjet të tjerash, nevoja për një *qasje gjithëpërfshirëse për të forcuar kapacitetin e Avokatit të Popullit* në trajtimin e rasteve të shkeljeve të të drejtave të njeriut.

Kjo padyshim kërkon një menaxhim të duhur të burimeve njerëzore përmes një vlerësimi të vazhdueshëm të njësive dhe strukturave të institucionit si një mjet i rëndësishëm dhe strategjik që ndihmon në krijimin e një përparësie të qëndrueshme konkurruese të institucionit dhe i shton vlerën asaj, si dhe rekrutimit të një trupe punonjësish të mirë përgatitur, profesionale të aftë për t'i shërbyer interesit publik dhe për të qenë të përgjegjshëm për veprimet e ndërmarra në interes të qytetarëve.

Mënyra e miratimit të strukturës dhe organikës së institucionit, është parashikuar shprehimisht në nenin 35, paragrafi 3 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar. Në ndryshim nga shumë institucione të pavarura kushtetuese, dhe të institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj, struktura dhe organika e institucionit caktohet nga vetë Avokati i Popullit, ç'ka krijon fleksibilitetin e nevojshëm për t'ju përshtatur dhe përgjigjur në formën dhe mënyrë e duhur funksioneve e detyrave të institucionit.

Gjatë viteve të fundit, struktura dhe organika e institucionit ka pësuar ndryshime të herëpashershme, ndryshime që kanë synuar rritjen e efikasitetit dhe përshtatjen me rregullat dhe procedurat e parashikuara nga kuadri ligjor në fuqi në fushën e shërbimit civil. Këto ndryshime kanë synuar dhe reflektuar pasjen e një strukture të qëndrueshme në kohë, relativisht homogjene me strukturat dhe kategorizimet e punonjësve të institucioneve të tjera shtetërore si dhe plotësimin e standardeve në drejtim të formatimit të njësive të strukturës. Gjithsesi, numri shumë i kufizuar i punonjësve në raport me mandatin që duhet të ushtrojnë ka ndikuar në efektivitetin e realizimit të tij.

Në zbatim të nenit 39 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se "*Avokati i Popullit miraton rregulloren e brendshme të institucionit, e cila hartohet në bashkëpunim me komisionerët*", me urdhërin nr.129, datë 17.06.2022, Avokatja e Popullit ka miratuar rregulloren e re të institucionit.

Rëndësia e miratimit të kësaj rregulloreje u imponua nga ndryshimet e herëpashershme të strukturës të instiucionit, nevojës së rregullimit, adresimit dhe përmirësimit të çështjeve të ndryshme administrative të hasura gjatë praktikës së përditshme të punës si dhe nevojës për të

patur një rregullim të detajuar që garanton efiçencën, efikasitetin, llogari-dhënënien dhe transparencën, në punën e institucionit të Avokatit të Popullit.

Rregullorja paraqet në mënyrë shumë funksionale dhe të plotë detyrimet e të gjitha strukturave të brendshme, në kuadrin e plotësimit të detyrës së tyre si të pavarura njëra nga tjetra, si dhe përcakton përgjegjësitë e secilës strukturë në kuadrin e misionit si institucion. Në të njëjtën kohë, ajo përcakton kriteret themelore të funksionit dhe nivelin e kërkuar të përgjegjësive funksionale.

Në zbatim të nenit 33/1, pika 4 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, në muajin dhjetor 2022, institucioni i Avokatit të Popullit shpalli konkurimin për 3 (tre) vende vakante për Komisioner dhe konkretisht:

- ✓ *Komisioner në Seksionin për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura dhe pushtetin gjyqësor;*
- ✓ *Komisioner në Seksionin për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre; dhe*
- ✓ *Komisioner në Seksionin e Përgjithshëm.*

Për shkak të numrit të kufizuar të kandidatëve dhe mos plotësimit të numrit të nevojshem që kerkohet në këtë proces, institucioni u detyrua të zgjasë disa here afatin e aplikimit. Në përfundim të procesit të vlerësimit të përmbushjes së kushteve dhe kritereve ligjore nga kandidatët, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të tyre (përfshirë edhe intervistimin) nga Komisioni Ad hoc, Avokatja e Popullit, znj. Erinda Ballanca më datë 13 mars 2023, i përcolli Kuvendit të Shqipërisë, listën e kandidaturave për pozicionet Komisioner në Seksionin për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura dhe pushtetin gjyqësor dhe Komisioner në Seksionin për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre.

Duhet të theksojmë, gjithashtu, se edhe gjatë vitit 2022, në përputhje me dispozitat e rekrutimit të legjislacionit në fushën e shërbimit civil, nga Institucioni janë shpallur disa pozicione të lira (13 pozicione), duke pasur parasysh dorëheqjet, largimet në detyra të tjera brenda administratës publike apo pezullimin e statusit për arsye të ndryshme.

Në kuadër të paraqitjes së kërkesave buxhetore për vitin 2023 dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, por edhe gjatë diskutimeve në Komisionin e Ligjeve, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë, institucioni i Avokatit të Popullit kërkoi miratimin e disa shtesave në burime njerëzore duke paraqitur dhe argumentet përkatëse.

Me miratimin e ligjit nr. 84/2021, "*Për buxhetin e vitit 2023*", u konstatua se numri i përgjithshëm i miratuar i punonjësve të institucionit për vitin 2023 është *59 (pesëdhjetë e nëntë)* nga 57 (pesëdhjetë e shtatë) që ishte. Këto shtesë kanë të bëjnë me:

- ✓ *shtimin e një specialisti në fushën e teknologjisë së informacionit (kategoria III-b), nisur ndër të tjera nga nevoja e mirëmbajtjes së infrastrukturës të teknologjisë të institucionit, gjenerimit dhe përpunimit të statistikave si dhe si dhe nevojës së mbrojtjes nga sulmet kibernetike;*

✓ *shtimin e një ndihmëskomisioneri, i cili do të fokusohet kryesisht në çështjet që lidhen me promovimin, informimin apo sensibilizimin lidhur me të drejtat e njeriut si dhe rolin e institucionit në këtë drejtim, bazuar sidomos në standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.*

Gjatë vitit raportues e në vijim, bazuar në marrëveshjen e nënshkruar me UNHCR (Dhjetor 2021) për monitorimin e emigrantëve në pikat e kalimit kufitar, në mbështetje të punës së Seksionit të Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit të Egër, Ç'njerëzor ose Poshtërues ka vazhduar puna me kohë të plotë e 2 (dy) ekspertëve të jashtëm. Ndërkohë, nisur nga marrëveshja e re e nënshkruar në fund të muajit dhjetor 2022, gjatë muajit shkurt 2023 u rekrutua edhe një ekspert i tretë me kohë të pjesshme (4 orë në ditë), në fushën e respektimit dhe mbrojtjes së refugjatëve.

Për vitin 2022, Struktura e institucionit, miratuar me Urdhërin e Brendshëm nr.17, datë 04.02.2022 "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të institucionit të Avokatit të Popullit", i ndryshuar, paraqitet si më poshtë:



Lidhja Nr.2

Emërtimi i funksionit	Numri i Punonjësve (57)	Kategoria/Klasa
Avokati i Popullit	1	Ligji nr. 8454, datë 04.02.1999, i ndryshuar
Kabineti -Drejtor Kabineti -Këshilltar -Sekretar	5 1 3 1	 VKM nr. 187, datë 08.03.2017, i ndryshuar I-b VKM nr. 187, datë 08.03.2017, i ndryshuar
Sekretar i Përgjithshëm	1	I-a
Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre -Komisioner -Ndihmëskomisioner -Ndihmëskomisioner	7 1 3 3	 Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, i ndryshuar II-a II-b
Seksioni për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura dhe pushtetin gjyqësor -Komisioner -Ndihmëskomisioner -Ndihmëskomisioner	5 1 2 2	 Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, i ndryshuar II-a II-b
Seksioni i Përgjithshëm -Komisioner -Ndihmëskomisioner -Ndihmëskomisioner	7 1 4 2	 Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, i ndryshuar II-a II-b
Seksioni për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve -Komisioner -Ndihmëskomisioner -Ndihmëskomisioner	4 1 2 1	 Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, i ndryshuar II-a II-b
Mekanizimi për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues -Komisioner -Ndihmëskomisioner -Ndihmëskomisioner	6 1 2 3	 Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, i ndryshuar II-a

Drejtoria e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve	18	II-b
-Drejtor	1	II-b
Sektori i Burimeve Njerëzore		
- Përgjegjës Sektori	1	III-a
-Specialist për Burimet Njerëzore	1	III-b
-Specialist Protokolli	1	III-b
Sektori i Shërbimeve		
- Përgjegjës Sektori	1	III-a
-Arkivist/Bibliotekar	1	Klasa VIII
-Shofer i titullarit	1	Klasa VI
-Shofer	2	Klasa IV
-Teknik i mesëm i specialiteteve të ndryshme	1	Klasa VI
-Punëtor pastrimi	2	Klasa I
Sektori i Financës dhe Prokurimeve		
-Përgjegjës Sektori	1	III-a
-Specialist i Financës	1	III-b
-Specialist i Prokurimeve	1	III-b
Sektori i IT dhe Pritjes së Qytetarëve		
-Përgjegjës sektori	1	III-a
-Specialist i Shërbimeve ndaj Qytetarit	2	III-b
Sektori për bashkëpunimin ndërkombëtar dhe integrimin Europian	3	
- Përgjegjës Sektori	1	III-a
- Specialist	2	III-b

6.2 Vështrim mbi të ardhurat dhe shpenzimet

Në mbështetje të ligjit nr. 115/2021, datë 25.11.2021, "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2022", Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2, datë 06.02.2012, “Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”- i ndryshuar, Udhëzimit Plotësues të Ministrit të Financave nr. 1, datë 10.01.2022 "Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2022" - i ndryshuar, performanca e produkteve të buxhetit për institucionin e Avokatit të Popullit, sipas programit buxhetor të miratuar për vitin 2022, paraqitet si më poshtë:

Programi - "Shërbimi Avokatisë"

Buxheti i akorduar për këtë program (i vetmi program që ka institucioni i Avokatit të Popullit) ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës së Programit (DPP) të hartuar gjatë procesit të PBA 2022-2024 dhe ka për qëllim arritjen e objektivave e produktit të përcaktuar e të miratuara në dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm (2022-2024)

Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Artikujve për vitin 2022

Me ligjin nr.115/2021, datë 25.11.2021, "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2022", fondet e akorduara me ndryshimet e bëra gjatë vitit për funksionimin e aktivitetit të institucionit të Avokatit të Popullit, sipas artikujve, paraqiten në tabelat e mëposhtme:

Raporti i Shpenzimeve Faktike të programit sipas Artikujve

Tabela nr. 1

Nr. Llog.	Emërtimi	Plani fillestar	Shtesa dhe Pakësime	Plani i ndryshuar	Fakti
600	Paga	89,000,000	-3,425,000	85,575,000	85,551,083
601	Sig. Shoqërore e Shëndetësore	13,500,000	162,500	13,662,500	12,456,188
602	Mallra dhe shërbime të tjera	18,000,000	680,000	18,680,000	16,829,887
605	Transferta. Korente të Huaja	1,700,000	520,000	2,220,000	2,191,738
606	Transf për buxhetet familjare	3,000,000	-154,238	2,845,762	2,114,898
231	Investimet	4,000,000		4,000,000	3,900,000
	TOTALI	**129,200,000**	**-2,216,738**	**126,983,262**	**123,043,794**

Raporti Vjetor i Realizimeve të Shpenzimeve për vitin 2022

Tabela nr. 2

Nr.	Emërtimi	Plani i ndryshuar	Fakti	Diferenca	Realizimi në %
1	Paga	85,575,000	85,551,083	23,917	99.97
2	Sigurime Shoqërore e Shëndetësore	13,662,500	12,456,188	1,205,812	91.20
3	Mallra dhe shërbime të tjera	18,680,000	16,829,887	1,850,113	90.10

4	Transferta Korente të Huaja	2,220,000	2,191,738	28,262	98.70
5	Transferta për buxhetet familjare	2,845,762	2,114,898	730,864	95.30
6	Investimet	4,000,000	3,900,000	100,000	97.50
	Totali	**126,983,262**	**123,043,794**	**3,939,468**	**96.90**



1-Shpenzime Personeli

Realizimi i fondit të pagave reflekton strukturën dhe organikën, lëvizjet e brendshme dhe të jashtme. Fondi i akorduar për vitin 2022, për mbulimin e shpenzimeve në paga personeli ishte 89,000,000 lekë, i ndryshuar me Akt-Normativ nr. 3, datë 12.03.2022, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 115/2021, 'Për buxhetin e vitit 2022", në 85,575,000 lekë, ndërsa realizimi është 85,551,083 lekë ose 99.97%, i buxhetit të ndryshuar, si dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore ishin në plan 13,500,000 lekë, i ndryshuar me Akt-Normativ nr. 3, datë 12.03.2022, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 115/2021, 'Për buxhetin e vitit 2022", në 13,662,500 lekë, ndërsa realizimi është 12,456,188 lekë ose në masën 91.20% i buxhetit.

Të dyja zërat së bashku paga personeli dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore (600+601) për vitin 2022 janë realizuar në masën 98.80% i buxhetit të ndryshuar dhe përbëjnë 85% të buxhetit faktik të institucionit. Gjatë vitit 2022, numri mesatar i punonjësve ka qenë 54,25 punonjës nga 57 punonjës që ka qenë kufiri i miratuar me ligjin e lartpërmendur. Mosrealizimi i këtij zëri të

shpenzimeve vjen për shkak të mosplotësimit të strukturave organike si rezultat i vendeve vakant të krijuara në fund të vitit 2021 dhe gjatë vitit 2022 nga lëvizja e punonjësve të institucionit tonë në detyra të tjera. Numri i punonjësve i miratuar me ligj për vitin 2022, nuk është plotësuar në të gjithë strukturat përbërëse të tij gjatë këtyre periudhave.

Ka patur mungesa në katër/mujorin e parë:

- ✓ 1 Ndihmëskomisioner në Seksionin për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre për katër muaj;
- ✓ 1 Ndihmëskomisioner në Seksionin për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të tëtretëve që veprojnë për llogari të tyre për tre muaj;
- ✓ 1 Ndihmëskomisioner në Seksionin e Përgjithshëm për katër muaj;
- ✓ 1 Specialist e Protokollit në Sektorin e Burimeve Njerëzore për një muaj.

Gjatë katër/mujorit të dytë institucioni ka patur këto mungesa:

- ✓ 1 Drejtori i Kabinetit AP për tre muaj;
- ✓ 1 Sekretar i AP për dy muaj;
- ✓ 1 Ndihmëskomisioner në Seksionin për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre për një muaj;
- ✓ 1 Ndihmëskomisioner në Seksionin për policinë, shërbimin sekret, burgjet, forcat e armatosura dhe pushtetin gjyqësor për dy muaj;
- ✓ 1 Ndihmëskomisioner në Seksionin e Përgjithshëm për një muaj;
- ✓ 1 Drejtor i Drejtorisë së Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve për katër muaj;
- ✓ 1 Përgjegjës i Shërbimeve për një muaj;
- ✓ 1 Specialist i Shërbimeve ndaj Qytetarëve për një muaj**;**
- ✓ 1 Përgjegjës në Sektorin për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrimin Europian për dy muaj;
- ✓ 1 Specialist në Sektorin për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrimin Europian për një muaj.

Gjatë katër/mujorit të tretë institucioni ka patur këto mungesa:

- ✓ 1 Drejtori i Kabinetit AP për dy muaj;
- ✓ 1 Sekretar i AP për katër muaj;
- ✓ 1 Ndihmëskomisioner në Seksionin për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të tëtretëve që veprojnë për llogari të tyre për dy muaj;
- ✓ 1 Ndihmëskomisioner në Seksionin për policinë, shërbimin sekret, burgjet, forcat e armatosura dhe pushtetin gjyqësor për dy muaj;
- ✓ 1 Ndihmëskomisioner në Seksionin e Përgjithshëm për dy muaj;
- ✓ 1 Drejtor i Drejtorisë së Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve për katër muaj;
- ✓ 1 Specialist për prokurimet në Sektorin e Financës dhe Prokurimeve për tre muaj;
- ✓ 1 Specialist në Sektorin për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrimin Europian për katër muaj.

Nr.	Vitet	Miratuara					
		600-601	602-606	231	Nr. i Punonjësve		Totali
		Paga dhe sigurime	Shpenzime Operative	Investime	Nd/Komisioner	Gjithsej	
1	**2015**	75,500	16,000	4,000	21	51	**95,500**
2	**2016**	84,500	17,000	4,000	21	55	**105,500**
3	**2017**	84,500	18,000	4,000	21	56	**106,500**
4	**2018**	94,500	17,500	4,000	21	56	**116,000**
5	**2019**	104,500	18,600	2,000	21	56	**125,100**
6	**2020**	98,500	17,000	1,000	21	56	**116,500**
7	**2021**	98,500	17,500	3,000	21	56	**119,000**
8	**2022**	102,500	22,700	4,000	22	57	**129,200**
9	**2023**	108,000	26,000	4,000	23	59	**138,000**

2.- Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera

Fondi i akorduar për shpenzime mallra e shërbime **(zëri 602)** për periudhën janar – dhjetor 2022 ishte 18,680,000, ndërsa realizimi është 16,829,887 lekë ose 90.10% i buxhetit.

Për këtë periudhë shpenzimet operative, janë përdorur kryesisht për pagesat e blerjeve për kancelari, materiale pastrimi, elektrike, materiale promovuese, furnizim me materiale të tjera zyre, shpenzime për energjisë elektrike, ujë, Albtelecom, Vodafonë, shërbimi postar, siguracion automjetesh, shpenzime për dezinfektim e ambienteve të institucionit, shpenzime për mirëmbajtjen e automjeteve të institucionit, dieta brenda dhe jashtë vendit. shpenzime për mirëmbajtje ndërtimore, shpenzime për mirëmbajtje aparatura e pajisje teknike, shpenzime pritje-përcjellje të huajve, si dhe shpenzime për taksa të paguara.

Fondi për transferta korente të huaja **(zëri 605)** për vitin 2022, ishte 1,700,000 lekë, i ndryshuar me "Transferim fonde për vitin 2022" në 2,220,000 lekë ndërsa realizimi është 2,191,738 lekë ose 98.70% i buxhetit të ndryshuar.

Për vitin 2022 këto fonde janë përdorur për shlyerjen e detyrimeve në kohë të kuotave të anëtarësimit ku institucioni i Avokatit të Popullit është anëtarë në organizata ndërkombëtare si:

- ✓ Associationdes Ombudsmanset Mediateursdela Francophonie (AOMF);
- ✓ European Ombudsman Institute (EOI);
- ✓ Association of Mediterranean Ombudsman (AOM);
- ✓ International Ombudsman Institute (IOI);
- ✓ Global Alliance of National Human Rights Institutions (GANHRI);
- ✓ European Network of National Human Rights Institutions (ENNHRI);
- ✓ European Network of Ombudspersons for Children (ENOC).

Nr.	**Emërtimi i Organizatës**	**Kuotacionet në vite**							
		Monedha	**Vlera në vite**						
			2016	**2017**	**2018**	**2019**	**2020**	**2021**	**2022**
1.	Shoqata e Ombudsmanit të Vendeve Mesdhetare (AOM)	Euro	750	750	750	1,000	1,000	1,000	1,000
2.	Shoqata e Ombudsmanëve dhe Mediatorëve të Frankofonisë (AOMF)	Euro	650	750	900	900	900	900	900
3.	Rrjeti Europian i Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (ENNHRI)	Euro	3,000	3,000	4,000	4,000	4,000	4,000	4,000
4.	Rrjeti Europian të Ombusdmanit për Fëmijë (ENOC)	Euro	1,100	1,100	1,100	1,100	1,100	1,100	1,100
5.	Instituti Europian i Ombudsmanit (EOI)	Euro	350	350	350	350	350	350	350
6.	Aleanca Globale e Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (GANHRI)	CHF	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000
7.	Instituti Ndërkombëtar i Ombudsmanit (IOI)	Euro	750	750	750	750	750	750	750

Fondi për transferta buxhetore familjare dhe individë **(zëri 606)** për periudhën Janar - Dhjetor 2022, ishte 3,000,000 lekë, i ndryshuar me "Transferim fonde për vitin 2022" në 2,845,762 lekë, ndërsa realizimi është 2,114,898 lekë ose 95.30% i buxhetit të ndryshuar.

3.- Shpenzime në investime

Fondi i investimeve akorduar nga buxheti i shtetit është 4,000 mijë lekë, ndërsa realizimi 3,900 mijë lekë.

Në mijë/lekë

Projekti	Kodi i Projektit	Plan	Fakt	%
Blerje automjeti për institucionin	M660015	4,000	3,900	97.50

"Blerje automjeti për institucionin"

Për këtë zë të investimeve siç paraqitet në tabelën mësipërme është realizuar në vlerën prej 3,900,000 lekë, ose në masën 97.50%.

KREU 7

Shifra dhe fakte në lidhje me ankesat dhe trajtimin e tyre

Gjatë ushtrimit të mandatit të tij, në institucionin e Avokatit të Popullit, për periudhën e vitit 2022, shtetas shqipëtar, të huaj, persona pa shtetësi apo organizata të shoqërisë civile, kanë depozituar rastet e tyre mbi pretendimet për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore në ccdo formë të mundshme. Këto raste janë depozituar nëpërmjet:

- Paraqitjes fizike në zyrën qëndrore me seli në qytetin e Tiranës si dhe paraqitjen fizike në 7 zyrat rajonale të cilat gjënden në qytetet: Berat, Dropull, Fier, Kukës, Pogradec, Sarandë, Shkodër dhe Vlorë;
- Shërbimit postar;
- Postës elektronike (e-mail);
- Rjeter sociale;
- Aplikacionit mobile;
- Faqes zyrtare të institucionit;
- Telefonit etj.

Kështu në vitin 2022, institucioni i Avokatit të Popullit ka trajtuar gjithsej 6264 raste /kërkesa, që do të thotë 427 raste më shumë se vitin e kaluar. Konkretisht:

- 1169 raste kanë rezultuar si ankesa "brenda juridiksionit dhe kompetencës" së institucionit;
- 367 raste janë trajtuar me iniciativën e institucionit;
- 16 raste kanë rezultuar jashtë juridiksionit në fazën e vlerësimit nga grupi i shqyrtimit të ankesave;
- 4712 raste janë trajtuar në formën e këshillimeve dhe orientimeve mbi rrugët ligjore që duhet të ndjekin qytetarët për trajtimin e mëtejshëm të rasteve të tyre.

Paraqitja grafike e rasteve të depozituara nga qytetarët në zyrën qëndrore dhe 7 zyrat rajonale të AP.



Paraqitja grafike e shpërndarjes së rasteve të depozituara pranë AP në vitin 2022.

Krahasur me vitin 2021, institucioni i AP në vitin 2022 ka trajtuar 816 ose 14% raste më shumë të pretendimeve mbi shkelje të të drejtave themelore, duke e bërë vitin 2022 gjithashtu si vitin me numrin më të lartë të rasteve të paraqitura ndonjëherë nga institucioni i Avokatit të Popullit.



Paraqitja grafike e rasteve të trajtuara ndër vite nga institucioni i Avokatit të Popullit.



Paraqitja grafike e të dhënave të zyrave rajonale në vitet 2019-2022.

	Zyra Rajonale Sarandë	Zyra Rajonale Dropull	Zyra Rajonale Berat	Zyra Rajonale Vlorë	Zyra Rajonale Kukës	Zyra Rajonale Pogradec	Zyra Rajonale Shkodër	Totali
Ankesa	66	12	69	54	44	285	37	567
Këshillime/Orientime	608	92	471	194	119	801	51	2336
Totali	674	104	540	248	163	1086	88	2903

Paraqitja grafike e shpërndarjes së rasteve sipas zyrave rajonale për vitin 2022.



Paraqitja grafike e rasteve të depozitura pranë zyrave rajonale të institucionit AP e shprehur në përqindje.

Paraqitja grafike e rasteve të zyrave rajonale në vitet 2020-2022.



Paraqitja grafike e shpërndarjes së rasteve të shqyrtuara nga institucioni AP sipas qarqeve.



Paraqitja grafike e shpërndarjes së rasteve të shqyrtuara nga institucioni AP sipas qyteteve.



Paraqitja grafike e shpërndarjes së rasteve të shqyrtuara nga institucioni i AP-së në vitet 2020-2022 sipas qyteteve.

❋ ❋ ❋

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij në vitin 2022, institucioni i Avokatit të Popullit, ka përfunduar hetimin administrativ për 1826 raste të pretendimeve për shkelje të të drejtave themelore të individëve. Nga këto, 737 raste ose 40% janë raste të depozituara në vitin 2022 dhe 1089 raste apo 60%, i përkasin rasteve të depozituara vite më parë.



Paraqitja grafike e rasteve për të cilat ka përfunduar hetimi administrativ në vitin 2022.

Për këto 1826 raste për të cilat ka përfunduar hetimi administrativ, rezulton se:

- Për 822 raste apo 45% e tyre, ka përfunduar hetimi administrativ ku shkeljet apo problematikat e konstatuara gjatë hetimit, janë adresuar pa nevojën e ndërhyrjes me rekomandim;
- Për 379 raste apo 21% të tyre, ka përfunduar hetimi administrativ dhe kërkesa është gjetur e pabazuar;
- Për 207 raste apo 11% e rasteve, ka përfunduar hetimi administrativ ku shkeljet janë adresuar nëpërmjet rekomandimeve;
- Për 134 raste ose 7% e tyre, ka përfunduar hetimi administrativ si shkak i heqjes dorë nga ankuesi;
- Për 112 raste ose 6% e tyre, gjatë hetimit administrativ kanë rezultuar si raste jashtë juridiksionit;
- Për 172 raste ose 9% e tyre, gjatë hetimit administrativ, kanë rezultuar si raste jashtë kompetencës së institucionit të Avokatit të Popullit.

Paraqitja grafike e mënyrave të përfundimit të hetimit të rasteve.

Paraqitja grafike e mënyrave të përfundimit të hetimit të rasteve e shprehur në %.



Paraqitja grafike e numrit të rasteve të zgjidhura në favor pa nevojën e ndërhyrjes me rekomandim në vitet 2020, 2021 dhe 2022.

❋ ❋ ❋

Gjatë vitit 2022, institucioni i Avokatit të Popullit, ka trajtuar me iniciativën e tij nga indicie të tilla si mediat, emisionet investigative, rrjetet sociale, etj. 367 raste të shkeljeve të të drejtave themelore të individit.



Paraqitja grafike e kurbës së ndryshimit të rasteve me iniciativë të trajtuara në vitet 2018–2022.



Paraqitja grafike e rasteve të trajtuara me iniciativë sipas seksioneve të institucionit të AP-së.



Paraqitja grafike e rasteve të trajtuara me iniciativë sipas seksioneve e shprehur në %.



Paraqitja grafike e rasteve të regjistruara për hetim nga institucioni i AP-së sipas shkeljes së të drejtës së pretenduar.



Paraqitja grafike e shpërndarjes së rasteve sipas institucioneve përgjegjës për shkeljet e të drejtave ndaj qytetarëve.

❋ ❋ ❋

Gjatë ushtrimit të mandatit të tij, në vitin 2022, institucioni i Avokatit të Popullit ka adresuar në total 249 rekomandime drejtuar organeve të Administratës Publike, përfshire ato qëndrore dhe vendore ku 184 rekomandime i përkasin rasteve të vitit 2022 dhe 65 rekomandime i përkasin rasteve të mbartura ndër vite.



Paraqitja grafike e kurbës së ndryshimit të numrit të rekomandimeve të adresuar nga institucioni i Avokatit të Popullit ndër vite.



Paraqitja grafike e rekomandimeve të adresuar nga seksionet në vitin 2022.



Paraqitja grafike në përqindje e rekomandimeve të adresuara nga seksionet në vitin 2022.



Paraqitja grafike e rekomandimeve të adresuar ndër vite nga seksionet përkatëse.

Nga 249 rekomandime institucioni i Avokatit të Popullit ka adresuar gjithsej 1312 zëra (nën rekomandime). Krahasuar me vitin 2021 vihet re një rritje me 4% të zërave të adresuar dhe një rritje me 58% krahasuar me vitin 2020.



Paraqitja grafike e numrit të zërave të rekomanduara sipas seksioneve krahasuar dhe vitet 2020, 2021 dhe 2022.



Paraqitja grafike e numri të institucioneve të adresuara dhe të vëna në dijeni sipas seksioneve.



Paraqitja grafike e zbatueshmërisë së zërave të rekomanduara në vitin 2022 sipas seksioneve.

Siç mund të shihet në grafikun e mëposhtëm, nga 1312 zëra të rekomanduara nga institucioni i Avokatit të Popullit gjatë ushtrimit të mandatit të tij në vitin 2022, vetëm 47% e tyre janë zbatuar nga institucionet e rekomanduara, 48% nuk janë zbatuar dhe 5% nuk kanë marre ende një përgjigje.



Paraqitja grafike e % së zbatueshmërisë së zërave të rekomanduara në vitin 2022.



Paraqitja grafike e rekomandimeve të adresuar në vitet 2020, 2021 dhe 2022 sipas gjinisë së ankuesit.

Shpërndarja e rekomandimeve të realizuara nga institucioni i Avokatit të Popullit sipas 17 Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) të miratuara nga miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në vitin 2015[204] paraqitet si më poshtë:



Paraqita grafike e shpërndarjes së rekomandimeve sipas SDG.

[204] Për një informacion më shumë lidhur mbi SDG -> Lexo SDG

❋ ❋ ❋

Gjatë vitit 2022 pranë institucionit të Avokatit të Popullit janë regjistruar gjithsej 34 kërkesa për informacion, sipas ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Të gjitha kërkesat janë pranuar dhe u është kthyer përgjigje sipas objektit, duke u siguruar për kufizimin e të dhënave personale sipas legjislacionit në fuqi. Koha mesatare e kthimit të përgjigjeve të kërkesave për informacion është 6 ditë kalendarike. Nga totali i kërkesave për informacion të regjistruara gjatë vitit 2022, rezulton se 23 prej tyre janë adresuar nga qytetarët , 1 prej tyre nga zyra e avokatisë Tiranë, 6 prej tyre nga organizata të shoqërisë civile dhe 4 nga media. Prej totalit objekt kërkese për kopje dokumentacioni, 4 prej tyre kanë pasur për objekt kërkese për kopje dokumentacioni, 22 prej tyre kërkesë për informacion dhe 8 prej tyre kërkesa për informacion dhe dokumentacion.



Paraqitja grafike e ecurisë së kërkesave për informacion ndër vite.

Aneksi 1 – Popullimi në IEVP

Nr.	IEVP	Data e inspektimit	Kapaciteti zyrtar i Institucionit	Numri i të burgosurve në ditën e inspektimit	Numri i të paraburgosurve	Mbi kapacitet
1	IEVP Tepelenë	11.05.2022	75 persona	113	112	37 persona
2	IEVP Elbasan	13.06.2022	165 persona	155	155	-
3	IEVP Peqin	27.06.2022	685 persona	486	160	-
4	IEVP Durrës	10.11.2022	300 persona	295	233	-
5	IEVP Kukës	29.09.2022	36 persona	36	36	-
6	IEVP Tropojë	19.05.2022	26 persona	20	11	-
7	IEVP 302	23.05.2022	170 persona	175	170	-
8	IEVP Fushë-Krujë	26.05.2022	312 persona	397	328	85
9	Instituti i të Miturve Kavajë	09.12.2021	40 persona	18	17	-
10	IEVP Korçë	07.03.2022	312 persona	441	241	137
11	IEVP Berat	28.01.2022	112 persona	143	109	31
12	IEVP Lushnjë	03.11.2022	185 persona	155	-	-
13	IEVP Fier	09.11.2022	870 persona	823	255	-
14	IEVP Reç	14.09.2022	781 persona	603	228	-
15	IEVP Rrogozhinë	24.02.2022	343 persona	300	-	-
16	IVSHB	07.10.2022	100 persona	63	23	-
17	IEVP 325	03.11.2021	114 persona	78	43	-

18	IEVP Jordan Misja (313)	29.06.2022	500 persona	451	440	-
19	IEVP Burrel	21.09.2022	196 persona	177	84	-
20	IEVP Kukës	29.09.2022	36 persona	36	36	-
21	IEVP Lezhë	17.02.2022	184 persona	341	-	157
22	IEVP Sarandë	01.09.2022	36 persona	43	43	7
23	IEVP Vlorë	12.10.2022	156 persona	164	164	8
TOTAL		**Viti 2022**	**5734 persona**	**5513**	**2888**	**462 mbi kapacitet**

Shënim: Në **7** Institucione të Ekzekutimit të Vendimeve penale ka **462 persona mbi kapacitetin zyrtar të përcaktuar për këto IEVP.**

Nisur nga ky numër të burgosurish mbi kapacitetin zyrtar nevojitet që nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të merren masat për rishpërndarjen e të dënuarve në mënyrë proporcionale duke respektuar standardet minimale të hapësirës dhe duke shfrytëzuar kapacitetet e institucioneve, për të shmangur mbipopullimin e krijuar veçanërisht në sektorët e Paraburgimit.

Shtretër të lirë në I.E.V.P. **- 221**.